

EFEKTET E TATIMIT NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË NJË VENDI. STRATEGJI APO THJESH PARIME?

Teuta Balliu

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Ekonomike, me profilin financë, për marrjen e gradës shkencore

“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. As. Dr. Arbi Agalliu

Numri i fjalëve: 52 002

Tiranë, Dhjetor 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Copyright ©

Teuta Balliu

2015

ABSTRAKTI

Një pjesë e rëndësishme e problemeve ekonomike në Shqipëri lidhen me keqmenaxhimin e financave publike dhe disiplinën e varfër fiskale, e cila më së shumti varet nga të qenit ose jo në vit elektoral. Në vendet në zhvillim, sikurse edhe në Shqipëri vihet re mungesa e harmonisë midis politikave fiskale dhe nevojave reale të ekonomisë. Nën këtë këndvështrim tatimet dhe taksat nuk duhen përdorur si instrumente për të përmbushur nevoja afatshkurtra, si ajo për më shumë të ardhura publike, por ato kërkojnë strategji, pasi rritja e tyre mund të dëmtojë rritjen ekonomike të vendit.

Qëllimi i këtij punimi lind pikërisht nga rëndësia gjithnjë e më e madhe që i kushtohet rolit të shtetit dhe lidhet me evidentimin e efekteve të sistemit tatimor mbi produktin e brendshëm bruto, si një prej treguesve të rritjes ekonomike. Ky punim synon të vlerësojë dhe analizojë efektet e tatimit direkt dhe indirekt mbi rritjen ekonomike në Shqipëri. Problemi i kërkimit është pikërisht vlerësimi i efekteve makroekonomike të tatimit. Pyetja kryesore mbi të cilën fokusohet ky studim është; Cilat janë efektet makroekonomike të tatimit si një prej tre elementëve të politikës fiskale?

Si çdo punë tjetër kërkimore edhe ky studim nis me bazën teorike e cila trajton gjerësisht dy traditat kryesore të mendimit intelektual, teoritë e rritjes ekonomike, financat publike, politikën fiskale dhe sistemet tatimore. Rishikimi i literaturës ka për qëllim të nxjerrë në pah se pse është i nevojshëm ky punim shkencor dhe për këtë është trajtuar si literatura teorike edhe ajo empirike. Është përdorur metodologjia krahasuese, metodologjia interpretuese, analitike dhe empirike. Paradigmat dhe konceptet teorike të autorëve dhe

shkencëtarëve të huaj, jo vetëm që kanë ndikuar mbi këtë hulumtim, por duke qenë se ato konsiderohen si trashëgimi e përbashkët shkencore janë fillesa e këtij studimi. Janë shfrytëzuar literatura klasike dhe ajo e kohëve të fundit si edhe revista shkencore ndërkombëtare.

ABSTRACT

An important part of the Albanian economic problems are related to the mismanagement of public finances and poor fiscal discipline, which mostly depends on the fact if it is an electoral year. In developing countries such as Albania, it is noticed a lack of harmony between fiscal policies and the real needs of the economy. Under this perspective taxes and fees should not be used as instruments for meeting short-term needs, such as having higher public revenues, but they require strategies since their rise could damage the country's economic growth.

The purpose of this paper stems from the ever-increasing importance dedicated to the role of state and is related to the identification of the effects of tax applied in Albania to the gross domestic product, as one of the indicators of economic growth. This paper aims to evaluate and analyze the effects of direct and indirect taxation. The research's problem is the assessment of the macroeconomic effects of tax on the economic growth. The main question of this study is: Which are the macroeconomic effects of tax as one of the elements of the fiscal policy?

The same as every other research paper, this study begins with the theoretical basis which broadly deals with two major intellectual traditions, the theories of economic growth, the public finances, the fiscal policy and the tax systems. The review of the literature aims to highlight the reason why this study is necessary. For this purpose, we have made a classification of the theoretical and empirical literature. We have used the comparative methodology, the interpretative one and the analytical as well as the empirical one. The paradigms and the theoretical concepts of foreign authors and scientists have not only

affected this research, but they are its starting point as they are considered common scientific heritage. Classical literature as well as recent international scientific journals has been used in this research.

FALENDERIME

Punimin doktoral e kam konsideruar gjithnjë një sfidë, porë kjo jo vetëm nga këndvështrimi i arritjes së suksesit në rrugën drejt ngritjes akademike, por edhe nga ai i një investimi të rëndësishëm për të ardhmen. Përfundimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen, inkurajimin dhe përkrahjen e familjes, miqve dhe kolegëve të mi të cilët dëshiroj ti falenderoj përzemërsisht.

Mirënjohja ime e sinqertë shkon për udhëheqësin tim shkencor Prof. As. Dr Arbi Agalliu. Ndihma dhe mbështetja e të cilit përforcuan tek unë konturet e integritetit akademik, profesionalizmit, drejtimit shkencor dhe modelit të një kandidati për një titull shkencor. Falenderime të veçanta për miken, kolegen dhe specialisten e ekonometrisë Xhensila Abazi, e cila nuk u lodh së diskutuari me mua në këtë rrugëtim të vështirë dhe më mbështeti në analizimin e modelit ekonometrik, rezultatet e të cilit janë aq të vyera për një punim shkencor.

Dua gjithashtu të falenderoj Universitetin European të Tiranës për mundësitë e krijuara dhe për organizimin e veçantë të ndjekjes dhe mbështetjes në çdo hap të punimit shkencor. Mbështetja e konsulentëve të shkëlqyer akademikë dhe burimet preferenciale bashkëkohore më kanë ndihmuar të rris potencialin tim shkencor, nxitur dhe inkurajuar të eci përpara dhe të përfundoj punimin tim doktoral. Dhe në fund dua të falenderoj familjen time e cila më ka frymëzuar të besoj në edukimin e vazhdueshëm, si një nga resurset më të mëdha që e shtyn njeriun të përparojë në shoqëri. Faleminderit Luis dhe Jamarb, ju jeni burimi i inspirimit tim për të studiuar, për të përballuar çdo sfidë dhe për të qenë ajo që dua të jem në udhët e mundimshme të jetës si nënë, si grua dhe si profesioniste.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

LISTA E TABELAVE.....	ix
LISTA E GRAFIKËVE	xi
LISTA E SHKURTIMEVE	xiii
KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1 Parathënie	1
1.2 Fokusi	3
1.3 Qëllimi	4
1.4 Objektivat	6
1.5 Metodologjia.....	7
1.6 Pyetja kërkimore dhe hipoteza	9
KAPITULLI II : RISHIKIM I LITERATURËS	11
2.1 Shkollat e mendimit ekonomik dhe teoritë e rritjes.....	11
2.2 Vështrim mbi revistat shkencore	42
2.3 Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike	48
2.4 Ideologjia e financave publike dhe linjat e funksioneve të shtetit.....	53
2.5 Klima e biznesit dhe e investimeve	55
2.6 Ndikimi i shtetit dhe rritja ekonomike.....	60
2.7 Politika fiskale	66
2.8 Sistemet tatimore dhe klasifikimi i tyre.....	72
2.9 Struktura e tatimeve, parimet dhe karakteristikat e saj.....	74
KAPITULLI III: SISTEMI TATIMOR NË SHQIPËRI	81
3.1 Politika fiskale përballë ekonomisë informale dhe evazionit fiskal	81
3.2 Sistemi tatimor në Shqipëri para viteve 1990.....	94
3.3 Reformat e pas viteve 1990 në sistemin tatimor në Shqipëri	96
3.4 Analiza e strukturës tatimore në Shqipëri për periudhën 1993-2014	105
3.5 Analiza e shpenzimeve publike përgjatë viteve 1993-2014	117
3.6 Deficiti buxhetor dhe ecuria e borxhit publik ndër vite.....	122
3.7 Të përbashkëtat dhe ndryshimet e sistemeve tatimore në vendet e Ballkanit Perëndimor. Analizë krahasuese	124

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT	139
4.1 Projektimi i kërkimit.....	139
4.2 Të dhënat	144
4.3 Kufizimet e metodologjisë.....	145
KAPITULLI V: ANALIZA EMPIRIKE DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE	147
5.1 Efektet e tatimit direkt dhe atij indirekt ndaj PBB-së.....	147
5.2 Ndikimi i zërave të veçantë të tatimit direkt dhe indirekt mbi PBB.....	155
5.3 Politika fiskale dhe ndikimi i elementëve të saj mbi PBB-në	157
5.4 Politika fiskale dhe faktorë të tjerë agregat	159
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE	163
6.1 Konkluzione dhe rekomandime.....	163
6.2 Hapësira për kërkime të tjera.....	173
BIBLIOGRAFIA	176
SHTOJCA.....	185

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Përmbledhje e gjetjeve të studimeve empirike mbi ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike.....	45
Tabela 2T: Norma e rritjes së PBB-së (në %)......	128
Tabela 3: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (1).....	153
Tabela 4: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (2).....	155
Tabela 5: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (4).....	158
Tabela 6: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (5).....	161
Tabela 7: Normat e tatimeve mbi të ardhurat personale për vendet e Ballkanit Perëndimor	185
Tabela 8: Korrelacioni i shumëfishtë i variablave (multikolineariteti).....	187
Tabela 9: Multikolineariteti për variablat e funksionit (1).....	188
Tabela 10: Testimi i formës funksionale për modelin (1).....	189
Tabela 11: Impakti dhe rëndësia e çdo variabëli të funksionit (1) mbi PBB-në.....	189
Tabela 12: Impakti i tatimeve direkte mbi PBB-në	189
Tabela 13: Testi për modelin ekonometrik	190
Tabela 14: Analiza e variancës së modelit ekonometrik	190
Tabela 15: Vlerësimi i koeficientëve	191
Tabela 16: Rezultatet e testeve të normalitetit	192
Tabela 17: Rivlerësimi i modelit ekonometrik	193
Tabela 18: Rezultatet e testit të heteroskedasticitetit	194
Tabela 19: Vlerësimi i modelit të ndikimit të zërave të veçantë të tatimit direkt	195
Tabela 20: Testet e modelit të katërt ekonometrik.....	197

Tabela 21: Testet e analizës faktoriale.....	199
Tabela 22: Testi i korrelacionit për variablat e modelit të pestë ekonometrik.....	200
Tabela 23: Testet e modelit të pestë ekonometrik	201

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Të ardhurat gjithsej për periudhën 1993-2014	106
Grafiku 2: Ecuria e tatimit direkt dhe tatimit indirekt (në milion Lekë)	106
Grafiku 3: Ecuria e tatimit direkt dhe indirekt (në milion Lekë) si edhe ritmi i rritjes së tyre (në %).....	107
Grafiku 4: Pësia e tatimit direkt dhe indirekt në totalin e të ardhurave (në milion Lekë)	108
Grafiku 5: Të ardhurat tatimore për periudhën 1993-1998 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %).....	108
Grafiku 6: Të ardhurat tatimore për periudhën 1999-2008 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %).....	110
Grafiku 7: Norma e rritjes së PBB-së ndër vite (në %)	111
Grafiku 8: Raporti i të ardhurave tatimore me PBB-në për periudhën 1999-2008.....	111
Grafiku 9: Zërat kryesorë të të ardhurave për periudhën 1999-2008 (në milion Lekë).....	112
Grafiku 10: Ecuria e të ardhurave më të rëndësishme për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë)	114
Grafiku 11: Ecuria e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %)	115
Grafiku 12: Ecuria e tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi të ardhurat personale për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre.....	116
Grafiku 13: Të ardhurat tatimore në raport me PBB-në për periudhën 2009-2014.....	116
Grafiku 14: Normat e rritjes së PBB-së dhe të të ardhurave tatimore për periudhën 2009-2014.....	116

Grafiku 15: Ecuria e shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale në përqindje të PBB-së	117
Grafiku 16: Ecuria e shpenzimeve korrente dhe ritmi i rritjes së tyre	118
Grafiku 17: Ecuria e shpenzimeve kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre.....	119
Grafiku 18: Shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale ndaj totalit të shpenzimeve publike.....	119
Grafiku 19: Deficiti buxhetor dhe norma e rritjes së tij përgjatë viteve 1993-2014.....	122
Grafiku 20: Deficiti buxhetor i shprehur në % të PBB-së	123
Grafiku 21: Ecuria e borxhit publik (në milion lekë) dhe norma e rritjes së tij (në %).....	123
Grafiku 22: Borxhi publik në përqindje të PBB-së dhe norma e rritjes së këtij raporti për periudhën 1993-2014	124
Grafiku 23: Tatimi mbi kompanitë rezidente në vendet e Ballkanit Perëndimor	133
Grafiku 24: Normat e T.V.SH-së në vendet e Ballkanit Perëndimor	135
Grafiku 25: Investimet e huaja direkte në vendet e Ballkanit Perëndimor	136
Grafiku 26: Shpenzimet buxhetore në përqindje të PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor	137
Grafiku 27: Të ardhurat buxhetore në përqindje të PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor	137
Grafiku 28: Testi i stacionaritetit për tatimet indirekte Grafiku 29: Testi i stacionaritetit për llojin e taksës	186
Grafiku 30: Testet e stacionaritetit për variablat e pavarur për modelet e tjera ekonometrike	196

LISTA E SHKURTIMEVE

BE - Bashkimit Evropian

BB - Banka Botërore

FKBF – Formimi i kapitalit fiks bruto

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

IHD - Investime të huaja direkte

KE - Komisioni Evropian

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PBB - Produkti i përgjithshëm bruto

PF - Politika fiskale

TBO - Teprica bruto operative

TD - Tatimet direkte

TI – Tatimet indirekte

TVSH - Tatimi mbi vlerën e shtuar

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Parathënie

Në ditët e sotme gjithnjë e më shumë po vihet re një rimëkëmbje e moderuar dhe e pabarabartë në ekonomitë e avancuara, ekonomi këto të mbështetura vazhdimisht nga politikat monetare, por me rregullime të ngadalshme fiskale. Megjithatë nivelet e larta të borxhit publik dhe privat vazhdojnë të krijojnë probleme për rritjen e qëndrueshme në disa prej ekonomive të zhvilluara. Rritja në ekonomitë e vendeve në zhvillim është ende në nivele të ulëta dhe luhatja financiare dhe e kurseve të këmbimit, ka rritur kostot e financimit. Politikat e qëndrueshme makroekonomike janë një pjesë vendimtare e kuadrit të politikave nxitëse, duke ulur rrezikun e të bërit biznes dhe duke garantuar një klimë përgjithësisht të parashikueshme, si për biznesin, ashtu edhe për investimet. Stabiliteti makroekonomik konsiderohet si parakusht për rritjen ekonomike. Vështirë të jepet një formulë politikash për krijimin e një mjedisi të fuqishëm makroekonomik dhe stimulimin e rritjes ekonomike, e cila do të rezultonte e suksesshme në ekonominë e cilitdo vendi. Në sistemin ekonomik mund të ndërhyhet nëpërmjet dy politikave të mëdha. Politika monetare e drejtuar nga Banka Qendrore, që kontrollon variacionet e stokut të parasë, normave të interesit dhe normave të zbritjeve, sipas së cilave ajo u jep hua bankave të nivelit të dytë, si dhe formave të tjera të sistemit bankar. Politika e dytë është ajo fiskale, e cila kontrollon normat fiskale, të ardhurat publike dhe shpenzimet. Një nga karakteristikat kryesore të politikës ekonomike është se efektet e politikës monetare dhe fiskale mbi sistemin ekonomik nuk janë plotësisht të parashikueshme, si në kohën ashtu edhe në masën me të cilat afektojnë kërkesën dhe ofertën. Në këtë mjedis sfidues për të gjitha ekonomitë,

politika fiskale vazhdon të luajë një rol thelbësor në ndërtimin e besimit dhe në mbështetjen e kërkesës agregate. Diskutimi rreth ndikimit të politikave fiskale në përbërjen dhe rregullimin e nivelit të të ardhurave, shpenzimeve dhe borxhit publik me qëllim arritjen në kohë të një tolerance të caktuar, konsiderohet si një nga diskutimet më të gjera në lëmin e financave publike. Në vendet në zhvillim ai përfshin çështje thelbësore të politikës, si madhësia e duhur e shtetit, roli i qeverisë në përsheptimin e rritjes ekonomike, në zhvillimin social dhe shpërndarjen e përfitimeve, në përmirësimin e punësimit dhe mirëqenies sociale. E gjitha kjo arrihet duke ulur pabarazinë në të ardhura, duke sjellë mirëqenie për gjeneratën aktuale dhe atë të së ardhmes, gjithashtu duke siguruar efikasitet në shpërndarjen optimale të burimeve. Midis instrumenteve të politikës fiskale, ndryshimi i normës tatimore ka efekte të ndryshme, bazuar kjo në modelet neoklasike dhe ato endogjene të rritjes ekonomike. Ndërsa pjesa më e madhe e modeleve ekzogjene parashikojnë se ndryshimet e vazhdueshme në politikat qeveritare nuk kanë efekt të qëndrueshëm në normën e rritjes së prodhimit për frymë, modelet neoklasike tregojnë se ndryshimet në strukturën e tatimeve të një shteti nuk ndikojnë në normën e rritjes ekonomike për një afat të gjatë kohor. Këto ndryshime bëjnë të mundur që aktiviteti ekonomik i një shteti të ecë drejt një niveli më të lartë, ose më të ulët, por rruga e re e rritjes afatgjatë ekonomike, konvergon me rrugën, apo drejtimin e mëparshëm. Modelet të cilat jo vetëm që lejojnë rritjen e qëndrueshme, por edhe shpjegojnë burimet e saj janë modelet endogjene. Teoria e rritjes endogjene synon ta bëjë endogjene normën e rritjes sipas vetë këtij përcaktimi teorik. Propozuesit e kësaj teorie mbështesin idenë se përgjithësisht politikat qeveritare dhe sjellja ekonomike duhet të jenë të afta të ndikojnë normën e rritjes në një periudhë kohore afatgjatë.

Instrumentet tatimorë bashkëveprojnë me një tok faktorësh politiko-ekonomikë, të cilët sjellin rritjen ekonomike. Rishikimi i modeleve tregon efektet që politikat mund të kenë, por nuk përcakton vlerësimin e peshës dhe rëndësisë që ato kanë në realitet. Që të përftohet ky vlerësim nevojitet të merren në konsideratë gjetjet e kërkimeve sasiore. Arritja e një analize politike bindëse është e pamundur pa kërkimet sasiore. Këto kërkime mund të konsistojnë në analiza eksperimentale, ose në përpunimin e të dhënave empirike. Ky studim synon të përcaktojë një pasqyrë të asaj çfarë ka përfaqësuar e vazhdon të përfaqësojë sektori publik dhe politika fiskale në Shqipëri dhe si kanë ndikuar ato në zhvillimin dhe rritjen ekonomike.

Jo vetëm teoritë, por edhe të dhënat empirike tregojnë se sa të rëndësishme janë tatimet në rritjen e ekonomisë së një vendi. Ajo që gjerësisht pranohet është fakti se kombinimi efektiv i teorisë me praktikën do të jenë dhe për shumë kohë një nxitje reale për gjetjen e instrumenteve të zbatueshëm në ekonominë e çdo vendi si dhe një burim i mendimit shkencor.

1.2 Fokusi

Në fokus të këtij punimi është analizimi i ndikimit të sektorit publik në zhvillimin ekonomik dhe më konkretisht në rritjen ekonomike. Ky impakt është studiuar në aspektin fiskal. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi varet nga faktorë të ndryshëm si historia, kultura, shtrirja gjeografike, marrëdhëniet tregtare me fqinjët dhe më gjerë, reformat në fusha të ndryshme, zhvillimi i sektorit privat etj. Në kushtet e këtij mjedisi kompleks dhe dinamik, me anë të këtij punimi do të përpiqemi të fokusohemi në rëndësinë e stabilitetit makroekonomik dhe rritjes ekonomike, të cilat konsiderohen thelbësore për nxitjen e zhvillimit të një vendi.

Ndërhyrja e shtetit në ekonomi është gjithashtu pjesë e fokusit të këtij punimi. Hulumtimi i literaturës së fushës së financës publike do të hedhë dritë mbi faktin se, për ndërhyrjen e shtetit në ekonomi nuk ka një përcaktim të vetëm dhe të saktë. Me anë të këtij punimi do të tregojmë se klima e favorshme e biznesit është thelbësore për zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Një mjedis i dobët biznesi i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë pengon zhvillimin ekonomik, e kundërta ndodh nëse shtetet miratojnë politika pro-zhvillim dhe ligje e praktika të cilat mbështesin investimet dhe zhvillimin e biznesit.

Me dëshirën për të arritur qëllimin e tij, ky punim ofron një panoramë të teorive të rritjes ekonomike dhe disa prej studimeve empirike të realizuara ndër vite nga autorë të ndryshëm, kryesisht të huaj. Pas analizës së sistemit tatimor në Shqipëri për periudhën 1993-2014, të reformave kryesore dhe të ecurisë së të ardhurave tatimore dhe shpenzimeve publike do të realizojmë edhe një analizë krahasuese mbi sistemet tatimore të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ndikimi i politikës fiskale në zhvillimin ekonomik do të analizohet duke u fokusuar tek studimi empirik i ndikimit të tatimit direkt dhe indirekt mbi rritjen ekonomike, si një prej ndarjeve të të ardhurave tatimore. Në mbështetje të ndikimit të tyre mbi rritjen ekonomike do të studiojmë ndikimin e një pjese të faktorëve të prodhimit së bashku me politikën fiskale në produktin e përgjithshëm bruto për frymë në Shqipëri.

1.3 Qëllimi

Një hap shumë i rëndësishëm për ta çuar vendin përpara drejt rrugës së zhvillimit konsiderohet ato politika, të cilat më shumë nxisin konkurrencën mes aktorëve privatë, se

sa e venë qeverinë në rolin e drejtuesit imponues të ekonomisë. Nevoja e përfshirjes së ndikimit të aktiviteteve të shtetit në rritjen ekonomike u trajtua fillimisht në vitin 1939 nga Harrod. Ai evidentoi disa mënyra se si ky burim i ndryshimit të kërkesës agregate mund të ndikojë në rrugën e rritjes ekonomike drejt ekuilibrit të ekonomisë. Sipas tij politikat qeveritare përdoren, si për të stabilizuar ekonominë, ashtu edhe për të arritur një rritje ekonomike më të lartë. Paketat fiskale sjellin ndryshime në sjelljen e individëve, shoqërive dhe të tregut në tërësi. Ndryshimet në sjelljen e tregut kanë ndikimin e tyre në mjedisin ku një shoqëri operon.

Qëllimi i këtij punimi lind pikërisht nga rëndësia gjithnjë e më e madhe që i kushtohet rolit të shtetit dhe lidhet me evidentimin e efekteve të tatimit mbi produktin e brendshëm bruto, si një prej treguesve më domethënës të rritjes ekonomike.

Synimi ynë është përcaktimi i faktorëve që ndikojnë rritjen ekonomike, ndikime këto të cilat duhet të jenë në vëmendje të aktorëve politikë sa herë që këtyre të fundit i duhet të hartojnë dhe miratojnë paketa fiskale. Do të përpiqemi të nxjerrim në pah disa të dhëna sasiore për sa i përket rëndësisë makroekonomike të tatimeve.

Ky punim synon të vlerësojë dhe analizojë efektet e tatimit direkt dhe indirekt. Në grupin e tatimeve direkte, ashtu sikurse edhe tek tatimet indirekte, bëjnë pjesë disa tatime të cilat në totalin e të ardhurave tatimore kanë pesha specifike të ndryshme. Nisur nga ky fakt pas studimit të ndikimeve të tatimeve direkte dhe indirekte do të kalojmë në studimin e ndikimit të zërave të veçantë tatimorë. Studimi do të analizojë gjithashtu dhe ndikimin që politika fiskale, elementë të së cilës janë edhe të ardhurat tatimore, si një prej faktorëve

agregat, ka mbi rritjen ekonomike duke dashur kështu të përmbushim përfundimisht edhe qëllimin e këtij punimi.

1.4 Objektivat

Objektivi kryesor i këtij punimi është të vërtetojë nëse nëpërmjet përdorimit të këtij modeli evidentohen ndikimet negative dhe pozitive të elementëve të politikës fiskale, të cilët për sa i përket nivelit dhe natyrës së tyre mund të jenë pengesë ose stimul i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të një vendi.

Ndikimi i politikës fiskale për vende të ndryshme është i ndryshëm. Analiza krahasuese e paketave fiskale aktuale do të fokusohet në vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi këto vende në rrugëtimin e tyre drejt zhvillimit, karakterizohen nga problematika të përbashkëta, ndër të cilat përmendim keqmenaxhimin e financave publike dhe disiplinën e varfër fiskale. Në këto vende vihet re mungesa e harmonisë midis politikave ekonomike e fiskale dhe nevojave reale të ekonomisë.

Për të realizuar qëllimin e këtij punimi janë ngritur edhe disa nën-objektiva. Kështu nëpërmjet tij synojmë:

- Të realizojmë një studim empirik mbi efektet e tatimeve mbi të ardhurat personale dhe atyre të kompanive dhe tatimit mbi konsumin në rritjen ekonomike.
- Të analizojmë dhe të tregojmë rëndësinë e stabilitetit ekonomik, mjedisit të biznesit, qeverisjes së mirë dhe politikave qeveritare në kuadër të përmirësimit të klimës së biznesit.

- Të analizojmë teoritë e ndikimit të shtetit në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi, duke u ndalur më gjerë në teorinë endogjene dhe ndikimin e disa prej tatimeve kryesore në rritjen ekonomike.
- Të analizojmë politikën fiskale, elementët, objektivat, parimet dhe rëndësinë e saj.
- Të trajtojmë teorikisht politikën fiskale përballë ekonomisë informale dhe evazionit fiskal.
- Të studiojmë politikën e të ardhurave buxhetore duke evidentuar zhvillimet, problematikat dhe sfidat e politikës fiskale në kuadër të konsolidimit fiskal.
- Të realizojmë një analizë krahasuese të sistemeve tatimore të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

1.5 Metodologjia

Studimet mbi faktorët ndikues të progresit human kanë si qëllim të zhvillojnë një metodologji pragmatike për vlerësimin e efekteve të një aktiviteti apo politike të caktuar, të zbatojnë një metodë e cila analizon dhe vlerëson nivelin e efekteve në mënyrë të tillë që të rrisin vlerësimin e rezultateve të programit dhe të japin sugjerime për të ardhmen.

Si çdo punë tjetër kërkimore edhe ky studim nis me bazën teorike e cila trajton gjerësisht dy traditat kryesore të mendimit intelektual, teoritë e rritjes ekonomike, financat publike, politikën fiskale dhe sistemet tatimore. Rishikimi i literaturës teorike dhe empirike ka për qëllim të nxjerrë në pah se pse është i nevojshëm ky punim shkencor. Gjithashtu është përdorur metodologjia krahasuese, metodologjia interpretuese, analitike dhe empirike. Paradigmat dhe konceptet teorike të autorëve dhe shkencëtarëve të huaj, jo vetëm që kanë

ndikuar mbi këtë hulumtim, por duke qenë se ato konsiderohen si trashëgimi e përbashkët shkencore janë edhe fillesa e këtij studimi. Për realizimin e tij është shfrytëzuar literatura klasike dhe ajo e kohëve të fundit, si dhe revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare.

Në këtë punim janë përdorur një sërë instrumentesh kërkimorë. Si fillim, është përdorur përshkrimi apo metoda narrative për të dhënë informacion teorik. Ajo kombinohet me instrumente krahasues, në mënyrë që konkluzionet e nxjerra të jenë sa më të sakta. Më pas, kalohet në analizë shifrash dhe faktesh për të dhënë një tablo më të qartë të situatës aktuale të sistemit fiskal shqiptar. Metodologjia e përdorur bazohet në alternimin e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë siguruar nga institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Banka Botërore. Ky informacion primar më pas është përdorur për realizimin e modelit ekonometrik, model ky i cili shërben për të vërtetuar hipotezat e studimit. Informacionin sekondar është siguruar nga literatura të ndryshme, për të cilat është hulumtuar në bibliotekat elektronike të universiteteve të ndryshme perëndimore, në bibliotekën e Universitetit European të Tiranës dhe në bibliotekën online të Oxfordit të ofruar nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Punimet akademike si kërkimet shkencore, punime konferencash apo dhe leksione mbi fushën kërkimore, kanë plotësuar kuadrin e burimeve sekondare.

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar nëpërmjet programit statistikor SPSS. Metodologjia e përdorur në këtë punim ka si objektiv të tregojë se rritja e tatimeve direkte ndikon negativisht në rritjen ekonomike të një vendi, ndërsa tatimet indirekte jo. Ajo do të

ndihmojë gjithashtu në analizimin e efekteve të llojeve të ndryshme të tatimeve si dhe të politikës fiskale në tërësi, efekte këto të cilat duhet të merren parasysh kur hartohen dhe miratohen paketa fiskale.

1.6 Pyetja kërkimore dhe hipoteza

Problemi i kërkimit është vlerësimi i efekteve makroekonomike të tatimit. Pyetja kryesore mbi të cilën fokusohet ky studim është; Cilat janë efektet makro ekonomike të tatimit? Nën pyetje të tjera lidhur me këtë temë janë:

- Cili është roli i shtetit në ekonominë në zhvillim?
- Sa i rëndësishëm është stabiliteti dhe mjedisi i të bërit biznes në një vend?
- Si ndikojnë paketat fiskale në zhvillimin ekonomik të një vendi?
- A ndikon pozitivisht rritja e tatimit direkt në rritjen ekonomike të një vendi?
- Cili është korrelacioni midis tatimit indirekt dhe rritjes ekonomike të një vendi?
- Cilat janë efektet e tatimit të fitimit të kompanive, të biznesit të vogël, të ardhurave personale, sigurimeve shoqërore, apo pasurive në rritjen ekonomike të një vendi?
- Si ndikon tatimit mbi vlerën e shtuar, taksave doganore dhe akcizës mbi rritjen ekonomike?

Pasi të bëhet analiza e të ardhurave tatimore për periudhën 1993-2014 do t'i japim përgjigje **hipotezës kryesore** sipas së cilës:

“Një pjesë e rëndësishme e problemeve ekonomike në Shqipëri lidhen me keqmenaxhimin e financave publike dhe disiplinën e varfër fiskale, e cila më së shumti varet nga të qenit ose jo në vit elektoral. Në vendet në zhvillim, sikurse edhe në Shqipëri vihet re mungesa e

harmonisë midis politikave fiskale dhe nevojave reale të ekonomisë. Nën këtë këndvështrim tatimet dhe taksat nuk duhen përdorur si instrumente për të përmbushur nevoja afatshkurtra, si ajo për më shumë të ardhura publike, por ato kërkojnë strategji, pasi rritja e tyre mund të dëmtojë rritjen ekonomike të vendit”.

Hipotezat e ngritura për këtë punim janë:

H1: Produkti i përgjithshëm bruto varet nga të ardhurat tatimore.

H0: Nuk ekziston asnjë lidhje midis produktit të brendshëm bruto dhe të ardhurave tatimore

Janë ngritur edhe dy nën hipoteza të cilat i përkasin ndarjes së të ardhurave tatimore në të ardhura direkte dhe indirekte. Në secilin prej dy grupeve të mësipërme të tatimeve bëjnë pjesë kategori të ndryshme tatimesh, efektet e të cilave do të studiohen një e nga një.

H1': Rritja e tatimit direkt ka ndikim negativ mbi produktin e brendshëm bruto.

H1'': Rritja e tatimeve indirekte ndikon pozitivisht mbi produktin e brendshëm bruto

KAPITULLI II : RISHIKIM I LITERATURËS

2.1 Shkollat e mendimit ekonomik dhe teoritë e rritjes

Në shkencën e makroekonomisë gjenden dy tradita kryesore intelektuale. Njëra prej tyre beson se tregjet funksionojnë më mirë në qoftë se nuk ndërhyjnë në to, ndërsa tjetra beson se ndërhyrja shtetërore mund të përmirësojë dukshëm veprimtarinë e ekonomisë (Rudiger Dornbusch; Stanley Fischer, 2000, f. 23). Shkolla klasike, e cila është edhe shkolla e parë e mendimit ekonomik, lidhet me ekonomistin skocez Adam Smith dhe ekonomistët britanikë si Robert Malthus dhe David Ricardo. Ideja kryesore e shkollës klasike është vetë rregullimi i tregjeve. Ata besojnë se efienca e tregut sjell zhvillim ekonomik. Mekanizmat e çmimeve sillen si “një dorë e padukshme” në treg. Në terma makroekonomikë, ekonomistët klasikë mbështesin idenë se nëpërmjet një mekanizmi automatik vetërregullues ekonomia gjithmonë kthehet në ekuilibër. Sipas shkollës klasike, politika fiskale e duhur është ajo nëpërmjet së cilës shteti krijon mjedisin ekonomik në të cilin prona private mbrohet më së miri dhe sipërmarrjet private kanë nxitësit e duhur për më shumë prodhim dhe novacion. Shpenzimet publike duhet të kufizohen në shpenzime për mbrojtje, sistemin ligjor, infrastrukturë, edukim, transport dhe një sistem administrativ të vogël dhe eficient. Tatimet duhet të jenë relativisht të ulëta dhe rregullat mbi to të jenë minimale.

Shkolla neoklasike e mendimit ekonomik është njëkohësisht edhe baza e zhvillimit të teorive moderne të ekonomisë. Modelet e kësaj shkolle janë modele shkencore, me supozime dhe hipoteza dhe përpjekje për të derivuar nga parimet dhe rregullat e përgjithshme për sjelljen e bizneseve dhe konsumatorëve. Klasikët e rinj dhe shkolla e tyre synon të shpjegojë problemet

dhe çështjet makroekonomike duke përdorur koncepte mikroekonomike si sjellja dhe pritjet racionale. Ekonomistët e rinj klasik janë ata të cilët iu bashkuan punës së Robert Lucas.

Lidhur me ekonomiksin Kejnesian mund të themi se ai ndjek idenë kryesore të ekonomistit britanik John Maynard Keynes. Kejnesi shihet si ekonomisti më i rëndësishëm i shekullit të XX. Kejnesianët janë skeptikë për faktin nëse një treg i lirë në lëviz drejt ekuilibrit të punësimit të plotë. Metoda e tyre është ajo e ndërhyrjes, e cila vjen nga besimi se vetë-interesimi i cili drejton sjelljen në nivelin mikroekonomik, jo gjithmonë të çon drejt zhvillimit makroekonomik afatgjatë apo stabilitetit ekonomik në një afat të shkurtër kohor. Kejnesi besonte se politika fiskale ishte më efektive. Sipas tij kur ekonomia është në rënie qeveria fillimisht duhet të rrisë shpenzimet publike. Ai gjithashtu thekson se për të stimuluar ekonominë shteti duhet të ulë tatimet, por gjithsesi ai preferonte rritjen e shpenzimeve, pasi shteti i shpenzon të gjitha paratë e tij, ndërsa qytetarët një pjesë të kursimeve që përfitojnë nga ulja e tatimeve mund ti kursejnë. Ndërsa në periudha inflacioni të lartë, sipas tij, shteti duhet të ulë shpenzimet dhe/ose të rrisë tatimet.

Ndonëse çështjet e rritjes ekonomike ishin shqetësimi i ekonomistëve klasikë, përgjatë viteve 1870-1945 pjesa më e madhe e kërkimeve të tyre ishin në nivel mikroekonomik. Pas vitit 1945 gjenden tre rryma interesi në teoritë e rritjes. Qëllimi i teorisë së rritjes është të shpjegojë përcaktuesit e normave të rritjes në një shtet dhe arsyet e ndryshimeve në normat e rritjes dhe në të ardhurat për frymë midis shteteve të ndryshme. Rryma e parë fokusohet në punën e Neo-Kejnesianëve si Harrod (1939 dhe 1948) dhe Domar (1947). Në mes të viteve 1950 u zhvillua modeli neoklasik i rritjes, i njohur si modeli Solow-Swan. Nëse kërkimet në periudhën e parë krijuan teorinë neoklasike të rritjes, kërkimet e mëvonshme njihen si teoria e rritjes endogjene. Ekonomistët klasikë si Adam Smith (1776), David Ricardo (1817) dhe Thomas Maltus (1798) dhe shumë më vonë Frank Ramsey (1928), Allyn Young (1928), Frank Knight (1944) dhe Josef

Schumpeter (1934) sollën elementët kryesorë të cilët gjenden edhe në teoritë moderne të rritjes ekonomike. Këto ide përfshijnë metodat bazë të sjelljes së konkurrencës dhe dinamikës së ekuilibrit, rolin e rënies së normave të kthimit dhe lidhjen e saj me akumulimin e kapitalit fizik dhe njerëzor, lidhjen midis të ardhurave për frymë dhe normës së rritjes së popullsisë, efektet e zhvillimeve teknologjike në format e rritjes së specializimit të punës dhe zbulimit të produkteve të reja dhe metodave të reja të prodhimit dhe rolit të fuqisë së monopoleve si nxitëse e zhvillimeve teknologjike. Rryma e tretë nisi me kërkimet e Paul Romer dhe Robert Lucas të cilët ndërtuan modelin endogjen të rritjes, i cili u zhvillua në përgjigje të përcaktimeve teorike dhe empirike të modelit neoklasik. Në librin e tij “Shteti apo Tregu. Cilin model zhvillimi të ndjekim?” Ardian Civici thekson se gjatë kësaj periudhe 22 vjeçare tranzicioni, debatet, alternativat ose thjesht pozicionet e politikës, ekspertëve të ekonomisë etj, kanë tentuar vazhdimisht të profilizohen hapur në pozicione liberale absolutisht në favor të tregut, ose në pozicione më ndërhyrëse në favor të një prezence më të madhe të shtetit në ekonomi. Për të njëjtat shqetësime dhe objektiva zakonisht të djathtët shprehen se; tregu i lirë dhe liria ekonomike...pasi shteti dhe sektori publik është pengesa kryesore e zhvillimit....shteti duhet ta ndihmojë zhvillimin si arbitër dhe jo si lojtar, ndërsa të majtët kundërshtojnë duke thënë se; shteti dhe sektori publik si aktorët apo lojtarët më të rëndësishëm, pasi tregu tërësisht i lirë mund të bëhet i rrezikshëm për shoqërinë.....shteti si faktor i rëndësishëm zhvillimi (Civici, 2013, f. 32). Këto dy logjika në vija të përgjithshme mund të përshkruhen si neoklasikët përballë kejnesianistëve.

Modelet ekzogjene

Modelet ekzogjene të rritjes ekonomike të viteve 1950 dhe 1960 fokusohen mbi akumulimin e kapitalit si burim rritjeje. Nëse niveli i kursimeve e kalon normën e amortizimit dhe rritjen e

popullsisë norma e kapitalit punë do të rritet në kohë, duke sjellë kështu rritje të prodhimit për frymë. Rritja ekonomike arrihet edhe nëse si pasojë e ndryshimeve teknologjike rritet produktiviteti i një pjese të kapitalit. Vënia e theksit mbi akumulimin e kapitalit, la jashtë kësaj teorie studimin e burimeve që sillte progresi teknologjik. Le të hedhim një vështrim mbi to;

1. Modeli Solow i rritjes ekonomike

Modeli i Swan dhe Solow (1956) konsiderohet si guri i themelit të modelit neoklasik. Sipas tyre modeli i funksionit të prodhimit tregon kthimin marzhinal në ulje, si për kapitalin, ashtu edhe për punën, ndërsa A dhe B janë faktorë ekzogjenë. Kështu kapitali fizik për punëtor (k) eventualisht gjithmonë do të arrijë një vlerë të qëndrueshme (k^*) dhe rritja e prodhimit për frymë në afatin e gjatë do të përcaktohet nga norma e ndryshimeve teknologjike, e cili konsiderohet faktor ekzogjen. Një politikë e cila të çon drejt rritjes së qëndrueshme të raportit kapital/punë, si për shembull politikat që rrisin normën e kthimit pas tatimit të një investimi, nuk mund të na çojë në rritjen për frymë në afatin e gjatë, pavarësisht se A rritet vazhdimisht. Megjithatë nisur nga fakti se shtimi i kapitalit është i kushtueshëm, kompanitë duket sikur kërkojnë të marrin më shumë kohë për të përballuar raportin e ri kapital/punë dhe kështu produkti për frymë nuk do të kalojë menjëherë në nivelin e tij të ri, por do të rritet gradualisht me kalimin e kohës (Solow M. , 1956, f. 59) (Swan, 1956, f. 125). Modeli neoklasik është ndërtuar mbi disa supozime, kështu; shtetet prodhojnë dhe konsumojnë një produkt të vetëm, nuk ka tregti ndërkombëtare meqenëse ka vetëm një produkt, teknologjia është variabël ekzogjen dhe konkurrenca konsiderohet se zhvillohet në kushte perfekte. Modeli i Solow me një normë konstante kursimi¹ lë pak hapësirë për politikat fiskale, apo më saktë për ndikimin e tyre në normën e rritjes. Norma e kursimit

¹ Një nga supozimet kryesore të këtij modeli është fakti se niveli i kursimit merret si një vlerë fiskale e prodhimit, pra $0 < S < 1$.

mund të ndërtohet nga variabla të ndryshëm, por sërish në strukturën e ndërtuar nga Solow ka pak zgjidhje ekonomike të cilat mund të tatohen.

2. Modeli Ramsey

Nëse nisemi nga këndvështrimi kronologjik, pikënisja e teorive moderne të zhvillimit është artikulli klasik i Ramsey në vitin 1928. Modeli Ramsey përfaqësohet nga një konsumator i vetëm i cili zgjedh mënyrat e konsumit, punës dhe kapitalit në kohë. Supozimi i një konsumatori të vetëm është bërë me qëllim përjashtimin e problemeve apo çështjeve që lidhen me shpërndarjen midis konsumatorëve të shijeve dhe aftësive të ndryshme të tyre, duke dashur kështu të përqendrohet tërësisht mbi efikasitetin. Funkcioni i Ramsey njihet si funksioni i prodhimit të Cobb-Douglas. (Robert J.Barro and Xavier Sala-iMartin, 1999, f. 10). Në këtë model përfshihet një kompani përfaqësuese e cila zgjedh të përdori kapitalin dhe punën me qëllim maksimizimin e fitimit. Duke pasur parasysh këtë, tregu duhet të jetë në ekuilibër, ndërkohë që zgjedhja apo vendimet e konsumatorit drejtojnë pjesën tjetër të ekonomisë nëpërmjet nivelit të kursimeve dhe kapitalit që ai përfshin. Oferta e punës dhe kapitali i konsumatorit kombinohen me faktorët e kërkesës së kompanisë, për të përcaktuar kështu faktorët të cilët çojnë në ekuilibër. Qëllimi është përcaktimi i karakteristikave të strukturës optimale tatimore në këtë ekonomi. Modeli si përfundim thekson se në afatin e gjatë vlera optimale e tatimit të kapitalit duhet të jetë zero. (Ramsey F. , 1928, f. 559) (Myles, 2009, f. 48)

Zhvillimi i modelit neoklasik për lëmin e financave publike solli një strukturë teorike të përshtatshme për të hulumtuar dhe menduar rreth efekteve të politikës fiskale në rritjen ekonomike. Në këtë pjesë pasqyrohet një model i thjeshtë i cili siguron një strukturë të organizuar për të menduar rreth mënyrave me të cilat elementët dhe komponentët e politikës

fiskale ndikojnë rritjen ekonomike. Në një version më të thjeshtuar funksioni i mëposhtëm tregon bazën e teorisë neoklasike:

$$Y(t) = F[A(t)K(t), B(t)L(t)]$$

Me $Y(t)$ është shënuar prodhimi në kohën t , me $K(t)$ dhe $L(t)$ janë shënuar vlerat e kapitalit fizik dhe punës në kohën t , $B(t)$ është një indeks i matur në termat e prodhimit për cilësinë e punësimit dhe $A(t)$ është indeks i ngjashëm me atë B , por për kapitalin fizik. Indeksi B varet si nga niveli i arsimit të forcës së punës ashtu edhe nga mirëqenia dhe statusi i tyre. Ndërsa indeksi A pasqyron nivelin e zhvillimit teknologjik. Ky funksion thjesht thekson se në një moment të caktuar produkti i përgjithshëm i një ekonomie varet nga sasia dhe cilësia e kapitalit fizik të përdorur, sasia e forcës së punës së përdorur dhe niveli mesatar i aftësisë së fuqisë së punës. Pra mund të themi se në përgjithësi është e qartë se produkti përfundimtar mund të rritet vetëm nëse rriten K , L , A ose B . Rritja proporcionale e produktit përfundimtar për punëtor mund të ndodhë vetëm nëse kapitali për punonjës, ose cilësia e punës apo kapitalit, rriten në mënyrë proporcionale.

3. Konvergjenca

Në përgjithësi pranohet se shtetet me ekonomi më të varfër kanë rritje për frymë më të shpejtë se sa shtetet më të pasura, të pakushtëzuara nga ndonjë karakteristikë tjetër ekonomike. Supozojmë një grup ekonomish të mbyllura të cilat kanë karakteristika, strukturë dhe funksion prodhimi të njëjtë dhe të vetmet ndryshime qëndrojnë në kapitalin fillestar për frymë. Shtetet me nivel më të ulët kapitali kanë rritje për frymë më të lartë dhe tentojnë të arrijnë ose të konvergojnë ato shtete të cilat kanë raport kapital-punë më të lartë.

Në mënyrë të përmbledhur themi se rezultatet kryesore të teorisë neoklasike të rritjes janë katër.

- Kështu norma e rritjes së produktit në gjendjen e qëndrueshme është egzogjene, për këtë arsye është e pavarur nga norma e kursimeve.
- Megjithëse një rritje në normën e kursimit nuk ndikon normën e rritjes së gjendjes së qëndrueshme, duke rritur normën kapital-produkt, rrisim nivelin e gjendjes së qëndrueshme të të ardhurave.
- Norma e rritjes së gjendjes së qëndrueshme të produktit mbetet egzogjene. Norma e rritjes së gjendjes së qëndrueshme të të ardhurave për frymë përcaktohet nga norma e progresit teknologjik. Norma e rritjes së gjendjes së qëndrueshme të produktit agregat është shuma e normës së progresit teknologjik dhe të normës së rritjes së popullsisë.

Rezultati i fundit i teorisë neoklasike lidhet me konvergjencën. Në qoftë se dy vende kanë të njëjtën normë rritjeje të popullsisë, të njëjtën normë kursimi dhe kanë të njëjtin funksion prodhimi ato përfundimisht do të arrijnë të njëjtin nivel të ardhurash. Në këtë kuadër vendet e varfra janë të tilla sepse ato kanë më pak kapital, por në qoftë se ato kursejnë me të njëjtën normë sikurse dhe vendet e pasura dhe janë në kontakt me të njëjtën teknologji ato përfundimisht do ti arrijnë këto vende.

Modelet endogjene

Rritja e produktit për frymë në modelet ekzogjenë është e limituar për shkak të uljes së kthimit nga kapitali. Produkti marzhinal i çdo njësie shtesë së kapitalit bie, ndërsa norma e amortizimit mbetet konstante. Meqenëse aktivet kapitale janë në rritje, arrihet një pikë në të cilën produkti marzhinal i kapitalit arrin normën e amortizimit, pra produkti marzhinal neto bëhet zero. Heqja e kufizimit të rritjes, kërkon heqjen nga modeli të produktit marzhinal të kapitalit në rënie. Modelet të cilat jo vetëm lejojnë rritjen e qëndrueshme, por edhe shpjegojnë burimet e saj janë modelet endogjene. Teoria e rritjes endogjene përpiket ta bëjë endogjene normën e rritjes, që do

të thotë, të përcaktuar nga teoria. Propozuesit e kësaj teorie udhëhiqen nga ideja se përgjithësisht politika qeveritare dhe sjellja ekonomike duhet të jenë të afta të ndikojnë normën e rritjes në afatin e gjatë dhe kështu janë në kërkim të teorive që e lejojnë këtë të ndodhë. Ka dy rrugë bazë të endogjimit të normës së gjendjes së qëndrueshme. Së pari, norma e zhvillimit teknologjik mund të bëhet endogjene, për shembull ajo duhet të ndikohet nga pjesa e burimeve të ekonomisë e destinuar për kërkim-zhvillim. Së dyti në qoftë se ka përfitime konstante të faktorëve të prodhimit që mund të akumulohen, atëherë norma e rritjes së gjendjes së qëndrueshme do të ndikohet nga norma me të cilën janë akumuluar këto faktorë.

1. Modeli AK

Modeli i parë dhe më i thjeshtë i modeleve endogjene është modeli AK. Ky model tregohet duke përdorur funksionin më të thjeshtë të mundshëm të prodhimit, në të cilin përfshihet vetëm kapitali, dhe duke pohuar përfitime konstante të shkallës. Në këtë funksion të thjeshtë mund të përfshihen edhe kombinime të kapitalit fizik dhe atij human. Funksioni i prodhimit është si më poshtë:

$$Y_t = AK_t$$

Funksioni i mësipërm pohon se produkti Y është në përpjesëtim të drejtë me stokun e kapitalit. Supozimi i përfitimeve konstante të shkallës siguron që produkti rritet me të njëjtën normë si kapitali. Për të treguar se ky model sjell rritje të vazhdueshme, është supozuar një normë konstante kursimi (s). Për thjeshtësi është supozuar se nuk ka rritje të popullsisë dhe as amortizim të kapitalit, pra i gjithë kursimi shkon për stokun e kapitalit. Për këtë arsye:

$$\Delta K = sY = saK$$

ose

$$\Delta K/K = sa$$

Pra norma e rritjes ndikohet nga norma e kursimit. Më tej, përderisa produkti është në përpjesëtim të drejtë me kapitalin, është gjithashtu e vërtetë se norma e rritjes së produktit është:

$$\Delta Y/Y = sa$$

Në këtë shembull sa më e lartë të bëhet norma e kursimit aq më e lartë do të bëhet norma e rritjes së produktit. Rezultati i përgjithshëm është se norma e rritjes së gjendjes së qëndrueshme ndikohet nga norma në të cilën akumulohen faktorët e prodhimit, në qoftë se ka përfitime konstante të faktorëve që mund të akumulohen.

2. Konvergjencia e kushtëzuar

Nga teoria e rritjes endogjene rrjedh se duhet të ketë diferenca në normën e rritjes midis vendeve me norma të ndryshme të kursimeve dhe investimeve. Teoria neoklasike predikon se këto diferenca ndikojnë në normën e rritjes së produktit vetëm për një periudhë tranzitore. Le të trajtojmë tashmë konvergjencën e kushtëzuar si një nga parashikimet, apo më saktë rezultatet e modeleve endogjene. Sa më i ulët të jetë niveli real fillestar i PBB-së, e lidhur kjo me afatin e gjatë ose me normën e gjendjes së qëndrueshme ², aq më e shpejtë është norma e rritjes. Konvergjencia konsiderohet e kushtëzuar sepse niveli i kapitalit dhe prodhimit për punëtor në pikën e ekuilibrit të rritjes, të modelit Solow-Swan, varen nga norma e kursimit, norma e rritjes së popullsisë dhe pozicioni i funksionit të prodhimit, karakteristika këto të cilat ndryshojnë nga një ekonomi në një tjetër. Studime empirike kanë treguar se modelit për shtete të ndryshme i duhen shtuar burime të ndryshme dhe veçanërisht ndryshimet e politikave qeveritare dhe ato në kapitalin fillestar human. Megjithatë pika kyçe mbetet fakti se koncepti i konvergjencës së

² I referohet pikës në të cilën produkti për frymë dhe kapitali për frymë bëhen të pandryshueshme. Ideja e gjendjes së qëndrueshme është: në qoftë se kapitali për frymë është i pandryshueshëm, me një teknologji të dhënë, kështu është edhe produkti për frymë. Por me kapital për frymë të pandryshuar, megjithëse rritet popullsia, kapitali duhet të rritet me pikërisht të njëjtën normë sikurse edhe popullsia. Në këtë gjendje ekonomia vendoset në një normë fikse kapital-punë.

kushtëzuar, i cili është element i modelit Solow-Swan, ka fuqi shpjeguese në nivel të konsiderueshëm për rritjen ekonomike midis shteteve apo rajoneve. Robert Barro ka treguar se ndërsa vendet që investojnë më shumë tentojnë të rriten më shpejt, veprimi i investimeve të larta në rritje duket të jetë kalimtar sa më shumë investitorët të përfundojnë në një gjendje të qëndrueshme me të ardhura për frymë më të larta, por jo me një normë më të lartë rritjeje. Kjo është ajo çfarë predikohet nga teoria neoklasike. Robert Barro i referohet këtij rezultati si konvergjenca e kushtëzuar, e cila do të thotë se, vendet po konvergojnë në gjendjet e qëndrueshme, të cilat janë të kushtëzuara nga pjesa e investimeve në PBB. Nivelet konsiderohen gjithashtu të varura nga variabla të tjerë, si pjesa e shpenzimeve qeveritare në produktin kombëtar bruto dhe norma e investimeve në kapitalin human.

3. Kapitali njerëzor

Me kërkimet e Romer (Romer, 1986), Lucas (Lucas, 1988) dhe Rebelo (Rebelo, 1991) të ndërtuara mbi punën e Arrow në 1962, Sheshinski në 1967 dhe Uzawa në 1965 nis një erë e re. Sipas këtyre modeleve, rritja mund të vazhdojë deri në një kohë të pacaktuar, sepse kthimi nga investimet në një klasë të gjerë të të mirave kapitale, e cila përfshin kapitalin njerëzor, jo domosdoshmërisht ulët me zhvillimin e ekonomisë. Shpërndarja e njohurive ndërmjet prodhuesve dhe përfituesve të jashtëm nga kapitali njerëzor konsiderohen pjesë të këtij procesi, por kjo vetëm sepse ato kanë ndihmuar në parandalimin e tendencës për uljen e normës së kthimit të kapitalit të akumuluar (Robert J.Barro and Xavier Sala-iMartin, 1999, f. 12).

4. Shpenzimet qeveritare

Për të analizuar efektet e shpenzimeve qeveritare Devereux dhe Love, në vitin 1995, përdorën një model rritje endogjene dy-sektorial, i cili u zgjerua edhe më tej me qëllim lejimin e hyrjes së

vendimit të lirisë së konsumit si variabël endogjen. Gjetjet shpjegojnë se një rritje e qëndrueshme në pjesën që zënë shpenzimet qeveritare në prodhim, e financuar kjo nga një shumë fikse të tatimeve, do të paraqesë interes dhe rritje ekonomike afatgjatë në të mirë të mirëqenies sociale. Ajo gjithashtu argumenton se një rritje e qëndrueshme në shpenzimet publike do të ulë rritjen afatgjatë ekonomike, kur ato financohet nga tatimi mbi të ardhurat apo nga tatimi mbi pagën, ndërsa një rritje e përkohshme në shpenzimet publike do të rrisë PBB-në. Kjo e fundit për rritjen ekonomike konsiderohet vetëm një impakt i përkohshëm. Ata gjithashtu argumentojnë se këto shpenzime mund të rrisin normën e rritjes ekonomike vetëm nëse financohen nga politika e taksës së sheshtë (Devrux, M. B & Love, D. R, 1995)

5. Inovacioni

Në mesin e viteve 1980 kërkimet për rritjen ekonomike morën hov të ri, kjo nisi më punimin e Romer në 1986 dhe Lucas në 1988. Këto kërkime u motivuan nga vëzhgimi se përcaktuesit e rritjes ekonomike në afatin e gjatë ishin çështje kritike, shumë më të rëndësishëm se mekanizmat e cikleve të biznesit apo efektet kundër ciklikë të politikave monetare dhe fiskale. Megjithatë njohja e rëndësisë së rritjes në afatin e gjatë është vetëm një hap i parë, për të vazhduar me tej duhet të largohesh nga “këmisha e forcës” se modelit neoklasik të rritjes, në të cilin ashtu siç është theksuar edhe më lart norma e rritjes për frymë në afatin e gjatë është e lidhur me normën e zhvillimit teknologjik si variabël ekzogjen. Kështu në një mënyrë apo në një tjetër kontributet e mëvonshme përcaktojnë normën e rritjes brenda një modeli, por duke e dizenuar atë si një model i rritjes endogjene. Hyrja e teorive të kërkimit dhe zhvillimit dhe konkurrencës jo optimale në strukturën e rritjes ekonomike filloi në vitet 1987 dhe 1990 nga Romer e më pas vijoi me punimet në vitin 1992 të Aghion dhe Howitt dhe në vitin 1991 të Grossman dhe Helpman. Në këto modele zhvillimi teknologjik vjen si pasojë e aktiviteteve të kërkim-zhvillimit,

aktivitete këto të cilat përftohen nga përdorimi i fuqisë së mëparshme dhe të mëvonshme monopoliste. Në qoftë se ekonomia nuk tregon tendencë të mungesës së kreativitetit, atëherë norma e rritjes mund të mbetet pozitive në afatin e gjatë. Norma e rritjes dhe theksimi i sasive të aktiviteteve krijuese priret të mos jetë optimale sipas konceptit të Paretos, si pasojë e devijimeve të lidhura me krijimin e produkteve të reja dhe metodave të reja të prodhimit. Në këtë strukturë, norma afatgjatë e rritjes varet nga aktivitetet e qeverisë të tilla si tatimi, ruajtja e rregullit dhe ligjit, sigurimi i shërbimeve në infrastrukturë, mbrojtja e të drejtës intelektuale, rregullimet e tregtisë ndërkombëtare, tregjet financiare dhe aspekte të tjera ekonomike. Kështu theksohet se qeveria nëpërmjet ndikimit të saj në normën afatgjatë të rritjes ka fuqi të konsiderueshme në aspektin pozitiv ose negativ.

6. Mëso duke bërë

Në 1962 Arrow dhe në 1967 Sheshinski ndërtuan një model në të cilin idetë nuk kishin si qëllim përfundimtar produktet e prodhimit apo investimit, mekanizëm ky i njohur si mëso-duke-bërë. Në këto modele zbulimet e çdo personi ndikonin menjëherë mbi të gjithë ekonominë, një proces përzierës i menjëhershëm i cili mund të jetë i mundshëm nga aspekti teknologjik meqenëse njohuritë janë jo rivale (Arrow, 1962) (Sheshinski, 1967). Në 1986 Romer tregoi se konkurrenca si pasojë e zhvillimeve teknologjike mund të ruhet për të përcaktuar një normë ekuilibri, por rezultati në normën e rritjes nuk është optimal sipas konceptit të Paretos³.

7. Teknologjia

³ Eficienca Pareto: alokimi i burimeve nga ana e shtetit përgjatë të cilit është e pamundur të përmirësosh jetën e një individi pa përkeqësuar të paktën jetën e një tjetri.

Cass dhe Koopmans në 1965 e ri sollën analizën e Ramsey në modelin neoklasik dhe treguan një variabël endogjen për normën e kursimit (Cass, 1965). Ky zgjerim i modelit krijoi hapësira për dinamizëm, por tentoi të ruaj hipotezën e konvergjencës së kushtëzuar. Trajtimi endogjen i kursimit nuk eliminon varësinë e normës së rritjes për frymë në afatin e gjatë nga procesi teknologjik si një variabël ekzogjen. Pika e ekuilibrit, në versionin që sollën Cass dhe Koopmans, mbështetet tek një mjedis konkurrues i decentralizuar në të cilin faktorët e prodhimit, punës dhe kapitalit paguajnë produktet marzhinale. Përfshirja e zhvillimeve teknologjike në modelin neoklasik është e vështirë, pasi konkurrenca nënkupton se avantazhi konkurrues nuk mund të mbahet. Zhvillimi teknologjik përfshin krijimin e ideve të reja, të cilat pjesërisht nuk janë rivale apo konkurrenca dhe kështu konsiderohen se kanë disa nga aspektet e të mirave publike. Për një nivel të caktuar të teknologjisë, pra për një nivel të caktuar njohurish, duket me vend që të supozosh norma kthimi konstante krahasuar me standardin, faktorë prodhimi rivalë si puna, kapitali dhe toka. Me fjalë të tjera, për një nivel të dhënë njohurish për mënyrat e prodhimit çdokush mund të mendojë se mund të kopjojë një kompani me të njëjtën sasi punë, kapitali dhe toke dhe të arrijë kështu të dyfishojë prodhimin. Por kështu shkalla e normës së kthimit tenton të rritet dhe idetë jo rivale përfshihen si faktorë prodhimi. Kjo rritje e normës së kthimit konsiderohet në konflikt me konkurrencën perfekte.

8. Politika tatimore

Modeli i Solow me normë konstante kursimi lë pak hapësirë për ndikim të politikës tatimore në normën e rritjes. Norma e kursimit mund edhe të jetë e ndryshueshme, por në strukturën e modelit të Solow ka numër të kufizuar zgjidhjesh ekonomike të cilat mund të tatohen. Si pasojë teoria e tatimit optimal bazohet mbi modelin e Ramsey. Ashtu siç e kemi shpjeguar edhe më lart ky model është ndërtuar mbi supozimin e një konsumatori të vetëm, por zgjedhjet për konsumin,

punën, kursimet dhe investimet janë variabla endogjen. Kjo e lejon tatimin të ndikojë në vendimet rreth këtyre katër variablave. Chamley (1986) dhe Judd (1985) zbuluan se në afatin e gjatë tatimi optimal mbi të ardhurat kapitale duhet të jetë zero. Rreth këtij përfundimi janë bërë një sërë komentesh. Së pari, vihet re se rezultati nuk thotë se tatimi duhet të jetë zero përgjatë rritjes deri në pikën e gjendjes së qëndrueshme, por është supozuar se ekonomia është në pikën e gjendjes së qëndrueshme, pra ai bëhet i aplikueshëm vetëm në këtë situatë. Kjo nuk parandalon që tatimi të jetë pozitiv apo negativ përgjatë periudhës së rritjes ekonomike. Së dyti, tatimi zero mbi të ardhurat kapitale bën që e gjithë barra tatimore të bjerë mbi të ardhurat nga puna. Nëse puna do të ishte një faktor i pandryshueshëm, ky përfundim nuk do të përbënte surprizë për askënd, por puna këtu është faktor i ndryshueshëm. Së fundmi, arsyeja se pse shmanget tatimi i kapitalit është sepse kthimi nga kapitali është thelbësor për shpërndarjen e burimeve në çdo kohë nga ana e konsumatorit dhe për shkak të strukturës së përhershme që kanë pasojat e ndikimeve të akumuluar në kohë. Rezultatet tregojnë se lënia e akumulimit (kursimeve dhe investimeve) në gjendje të qëndrueshme dhe fokusimi tek ndryshimet që mund të shkaktohen mbi zgjedhjen në periudha të caktuara midis konsumit dhe punës është optimale. Duke qenë se norma optimale e tatimit është zero, çdo vlerë tjetër mbi kapitalin do të çonte në rënie të mirëqenies krahasuar kjo me maksimumin që synohet të arrihet. Nëpërmjet disa eksperimenteve Cobb dhe Douglas llogaritën se çfarë ndodh nëse tatimi mbi kapitalin zëvendësohet me tatimin me një shumë të vetme. Rritja e konsumit dhe e kostove të mirëqenies u matën nga krahasimi i pikës së ekuilibrit kur aplikohen tatime dhe pikës së ekuilibrit pa tatime. Kështu ata provuan se kur një normë tatimi prej 30 për qind mbi të ardhurat kapitale, zëvendësohet nga tatimi me një shumë të vetme, konsumi rritej me 3.3 për qind dhe kostot e mirëqenies ishin 11 për qind e të ardhurave tatimore. Rritja në konsum dhe e kostove të mirëqenies janë të dyja më të larta nëse llogaritja do të bëhej

mbi një normë fillestare tatimi prej 50 për qind. Si përfundim thuhet se politika optimale e tatimit arrihet kur në afatin e gjatë tatimi mbi kapitalin është zero. Ndodhur në këto kushte kuptohet që të gjitha të ardhurat duhet të realizohen nga tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

9. Tatimi dhe rritja ekonomike

Nevoja e përfshirjes së ndikimit të aktivitetet të qeverisë në rritjen ekonomike u trajtua në vitin 1939 nga Harrod. Ai tregoi disa mënyra se si ky burim i ndryshimit të kërkesës agregate mund të ndikojë rrugën e rritjes ekonomike drejt ekuilibrit të ekonomisë. Sipas tij politikat qeveritare përdoren, si për të stabilizuar ekonominë, ashtu edhe për të arritur një rritje më të lartë (Harrod, 1939, f. 23). Hipoteza e Robert Barro në vitin 1979, mbi taksën e sheshtë thekson se nëse rritet kostoja marzhinale e rritjes së të ardhurave nga tatimet atëherë norma optimale e tatimit është shtrënguese⁴. Kjo tregon se ndryshimet në normat e tatimit do të jenë të qëndrueshme duke u nisur nga efekti i tyre i ndryshëm në rritjen ekonomike. Modelet e rritjes endogjene parashikojnë që politikat e përkohshme të shpenzimeve qeveritare kanë efekte pozitive në prodhim, por nuk kanë efekt, pra ai është zero, për luhatje apo goditje në politikat e shpenzimeve (Barro, 1990). Diskutimi mbi modelet endogjene ka nxjerrë në pah mënyra dhe rrugë nëpërmjet të cilave tatimi ndikon rritjen ekonomike. Zagler dhe Durnecker në 2003 ndërtuan një model me qëllim ilustrimin e mënyrës se si një varg instrumentesh tatimorë ndikonin rritjen ekonomike të një vendi. Modeli i tyre përmban disa prej elementëve më të rëndësishëm të modeleve endogjene. Prodhimi në një kohë të caktuar shprehet me funksionin e mëposhtëm të prodhimit agregat;

$$Y_t = X_t^\alpha G_t^\beta L_t^{1-\alpha} \quad (1)$$

⁴ Koncepti i një këmishë të ngushtë fiskale është një parim i përgjithshëm ekonomik që sugjeron kufizime të rrepta mbi shpenzimet e qeverisë dhe të huamarrjes të sektorit publik, për të kufizuar ose rregulluar deficitin buxhetor gjatë një periudhe kohore.

Ku X_t përcakton sasinë e një inputi ndërmjetës të përbërë. Ky agregat përbëhet nga një numër n inputesh ndërmjetës të specializuara të shprehura sipas barazimit të mëposhtëm;

$$X_t^\alpha = \sum_{i=1}^n x_{i,t}^\alpha \quad (2)$$

Ku $x_{i,t}$ është sasia e inputit ndërmjetës i . Nivelet e inputeve $\{L_t, X_{i,t}\}$ zgjidhen në mënyrë të tillë që të minimizojnë koston e prodhimit.

$$C_t = (1 + \tau_L)w_t L_t + \sum_{i=1}^n (1 + \tau_{xi})p_{i,t}x_{i,t} \quad (3)$$

Ku τ_L është tatimi mbi punën dhe τ_{xi} tatimi mbi të mirën ndërmjetës i . Përcaktimi i indeksit të çmimit agregat P_t dhe i një tatimi të caktuar agregat τ_X bën që kostoja e prodhimit të shkruhet edhe sipas bazazimit të mëposhtëm;

$$C_t = (1 + \tau_L)w_t L_t + (1 + \tau_X)P_t X_t \quad (4)$$

Kushtet e domosdoshme për minimizimin e koston mund të zgjidhen për të treguar se;

$$(1 + \tau_X)P_t = \left(\sum_{i=1}^n [(1 + \tau_{xi})p_{i,t}]^{\alpha/(\alpha-1)} \right)^{(\alpha-1)/\alpha} \quad (5)$$

Prej nga rezulton se;

$$x_{i,t} = \left(\frac{(1 + \tau_{xi})p_{i,t}}{(1 + \tau_X)P_t} \right)^{1/(\alpha-1)} X_t \quad (6)$$

Secila prej të mirave apo inputeve ndërmjetës prodhohet nga një kompani monopoliste e veçantë. Kompania e cila prodhon të mirën i , e maksimizon fitimin e saj sipas funksionit të mësipërm (6) të kërkesës agregate. E gjitha kjo të çon në çmimin optimal i cili llogaritet si më poshtë;

$$p_{i,t} = \frac{1}{\alpha} \quad (7)$$

Si pasojë indeksi i çmimit agregat, kur të gjitha tatimet mbi të mirat ndërmjetëse janë të njëjta, shprehet;

$$P_t = \frac{1}{\alpha} \frac{1+\tau_x}{1+\tau_X} n^{(\alpha-1)/\alpha} \quad (8)$$

Në këtë moment mund të përcaktohet koncepti i kapitalit fizik duke përmbledhur të mirat ndërmjetëse individuale. Pra;

$$K_t = \sum_{i=1}^n x_{i,t} = n^{(\alpha-1)/\alpha} X_t \quad (9)$$

Kjo përmbledhje mundëson shprehej e prodhimit si një funksion i kapitalit, inputit publik dhe punës.

$$Y_t = K_t^\alpha G_t^\beta (nL_t)^{1-\alpha} \quad (10)$$

Aktivitet kapitale në ekuilibër do të jenë;

$$K_t = \alpha^2 \left(\frac{1-\tau_Y}{1+\tau_x} \right) Y_t \quad (11)$$

Kjo tregon se norma e rritjes shprehet;

$$\hat{Y}_t = \frac{\beta}{1-\alpha} \hat{G}_t + \hat{n}_t + \hat{L}_t \quad (12)$$

Supozojmë një konstante, s , për të ardhurat që kursehen dhe përdoren për të financuar aktivitetet e kërkim zhvillimit të shoqërisë. Nëse shënojmë tatimin mbi kursimin me τ_s dhe tatimin mbi kërkim zhvillimin me τ_{RD} shpenzimet e punës për kërkim zhvillimin shprehen si më poshtë vijon;

$$(1 - \tau_s)sY_t^D = (1 + \tau_{RD})w_tE_t \quad (13)$$

E ndërsa inovacioni arrin në normën;

$$\hat{n}_t = \phi h_t E_t \quad (14)$$

Ku h_t është kapitali human publik. Duke përdorur këto rezultate norma e rritjes për frymë shprehet;

$$\hat{Y}_t - \hat{N}_t = \frac{\beta}{1-\alpha} \hat{G}_t + \phi \frac{s+\alpha s(1+\tau_L)(1-\tau_\pi-\tau_x)}{1+\tau_{RD}+\tau_s+\alpha s(1+\tau_L)(1-\tau_\pi-\tau_x)} \frac{h_t N_t}{n_t} \quad (15)$$

Ku τ_π është tatimi mbi fitimin e prodhuesve të të mirave ndërmjetëse, pjesa e parë e barazimit tregon efektin pozitiv që tatimet kanë mbi rritjen ekonomike nëpërmjet financimit të inputeve publike. Pjesa e dytë tregon efektet e tatimit të cilat operojnë nëpërmjet ndryshimeve në nivelet e inovacionit. Si taksat mbi kursimin ashtu edhe ato mbi kërkim zhvillimin e ulin akumulimin e kapitalit. Tatimi mbi kërkim-zhvillimin ul inovacionin dhe tatimi mbi kursimin ul akumulimin e kapitalit. Tatimet e tjera nuk kanë ndikim të dukshëm në rritjen ekonomike. Autorët theksojnë se modeli mund të zgjerohet edhe më tej, por megjithatë ai tregon efektet që tatimet mund të kenë mbi rritjen ekonomike.

Tatimi dhe rritja ekonomike. Argumente teorike

Teoritë ekonomike e lidhin tatimin me rritjen për shkak të influencës së tij në vendimet e agentëve ekonomik. Në 1999 Stiglitz dalloi tatimin jo-deformues, ku individët nuk mund të ndryshojnë detyrimet e tyre tatimore, nga tatimi deformues, ku individët mund të ndërmarrin veprime në mënyrë që të reduktojnë detyrimet e tyre tatimore (Prammer D. , 2011, f. 3-11). Kështu tatimi, së paku teorikisht, ndryshon vendimet ekonomike dhe si i tillë ndikon rritjen ekonomike. Duke marrë në konsideratë një funksion të thjeshtë:

$$Y_t = AKL_t$$

Në funksionin e mësipërm të produktit të përgjithshëm, ku K përfaqëson kapitalin fizik, L punën dhe A përfaqëson gjendjen e teknologjisë, bëhet e qartë se tatimi mund të ndikojë PBB dhe rritjen ekonomike nëpërmjet ndikimit të tij në kapitalin fizik, atë human dhe nëpërmjet efekteve të tij në faktorin total të prodhimit. Ashtu siç do të shpjegohet edhe më poshtë tatimi mbi punën mund të ndikojë në tregun e punës dhe vendimet për edukim meqenëse ai e bën punën më pak fitimprurëse. Tatimi mbi kapitalin ul nxitjen për kursim dhe investim për shembull akumulimi i kapitalit fizik dhe tatimi mbi kërkimin-zhvillimin mund të frenojnë zhvillimin teknologjik duke i bërë këto aktivitete më pak fitimprurëse. Në modelet ekzogjene tatimi mund të ndikojë nivelin e gjendjes së qëndrueshme të të ardhurave për frymë dhe normën e rritjes në afatin e shkurtër e ndërsa në modelet endogjene tatimi ndikon normën e rritjes në afatin e gjatë⁵. Paragrafët e mëposhtëm tregojnë disa mënyra se si tatimi ndikon vendimet për rritjen ekonomike.

- Tatimi mbi punësimin

Pavarësisht nga studimet e shumta nuk njihet me siguri efekti i tatimit mbi lloje të ndryshme sjelljesh. Politikanët shpesh herë marrim nga ekspertë të ndryshëm këshilla të ndryshme. Kështu që është pothuajse e paevitueshme që ata, politikanët, të adaptojnë ato supozime sjelljeje që lehtësojnë arritjen e objektivave të tyre. Megjithëse përgjithësimet konsiderohen të rrezikshme shpesh thuhet se liberalët besojnë se sjellja nuk i përgjigjet shumë sistemit tatimor, ndërsa konservatorët mbështesin pikëpamjen e kundërt. Liberalët preferojnë elasticitete të ulëta, për shkak se ato mund të bëjnë sasi të mëdha parash për aktivitetin e sektorit publik, pa dashur të shqetësohen shumë për tarifatat e larta për të cilat thuhet se ‘hanë patën që pjell vezën e artë’. Në të kundërt, konservatorët dëshirojnë të supozojnë elasticitete të larta, sepse ato kufizojnë volumin

⁵ Myles në 2009 ka vëzhguar funksione të ndryshme të prodhimit, të cilave gjithashtu iu referohet si modele të rritjes ekonomike dhe efektet e tatimit në PBB dhe rritjen ekonomike.

e tatimeve që mund të mblidhet përpara se në ekonomi të vendosen kosto efëente. Prandaj shpesh kur gazetarët, politikanët dhe ekonomistët diskutojnë rreth mënyrës se si tatimet ndikojnë iniciativat, duhet të vlerësohen pretendimet e tyre në dritën e faktit se si mund të jetë axhenda e fshehtë e tyre. Tatimi mbi punësimin, ku përfshihen tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi pagën dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, mund të ndikojnë vendimmarrjen në tre mënyra kryesore: *alokimin e kohës midis punës dhe kohës së lirë, akumulimin e kapitalit human, zgjedhjet dhe sjelljet profesionale dhe sipërmarrëse*⁶. Në veçanti ky lloj tatimi ndikon vendimet e krahut të ofertës të cilat lidhen me vendimet për pjesëmarrjen në tregun e punës dhe orët e punës (Chen, 2007). Megjithatë teorikisht nuk mund të përcaktohet saktësisht ndikimi i tatimit në ofertën për punë kjo pasi zëvendësimet dhe të ardhurat ndikojnë mbi punën në drejtime të kundërta. Ndërsa efektet e zëvendësimit i bëjnë njerëzit të punojnë më pak, të zëvendësojnë punën me më shumë kohë të lirë, efektet e të ardhurave bëjnë që njerëzit të punojnë më shumë në mënyrë që të ruajnë të njëjtën sasi të ardhurash. Teoritë ekonomike theksojnë gjithashtu se ndikimi ekzakt i tatimit mbi punën në tregun e punës varet nga elasticiteti i kërkesës për punë, shkalla e centralizimit të vendosjes së pagave dhe shpërndarja e të ardhurave ndërmjet niveleve të ndryshme të të ardhurave (King, R.E. & Rebelo, S. , 1990). Përveç kësaj tatimi mbi punën, e në veçanti tatimi progresiv, mund të ndikojë vendimin për t'iu nënshtruar trajnimeve dhe edukimit shtesë të cilat në të ardhmen do të ndryshojnë kthimin nga edukimi dhe trajnimi. Woehlbier në 2002 ka theksuar se tatimi progresiv ul kthimin e kapitalit human, gjë e cila merr më shumë trajtën e të ardhurave më të larta në të ardhmen, se sa ul kostot për të. Këto kosto konsistojnë në fitime të pashmangshme apo të pazbritshme përpara llogaritjes së tatimit. Kjo bën që të ulet vlera aktuale neto e investimeve në edukim dhe trajnim. Johansson në 2008 tregon se

⁶ Ky klasifikim sugjerohet bazuar në studimet e Meghir dhe Philips në 2010, Myles në 2009 dhe në një studim të Universitetit të Bocconit në 2011.

për shkak të ndikimit të tatimit mbi punën në çmimin relativ të kapitalit dhe punës, mund të kemi rialokim të inputeve, duke ulur ndoshta efikasitetin në përdorimin e inputeve⁷. Pra nxitja apo dekurajimi i tatimit mbi punësimin varet gjithashtu nga trajtimi tatimor i formave të investimeve alternative. Myles në 2009 tregoi se tatimi mbi të ardhurat (tatimi mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimi mbi të ardhurat personale) mund të influencojë zgjedhjen për tu përfshirë në aktivitete sipërmarrëse, për shkak të ndryshimeve në profilin risk-kthim të lidhur me të. Nga njëra anë tatimet ulin të ardhurat e sipërmarrësve të suksesshëm, të cilët mund të jenë kundërshtarë të riskut, dhe nga ana tjetër nëse humbjet janë të zbritshme në të ardhura të tjera atëherë risku i sipërmarrjes ndahet me shtetin. Megjithatë nëse sistemi i tatimit është progresiv, apo ka limite për kompesimin e humbjeve, ato mund të kompesohen vetëm në një normë më të vogël se sa ajo me të cilën tatóhen të ardhurat. Mospërputhjet nga marrja përsipër e riskut ulin kthimin e pritshëm pas tatimit dhe gjithashtu dekurajojnë sipërmarrjen⁸. Meqenëse profili kthim-risk ndryshohet nga tatimi i të ardhurave, gjë e cila thellohet edhe më shumë në rastin e tatimit progresiv, ai ndikon zgjedhjen midis punësimit dhe aktivitetit sipërmarrës dhe riskun e marrë përsipër nga aktivitetet sipërmarrëse. Meqë kthimi dhe risku nga inovacioni ndryshon, kjo mund të ulë, si investimet në kërkim-zhvillim, ashtu edhe ato në formimin e kapitalit human, duke ndikuar kështu në rritjen ekonomike në afatin e gjatë. Për më tepër duhet theksuar se qëllime të ndryshme të shmangies apo evazionit fiskal në punësim mund të ndryshojnë zgjedhjet në punësim. Në një studim të Universitetit të Bocconit, në 2011, theksohet se tatimi i lartë marzhinal mbi të ardhurat, jo vetëm që paragjykon paketën e kompesimeve përkundrejt zërave

⁷ Sipas teoremës së prodhimit eficient të Diamond dhe Mirrlees të pasqyruar në punimin e tyre në 1999 theksohet se pavarësisht asaj çfarë qeveria mund të bëjë me tatimet deformuese mbi prodhuesit ajo do të kishte më shumë rezultate duke përdorur tatimet direkte mbi konsumin.

⁸ De Mooij dhe Nicodème në 2007

me tatime më të ulëta, por gjithashtu mund të shtrembërojë zgjidhjet e punësimit ndërmjet tyre dhe në këtë rast shmangia nga tatimet është më e lehtë. Pra tatimi mbi punësimin ndikon, jo vetëm vendimmarrjen në afatin e shkurtër, por edhe vendimet për ciklin e jetës. Ekonomistë të tjerë argumentojnë se sistemi i sigurimeve shoqërore çorienton sjelljen e individëve dhe dobëson efikasitetin ekonomik.

- Efektet e sigurimeve shoqërore ndaj kursimit

Ashtu sikurse kemi theksuar edhe më lart pjesa kryesore e diskutimit përqendrohet mbi vendimet lidhur me kursimet dhe ofertën e punës. Por si paraqitet sjellja ndaj konsumit? Pika e nisjes në lidhje me sigurimet shoqërore dhe kursimin është teoria e ciklit të jetës së kursimit, e cila konsiston në faktin se konsumi dhe kursimet e individëve bazohen në aspekte të ndryshme të jetës së një individi (Rosen, 2002, f. 229). Gjatë jetës së tyre në punë individët kursejnë një pjesë të të ardhurave të tyre për të akumuluar pasuri nga e cila ata mund të financojnë kursimin me daljen në pension. Këto kursime vazhdojnë deri në momentin që lind nevoja për ti përdorur, në këtë mënyrë themi se rritet gjendja e kapitalit të shoqërisë. Sistemi i sigurimeve shoqërore mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme kursimet, këto ndryshime rrjedhin nga tre efekte. Së pari të punësuarit kuptojnë se në këmbim të kontributeve të tyre për sigurimet shoqërore, në kohën e daljes në pension ata do të marrin të ardhura. Nëse sigurimet shoqërore do të shihen si mjete kursimi për të siguruar përfitime në të ardhmen, individët do të synojnë të kursejnë më pak në të tashmen. Ky fenomen në literaturën e financave publike njihet si *efekti i zëvendësimit të pasurisë*. Në një sistem pjesërisht të financuar kontributet nuk janë të gjitha rezultat i kursimeve, por një pjesë u paguhet menjëherë përfituesve aktualë. Kjo bën që kursimi publik të jetë më i vogël se rënia në kursimin privat, gjë e cila nënkupton një rënie në shumën totale të akumulimit të kapitalit. Së dyti, sigurimet shoqërore mund të ndikojnë në daljen më herët në pension.

Njerëzit duke dashur të sigurojnë përfitime mund të reduktojnë pjesëmarrjen e tyre në forcën e punës. Megjithatë nëse koha e të qenit në pension rritet, individit do të ketë më shumë vite jo pune, gjatë të cilave konsumi duhet të financohet, por më pak vite pune për të akumuluar fondet. Ky efekt i daljes në pension synon të rrisë kursimet. Së treti, zakonisht sistemet e sigurimeve shoqërore lejojnë transferimin e të ardhurave nga fëmijët (të punësuarit apo kontribuesit) tek prindërit (pensionistët apo përfituesit). Prindërit si rrjedhojë e këtij transferimi mund të kursejnë më shumë për të rritur trashëgiminë për fëmijët e tyre në mënyrë që të kompesojnë efektin e shpërndarjes së sigurimeve shoqërore. Në thelb individët rrisin kursimet e tyre për të eliminuar ndikimin e sigurimeve shoqërore mbi të ardhurat e fëmijëve të tyre. Ky efekt njihet si *efekti i trashëgimisë*. Ajo çfarë thuhet në lidhje me këto tre efekte është fakti se ato veprojnë në drejtime të ndryshme, pra mbështetja teorike për ndikimin e sigurimeve shoqërore mbi kursimin është e pamjaftueshme. Lind nevoja e studimeve apo analizave ekonometrike të tjera. Studiues dhe ekonomistë të ndryshëm argumentojnë se sigurimet shoqërore kanë pasur efekt negativ mbi kursimet, por madhësia e këtij efekti është e paqartë (Hurd, 1990).

- Tatimi mbi kapitalin

Tatimi mbi kapitalin, si ai mbi fitimet nga biznesi, fitimin kapital, dividendët dhe interesat, ndikon mbi normën e akumulimit të kapitalit. Kursimet dhe investimet e agjentëve ekonomikë mund të dekurajohen si pasojë e ndryshimit të kthimit nga kapitali, thënë këtë kuptojmë se tatimi mbi kapitalin sjell ndryshime në shpërndarjen në kohë të burimeve (Devereux, M.P. & Griffith, R., 2003). Sa më i ulët të jetë niveli i investimeve aq më të ulëta janë aksionet kapitale të cilat ndikojnë më pas në rritjen ekonomike. Pra për shkak të strukturës së tij tatimi mbi kapitalin

krijon çrregullime në kohë. Për të hedhur dritë mbi këto çrregullime⁹ disa autorë si Judd në 1985, Chamely në 1986 dhe Jones në 1997 theksojnë se në ekonomitë e hapura dhe në ato të mbyllura në mënyrë që shpenzimet qeveritare të konsiderohen ekzogjene duhet që tatimi mbi kapitalin në afatin e gjatë të jetë zero. Përfundimet se tatimi optimal mbi kapitalin duhet të jetë zero datojnë edhe më herët, në 1954 Samuelson (Samuelson, 1954) dhe në 1946 Tiebout (Tiebout, 1956) kur kanë marrë në studim ekonomi të vogla të hapura dhe duke supozuar lëvizje të kapitalit në kushte optimale kanë arritur në këtë përfundim. Gjetjet u tyre mbështeten edhe nga Gordon në 1986 (Gordon, 1985) dhe Razin e Sadka në 1991 (Assaf Razin and Sadka Efraim , 1991) të cilët specifikojnë se “ një vend i vogël me ekonomi të hapur nuk duhet të vendosë tatim mbi burimet e kapitalit”. Ata argumentojnë se për shkak të rrjedhjes së kapitalit, si pasojë e së cilës mbetet më pak kapital për tu përdorur në prodhim, bie produktiviteti në faktorët e prodhimit të cilët konsiderohen më pak të lëvizshëm. Kjo rënie e produktivitetit mund të shmanget duke tatuar direkt faktorët e lëvizshëm në vend që të tatohet kapitali, gjë e cila më pas ndikon mbi inputet. Megjithatë në botën reale ekziston tatimi mbi të ardhurat kapitale. Ka disa arsye se pse tatohen burimet që krijojnë të ardhura kapitale (Nicodème, 2007).

- Ekzistenca e qerasë për ambiente të veçanta: Ashtu siç e kemi theksuar edhe më lart tatimi mbi kapitalin sjell çrregullime të normës së kthimit e ndërsa tatimi kapital mbi qiranë nuk shkakton lëvizje të kapitalit, për aq kohë sa nuk hiqet dorë nga qiraja mbi një vendndodhje si për shembull vend grumbullimi.

⁹ Sipas standardeve të specifikuara në modelin e horizontit të pafund të Ramsey këto çrregullimet bëhen pafundësisht të mëdha.

- Lëvizje jo optimale e kapitalit. Kapitali është më pak lehtësisht i lëvizshëm se sa sugjerohet nga literatura, kjo edhe për shkak të kostove që mbart vetë rregullimi apo përshtatshmëria e kapitalit dhe e ndikimeve të saj në portofolin e investitorit.
- Ulja e çrregullimeve të tatimit mbi të ardhurat personale: ekzistenca e tatimeve mbi të ardhurat personale mund të shkaktojë paragjykime në drejtim të investimeve në kapitalin financiar, duke dekurajuar investimet në kapitalin human. Për pasojë ato mund të bëjnë që sipërmarrësit të zhvendosin të ardhurat nga puna, në të ardhura nga kapitali në mënyrë që të shmangin tatimet. Kështu tatimi mbi kapitalin konsiderohet si një ndihmës për tatimin mbi të ardhurat personale dhe lehtëson çrregullimet në formimin e kapitalit human.
- Parimi i përfitimit: parimi i përfitimit argumenton se për sa kohë që kompanitë konsumojnë të mira publike duhet të paguajnë për to. Meqenëse nuk ka një lidhje direkte mes këtyre shërbimeve dhe tatimit të kompanive, forma të tjera pagesash do të ishin ato që do ti përshtateshin më mirë kuptimit të parimit të përfitimit. Në një botë ku dita ditës po rritet lëvizja ndërkombëtare e kapitalit, dhe sidomos në një treg të integruar siç është Bashkimi Evropian, tatimi mbi të ardhurat nga burime të kapitalit mund të ndikojë rritjen ekonomike në nivele të ndryshme. Duke i lënë mënjane faktorët e tjerë, si baza ligjore e një shteti e cila i referohet administrimit apo bazës tatimore, sistemi tatimor mbi korporatat mund të ndikojë vendimet për vendin ku firmat zgjedhin të vendosin investimet e tyre, sa shumë ato do të investojnë dhe vendin që ato do të zgjedhin të vendosin fitimet e tyre.

Kërkimet parashikojnë se norma efektive mesatare e tatimit në shtete të ndryshme, së pari mund të ndikojë mbi vendimet, së dyti mbi normën efektive marzhinale të tatimit dhe së treti mbi

normën statuale të tatimit¹⁰. Trajtimi tatimor i fitimit kapital si dhe i kthimeve të tjera kapitale, si interesat dhe dividendët, mund të sjellin ndryshime apo edhe devijime të vendimeve financiare të një kompanie. Shumë prej sistemeve tatimore në Evropë i pranojnë shpenzimet e interesave si shpenzime të zbritshme përpara llogaritjes së tatimit, e ndërsa pagesat e dividendëve nuk e ulin bazën tatimore. Për shkak të këtij diskriminimi kompanitë për financimin e një investimi favorizojnë financimin me borxh ndaj atij me kapital (De Mooij, R.A. dhe S. Ederveen, 2005). Kjo jo vetëm që i favorizon kompanitë që kanë akses në financimin me borxh, zakonisht të tilla janë kompanitë me eksperiencë dhe më pak inovative, por gjithashtu i çon ato drejt një leve financiare më të lartë. Norma më e lartë e levës financiare ul aftësinë e kompanive për të financuar luhatjet e tregut, gjë e cila së bashku me uljen e aktiviteteve inovative mund përfundimisht të ndikojnë mbi rritjen ekonomike. Për më tepër tatimi i fitimeve kapitale mund gjithashtu të godasë rialokimin eficient të kapitalit. Agjentët ekonomikë në përpjekje për t'iu shmangur tatimit mbi kapitalin e realizuar, mund të mbeten brenda korporatave ekzistuese me mundësi jo eficiente investimi. Kështu duke limituar aksesin e financimit çënohet edhe hyrja në treg e kompanive të reja të cilat mund të jenë edhe më produktive.

- Tatimi mbi qarkullimin

Tatimi mbi qarkullimin, si tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akciza, shihet shpesh si tatimi i cili në krahasim me tatimin mbi të ardhurat sjell më pak çrregullime, kjo pasi ai nuk ndryshon vendimet në kohë në të njëjtën mënyrë siç bëjnë tatimet mbi të ardhurat. Tatimet mbi konsumin bien pjesërisht mbi mjetet e akumuluar, të cilat konsiderohen si bazë tatimore jo elastike. Për më tepër ky lloj tatimi nuk ndikon mbi kthimin nga kursimet dhe zakonisht nuk ka strukturë tatimore progresive (Stiglitz J. E., 1999). Stiglitz shpjegon se tatimi progresiv është më pak

¹⁰ Për më shumë detaje referohu Nicodeme (2008)

efiçient se tatimi proporcional. Efiçenca në këtë rast i referohet të ardhurave, tatimi progresiv mbledh apo kthen më pak të ardhura se ai proporcional. Crawford në studimin e tij në 2009 thekson se nëse i referohemi ndikimit në buxhetin e individëve dhe sjelljes së tyre nuk duhet të ketë diferenca midis tatimit uniform në konsum dhe tatimit uniform të pagës (Crawford I, M. Keen and S. Smith, 2009). Prandaj tatimi mbi pagën dhe tatimi mbi konsumin janë të barabarta. Kjo është edhe arsyeja se pse ata arrijnë në përfundimin se kalimi nga tatimi mbi pagat në atë mbi konsumin nuk ka ndikim mbi ofertën e punës. Efektet pozitive mbi punësimin dhe rritjen më së shumti rrjedhin nga zbutjet e luhatjeve të natyrshme në tregun e punës ose efekteve në vlerën reale të burimeve dhe përdorimeve të fondeve¹¹. Për më tepër çështje të ndryshme që lidhem me kostot administrative dhe ato të pajtueshmërisë ligjore midis tatimit mbi punësimin dhe atij mbi konsumin mund të ndikojnë në sigurimin e efiçencës kur lëvizim nga tatimi mbi punësimin drejt atij mbi konsumin. Tatimi mbi produktet dhe shërbimet krijon hapësira për të aplikuar norma të ndryshme tatimore mbi komponentë të ndryshëm të konsumit. Në 1927 Ramsey në punimin e tij sugjeronte një sistem të diferencuar tatimi mbi produktet, i cili të sillte sa më pak të mundej luhatje në sjelljen konsumatore (Ramsey, 1927). Rregulli i tij i elasticitetit të kundërt varet nga elasticiteti i çmimit të produkteve dhe shërbimeve dhe ai sugjeron tatime të larta për produktet me çmime më pak elastike. Vendosja e çmimeve të larta, kur elasticiteti i çmimit është i ulët, nuk do ta ulte ndjeshëm kërkesën. Pra këto produkte konsumohen pavarësisht çmimit të tyre. Kështu që vendosja e tatimit mbi këto produkte nuk do ta ndryshonte ndjeshëm sjelljen konsumatore. E kundërta ndodh me tatimin mbi produktet me çmime vërtetë elastike, tatim ky i cili duhet të jetë i ulët në mënyrë që të kemi një sistem tatimor efiçent meqenëse ato, tatimet, mund ta ndryshojnë sjelljen konsumatore. Studime të mëvonshme, të cilat përsëri mbështetet mbi diferencimin

¹¹ Sipas Crawford (2009) një rritje në tatimin mbi mallrat do të sillte ulje të vlerës reale të përfitimeve sociale gjë e cila ka shumë mundësi të rrisë ofertën e punës.

tatimor, janë pro vendosjes së tatimeve mbi mallrat e luksit për ti bërë ato jo atraktive krahasuar me punën (Corlett W.J. and D. C. Hague , 1953). Në vitin 2000 dhe 2004 Kleven thekson se është rasti që në krahasim me mallrat e luksit mallrat konsumi, apo përgatitja e të cilave merr më pak kohë nga koha e lirë e familjarëve, të tatohen më pak (Kleven H.J., W.F. Richter and P.B. Sørensen, 2000) (Kleven, 2004). Tatimi i lartë e bën blerjen e këtyre të mirave dhe shërbimeve më të shtrenjtë dhe njerëzit zgjedhin ti bëjnë ato vetë. Nxitja për të shpenzuar më shumë kohë për ti bërë vetë disa produkte dhe shërbime është më e lartë për individët të cilët përballen me norma marzhinale tatimore të larta. Tatimi i ulët i këtyre zëvendësuesve, si kujdesi ndaj fëmijëve apo shërbimi i restoranteve, mund ti inkurajojë njerëzit të shpenzojnë më shumë kohë produktive, apo orë pune, në tregun e punës në vend që ti bëjnë vetë këto produkte dhe shërbime. Kleven ka theksuar gjithashtu se të mirat të cilat janë të domosdoshme për shëndetin duhet të tatohen më norma të ulëta (Kleven, 2004). Këto produkte shëndetësore mund të kursejnë kohë pasi parandalojnë sëmundjen e njeriut, pra ulin kohën e qëndrimit të njeriut jashtë pune apo edhe përmirësojnë jetën e punonjësve, duke ndikuar kështu edhe mbi rritjen ekonomike. Crawford, nga këndvështrimi teorik, konfirmon strukturën e normave optimale të diferencuara duke iu përgjigjur zbatimit të tij dhe përfitimit social që mund të arrihet (Crawford I, M. Keen and S. Smith, 2009). Zakonisht ajo që mbetet në praktikë nga ideja e tatimit të diferencuar të mallrave është në formën jo optimale të T.V.SH-së së diferencuar dhe akciza e vendosur mbi të mira specifike. Ashtu siç është shpjeguar edhe më lart Kleven në 2004 solli rastin e tatimit të lartë për shembull mbi produkte që dëmtojnë shëndetin, tatim ky i cili gjendet apo aplikohet në formën e akcizës¹². Akciza konsiderohet si një formë për të korrigjuar apo rregulluar eksternalitetet apo edhe kostot e vendosura mbi vete, si në rastin e alkoolit dhe duhanit të cilat ndodhin gjatë

¹² Në punimin e tij të 2004 Kleuven ka sjellë arsye të ndryshme për vendosjen e akcizës bazuar në teorinë e tatimit optimal.

konsumit final të këtyre produkteve¹³. Kështu në rastin e akcizës, luhatjet si efekt i tatimit janë të mirëpritura më shumë në fushën e pijeve alkoolike, produkteve të duhanit si dhe në produkte apo sjellje të cilat dëmtojnë mjedisin. Për më tepër, ashtu siç kemi thënë edhe pak më lart, tatimi i lartë në të mira të cilat dëmtojnë shëndetin, tatim ky i cili mund të jetë në formën e akcizës, mund të rrisë kohën e qëndrimit në punë apo orët e punës.

- Tatimi mjedisor

Ashtu siç është shpjeguar edhe pak më lart tatimi mjedisor, si për shembull detyrime akcize të vendosura mbi aktivitete të cilat dëmtojnë mjedisin si energjia, transporti dhe burimet ndotëse të mjedisit, ka për qëllim të influencojë konsumatorët dhe prodhuesit nëpërmjet nxitësve në formë çmimi dhe ti drejtojë ata drejt sjelljes së dëshiruar, që në këtë rast është dëmtimi i ulët i mjedisit (Itaya, 2008). Tatimi ideal Pigouvian¹⁴, tatim i cili ka për qëllim të korrigjojë atë çfarë prodhon tregu, mund të rrisë kostot marzhinale private në nivelin që barazon kostot marzhinale sociale. Ai merr në konsideratë kostot e ndotjes së shkaktuar tek të tjerët dhe kështu zbut eksternalitetet. Pra tatimi mjedisor Pigouvian mund të korrigjojë çrregullimet e tregut duke rritur efikasitetin e shpërndarjes së burimeve. Të ardhurat e mbledhura mund të përdoren për të ulur tatimet që sjellin çrregullime në treg si për shembull tatimin mbi punësimin. Në afatin e shkurtër “dividendi i dyfishtë”¹⁵ mund të materializohet dhe ndërsa tatimet mjedisore riciklohen për të ulur tatimin

¹³ Një normë më e lartë T.V.SH mbi këto produkte nuk do ndikonte mbi përdorimin e këtyre produkteve nga prodhuesit.

¹⁴ Taksa Pigouvian është një taksë e aplikuar mbi një aktivitet i cili shkakton eksternalitete negative. Taksa ka për qëllim korrigjimin e prodhimeve të tregut dhe e bën këtë duke u vendosur atë sa eksternaliteti negativ. Kur ndodhin eksternalitetet negative kostoja sociale e aktivitetit të biznesit nuk mbulohet nga kostot private të këtij aktiviteti. Në rastet e tilla prodhimi i tregut nuk konsiderohet efikas dhe mund të shoqërohet me mbi konsumim të produktit. Një shembull i këtij eksternaliteti, i cili përmendet më shpesh, është ai i ndotjes së mjedisit.

¹⁵ Hipoteza e “dividentit të dyfishtë” sugjeron se tatimi i rritur mbi aktivitetet që ndotin mjedisin mund të sjellë dy lloje përfitimesh. E para i referohet përmirësimit të mjedisit dhe e dyta përmirësimit të efikasitetit ekonomike nga përdorimi i të ardhurave nga tatimi mjedisor për të ulur tatime të tjera si tatimi mbi të ardhura të cilat sjell ndryshime në ofertën e punës dhe në vendimet për kursime.

mbi punësimin, meqenëse ato ulin sjelljet që dëmtojnë mjedisin dhe ndihmojnë në uljen e çrregullimeve në tregun e punës. Megjithatë Parry dhe Oates tregojnë se pavarësisht parandalimit të çrregullimeve në sistemin tatimor, tatimi mjedisor krijon çrregullime edhe për vetë atë (Parry, I. W.H. and W. E. Oates , 1998). Rritja e tatimit rrit kostot e prodhimit dhe jo vetëm kaq, pasi mund të ndryshojnë edhe vendimet e kompanive për investim dhe prodhim, duke ndikuar kështu mbi kërkesën për punë. Nëse rritja e kostove rëndon apo kalon në çmimin me të cilin konsumatorët blejnë, atëherë paga reale neto e familjarëve apo individëve do të ulet, gjë e cila do të ndikojë në ofertën për punë. Pra ekzistenca e “dividendit të dyfishtë” bie në kundërshtim me atë që shprehet në literaturë¹⁶. Megjithatë në afatin e gjatë tatimi mjedisor duhet ta ulë bazën tatimore duke rezultuar me më pak të ardhura dhe “dividend të dyfishtë” të reduktuar. Në kontrast me instrumentet rregullatorë tatimi mjedisor vendos një çmim për çdo njësi ndotjeje, kështu ai krijon nxitësa të vazhdueshëm për të ulur ndotjen për çdo njësi dhe inkurajon kosto të ulëta për sasi të kufizuara midis ndotësve të mjedisit, meqenëse ky tatim i lë atyre mundësinë e zgjedhjes së zvogëlimit të teknologjisë së përdorur. Pra tatimi mjedisor mund të inkurajojë inovacionin dhe aktivitetet e kërkim - zhvillimit për të pasur teknologji të reja dhe që e ndotin më pak mjedisin. E gjitha kjo rezulton në një përzierje më të barabartë midis një procesi të pastër prodhimi dhe masave zvogëluese krahasuar me ato të përftuara nga ndërhyrjet e tjera rregulluese apo ligjore. Një bazë e gjerë tatimore, në kuptimin gjeografik zakonisht shkakton më shumë aktivitete të reja, meqenëse mundësitë për të përfituar prej inovacionit, për shembull duke ia shitur atë të tjerëve, janë më të mëdha.

- Tatimi mbi pronën

¹⁶ Për detaje mund ti referoheni punimit të Kosonen dhe Nicodeme (2009).

Klasifikimi që OECD i bën tatimit mbi pronësinë përfshin në këtë kategori tatimin mbi pronat e paluajtshme (të paguara nga familjarët dhe nga bizneset), tatimin mbi trashëgiminë (paguar gjithashtu nga familjarët dhe bizneset), tatimin mbi dhuratat dhe trashëgimitë dhe tatimin mbi transaksionet financiare dhe ato kapitale. Këto tatime për nga vetë natyra e tyre janë shumë heterogjene si të tilla edhe efektet që ato kanë mbi rritjen ekonomike janë të ndryshme. Për motive trashëgimie tatimi mbi dhuratat dhe trashëgimitë ka ndikime të ndryshme mbi efikasitetin ekonomik¹⁷ (Cremer H. and P. Pestieau, 2003). Tatimi mbi trashëgiminë e planifikuar shkakton luhajtje apo çrregullime si pasojë e dekurajimit mbi akumulimin e kapitalit duke i sjellë, në rast trashëgimie, disavantazhe dhe pengesa kompanive. Megjithatë nëse trashëgimia është rezultat i paplanifikuar i një parandalimi apo motivi konsumi, atëherë tatimi mbi të mund të mos e ndryshojë sjelljen ekonomike. Tatimet periodike mbi pasuritë konsiderohen afërsisht analoge me tatimin mbi të ardhurat kapitale mbi atë pasuri, si pasojë efektet e tyre mbi aktivitetin ekonomik duhet të konsiderohen të ngjashme (Boadway R., E. Chamberlain and C. Emmerson , 2009). Ashtu siç është shpjeguar edhe më lart këto tatime mund të ndryshojnë vendimet për të rritur kapitalin, si për shembull kursimi dhe investimi të cilat ndikojnë mbi produktivitetin në afatin e gjatë. Tatimi mbi pronat e paluajtshme zakonisht konsiderohet si më pak çrregullues, kjo pasi ai nuk ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në vendimet e agjentëve ekonomikë për të ofruar punë dhe për të investuar në kapital njerëzor dhe fizik aq sa bëjnë tatimet e tjera (Boadway R., E. Chamberlain and C. Emmerson , 2009). Për më tepër palëvizshmëria e bazës tatimore konsiderohet si një tërheqës i pronësisë. Megjithëse prona mund të jetë e paluajtshme, në afatin e mesëm tatimet mbi të mund të influencojnë vendimet fillestare mbi vendndodhjen e bizneseve dhe çmimit të pronës, si bazë e tatueshme në të ardhmen, mund të shtohet tatimi që do të paguhet.

¹⁷ Për detaje referohuni Cremer and Pestieau (2003).

Ky lloj tatimi bëhet objekt ndryshimi për sjelljen, sidomos kur ato rëndojnë mbi pronat e bizneseve, duke ndikuar në vendimet për investime dhe në konkurrencën me prodhuesit e huaj. Nëse i referohemi sërish studimit të Boadway në 2009, në rishikimin që ai i bën literaturës, sugjerohet që si bazë tatimore në vend të vlerës së pasurisë të përdoret vlera e tokës (vlera e pasurisë minus vlerën e ndërtesës), kjo pasi në këtë mënyrë shmangen pengesat, jo vetëm për bizneset, por edhe për individët, që i shtohen vlerës së pronës apo pasurisë së tyre. Tatimi mbi transaksionet financiare dhe ato kapitale, nga i njëjti autor, shihet si dekurajues i transaksioneve të mjeteve duke penguar apo goditur efikasitetin e tregjeve të mjeteve. Kështu këto tatime mund të rregullojnë vendimet për investim duke rritur koston e kapitalit të kompanisë, ose duke dekurajuar aksionerët të investojnë në projekte me vlerë të lartë.

2.2 Vështrim mbi revistat shkencore

Jo vetëm teoritë, por edhe evidencat tregojnë rëndësinë dhe ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike të një vendi. Tatimi progresiv mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi të ardhurat e kompanive ulin kthimin neto në kapitalin njerëzor dhe atë fizik dhe këto mund ta dëmtojnë rritjen. Tatimet e larta në punësim janë veçanërisht të dëmshme pasi ato frenojnë punësimin formal dhe promovojnë punësimin në sektorin informal duke prekur apo dëmtuar të ardhurat që mbledh qeveria të cilat mund të përdoren për shpenzime produktive. Në kontrast me këtë që sapo u tha taksat indirekte, të vendosura në mënyrë jo uniforme, mbi konsumin (siç është tatimi mbi vlerën e shtuar) mund të kenë impakt më pak të dëmshëm mbi rritjen ekonomike, kjo pasi ato janë relativisht më neutrale përkundrejt vendimeve të kursimit dhe investimit dhe nuk tjetërsojnë stimujt për punë (Gray Ch., Lane T. & Varoudakis A., 2007). Kërkimet mbi rritjen ekonomike kanë tërhequr vëmendjen e ekonomistëve në fusha të ndryshme. Në konferencat e realizuara mbi rritjen ekonomike kanë marrë pjesë specialistë të fushave të ndryshme si ekonomiksi, zhvillimi,

ekonomi ndërkombëtare, teori, histori, ekonometri dhe menaxhim. Ajo çfarë gjerësisht pranohet është fakti se, kombinimi efektiv i teorisë me praktikën do ta mbajë gjallë këtë thirrje dhe teoritë e rritjes si një fushë studimi brilante do ti mbijetojnë kohës. Le të shohim, në mënyrë të përmbledhur, disa prej artikujve të botuar në revista shkencore apo prezantuar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Koester dhe Kormendi në 1988 nëpërmjet analizës së regresionit ndër sektorial treguan se norma marzhinale e tatimit, norma mesatare e tatimit fiks apo e kushtëzuar, ka efekt të pavarur negativ në normën e rritjes së prodhimit (Koester B.Reinhard dhe Roger C.Kormendi, 1988).

Në studimin e tyre Easterly dhe Rebelo, 1993, dhe Mendoza, 1997, gjetën se rritja në afatin e gjatë nuk ndikohet nga tatimi. Në kontrast me ta Widmalm, në 2001, duke përdorur të dhënat nga 23 vende të OECD gjeti se tatimi mbi të ardhurat ka efekt negativ në rritjen ekonomike. Kocherlakota dhe Yi në 1997 përdorën të dhënat historike të 100 viteve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe treguan se kur në një regresion përfshihet një variabël tatimor së bashku me një variabël të kapitalit publik variablat fiskalë japin evidenca direkte për ekzistencën e modeleve endogjene në afatin e gjatë. Në 1999, duke përdorur të dhëna nga 22 vende anëtare të OECD, Kneller, Bleaney dhe Gemmell treguan se tatimi deformues e ul rritjen ekonomike e ndërsa ai jo deformues nuk sjell të njëjtin efekt, dhe se shpenzimet qeveritare produktive e zgjerojnë rritjen e ndërsa ato joproduktive nuk sjellin rritje.

Teoritë ekonomike sugjerojnë se grupe të ndryshme tatimesh kanë efekte të ndryshme në ekonomi. Kështu Atkinson dhe Stiglitz në 1980 zhvilluan një model bazë të përhershëm për të treguar se tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi konsumin kanë efekte të ndryshme mbi vendimet e konsumit të individëve. Peretto në 2001 argumenton se vetëm tatimi mbi të ardhurat nga asetet shtëpiake ndikojnë në normën e rritjes së gjendjes së qëndrueshme të të ardhurave për frymë.

Amanja dhe Morrissey (2006) tregojnë se politikat tatimore dhe të shpenzimeve mund të dëmtojnë ose të stimulojnë rritjen ekonomike. Një sistem tatimor që shkakton deformime ndaj stimujve të agjentëve privatë për investime mund të vonojë investimet dhe rritjen ekonomike. Në mënyrë analoge nëse sistemi është i tillë që çon në ndërkombëtarizimin e faktorëve të jashtëm (eksternaliteteve) nga agjentët privatë, mund të shkaktojë efektivitet në shpërndarjen e burimeve dhe në këtë mënyrë të nxisë investimet dhe rritjen ekonomike. Mançellari ka hulumtuar efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri duke përdorur modelet e vektorëve strukturorë auto regresivë për të matur reagimin e PBB-së, çmimeve dhe normave të interesit ndaj goditjeve në shpenzimet korrente, shpenzimet kapitale dhe të ardhurat tatimore të qeverisë. Ka rezultuar se ulja e taksave ka shumëzuesin më të lartë fiskal, duke arritur në 1.65 pikë pas katër tremujorësh. Mes shpenzimeve korrente dhe kapitale këto të fundit shumëzojnë PBB-në me 0.95 pas një tremujori, ndërsa shpenzimet korrente e shumëzojnë me 0.69 në pikën maksimale, pas një tremujori. Ndërkohë që një ulje taksash sjell rritje të normave të interesit për shkak të rritjes së konsumit dhe uljes së kursimeve, goditjet e shpenzimeve kapitale dhe korrente nuk sjellin ndryshime statistikisht të rëndësishme në normat e interesit. Rritja e shpenzimeve kapitale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm mbi çmimet (Mançellari, 2010). Punime më të hershme flasin për efekte të vogla në afatin e gjatë në rritjen ekonomike. Studimet provojnë se nivelet e taksave dhe të tatimeve kanë një influencë të ndjeshme në vendosjen e balancave të drejta midis kursimeve dhe investimeve, për rrjedhojë dhe në rritjen ekonomike. Ndër punimet më të hershme mund të përmendim Atkinson dhe Stern (1980); Poterba, Rotemberg dhe Summers (1987); Ocran (2011) dhe Easterly dhe Rebelo (1993). Në studime më të vonshme përmendim Martinez-Vazquez, Vulovic dhe Liu (2011); Li dhe Sarte (2004); Kneller, Bleaney dhe Gemmell (1999); dhe Padovano dhe Galli (2001), studime të cilat flasin për efekte domethënëse të strukturës

tatimore në rritjen ekonomike. Në të njëjtën linjë me studimet e mësipërme mund gjithashtu të përmendim Kneller, Bleaney, dhe Gemmell (1999) të cilët tregojnë se nga studimi i tyre në vendet e OECD ka rezultuar se tatimi mbi të ardhurat (tatimi direkt) ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike e ndërsa tatimi mbi konsumin nuk ka ndikim negativ. Wildman në studimin e tij, sërish në vendet e OECD, në vitin 2001, sugjeron se tatimi mbi të ardhurat personale ndikon mbi rritjen ekonomike në afatin e gjatë më shumë si pasojë e akumulimit të kapitalit njerëzor se sa nga akumulimi i kapitalit fizik. Gordon dhe Li (2009) sugjerojnë se norma më të larta të tatimit mbi fitimin shoqërohen me norma më të ulëta të rritjes ekonomike. Ashtu siç edhe mund të kuptohet studimet dhe evidencat tregojnë se zgjedhja e sistemit tatimor mund të ketë pasojë të rëndësishme mbi rritjen ekonomike dhe mbi variabla të tjerë makroekonomikë.

Tabela 1: Përmbledhje e gjetjeve të studimeve empirike mbi ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike

	Artikulli	Metoda/Të dhënat	Ndikimi	Përmbledhje e gjetjeve
1	Ergete Ferede & Bev Dahlby, <i>Ndikimi i uljes së tatimeve në rritjen ekonomike: Të dhëna nga provinca të Kanadasë</i> , 65 National Tax Journal 563-594 (2012).	Provinca të Kanadasë (1977-2006)	Negativ	Ulja me 1 për qind e tatimeve mbi fitimin e kompanive e rrit rritjen vjetore ekonomike nga 0.1 deri në 0.2 pikë.
2	Norman Gemmell, Richard Kneller, & Ismael Sanz, <i>Koha dhe qëndrueshmëria e ndikimit të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike; Të dhëna nga shtetet anëtare të OECD</i> , 121 Economic Journal F33-F58 (2011).	17 shtete anëtare të OECD (1970-2004)	Negativ	Tatimet mbi të ardhurat personale dhe ato mbi fitimet e kompanive e dëmtojnë më shumë rritjen ekonomike në afatin e gjatë, të ndjekura më pas nga deficioni dhe tatimet mbi konsumin.

3	Robert Barro & C.J. Redlick, <i>Efektet makro ekonomike të tatimeve dhe blerjeve të qeverisë</i> , 126 Quarterly Journal of Economics 51-102 (2011).	U.S.A (1912 - 2006)	Negativ	Ulja me 1 për qind e tatimeve sjell vitin e ardhshëm një rritje me 0.5 për qind të PBB-së për frymë.
4	Christina Romer & David Romer, <i>Efektet makro ekonomike të ndryshimeve tatimore; vlerësime të bazuara mbi një matje të re të lëvizjeve fiskale</i> , 100 American Economic Review 763-801 (2010).	U.S.A (104 ndryshime tatimore)	Negativ	Rritja e tatimeve ndaj PBB-së (të ardhurat federale) me 1 për qind, pas rreth 2 vitesh e ulin prodhimin me 3 për qind.
5	Alberto Alesina & Silvia Ardagna, <i>Ndryshimet e mëdha në politikën fiskale; tatimet përkundrejt shpenzimeve</i> , Tax Policy and the Economy, Vol. 24 (Univ. of Chicago Press, 2010).	Shtetet e OECD (stimujt fiskal dhe rregullimet fiskale, 1970-2007)	Negative	Stimujt fiskal të ndërtuar mbi uljen e tatimeve e rrisin më shumë zhvillimin ekonomik se sa ato të bazuara mbi rritjen e shpenzimeve. Konsolidimi fiskal i ndërtuar nga njëra anë mbi uljen e shpenzimeve dhe nga ana tjetër duke mbajtur të pandryshuar tatimet ka më shumë mundësi të uli defiçitin dhe borxhin se sa të krijojë reçension.
6	International Monetary Fund, <i>A do të na dëmtojë? Efektet makroekonomike të konsolidimit fiskal</i> , World Economic Outlook: Recovery, Risk, and Rebalancing (2010).	15 vende të zhvilluara (170 konsolidime fiskale përgjatë 30 viteve të fundit)	Negativ	Rritja më 1 për qind e të ardhurave tatimore e ul pas dy vitesh me rreth 1.3 për qind PBB-në.
7	Young Lee & Roger Gordon,	70 shtete (1980 -	Negativ	Ulja me 1 për qind e të ardhurave

	<i>Struktura tatimore dhe rritja ekonomike</i> , 89 Journal of Public Economics 1027-1043 (2005).	1997, panel-data)		tatimore mbi fitimin kapital e rrit me 0.1 deri 0.2 pikë rritjen ekonomike.
8	Randall Holcombe & Donald Lacombe, <i>Ndikimi i të ardhurave tatimore mbi PBB-në për frymë</i> , 32 Public Finance Review 292-312 (2004).	(1960 - 1990)	Negativ	Vendet të cilat i rrisin të ardhurat tatimore direkte ulin me afro 3.4 për qind PBB-në për frymë.
9	Stefan Folster & Magnus Henrekson, <i>Efektet e shpenzimeve dhe të ardhurave publike mbi rritjen</i> , 45 European Economic Review 1501-1520 (2001).	(1970 -1995)	Negativ	Të ardhurat tatimore (të vendosura në raport me PBB-në) janë të korreluara negativisht me rritjen e PBB-së.
10	M. Bleaney, N. Gemmell & R. Kneller, <i>Testimi i modeleve endogjene të rritjes; shpenzimet publike, tatimet dhe rritja ekonomike në afatin e gjatë</i> , 34 Canadian Journal of Economics 36-57 (2001).	OECD (1970 - 1995)	Negativ	Tatimet direkte ulin rritjen ekonomike. Tatimet mbi konsumin nuk sjellin ndryshime.
11	R. Kneller, M. Bleaney & N. Gemmell, <i>Politika fiskale dhe rritja ekonomike; Të dhëna nga shtetet e OECD-së</i> , 74 Journal of Public Economics 171-190 (1999).	OECD (1970 to 1995)	Negativ	Tatimet direkte ulin rritjen e PBB-së.
12	Howard Chernick, <i>Tatimet progresive dhe performanca ekonomike e qeverisë</i> , 11 Economic	U.S. A (1977 - 1993)	Negativ	Të ardhurat tatimore progresive ndikojnë negativisht mbi rritjen ekonomike.

	Development Quarterly 249-267 (1997).			
13	William Easterly & S. Rebelo, <i>Politika fiskale dhe rritja ekonomike; investigim empirik</i> , 32 Journal of Monetary Economics 417-458 (1993).	Vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim	Asnjë	Vështirë të izoloohen në mënyrë empirike efektet e tatimeve.

2.3 Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike

Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike janë thelbësore për nxitjen e zhvillimit ekonomik të një vendi. Për investitorët, treguesit më të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik janë ata të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në bilancet e tyre, si për shembull rritja e produktit të përgjithshëm bruto (PBB), rritja e PBB-së për frymë, inflacioni, rritja e popullsisë apo edhe niveli i arsimit. Hapja e dyerve të një shteti ndaj tregtisë së jashtme, investitorëve dhe punëtorëve të huaj, konsiderohen si të tjera strategji të suksesshme për të arritur më shumë zhvillim ekonomik. Qeveritë duhet të miratojnë strategji ekonomike afatmesme, politika fiskale të disiplinuar dhe një qasje të hapur ndaj tregtisë me jashtë. Politikat nxitëse kanë si pjesë të rëndësishme të tyre politikat e qëndrueshme makroekonomike, këto politika ulin riskun e të bërit biznes, sigurojnë klimë të parashikueshme për biznesin si edhe ndikojnë në vendimmarrjen për investimet (Baumol J.W & Blinder S.A, 2009). Meqenëse stabiliteti makroekonomik konsiderohet si parakusht për rritjen ekonomike, natyrshëm na lind pyetja: Çfarë është stabiliteti ekonomik dhe si përkufizohet ai? Stabiliteti ekonomik përkufizohet si llogari rrjedhëse dhe bilanc fiskal i qëndrueshëm me nivel të ulët dhe në rënie të borxhit publik, inflacion të ulët me një shifër dhe rritje të PBB-së për frymë (Laurence, 2008). Rritja e vazhdueshme është çelësi i

stabilitetit makroekonomik. Investitorët, vendas apo të huaj qofshin ata, frenohen nga mungesa e stabilitetit ekonomik që rezulton në periudha me inflacion shumë të lartë apo goditje të tregut financiar. Rënia e PBB-së sinjalizon për një treg në amulli. Kur kostot janë shumë të larta, bizneset nuk mund të funksionojnë dhe nuk mund të realizojnë fitime. Nga ana tjetër edhe ndryshimet e çmimeve e dëmtojnë së tepërmi biznesin. Kështu gjerësisht pranohet se mjedisi i fuqishëm dhe i qëndrueshëm makroekonomik është i domosdoshëm për të mbështetur rritjen afatgjatë ekonomike (Snowdon B. & Howard R.V., 2005). Por cilët janë treguesit makroekonomikë që përdoren më shumë nga investitorët në analizat dhe vendimmarrjet e tyre? Ndërkohë që forumet ekonomike, institucionet donatore, bankat e zhvillimit, bankat e investimeve, ekonomistët dhe akademikët studiojnë me kujdes statistikën që lidhen me ofertën monetare, apo edhe deficitin e llogarive rrjedhëse, pjesa dërrmuese e investitorëve përqendrohen tek treguesit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në bilancin e biznesit të tyre. Investitorët e huaj e shohin rritjen ekonomike dhe veçanërisht nivelin e rritjes së PBB-së dhe PBB-së për frymë, si tregues të destinacioneve me potencial investues (Mishkin F. S., 2012). Shtetet me PBB në rritje, jo vetëm që shihen si tregje potenciale, por ekonomitë e tyre janë gjithashtu në gjendje të mbështesin investimet me burime të ndryshme si kapital njerëzor, furnitorë dhe shërbime, burime këto që i duhen investitorëve për të zgjeruar dhe modernizuar biznesin e tyre. Niveli i rritjes së popullsisë dhe arsimit universitar shpesh shihen si potenciale për kapitalin njerëzor (Gärtner, 2006). Një shtet me kosto të ulët, por me ekonomi të paqëndrueshme, vërtet mund të sigurojë hyrje konkurruese në treg, por modeli i tij mund të mos jetë një model i qëndrueshëm biznesi. Kështu për shembull kompanitë të cilat kërkojnë specialistë të fushave të ndryshme i kushtojnë shumë kujdes faktit nëse vendi ku do të vendosin investimet e tyre mund të prodhojë apo jo punonjës të cilët zotërojnë aftësitë dhe mjeshtritë e kërkuara të tyre. Disa kompani prodhuese, në mënyrë që

të tërheqin krah të lirë pune dhe lehtësira të ndryshme nga qeveritë, kërkojnë të vendosen në zona me papunësi të lartë, ndërkohë që kompani të tjera mallrash konsumi dhe shërbimesh e shohin papunësinë e lartë, në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, si një tregues se vendi nuk e ka arritur stabilitetin makroekonomik dhe se tregu i brendshëm është i paqëndrueshëm. Pas këtij trajtimi mund të ndërtojmë një tjetër pyetje: Si mund të krijohet një mjedis makroekonomik i fuqishëm?

Nuk ka një recetë politikash standarde për krijimin e një mjedisi makroekonomik të fuqishëm dhe stimulimin e rritjes ekonomike, e cila të jetë e suksesshme për të gjitha ekonomitë. Sidoqoftë, mbi bazën e praktikave më të mira të disa prej ekonomive në tranzicion të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ajo vetë jep disa orientime të përgjithshme për shtetet që ende nuk e kanë arritur stabilitetin makroekonomik. Megjithatë duhet të kemi parasysh se këto politika nuk duhet të merren si standarde, por duhen interpretuar dhe përshtatur sipas kushteve dhe specifikave të secilit vend. Kështu OSBE në raportin e saj për vitin 2013 ndër të tjera sugjeron:

- Politikë të disiplinuar fiskale. Ndryshimet në politikat fiskale që sjellin mes të tjerash luhatje të nivelit të taksave shqetësojnë, si investitorët e huaj, ashtu edhe ata vendas. Premisat e borxheve të mëdha shqetësojnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare. Shpenzimet e kontrolluara qeveritare të shoqëruara me nivel konkurrues taksash dhe një sistem tatimor të thjeshtë dhe të qëndrueshëm, promovojnë zhvillimin e biznesit.
- Politika në mbështetje të tregtisë ndërkombëtare. Politikat liberale tregtare janë të rëndësishme sepse u sigurojnë bizneseve akses më të madh dhe tërheqin investitorë të huaj që kërkojnë të eksportojnë në tregje të tjera rajonale. Politikat proteksioniste i dekurajojnë investitorët. Politikat e fuqishme në mbështetje të tregtisë nënkuptojnë

lidhjen e marrëveshjeve rajonale dhe dypalëshe të tregtisë së lirë, me vendin me tarifat më të ulëta në përputhje me normat ndërkombëtare, përdorim të pakufizuar të valutës së huaj në tregti dhe sistem doganor funksional dhe jo të korruptuar.

- Lehtësim të lëvizjeve të fluksit të kapitalit ndërkombëtar. Mund të ekzistojë një tendencë për të administruar ekonominë makro nëpërmjet politikave monetare. Një bankë qendrore edhe pse ka disa “leva manovrash” në dispozicion, nuk mundet që e vetme të krijojë, të drejtojë apo të administrojë një mjedis të favorshëm makroekonomik. Janë qeveritë ato të cilat ndihmojnë në krijimin e mjedisit të favorshëm, kur lehtësojnë lëvizjet e tregjeve me kapital ndërkombëtar nëpërmjet politikave që mbështesin këmbimin e monedhave, stabilizimin e kursit të këmbimit dhe interesat e ulëta.

Mundësitë dhe nxitësit që firmat të investojnë, të hapin vende pune dhe të rriten, varen më së shumti nga fitimet e pritshme. Fitimet ndikohen nga kostot, rreziqet dhe barrierat ndaj konkurrencës. Sipas Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) qeveritë mund të kenë një ndikim të madh në secilin prej tre faktorëve të mëposhtëm: (BERZH, 2010)

- Kosto. Nëpërmjet një rregullatori dhe një procedure, taksave, nivelit të korrupsionit, shërbimeve të infrastrukturës, rregullimeve të tregut të punës dhe financave.
- Risk. Nëpërmjet politikave të parashikueshme, të drejtave të pronësisë dhe ekzekutimit të kontratave.
- Barriera ndaj konkurrencës. Nëpërmjet rregullimeve të cilat kontrollojnë bizneset e reja dhe falimentimin, ligjit për konkurrencën dhe hyrjen në tregjet e financave dhe infrastrukturës.

Në këtë pjesë të trajtimit të stabilitetit makroekonomik trajtuam rëndësinë e tij dhe disa prej faktorëve që ndikojnë mbi të. Le të shohim tashmë se si lidhet politika tatimore me stabilitetin ekonomik. Tatimet dhe taksat janë të domosdoshme për rritjen e të ardhurave publike, të cilat nga ana e tyre janë të domosdoshme për qeveritë, në mënyrë që ato të financojnë operacionet e tyre dhe ti garantojnë shtetasve sigurinë dhe shërbimet e tjera bazë. Megjithatë, praktikat dhe politikat tatimore joefikase, diskriminuese dhe tepër rënduese, mund të dekurajojnë pagimin me vullnet të lirë të tatimeve nga ana e tatimpaguesve. Kjo gjë ul nivelin e të ardhurave tatimore, rrit tundimin për korrupsion dhe bën që disa kompani në mënyrë që të fshehin transaksione të ndryshme nga pasqyrat e tyre financiare të përdorin praktikat jo transparente dhe joefikase. Në shumë ekonomi në tranzicion, procedurat për mbledhjen e taksave janë akoma të dobëta dhe evazoni tatimor është mjaft i përhapur. Punonjësve tatimorë shpesh u duhet ta mësojnë në praktikë mënyrën se si të operojnë me një sistem tatimor të bazuar te tregu dhe shumë zyrave tatimore u mungon teknologjia dhe infrastruktura e nevojshme për ecurinë optimale dhe funksionimin e tyre. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive të ndryshme të mbledhjes së taksave, si për shembull midis organeve tatimore dhe atyre doganore, shpesh është i dobët. Mangësitë në sistemin gjyqësor e bëjnë edhe më të vështirë mbledhjen e taksave. Këto probleme i ngarkojnë një barrë të pabarabartë kompanive private që duan të respektojnë ligjin. Por jo vetëm kaq, ato gjithashtu e privojnë shtetin nga të ardhurat publike aq shumë të nevojshme. Rritja e rrezikut dhe kostove potenciale të evazionit tatimor dhe nxitja e kulturës së qeverisjes së përbashkët, mund ti bindin firmat që të mos ndërmarrin praktika të paligjshme. Politikat dhe praktikat e këqija tatimore frenojnë, si biznesin në vend, ashtu edhe investimet e huaja. Kjo ndodh për shkak se këto politika dhe praktika rrisin kostot e tyre, injektojnë rrezik dhe pasiguri dhe ulin konkurrencën. Politikat tatimore të fokusuara tek zhvillimi duhet të kenë si kryefjalë të tyre, jo

vetëm rritjen në maksimum të mbledhjes së të ardhurave tatimore, por edhe krijimin e ruajtjen e një mjedisi biznesi i cili nxit zhvillimin ekonomik. Nivelet e tatimeve dhe taksave mund të ndikojnë në vendimin e investitorëve lidhur me vendin se ku do të investojnë brenda një rajoni specifik. Regjimet tatimore për biznesin duhet të bazohen në politika të balancuara të cilat projektohen në planin afatgjatë.

2.4 Ideologjia e financave publike dhe linjat e funksioneve të shtetit

Nuk është e rëndësishme të analizohen vetëm efektet e veprimeve të qeverisë në lidhje me mënyrën e të tatuarit dhe shpenzimet, por edhe me mënyrën se si këto veprime duhet të shihen. Pikëpamjet ideologjike mbi lidhjen e individit me shtetin ndikojnë mbi mënyrën e funksionimit të qeverisë në sferën ekonomike (Harvey S.R & Gayer T., 2008). Filozofët politikë kanë veçuar dy teori kryesore:

Pikëpamja organike mbi qeverinë

Shoqëria perceptohet si një organizëm natyror. Secili individ është pjesë e këtij organizimi dhe qeveria mund të mendohet si zemra e tij. Individu ka rëndësi vetëm si pjesë e komunitetit dhe e mira e individit përcaktohet në lidhje me të mirën e tërësisë. Rrjedhimisht komuniteti vendos mbi individin. Objektivat e shoqërisë vendosen nga shteti, i cili e drejton shoqërinë drejt realizimit të tyre. Sigurisht që zgjedhja e objektivave ndryshon shumë. Kështu Platoni perceptoi një shtet, objektivi i të cilit ishte arritja e moshës së artë, në të cilin aktivitetet njerëzore do të udhëhiqeshin nga racionaliteti i plotë. Nga ana tjetër Adolf Hitler i shihte qëllimet e shtetit si arritje të pastërtisë raciale. Sipas tij “*Shteti është një mjet drejt një qëllimi. Qëllimi i tij qëndron në mbrojtjen dhe avancimin e një komuniteti me krijesa fizikisht dhe psikologjikisht homogjene*”. Sipas Leninit shteti i proletariatit kishte si qëllim të “*udhëhiqte të gjithë popullin drejt*

socializmit,.... të qenit mësues, udhëheqës dhe drejtues i të gjithë popullit trim dhe punëtor”.

Përkrahësit e pikëpamjes organike zakonisht argumentojnë se objektiva të caktuar natyrshëm ndiqen nga organizimi shoqëror. Ndjekja e sovranitetit në disa zona gjeografike është shembull i një objektivi të tillë të natyrshëm. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se filozofët kanë luftuar me shekuj për të shpjeguar se çfarë do të thotë e natyrshme, përgjigja ende nuk është e qartë.

Pikëpamja mekançiste mbi qeverinë

Sipas kësaj pikëpamje, qeveria nuk është pjesë organike e shoqërisë. Për më tepër është një mjet i krijuar nga individët për të arritur më mirë objektivat e tyre individuale. Henry Clay, politikan amerikan, në vitin 1829 theksonte se “*Qeveria është një kujdestar dhe zyrtarët e saj tutorë dhe si kujdestari ashtu edhe tutori krijohen për të mirën e njerëzve*”. Në qendër është njeriu dhe jo grupi. Duke pranuar se qeveria ekziston për të mirën e njerëzve, ekziston akoma problemi i përcaktimit se çfarë është e mirë dhe se si duhet të veprojë qeveria për ta promovuar atë. Në të vërtetë ekziston një marrëveshje universale që e mira për individët është kur qeveria i mbron ata nga dhuna. Për të vepruar kështu ajo, qeveria, duhet të ketë një monopol me fuqi detyruese. Në të kundërt do të kishim anarki. Adam Smith në veprën e tij “*Pasuria e Kombeve*” argumenton se qeveria duhet të mbrojë shoqërinë nga dhuna dhe nga pushteti i shoqërive të tjera të pavarura dhe të mbrojë sa më shumë të jetë e mundur çdo anëtar të shoqërisë nga padrejtësia ose nga shtypja e çdo anëtari tjetër të saj (Smith, 1977, p. 182). Më tej Smith, në të njëjtën vepër, argumenton se qeveria duhet të ketë përgjegjësinë për krijimin dhe mirëmbajtjen e punëve të caktuara publike dhe institucioneve të caktuara publike, të cilat nuk mund të jenë kurrë në interes të një individi ose të një numri të vogël individësh. Në këtë pikë ndahen opinionet brenda pikëpamjes mekançiste. Liberalët, të cilët besojnë në një qeveri shumë të kufizuar, janë kundër çdo roli të qeverisë për të përmirësuar mirëqenien sociale. Nga ana tjetër demokratët socialë besojnë se

ndërhyrja e qeverisë është e rëndësishme për të mirën e individëve. Këto ndërhyrje mund të marrin forma të ndryshme.

Ideologjia mund të ndikojë mbi pikëpamjet lidhur me qëllimin e përshtatshëm të veprimtarisë së qeverisë. Megjithatë për të formuar pikëpamje të ndjeshmërisë rreth politikës publike kërkohet më shumë se sa thjesht ideologji. Kërkohet informacion rreth funksionimit aktual të qeverisë. Kërkohen të njihen ligjet dhe kufizimet e tyre mbi sektorin publik. Kërkohet të njihen gjithashtu burimet e të ardhurave dhe mënyrat e financimit të shpenzimeve publike.

Në 1959 Musgrave ka identifikuar tre funksione bazë të një shteti alokimit, rishpërndarjen dhe stabilizimin (Stiglitz J. E., 2002). Alokimi ndodh atëherë kur shteti ndërhyr për të korrigjuar çrregullime ekonomike të shkaktuara nga dështimet e tregut. Nëse tregu nuk siguron shpërndarje adekuate të të ardhurave, thënë ndryshe ai dështon në këtë operacion, atëherë rishpërndarja mbetet detyrë e shtetit. Nëse tregu është i paqëndrueshëm, për shembull ka papunësi dhe inflacion të lartë, atëherë lind nevoja e linjës së tretë të aktiviteteve të shtetit, stabilizimit. Këto tre linja të aktiviteteve të shtetit njihen edhe si roli neoklasik i shtetit.

2.5 Klima e biznesit dhe e investimeve

Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Një mjedis i dobët biznesi, domethënë i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë pengon zhvillimin ekonomik, e kundërta ndodh nëse shtetet miratojnë politika pro-zhvillim dhe ligje e praktika që mbështesin investimet dhe zhvillimin e biznesit (Mooij, R. A. & Ederveen, S, 2003). Nëse kërkojmë një përkufizim të saktë për konceptin e klimës së favorshme të biznesit dhe të investimeve, nuk do të mund ta gjenim atë. Megjithatë mund të themi se për shembull Banka Botërore në klimën e biznesit dhe të investimeve përfshin mundësinë dhe nxitësit për kompanitë

që të investojnë në mënyrë produktive, të hapin vende pune dhe të zgjerohen (BB dhe IFC, 2009). Në vija të ngjashme, mund të themi se klima e biznesit dhe e investimeve shërben si një kuadër i cili u mundëson kompanive të huaja dhe vendase, të bëjnë biznes dhe të kërkojnë fitime në një vend të caktuar. Në përgjithësi klima e investimeve mund të përkufizohet nga tre variabla:

- Politikat makroekonomike si ato fiskale, monetare dhe tregtare.
- Qeverisja dhe institucionet.
- Infrastruktura.

Klima e biznesit dhe e investimeve përbëhet, jo vetëm nga niveli i taksave dhe nxitësit fiskale për bizneset, por edhe nga komponentë të tjerë vendimtare siç janë edhe stabiliteti politik, shteti i së drejtës, kushtet makroekonomike, perceptimet e qeverisë dhe mjedisi rregullator.

Gjendja e klimës së biznesit dhe investimeve të një shteti është një faktor kyç i aftësisë së tij për të thithur investime të huaja dhe për të zhvilluar biznesin (Buettner, 2007). Ndërmarrjet ndërkombëtare parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë në nivele minimale. Përveç kësaj, bizneset e vogla dhe të mesme, forma e organizimit të biznesi më e përhapur në vendin tonë, tentojnë të zhvillohen në një klimë ku nuk rëndohen së tepërmi me taksa dhe burokraci. Banka Botërore në faqen e saj zyrtare shkruan: “Klima e mirë e investimeve është një shtyllë jetike për strategjinë e një shteti për të stimuluar rritjen ekonomike, e cila pastaj ofron mundësi për të varfrit, që të kenë punë më produktive dhe të ardhura më të larta”.

Në mbarë globin vendet e pasura priren të kenë klimë më të favorshme për biznesin dhe investimet. Ka një lidhje të pandashme ndërmjet rritjes ekonomike, investimeve dhe klimës së biznesit. Shumë nga vendet e Evropës Lindore pa rezerva të mëdha energjie apo lënde të parë, i kanë kthyer ekonomitë e tyre në destinacione globale për tërheqjen e IHD-ve nëpërmjet

reformimit të klimës së tyre të biznesit dhe investimeve (Baranova, V. & Janickova, L., 2012). Qeveritë shpesh e shpërfillin rëndësinë e klimës së biznesit kur ftojnë investimet e huaja të drejtpërdrejta. Ato priren të përqendrohen tek përmasat e tregut, niveli i burimeve natyrore dhe kostot. Edhe pse këta faktorë janë të rëndësishëm, klima e investimeve është një faktor vendimtar i cili asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar.

Por cilat janë mundësitë për ekonomitë e vendeve në zhvillim? Si mund këto vende të përmirësojnë klimën e biznesit?

Për të qenë konkurrues vendeve në zhvillim u duhet të përmirësojnë klimën e biznesit. Pothuajse të gjithë indekset e organizatave ndërkombëtare që lidhen me klimën e biznesit tregojnë se vendet më të pasura dhe me të ardhura mesatare, kanë klimën e biznesit më të fuqishme apo me përmirësim më të shpejtë, dhe vendet që kanë marrë masa për përmirësimin e klimës së biznesit, kanë IHD më të mëdha dhe ecuri ekonomike më të mirë. Edhe pse ndërmarrjet private janë vetë përgjegjëse për suksesin e tyre, i takon qeverive që të sigurojnë kuadrin më të mirë të mundshëm që këto ndërmarrje të operojnë me sukses. Qeveritë zakonisht i kanë mjetet për t'ua bërë njerëzve më të lehtë biznesin. Rritja e nivelit teknologjik dhe nxitja e rritjes ekonomike janë çështje komplekse dhe të vështira, por ndryshimi i legjislacionit për punësimin, thjeshtimi i procedurave të dhënies së lejeve, përpilimi i regjistrimit kombëtar të tokës, apo mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës, janë çështje të cilat zgjidhjen e presin nga qeveria. Nëse qeveritë dëshirojnë të tërheqin IHD dhe të zhvillojnë biznesin, duhet të angazhohen seriozisht në ndërtimin e një politike të kujdesshme. Regjimet e dobëta rregullator dhe kapacitetet e dobëta institucionale, që çojnë në sjellje jo konkurruese të tregut apo në mos mbledhjen e taksave, priren të kenë ndikim negativ në zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe në thithjen e IHD.

Në mënyrë që mjedisi politik të mbështesë klimën e duhur për të bërë biznes dhe për të tërhequr investime duhet mbi të gjitha të ketë stabilitet legjislativ. Ndryshimet e vazhdueshme të bazës ligjore ndikojnë negativisht në aftësinë e investorëve për të parashikuar fitimet e projekteve të tyre. Nëse një investitori do ti duhej që kohë pas kohe të ndryshonte praktikatat apo operacionet e përditshme të tij atëherë të gjitha këto ndryshime do të përktheheshin në më shumë kosto dhe humbje kohe.

Mjedisi i qëndrueshëm legjislativ është mjaft i rëndësishëm për vendimmarrjen e investorëve. Edhe në rastet kur kushtet e tjera do të ishin të qëndrueshme, ndryshimet legislative do të krijojnë investorëve përshtypjet se ka shumë mundësi që të ndryshojnë kushtet në të cilat ata janë duke bërë biznes. Këto ndryshime mund gjithashtu ti detyrojnë investorët të heqin dorë nga investimet apo edhe nga projektet për investime. Nëse për një projekt të caktuar norma e riskut konsiderohet më e lartë se norma e fitimit, atëherë investorët e huaj priren të zhvendosin kapitalin e tyre drejt një vendi tjetër. Në raportin e tij të vitit 2013 Komisioni Evropian (KE) thekson se çdo mungesë stabiliteti në sistem krijon rreziqe të mëdha për investimet, çka shprehet në kosto më të larta për konsumatorët (Union, 2013). Sipas të njëjtit raport tri masat e mëposhtme mund të ndihmojnë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që të arrijnë stabilitet më të madh legjislativ duke rritur transparencën dhe parashikimin si në procesin legjislativ, ashtu edhe në atë ligjbërës.

- Miratimi i legjislacionit tregtar të krahasueshëm ose të ngjashëm me Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian (BE). Ky rekomandim nënvizon nevojën për ligje tregtare që janë të njohura për investorët dhe janë në të njëjtën linjë me standardet ndërkombëtare. Në BE, *acquis communautaire* siguron një kornizë të njohur ligjesh të cilat investorët i njohin dhe i kuptojnë mirë. Miratimi i ligjeve të ngjashme, duke mos

diskriminuar shtetet jo anëtare të BE-së dhe OSBE-së, u siguron investitorëve mundësi parashikimi, qetësi dhe krijon një atmosfere pro-investim. Gjithashtu, kur investitorët investojnë në një shtet me mjedis të përcaktuar legjislativ dhe rregullator, atëherë për ta është më e lehtë dhe më e lirë që të zgjerohen në tregje, që rregullohen nga kuadër të ngjashme apo të njëjta. Udhëzuesit e OSBE-së nuk propozojnë që, shtetet të cilat nuk janë zyrtarisht në procesin e zgjerimit të BE-së duhet në mënyrë specifike të përputhin legjislacionin e tyre me *acquis*. Secili shtet pjesëmarrës i OSBE-së është sovran dhe ka paketat e veta ligjore, bazuar në traditën e tyre ligjore dhe kulturore, qoftë kur kjo traditë është e drejta e përbashkët, e drejta civile, apo diçka tërësisht tjetër. Por ato sugjerojnë që këto vende duhet të mirë orientohen për të qenë të hapura ndaj reformës në legjislacionin tregtar dhe të miratojnë ligje jo diskriminuese që janë sa më afër legjislacionit ndërkombëtar.

- Vendosja e një periudhe për njoftime dhe komente për projektligjet për tregtinë. Qeveritë e kanë më mirë që të lejojnë një periudhë 30-ditore për njoftim dhe komente për legjislacionin e lidhur me biznesin, 90 ditë për ligjet me ndikim të fuqishëm mbi tregtinë, duke postuar projektligjet në një vend qendror në internet si dhe njoftime elektronike aktive për palët e interesuara dhe/ose të regjistruara. Dekretet emergjente dhe urdhrat e befasishtë ekzekutivë nuk pëlqehen aspak nga investitorët, me përjashtim të rasteve kur ato nxirren si përgjigje ndaj një problemi specifik dhe të njohur. Publikimi paraprak i projektligjeve i paralajmëron investitorët dhe biznesin se ata ndoshta duhet të përgatiten që të ndryshojnë mënyrën si bëjnë biznes. Gjithashtu, komentet e ardhura nga njerëzit e biznesit zakonisht përmirësojnë legjislacionin tregtar. Kur qeveritë kërkojnë përshtypjet dhe vërejtjet e komunitetit të biznesit, shpesh ndikojnë pozitivisht në mjedisin e biznesit.

Përdorimi i internetit cilësohet si metoda më e mirë për njoftime dhe komente, sepse e zgjeron rrezen e përhapjes së njoftimit dhe të gjitha projekt-aktet mund të gjenden në një vend qendror.

- Vendosja e një kalendari ngjarjesh periodike legjislativë. Ideja është që ndryshimet legjislativë të jenë të parashikueshme. Për shembull, rishikimi i nivelit të taksave mund të bëhet një apo dy herë në vit. Kështu firmat janë të përgatitura me rastin e çdo eventualiteti.

Suksesi i ndërmarrjeve të sektorit privat qëndron në aftësinë e ndërmarrjes për të ofruar produkte dhe shërbime që kërkohen nga tregu, me çmime të pranueshme dhe me synimin për të nxjerrë fitime. Mësimet e nxjerra nga eksperiencia e shumë vendeve mbështetin fuqimisht tezën se përpjekjet e qeverive për të siguruar suksesin e kompanive duke ndërhyrë drejtpërdrejt në administrimin e tyre, ose duke manipuluar konkurrencën ndërmjet kompanive me metodën e grushtit të hekurt rrallëherë, në mos kurrë, prodhojnë rezultate optimale. Veç kësaj, politikat që ideohen për vendosjen e një klime të mirë biznesi, mund të ndihmojnë në ndërtimin e një kuadri bazë i cili u ofron kompanive mundësi maksimale për sukses.

2.6 Ndikimi i shtetit dhe rritja ekonomike

Që prej mesit të shekullit XVIII historia njerëzore dominohej nga fenomeni modern i rritjes ekonomike. Debati në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi përqendrohet më së shumti në efektin që ai ka në rritjen ekonomike. Rëndësia e rritjes ekonomike, në bazë të së cilës qëndron përmirësimi i mirëqenies së shoqërisë konfirmohet nga një sërë studimesh empirike (Brian Snowdon and Howard R Vane, 2005, p. 589). Ekspertët e ekonomisë njëzëri bien dakord me rolet e reja të shtetit në epokën moderne të shek. XXI. Si të tilla tashmë përmenden roli

stabilizues që siguron kontrollin e nevojshëm për të evituar pasojat negative të një hapjeje ekonomike dhe tregtare totale, roli garant i transparencës, qëndrueshmërisë së sistemit financiar, bankave dhe institucioneve të tjera financiare, roli promovues dhe shpërndarës i informacionit, roli aktiv në zbulimin dhe konsolidimin e burimeve efektive të rritjes dhe zhvillimit, sepse shteti është i vetmi aktor kombëtar që mund ti angazhojë të gjithë aktorët e tjerë në linjën e një vizioni afatgjatë të qëndrueshëm, roli organizues dhe garantues i solidaritetit kombëtar dhe i politikave sociale dhe roli i menaxherit në atë që quhet qeverisje e kujdesshme e tregjeve (Civici, Shteti apo tregu. cilin model zhvillimi të zgjedhim?, 2013, p. 40). Nëse do i referohemi raportit vjetor të Bankës Botërore për vitin 2014 qartazi shquajmë se standardet e jetesës ndryshojnë, jo vetëm nga njëri shtet në tjetrin, por në kohë të ndryshme edhe brenda së njëjtit shtet (Bank W. , 2014). Por çfarë i shpjegon këto ndryshime në kohë, brenda së njëjtit shtet dhe midis shteteve të ndryshme? Shpjegimi është i thjeshtë, diferenca në produktivitetin e shteteve apo atë të një shteti në periudha të ndryshme kohore, thënë ndryshe diferenca në sasinë e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara nga çdo njësi e burimit punë (Acemoglu, 2008). Në ato vende ku punonjësit mund të prodhojnë një sasi më të madhe të të mirave dhe shërbimeve në njësi të kohës, shtetasit kanë standarde jetese më të lartë, e kundërta ndodh në ato shtete ku punonjësit janë më pak produktivë. Pra mund të themi se norma e rritjes së produktivitetit të një shteti përcakton normën e rritjes së të ardhurave mesatare të tij. Marrëdhënia midis produktivitetit dhe standardit të jetesës ka shfaqur nevojën për politika publike. Kur mendohet rreth politikave të cilat do të ndikonin mbi standardin e jetesës, pyetja më thelbësore që lind është se si ajo mund të ndikojë aftësitë tona për të prodhuar të mira dhe shërbime (Mankin, N.G., & Biederman, D.K, 2003, p. 14). Rritja ekonomike përcaktohet si rritje në prodhimin përfundimtar. Kjo, sipas autorëve të cituar pak më lart, mund të ndodhë në një nga katër mënyrat e mëposhtme:

1. Një agjent qoftë ky individ, grup, privat apo publik, vendos të prodhojë më shumë se sa të mirat dhe shërbimet ekzistuese me çmimin e vendosur nga tregu apo institucionet përgjegjëse. Kjo rritje e prodhimit nuk matet nga rënia e prodhimit të një agjenti tjetër, gjë e cila mund të ndodhë edhe si pasojë e rënies së kërkesës për produktet e tij, apo sepse agjenti i ri ka marrë burimet që më parë i përdornin të tjerët. Kjo lloj rritje është e para që perceptohet nga individët si rritja ekonomike. Ekonomistët argumentojnë se kurba e kërkesës, zakonisht, zhvendoset poshtë, pasi individët janë të gatshëm të paguajnë më shumë për njësitë e para të produkteve dhe shërbimeve të cilat ata konsumojnë në krahasim me njësitë e konsumuara më pas. Kështu agjentët të cilët hyjnë në treg me çmimet e tregut, kur duan të shesin njësi shtesë të prodhimit të tyre, përballen me vështirësi të ndryshme. Duke rritur ofertën ata duhet njëkohësisht të shpenzojnë më shumë para në lëndë të parë, punonjës, qira etj. Ekonomisti i shek të XVIII, Jean-Baptiste Say ka theksuar se oferta krijon kërkesën e saj; pra çdo rritje në prodhim është njëkohësisht rritje në të ardhura dhe kjo rritje e të ardhurave mund të përdoret për të blerë sasi të rritura të prodhimit. Ekonomistët shprehen se vija e kërkesës zhvendoset djathtas, megjithatë ata dyshojnë nëse kjo marrëdhënie e thjeshtë funksionon në realitet. Nëse do të ishte kështu atëherë rritja ekonomike mund të arrihej thjesht duke prodhuar më shumë, por kjo është shumë më e vështirë se kaq.
2. Një agjent vendos të prodhojë më shumë me çmim më të ulët. Disa analiza të thjeshta të kërkesës dhe ofertës na bëjnë të mendojmë se në përgjithësi rritja ekonomike do të kërkojë inovacione apo zbulime të mënyrave dhe rrugëve për ti bërë gjërat më mirë. Thënë këtë nuk kuptojmë se kemi zgjidhur të gjitha problemet e anës së ofertës apo të kërkesës, por kjo mund të zhvendosë poshtë grafikun e ofertës gjë e cila na lejon të ulim

grafikun e kërkesës. Kështu konsumatorët marrin më shumë nga të njëjtat produkte dhe shërbime, por me çmim më të ulët. Inovacioni në mënyrë automatike rrit të ardhurat reale të të gjithë atyre që i blejnë këto të mira dhe shërbime me çmim më të ulët. Fjala inovacion më së shumti lidhet me teknologjinë e ndërsa zhvillimet teknologjike konsiderohen larg novacioneve që sjellin ulje të çmimeve. Zhvillime apo ndryshime të tjera, po aq të rëndësishme dhe në periudha të ndryshme historike edhe më të rëndësishmet, janë edhe ato institucionale. Në këtë kontekst mund të theksojmë se edhe ndryshimet tranzitore në politikat e qeverisjes janë po aq të rëndësishme. Duhet theksuar gjithashtu se ndryshimet, qofshin këto teknologjike apo institucionale, mund të ndikojnë jo vetëm në koston e prodhimit, por edhe në uljen e çmimit të produkteve përfundimtare, si pasojë e uljes së kostove të lëndëve të para, të lëvizjes së materialeve apo edhe të shpërndarjes së produkteve deri në pikën fundore, konsumatorin. Të gjitha këto ndërtojnë një rrjet të tërë me inovacione. Këto rrjete zgjerohen si pasojë e ndryshimeve institucionale, kulturore apo si pasojë e investimeve.

3. Një agjent vendos të prodhojë një produkt apo shërbim të ri. Inovacionet e përmendura më lart bëjnë që grafiku e kërkesës për disa të mira dhe shërbime të lëvizë më poshtë, por askush nuk është i sigurt se si ky proces do të vijojë më tej, pavarësisht se sa bie çmimi njerëzit do të kërkojnë sasi të konsiderueshme ushqimesh dhe veshjesh e më pak produkte elektro-shtëpiake dhe makina. Thënë këtë kuptojmë se rritja ekonomike në afatin e gjatë nuk mund të nënkuptojë thjesht më shumë sasi nga të njëjtat produkte dhe shërbime, por ajo gjithashtu përfshin edhe krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja.
4. Tre llojet e mësipërme të rritjes fokusohen në tregun e brendshëm, por secila prej tyre mund të përsëritet po ti referohemi tregut të jashtëm dhe më saktësisht eksporteve. Në të

gjitha rastet bie në sy fakti se në thelb rritja është një proces që sjell disekuilibër. Teoria e avantazheve krahasuese na tregon se shtetet mund të eksportojnë të mira dhe shërbime për prodhimin e të cilave ata qëndrojnë në pozicione më të mira krahasuar me shtete të tjera dhe të importojnë ato lloj të mirash dhe shërbimesh për të cilat nuk gëzojnë të njëjtat pozita. Në këtë mënyrë ndikimi i drejtpërdrejtë i tregtisë në rritjen ekonomike duhet të jetë pozitiv pavarësisht faktit se politikat qeveritare përcaktojnë se cilat janë të mirat dhe shërbimet që eksportohen apo importohen (Szostak R. , 2009, p. 47).

Ndërsa shumë më herët Kaldor në 1963 ka identifikuar disa fakte të cilat sipas tij përcaktojnë procesin e rritjes ekonomike (Robert J.Barro and Xavier Sala-iMartin, 1999, p. 5):

1. Prodhimi për frymë rritet në kohë dhe norma e rritjes nuk ka tendencë të ulet.
2. Kapitali fizik për punonjës rritet përgjatë kohës.
3. Norma e kthimit të kapitalit është pothuajse konstante.
4. Norma e prodhimit për kapitalin fizik është pothuajse konstante.
5. Pjesa që zë punësimi dhe kapitali fizik në të ardhurat kombëtare është pothuajse konstante.
6. Norma e rritjes së produktit për punonjës ndryshon nga njëri shtet në tjetrin.

Por kush është treguesi i rritjes ekonomike dhe si llogaritet ai? Produkti i Brendshëm Bruto, është variabëli më shumë i përdorur për të monitoruar ndryshimet ekonomike të një vendi, kjo për vetë faktin se ai konsiderohet një matës gjithëpërfshirës i aktivitetit ekonomik. Kur PBB-ja bie dhe ekonomia e vendit është në rënie atëherë të ardhurat personale, fitimet e biznesit, shpenzimet për konsum, shpenzimet për investime dhe shumë variabla të tregut shënojnë rënie. Kur PBB-ja rritet atëherë të gjithë variablat e sipërpërmendur rriten. Teknikisht PBB-ja njihet si vlera e tregut e të gjitha produkteve dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara brenda një vendi

në një periudhë të caktuar kohe. (Mankin, N.G., & Biederman, D.K, 2003). Njihen tre metoda për të llogaritur PBB-në, metoda e prodhimit, e shpenzimeve dhe ajo e të ardhurave (Mishkin F. S., 2012, p. 20).

Sipas metodës së prodhimit produkti i përgjithshëm bruto llogaritet si më poshtë vijon;

$$\text{PBB} = \text{Vlera e shtuar bruto}^{18} + \text{Taksat mbi produktet}^{19} + \text{Taksa doganore} - \text{Subvencionet mbi produktet dhe importet}^{20}.$$

Metoda e shpenzimeve e llogarit vlerën e PBB-së duke shtuar vlerën në dollar sipas çmimit aktual të tregut të të gjithë të mirave dhe shërbimeve. Pra;

$$\text{PBB} = \text{Shpenzimet e konsumit}^{21} + \text{Investimet}^{22} + \text{Shpenzimet qeveritare}^{23} + \text{Eksportet neto}^{24}$$

Një tjetër mënyrë për të matur PBB-në është duke llogaritur të ardhurat totale. PBB-ja me metodën e të ardhurave llogaritet si shuma totale e të ardhurave të individëve që jetojnë në një vend gjatë një viti. Kjo metodë e mat PBB-në duke mbledhur të ardhurat e kompanive dhe punonjësve siç janë pagat e punës, interesi i kapitaleve, qiratë për tokën dhe pronën dhe fitimet e sipërmarrjeve. Totali i të ardhurave mund të ndahet sipas skemave të ndryshme, duke rezultuar

¹⁸ Përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

¹⁹ Ku përfshihet edhe TVSH-ja.

²⁰ Këto janë pagesa të pakthyeshme që institucionet e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një produkti apo shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e produkteve apo shërbimeve që bëhen të pagueshme kur kapërcehet kufiri i territorit ekonomik ose kur ato i kalohen njësive institucionale rezidente.

²¹ Shpenzimet për të mira dhe shërbime.

²² Investimet private direkte bruto, të cilat përfshijnë krijimin e të mirave kapitale si linjat e fabrikave dhe makineritë të cilat do të sjellin prodhim e kështu edhe konsum në të ardhmen, duhet të theksojmë se këtu nuk përfshihen shpenzimet e kërkimit apo trajnimit të punonjësve.

²³ Qeverisë qendrore dhe lokale në vlerë kostoje.

²⁴ Eksportet-Importet.

me formula të ndryshme për PBB-në e matur me metodën e të ardhurave. Një formulë e zakonshëm është:

$$\text{PBB} = \text{Pagat e Punonjësve}^{25} + \text{Teprica Bruto Operative}^{26} + \text{të Ardhurat Bruto të Përziera}^{27} + \text{Taksat - Subvencionet për prodhimin dhe importet.}$$

Ka edhe një tjetër formulë për PBB sipas metodës të të ardhurave, më konkretisht:

$$\text{PBB} = \text{Qiratë} + \text{Interesat} + \text{Fitimi} + \text{Rregullime statistikore}^{28} + \text{Pagat.}$$

2.7 Politika fiskale

Për të ndërhyrë në sistemin ekonomik janë në dispozicion dy kategori të mëdha ndërhyrjeje. Politika monetare, pjesë e kategorisë së parë, e drejtuar nga Banka Qendrore, që kontrollon variacionet e stokut të parave, normave të interesit dhe normave të skontos sipas së cilave Banka Qendrore u jep hua bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve të tjera të sistemit bankar (Mishkin, 2010, p. 319). Kategoria e dytë përbëhet nga politika fiskale e kontrolluar kryesisht nga parlamenti dhe e zbatuar nga ekzekutivi, e cila kontrollon normat fiskale dhe shpenzimet publike. Një nga karakteristikat kryesore të politikës ekonomike është se efektet e politikës monetare dhe fiskale mbi sistemin ekonomik nuk janë plotësisht të parashikueshme, si në kohën ashtu edhe në masën me të cilën ato influencojnë kërkesën dhe ofertën (Mishkin F. , 2010). Këto papërcaktueshmëri janë në qendër të problemeve të politikës së stabilizimit. Politika e stabilizimit njihet edhe si politika kundër ciklike, pra si një politikë që synon përmirësimin e ciklit ekonomik. Ecuria dhe ekzistenca e cikleve ekonomike varen kryesisht nga politika e

²⁵ Paga e punonjësve mat pagesën totale të punonjësve për punën e bërë. Ato përfshijnë pagat dhe rrogat, si dhe kontributet e punëdhënësve për sigurimet shoqërore dhe programet e tjera.

²⁶ TBO është tepricë për shkak të pronarëve të bizneseve të trupëzuar. Shpesh quhet fitim, edhe pse vetëm një mesatare e kostos totale zbritet nga prodhimi bruto i llogaritur.

²⁷ Masë e njëjtë si TBO, por i referohet bizneseve pa trupëzuara. Ajo shpesh përfshin biznese më të vogla.

²⁸ Taksat e korporatave, të ardhurat, dividendët dhe fitimet e pashpërndara.

stabilizimit. Një politikë korrekte stabilizimi zbut ecurinë e ciklit të biznesit, ndërsa një politikë e gabuar mund të rrisë ndryshimet e sistemit ekonomik (Mishkin F. S., 2012, p. 203). Analiza e politikave më të përshtatshme të administrimit të sistemit ekonomik i ka ndarë studiuesit në dy grupe të mëdha, monetarist dhe jo-monetarist, pikëpamjet kryesore të së cilëve ndryshojnë në mënyrën e zgjidhjes së ekuilibrit kërkesë-ofertë agregate, monedhë dhe inflacion, funksionet e sektorit publik në sistemin ekonomik, etj. Pra politika fiskale, nga shumë ekonomistë, shihet si gjysma e politikës makroekonomike dhe gjysma tjetër është politika monetare. Politika fiskale ecën paralelisht me politikën monetare, kjo pasi monedha e një vendi do të humbte vlerën e saj nëse politika fiskale e tij nuk do të ishte mbështetëse. Në themel të saj, politika fiskale, përshkruan mënyrën se si një qeveri formon veprimet e saj dhe se cilat janë këto veprime. Ajo shihet si mbështetëse ose racionale kur publiku dhe ata që blejnë instrumentet e borxhit publik perceptojnë se politika fiskale e një qeverie është e parashikueshme dhe se ajo do të vazhdojë të shlyejë detyrimet e saj. Shembulli më tipik i një politike racionale është kur burimet e të ardhurave publike, si taksat, tarifat dhe të tjera janë afërsisht të barabarta me shpenzimet për programet qeveritare. Për Kejnesianët ekonomia kombëtare është si një automobil. Pedali i gazit quhet “më shumë shpenzime qeveritare/më pak taksa”; pedali i frenave quhet “më pak shpenzime qeveritare/më shumë taksa”. Një qeveri e cila e nget makinën me kujdes mund të sjellë rritje ekonomike dhe çmime të pandryshueshme” (Buchholz, 2007, p. 323). Në shkrimin e tij mbi politikat fiskale John Maynard Kenynes thekson se lidhja midis ideve, interesave dhe institucioneve mbështet ose kundërshton zbatimin e një grupi idesh. Zbatimi i një grupi idesh me natyrë ekonomike përcaktohet nga faktorë ekonomikë, politikë dhe administrativë. Zbatimi ekonomik bazohet në marrëdhëniet e ideve, që gjenden në teori apo modele, me natyrën e ekonomisë kombëtare dhe kufizimet ndërkombëtare. Zbatimi politikë i lidh idetë me qëllimin e

përgjithshëm të partive politike, me interesat e koalicionit qeveritar dhe me ato të bashkimeve të tjera me interesa të përbashkëta. Ndërsa zbatimi administrative i lidh idetë me anën administrative, me fuqinë relative të agjencive adekuate dhe me kapacitetin e strukturave administrative për të siguruar informacion. Ai gjithashtu argumenton se sa më i zbatueshëm të jetë grupi i ideve, sipas tre këndvështrimeve të sipërpërmendura, aq më shumë mundësi ka që një politikë e caktuar të zbatohet (Keynes J. M., 1936). Ekonomistë të ndryshëm, të njohur si ndjekës së Keynesit, besojnë se politika fiskale mund të bëjë të mundur që një qeveri të menaxhojë ekonominë dhe të sigurojë punësim. Keynesianët besojnë se kur sektori privat nuk krijon mjaftueshëm kërkesë në ekonomi për të siguruar punësim të plotë, atëherë mund të përdoret politika fiskale në mënyrë që të rritet kërkesa, gjë e cila do të stimulojë mjaftueshëm aktivitet ekonomik dhe për pasojë do të krijojë më shumë vende pune (Keynes J. M., 1936). Ideja e menaxhimit aktiv të ekonomisë përmes politikës fiskale është zhvilluar nga John Maynard Keynes në librin *“The General Theory of Employment, Interest and Money”* i publikuar në vitin 1936. Sipas të njëjtit filozof, politikë fiskale aktive konsiderohet përdorimi i tatimeve të shtetit dhe politikave të shpenzimeve për të krijuar kërkesë në një ekonomi. Në debatet politike përdorimi i politikës fiskale qeveritare për të rritur kërkesën njihet si stimul fiskal. Qartësimi i këndvështrimeve rreth rolit dhe qëllimeve të politikës qeveritare, konsiderohet si një nga qëllimet e studimeve të ekonomistëve. Një nga arsyet e domosdoshmërisë të qeverisë është edhe fakti se dora e padukshme e tregut mund të realizojë “magjinë” e saj, vetëm nëse qeveria forcon rregullat dhe mbështet institucionet të cilat janë çelësi për ekonominë e tregut. Ajo çfarë konsiderohet më e rëndësishme është fakti se ekonomia e tregut, në mënyrë që të përforcojë të drejtën e pronësisë, ka nevojë për institucione. Në këtë mënyrë individët mund të zotërojnë dhe kontrollojnë burimet e limituara (Mankin, N.G., & Biederman, D.K, 2003, p. 11). Arsyet kryesore se pse një qeveri

ndërhyn në ekonomi dhe ndryshon alokimin e burimeve të cilat njerëzit duhet ti zgjidhnin vetë janë dy; të promovojë efikasitet dhe barazi. E thënë ndryshe qëllimi kryesor i pjesës më të madhe të politikave është rritja e pjesëve përbërëse të ekonomisë ose mënyrës se si ajo ndahet.

Elementët dhe qëndrimet e politikës fiskale

Elementët kryesore të politikës fiskale janë; tatimi, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik (Howard M. , 2001, p. 8). Qeveria gëzon të drejtën e kontrollit mbi të tre këto elementë. Ndryshimet në nivelin dhe përbërjen e taksave dhe shpenzimeve qeveritare mund të ndikojë në variablat e mëposhtëm të ekonomisë:

- Kërkesën agregate dhe nivelin e aktivitetit ekonomik
- Modelin e shpërndarjes së burimeve
- Shpërndarjen e të ardhurave

Tre qëndrimet e mundshme të politikës fiskale janë neutrale, ekspansioniste dhe shtrënguese. Një qëndrim neutral i politikës fiskale nënkupton një ekonomi të ekuilibruar. Shpenzimet e qeverisë financohen plotësisht nga të ardhurat e përgjithshme tatimore dhe rezultatet buxhetore kanë një efekt neutral në nivelin e aktivitetit ekonomik. Një qëndrim ekspansionist i politikës fiskale përfshin faktin se shpenzimet e qeverisë tejkalojnë të ardhurat tatimore dhe një politikë fiskale shtrënguese ndodh kur shpenzimet e qeverisë janë më të ulëta se të ardhurat tatimore. Ekspansion fiskal do të thotë shkurtim i taksave ose rritje e shpenzimeve publike me qëllim stimulimin e rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate. Kjo ndodh kur qeveria vëren ngecje apo shtim të ngadalshëm ekonomik, ose kur papunësia është e lartë. Kështu, me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për t'i përdorur për shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit dhe shtimin ekonomik. Ndërsa, politikë fiskale shtrënguese

do të thotë ulje e shpenzimeve publike dhe rritje e taksave. Kur qeveria synon uljen e kërkesës agregate për të ngadalësuar shtimin ekonomik apo uljen e inflacionit, thuhet se po përdor politikën fiskale shtrënguese. Nëpërmjet politikës fiskale shtrënguese ulet oferta e parasë e cila nga ana e saj ul shpenzimet dhe kërkesën agregate. Kur qeveria vendos të zbatojë një politikë fiskale të caktuar, ajo bën paraprakisht vlerësimin e një numri të madh faktorësh përfshirë këtu edhe ecurinë e variablave dhe indikatorëve kryesore ekonomik dhe financiar, kjo ndodh për shkak të ndikimit të tyre në shumën e të hyrave të grumbulluara përmes taksave me të cilat përmbushen nevojat e financimit të programeve qeveritare. Vendimi lidhur me deficitin buxhetor konsiderohet një tjetër çështje me rëndësi për qeverinë, pra a do të mbulohen shpenzimet e rritura ose të pambuluara të qeverisë me financim nga huaja apo përmes emetimit të parasë. Vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga konsideratat politike si besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi, por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë (Davidsson, 2011). Vendime të tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët të jashtëm, që do të thotë se qeveria duhet të marrë parasysh edhe tendencat e ekonomisë globale dhe politikat fiskale të vendeve tjera, të cilat mund të ndikojnë në rialokimin e kompanive vendase dhe të huaja. Ka edhe një tjetër këndvështrim në lidhje me interpretimin e termave ekspansioniste dhe shtrënguese. Nëse ne do të shohim efektet e politikës fiskale në ekonominë si një e tërë dhe jo në nivel individit, mund të shohim se politika fiskale ekspansioniste rrit prodhimin ose të ardhurat kombëtare, kurse politika shtrënguese i ul ato (Engen M. E. & Skinner, J. , 1992). Pra ekzistojnë dy kategori të ndikimeve të politikave fiskale, ato të cilat kanë të bëjnë me individët dhe ato të cilat lidhen me ekonominë si një e tërë.

Objektivat e politikës fiskale

Në procesin e formulimit të politikës fiskale, politikë bërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë dhe instrumentet me të cilat këto objektiva bëhen të realizueshme, duke iu përmbajtur detyrimit parimeve të menaxhimit fiskal si:

- transparenca e lidhur me objektivat, implementimin e politikës fiskale dhe publikimin e llogarive publike;
- stabiliteti i procesit të bërjes së politikës fiskale;
- efikasiteti i ndikimit të politikës fiskale në ekonomi;
- përgjegjësia në menaxhimin e financave publike;
- efikasiteti i modelimit dhe implementimit të politikës fiskale;
- drejtësia, duke përfshirë edhe atë ndërmjet brezave.

Objektivat e politikës fiskale lidhen me rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore, si qëllimi parësor i një shoqërie bashkëkohore (Wildasin, 1995). Kjo mirëqenie sigurohet vetëm në kushtet e një ambienti që e cilësojnë si ambient me stabilitet ekonomik, politik dhe social. Pra, kur flasim për objektivat e politikës fiskale kemi parasysh:

- përmbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik,
- realizimin e punësimit të plotë,
- rritjen e normës së zhvillimit ekonomik,
- ruajtjen e stabilitetit të çmimeve,
- stabilitetin e bilancit të pagesave,
- përmirësimin e kushteve të punës duke përfshirë përmirësimin e strukturës kualifikuese të fuqisë punëtore dhe përparimin teknologjik,
- stimulimin e kursimeve,

- stimulimin e investimeve,
- rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore, dhe
- rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi.

Realizimi i këtyre objektivave varet më së shumti nga, aftësia e qeverisë për bashkërenditjen e tyre me instrumentet fiskale për të influencuar përbërjen dhe nivelin e kërkesës agregate, saktësia e analizave makroekonomike lidhur me ecurinë dhe tendencat e indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar dhe rregullimi e marrëveshjet institucionale për koordinimin e politikave makroekonomike. Politika fiskale në funksion të sistemit tatimor të një vendi duhet që mbi të gjitha :

- të garantojë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik,
- të konsolidojë të ardhurat fiskale në funksion të realizimit të shpenzimeve në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit,
- të kontribuojë në reduktimin e mëtejshëm të evazionit fiskal dhe kontrabandës, duke zgjeruar bazën e tatueshme dhe duke hequr përjashtimet nga rregullat e përgjithshme,
- të krijojë një klimë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm të biznesit vendas dhe të huaj.

Këto dhe probleme të tjera të kësaj natyre, të para nga këndvështrimi i politikave fiskale, përbëjnë çështje thelbësore për mbarëvajtjen në tërësi të jetës ekonomike të vendit si dhe në zgjidhjen e mjaft problemeve të aspektit social.

2.8 Sistemet tatimore dhe klasifikimi i tyre

Sistemet tatimore mbështeten në tri shtylla kryesore, në llojin e tatimit, bazën tatimore dhe nivelin e qeverisjes (Harvey S.R & Gayer T., 2008). Sipas llojit të tatimit dallojmë tatimin direkt,

i cili përfshin tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat e kompanive dhe të ardhura të tjera dhe taksat mbi kapitalet, tatimi indirekte i cili përfshin tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), akcizën, tatimin mbi konsumin dhe taksat mbi produktet dhe prodhimin. Taksat mund të klasifikohen edhe sipas bazës tatimore. Dhe së fundmi, tatimet ndahen edhe sipas nivelit të qeverisjes, pra në qendrore dhe lokale.

Pa marrë parasysh variablat dhe kriteret që janë përdorur, klasifikimi më i përgjithshëm i tatimeve, në literaturat e ndryshme financiare bëhet, sipas disa kriterëve (Harvey S.R & Gayer T, 2008, p. 314).

- Sipas kriterit të bartjes dhe burimit tatimor tatimet klasifikohen në tatime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Tek tatimet e drejtpërdrejta barra e tatimit nuk mund të bartet tek personat e tretë, por ajo paguhet direkt mbi të ardhurat në burim. Tatime të tërthorta, janë ato tatime ku barra e tatimeve u kalon personave të tretë dhe që paguhen me rastin e shpenzimit të të ardhurave.
- Kriteri i dytë është ai në bazë të aftësisë tatimore dhe sipas tij kemi tatime subjektive, ku tatimi dhe lartësia e detyrimit varen, si nga fuqia ekonomike e obliguesit tatimor, ashtu edhe nga cilësitë personale të këtij të fundit, dhe tatime objektive, ndryshe nga ato të parat, në këtë rast në përcaktimin e detyrimit nuk merren parasysh cilësitë personale të obliguesit tatimor.
- Një tjetër kriter klasifikues është edhe ai i destinacionit apo përdorimit të tyre. Në këtë rast tatimet do të ishin tatime të përgjithshme, këto tatime përdoren për financimin e të gjitha nevojave dhe shpenzimeve shtetërore, në mënyrë që shteti të realizojë funksionet e tij dhe tatime të destinuara, të cilat përdoren për të mbuluar shpenzime të caktuara, të specifikuara që para mbledhjes së tatimeve (rasti i emergjencave civile).

- Kemi edhe një kriter tjetër, atë të përcaktimit të lartësisë së bazës tatimore. Në këtë rast tatimet i kemi tatime të supozuara, tek të cilat detyrimi tatimor vendoset mbi supozimin se tatimpaguesi ka arritur të realizojë të ardhura në një madhësi të caktuar. Tatime faktike, në këto lloj tatimesh detyrimi tatimor vendoset në bazë të të dhënave mbi të ardhurat e realizuara realisht. Në sistemet e sotme tatimore, pjesa më e madhe e tatimeve janë tatime faktike dhe vetëm një pjesë shumë e vogël janë tatime të supozuara. Kjo bëhet në mënyrë që të mos dëmtohet tatimpaguesi përtej detyrimit real. Sipas kriterit të llojit të bazës tatimore kemi tatime sipas vlerës dhe tatime specifike. Detyrimi tatimor, në rastin e tatimit sipas vlerës, vendoset në përqindje të bazës tatimore, e cila mund të jetë proporcionale, progresive ose regresive. Për shkak të saktësisë që ofrojnë në caktimin e drejtë të detyrimit tatimor, këto lloj tatimesh zënë vendin kryesor në sistemet moderne tatimore. Ndërsa detyrimi tatimor tek tatimet specifike caktohet në varësi të njësive të masës të cilat shërbejnë si bazë tatimore. Të tilla mund të jenë metri, kilogrami, numri i kuaj fuqive (forca e motorit të një automjeti) etj. Për shkak të mangësive që kanë nga pikëpamja financiare dhe praktike, këto lloj tatimesh nuk përdoren shumë.
- Dhe kriteri i fundit që do trajtohet në këtë pjesë është ai i rolit që ka secili tatim në sistemin tatimor. Sipas këtij kriteri tatimet klasifikohen në tatime themelore, janë ato lloj tatimesh që sigurojnë pjesën më të madhe të të hyrave publike dhe tatime plotësuese, të cilat zënë një vend fare të vogël në këto të hyra.

2.9 Struktura e tatimeve, parimet dhe karakteristikat e saj

Në një ekonomi private është vetë individi ai që vendos se sa do të punojë dhe në varësi të saj përfiton në formë shpërblimi pagën. Pas përfitimit të shpërblimit është po ai i cili vendos ta përdorë atë për të blerë ushqime, veshje, mobilie, apo të tjera të mira dhe shërbime. Ai

gjithashtu mund të vendosi të mos i konsumojë, por ti kursejë ato për ti përdorur në të ardhmen. Nëse secilin prej transaksioneve të mësipërme e analizojmë nga këndvështrimi ekonomik themi se diskutimi nuk lidhet me pagesën apo përfitimet nga të mirat dhe shërbimet, por me sasinë e të mirave dhe shërbimeve që duhen prodhuar, çmimin që duhet të vendoset mbi të mirat dhe shërbimet e konsumuara dhe se kush do ti konsumojë këto të mira dhe shërbime. Individët dhe bizneset i marrin vendimet duke u bazuar në interesat e tyre. Ndërkohë që sektori publik i merr vendimet duke pasur parasysh interesin e komunitetit në tërësi. Këto vendime prekin vendimet e individëve dhe të biznesit, kështu për shembull mund ti krijojnë mundësi individëve për të përdorur lehtësirat në transport, por nga ana tjetër zbatimi i ligji tatimor bën që ata të përpiqen ti shmangen atij sa më shumë që të jetë e mundur. Vendosja e taksave është vërtet një proces politik, por ajo kërkon gjithashtu një ekzaminim të kujdesshëm brenda mjedisit ekonomik. Procesi politik në vetvete ka si qëllim aprovimin e një strukture taksash të propozuar, por duhet së paku një standard për të vlerësuar produktin përfundimtar, paketën fiskale të këtij procesi politik. Parimet ekonomike të tatimit sipas Richardson dhe Hildreth janë si më poshtë vijon: (Richardson A.J & Hildreth W.B, 1999, p. 21). Le ti shohim me radhë;

Parimi i përfitimit ose aftësisë për të paguar

Tatimet zakonisht bazohen, ose në parimin e përfitimit, ose në atë të aftësisë për të paguar. Sipas parimit të përfitimit personi apo biznesi që paguan tatimet dhe taksat duhet të përfitojë drejtpërdrejt nga shërbimet publike të ofruara nga të ardhurat e krijuara nga mbledhja e këtyre tatimeve. Ky parim i përaftron të mirat publike me të mirat private. Për ta përgjithësuar mund të themi se personi i cili përfiton më shumë nga një e mirë publike, në krahasim me një tjetër i cili përfiton më pak, duhet të paguajë më shumë. (Mankin, N.G., & Biederman, D.K, 2003, p. 246). Ashtu siç e kemi theksuar edhe më lart ky parim ka në fokus të tij tregun privat, e thënë ndryshe

një person i cili po përdor një të mirë duhet të paguajë për të. Megjithatë duhet theksuar se pjesa më e madhe e të mirave publike nuk financohen janë lehtësisht nga tatimet dhe taksat e mbledhura nga përdoruesi i saj i parë. Ka programe publike për të cilat nuk mund të zbatohet parimi i përfitimit të drejtpërdrejtë, si për shembull programet e sigurisë kombëtare, nuk mund të vendoset një taksë mbi të pasi askush nuk mund të llogarisë saktësisht se sa nga ky shërbim konsumon çdo individ. Financimi i këtyre programeve publike kërkon metoda të tjera taksimi.

Metoda tjetër e taksimit quhet parimi i aftësisë për të paguar. Ndonjëherë zbatimi i këtij parimi justifikohet me thënien se çdo qytetar për të mbështetur qeverinë duhet të sakrifikojë njësoj. Nocioni i barazisë është i gjithë pranuar, por aplikimi i tij me qëllim ndërtimin e një sistemi taksash rrallë pranohet lehtësisht. (Mankin, N.G., & Biederman, D.K, 2003, p. 247). Ky parim, nga këndvështrimi i përkufizimit, është i lehtë për tu kuptuar, por zbatimi i tij hap polemika dhe debate të shumta. Aftësia për të paguar përcaktohet në bazë të të ardhurave dhe mirëqenies. Aftësia për të paguar na çon në dy nocione të varura nga njëra tjetra që janë, barazia vertikale dhe ajo horizontale. Barazia vertikale thekson se taksapaguesit me aftësi më të madhe për të paguar duhet të paguajnë më shume. Ndërsa barazia horizontale thekson se taksapaguesit me aftësi të njëjtë për të paguar duhet të paguajnë të njëjtën shumë. Por a duhet të financohen të gjitha programet publike pikërisht nga këta individë? Edhe nëse jo, sa duhet të paguajnë ata dhe çfarë kuptojmë me mirëqenie? Aplikimi i niveleve të larta të tatimeve mbi të ardhurat dhe pasurinë e këtij grupi individësh mund ti bëjë ata të ndërmarrin veprime me qëllim shmangien e taksave, apo ti dekurajojë ata ndaj realizimit të prodhimit, gjë e cila do të ndikonte në mirëqenien e të gjithë shoqërisë. Për politikën dhe për shoqërinë në përgjithësi zbatimi i një sistemi taksash të bazuar mbi aftësinë për të paguar sjell një listë të gjatë pyetjesh dhe vështirësish. Këto pyetje zakonisht përfshijnë; normat marzhinale të taksave për kategori të ndryshme të ardhurash,

përrjashtime dhe ulje për njësi të veçanta konsumi apo për persona në nevojë, përrjashtime të veçanta për disa lloj shpenzimesh si për shembull bamirësitë, norma të ndryshme taksash për nivele të ndryshme të ardhurash, dhe shumë pyetje të cilat kërkojnë përrgjigje, pasi në të kundërt është e pamundur krijimi i një strukture funksionale të ardhurash tatimore. Pjesa më e madhe e diskutimeve mbi të ardhurat tatimore janë të përrqendruara në ndikimin e pritshëm ekonomik të dimensioneve të ndryshme të ligjit tatimor, duke u fokusuar mbi eficiency dhe paanshmërinë e sistemit tatimor. Të dyja këto parime japin udhëzime për ndërtimin e një sistemi tatimor, por nuk ofrojnë udhëzime të detajuara për përrkatësinë ideale të një strukture tatimore.

Karakteristikat e strukturës tatimore

Struktura e tatimeve duhet të bazohet mbi një grup parimesh të cilat pasqyrojnë qartësisht bazën filozofike të saj, por përrsëri ajo duhet të pranojë kufizimet mbi metodat e taksimit që rrjedhin nga kombi, shteti dhe ekonomia lokale (Lee, Y. & Gordo, R.H. , 2005). Në punimin e tyre mbi parimet e taksave Richardson dhe Hildreth përrmendim pesë karakteristika të një sistemi ideal taksash. (Richardson A.J & Hildreth W.B, 1999, p. 23).

- Besueshmëria dhe parashikimi i rritjes së të ardhurave

Qëllimi kryesor i çdo sistemi tatimor është realizimi i të ardhurave për të financuar shërbimet publike. Qeveritë vendore dhe ato lokale varen më së shumti nga besueshmëria dhe parashikimi i rritjes së të ardhurave, kjo pasi ato janë të detyruara të lëvizin brenda kufijve të buxhetit. Qeveria nuk duhet të ndryshojë vazhdimisht ligjin tatimor në mënyrë që të mbulojë apo ti përrgjigjet rritjes së papërrshtatshme të të ardhurave në afatin e gjatë, të balancojë ritmet e ndryshimeve të të ardhurave në afatin e shkurtër apo të ruajë legjitimitetin e shërbimeve publike. Një ndër qëllimet e çdo qeverie duhet të jetë stabiliteti i ligjit tatimor. Përrpara tyre shtrohet domosdoshmëria e

gjetjet së një balance midis shërbimeve publike, që ajo dëshiron të ofrojë dhe taksave që ajo do të imponojë. Thënë të gjitha këto kuptojmë se një nga karakteristikat kryesore të strukturës së taksave është stabiliteti. Bizneset dhe individët preferojnë të kenë njohuri të mjaftueshme mbi ligjet tatimore dhe që ato të mos ndryshojnë shpesh.

- Bazë e gjerë dhe norma të ulëta

Askush nuk i do taksat. Vendosija e tyre ndryshon sjelljen e individëve, i bën ata të gjejnë mënyra dhe rrugë për të shmangur pagesën e tyre. Më qëllim minimizimin e këtij lloj reagimi ndaj taksave ekonomistët sugjerojnë një bazë tatimore sa më të gjerë të jetë e mundur dhe norma tatimore sa më të ulëta. Baza e gjerë lë pak hapësirë për të shmangur taksat, apo për të ndryshuar sjelljen. Ajo gjithashtu mban një lloj barazie në strukturën e taksave, pasi nuk përjashton askënd nga pagimi i taksave, pavarësisht mënyrës se si janë krijuar apo shpenzuar të ardhurat.

- Zhvillimi dhe rritja ekonomike

Qeveria vepron më mirë kur ekonomia e vendit është në rritje. Në asnjë mënyrë qeveritë nuk duan të dëmtojnë zhvillimin dhe rritjen ekonomike afatgjatë. Tatimet dhe taksat mund të ndikojnë si mbi zhvillimin ashtu edhe mbi rritjen ekonomike të një vendi. Në termat e rritjes afatgjatë debati mbi ndikimin e strukturës së tatimeve në kursime dhe akumulimin e kapitalit merr rëndësi të veçantë. Kështu për një shtet debati mbi tatimin e fitimit kapital dhe diskutimet mbi bazën e përshtatshme tatimore konsiderohen si çështje primare. Megjithatë të dyja këto çështje, të trajtuara si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, konsiderohen komplekse për vetë faktin se vendimet e individëve dhe të biznesit ndikohen nga shumë faktorë. Struktura e taksave të një shteti duhet të krijojë kushtet për një mjedis konkurrues, kjo edhe për faktin se kapitali është i lëvizshëm, dhe sidomos ajo pjesë e kapitalit që ende nuk është investuar.

- Barazia dhe drejtësia

Organet administruese të tatimeve nuk mund të kontrollojnë çdo tatimpagues dhe çdo taksë të paguar. Detyrimin për të paguar taksa individët dhe bizneset duhet ti përgjigjen vullnetarisht. Për të realizuar këtë, ata duhet të besojnë se sistemi i taksave është i drejtë, në të kundërt do të përpiqen ta shmangin sa më shumë të jetë e mundur pagimin e tyre. Drejtësia në vetvete është nocion subjektiv. Në literaturën e financave publike dhe tatimeve ajo shpesh lidhet me kërkesën që përfituesit e shërbimeve publike të paguajnë për shërbimet e përfituara, me taksimin e njëjtë mbi individët të cilët përdorin njësoj shërbimet publike dhe kanë të njëjtat burime të ardhurash dhe me krijimin e një baze tatimore e cila nuk përjashton në mënyrë proporcionale si qytetarët me të ardhura të ulëta, ashtu edhe ata me të ardhura të larta. Drejtësia lidhet gjithashtu me nocionin e barazisë horizontale të trajtuar më lart tek parimi i aftësisë për të paguar.

- Thjeshtësia

Thjeshtësia e ligjit tatimor ul jo vetëm kostot qeveritare të administrimit të ligjit tatimor, por edhe kostot e qytetarëve dhe të biznesit në kuptimin dhe zbatimin e tij. Nga njëra anë thjeshtësia e tatimeve gëzon pëlqimin e të gjithëve, por nga ana tjetër ajo ngjan me një qëllim iluzionar dhe kjo jo se njerëzit e kundërshtojnë atë në parim, por se vetë ekonomia është komplekse dhe sepse vetë thjeshtësia e tatimit mund të jetë në kontradiktë me karakteristika të tjera të sistemit tatimor dhe me qëllimin e tij. Kjo karakteristikë e sistemit tatimor përgjatë historisë është përdorur për të ndikuar politikën e tregtisë, për të inkurajuar investimet, për të inkurajuar bashkëpronësitë dhe për shumë objektiva të tjera.

Paguesi i tatimit

Tatimi është detyrim ligjor. Legjislativi vendos se kush është paguesi fundor i tatimit. Kështu për shembull akciza e duhanit vendoset nga shteti për importuesit, prodhuesit apo importuesit e cigareve, por në realitet pagues real i saj janë një numër personash duke filluar që nga

konsumatori, shitësit me pakicë, shpërndarësit e produktit, shitësit me shumicë dhe deri tek prodhuesit. Në këndvështrimin ligjor paguesi i tatimit është i qartë, por në atë ekonomik është vështirë të përcaktohet qartë se kush e paguan një tatim apo taksë. Përcaktimi ligjor i paguesit të tatimit është i rëndësishëm për qëllime administrative, ndërsa paguesi ekonomik merr më shumë kuptim kur duam të vlerësojmë ndikimin që tatimet mund të kenë mbi ekonominë e një vendi. Kur trajtohet tatimi mbi të ardhurat personale kuptohet që, si paguesi ligjor ashtu edhe ai ekonomik është i njëjtë. Debatet lind kur diskutohet mbi tatimin e të ardhurave nga korporatat apo nga biznesi. Shteti i mbledh tatimet nga korporatat apo biznesi, por debatet lindin pikërisht nga përcaktimi i paguesit real të këtij tatimi. Të gjithë aktorët e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të një korporate mund të përfshihen në pagimin e këtij tatimi, ndër ta mund të përmendim pronarët, kreditorët, punëtorët, klientët etj. Çdo tatim, i cili nuk është i vendosur drejtpërdrejtë mbi një individ, krijon hapësira për ekzistencën e paguesve ekonomik të tatimit të cilët ndryshojnë nga paguesi ligjor i tij.

Taksat lokale dhe qendrore

Pavarësisht se kush i mbledh të ardhurat tatimore, tatimi mbetet tatim. Thënë këtë kuptojmë se pak rëndësi ka se cili nivel i qeverisë i mbledh ato. Në bazë të politikave të një qeverie, është pikërisht ajo e cila vendos se çfarë tatimesh dhe taksash do të mblidhen nga organet e qeverisjes vendore dhe çfarë nga organet e qeverisjes lokale. Tek e fundit gjithë secili ka detyrimin ligjor ta paguajë atë.

KAPITULLI III: SISTEMI TATIMOR NË SHQIPËRI

3.1 Politika fiskale përballë ekonomisë informale dhe evazionit fiskal

Ekonomistë dhe studiues të ndryshëm gjithnjë e më shumë debatojnë rreth kostove, përfitimeve apo edhe matjeve të nivelit të ekonomisë informale. Të tilla diskutime janë pjesë e padiskutueshme edhe e realitetit të vendit tonë. Ata i mëshojnë gjithnjë e më shumë peshës që ekonomia informale zë në PBB-në e një vendi. Të tjerë e konsiderojnë ekonominë informale si lubrifikuese të mirëqenies sociale. Në ditët e sotme, duke marrë parasysh edhe situatën ekonomike në të cilën ndodhet Shqipëria, ekonomia informale konsiderohet një goditje e rëndë për konkurrencën në treg, konkurrencë kjo e cila nga ana e saj konsiderohet e një rëndësie të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit. Në fillimet e shfaqjes së saj, diku rreth shekullit XVII, ekonomia informale konsiderohej si një fenomen i përkohshëm, i parëndësishëm. Ajo gjithashtu shihej si e ndarë nga ekonomia formale dhe sektorët e ekonomisë formale. Por a është vërtet i përkohshëm ky fenomen? Edhe nëse është i tillë sa zgjat në përgjithësi ekonomia informale? Nga realiteti i viteve të fundit ajo nuk rezulton të jetë më një fenomen i përkohshëm, por një fenomen i pashmangshëm për ato vende të cilat nuk arrijnë të shpërndajnë në mënyrë eficiente kapitalet dhe të ardhurat e tyre. Nëse politikat dhe strategjitë e një shteti, të ndërmarra në kuadër të rritjes ekonomike, nuk sjellin ulje të nivelit të papunësisë dhe shpërndarje eficiente të të ardhurave, atëherë nuk do të kemi ulje të nivelit të informalitetit. Ekonomia informale është një temë e nxehtë dhe sfidë për realitetin shqiptar (Union, 2013). Por si përkufizohet ajo? Ekonomia informale përmbledh në vetvete të gjitha aktivitetet ekonomike dhe tregtare të paregjistruara në sistemin fiskal dhe legal. Ajo në thelb të natyrës së saj ka evadimin nga tatimet, taksat, sistemi i sigurimeve shoqërore, detyrimet ligjore rreth sigurisë dhe besueshmërisë së shërbimeve dhe produkteve të ofruara si dhe nga përgjegjësia sociale e biznesit. Ekspertë të

fushës si edhe politikanë të niveleve të ndryshme, në pamundësi të fshirjes tërësore të saj, shpesh debatojnë mbi gjetjet e mënyrave dhe mjeteve për ta vendosur atë nën kontroll. Këto debate nuk janë karakteristike vetëm për vendet në zhvillim, por edhe për ato të zhvilluara. Statistikat nga raporte të ndryshme të Komisionit Evropian tregojnë se ekonomia informale zë afro 5-20 për qind të PBB-së, kjo shifër është edhe më e lartë për vendet në zhvillim. Nivelet e ndryshme të saj vijnë nga fakti se ajo, ekonomia informale, në vende të ndryshme ndodhet në stade të ndryshme zhvillimi. Shkaqet e informalitetit në ekonomi në përgjithësi konsiderohen si të identifikuar. Rezultatet pozitive ndaj informalitetit gjithnjë e më shumë theksojnë nevojën e reformave në të gjithë ata sektorë të cilët përbëjnë nxitje dhe turrje në të njëjtën kohë. Pranohet gjerësisht se ngarkesat e larta fiskale nxisin rritjen e informalitetit. Bizneset të cilat operojnë në tregun informal pohojnë se evadojnë pasi nuk i përballojnë dot tatimet, taksat dhe sigurimet shoqërore. Megjithatë duke u sjellë në këtë mënyrë ato përfitojnë dhe krijojnë avantazhe të pamërituara në krahasim me bizneset të cilat janë të regjistruara dhe janë pjesë e sistemit tatimor. Nga kjo konkurrencë aspak e ndershme vjen, si falimentimi i bizneseve të regjistruara, ashtu edhe nxitja për kalim nga sektori formal në atë informal. Literatura dhe studimet rreth këtij fenomeni flasin për një lidhje të ndërsjelltë midis ekonomisë formale dhe asaj informale dhe kjo për faktin se tregu ekziston pikërisht për të barazuar kërkesën me ofertën për të mira edhe shërbime. Sektori informal ofron shërbime dhe të mira për sektorin formal. Që të bëjmë dallim midis këtyre dy sektorëve do ti kthehemi edhe një herë përkufizimit të ekonomisë informale së cilës gjithashtu mund ti referohemi edhe si ekonomi paralele, ekonomi e zezë, ekonomi e nëndheshme, klandestine apo edhe si ekonomi e paregjistruar. Në terma të përgjithshëm ekonomia informale njihet si pjesa e pa vëzhguar dhe e paregjistruar e ekonomisë së tregut e cila prodhon të mira dhe shërbime me qëllim tregtimin e tyre ose sigurimin e përfitimeve në forma dhe mënyra të tjera.

Mirus dhe Smith në 1997 japin këtë përkufizim për të “*Termi ekonomi informale i referohet të gjitha aktiviteteve të pa vëzhguara ekonomike të realizuara nga punonjësit dhe njësitë ekonomike, të cilat kanë për qëllim shmangien e tatimeve dhe taksave ose operimin në kundërshtim me ligjet dhe procedurat administrative që aplikohen në një vend*”. Në përgjithësi ekonomia informale karakterizohet nga kërkesa të ulëta në terma të kapitalit dhe kualifikimeve për hyrjen në treg, aftësi të përfituara jashtë kuadrit të edukimit formal, metoda intensive prodhimi të realizuara nga fuqi punëtore dhe teknologji të papërshtatshme dhe nga operimi jashtë ekonomisë së shkallëve edhe pse me kosto më të ulët.

Ndikimi i politikave fiskale mbi ekonominë informale parë kjo e fundit në aspektin e evazionit fiskal

Administrimi i sistemit tatimor përbën një problem shqetësues jo vetëm për vendet në zhvillim, por edhe për vendet e zhvilluara. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë në ekonominë informale dhe secili prej tyre ka një peshë specifike, por ai që prek më shumë dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ekonominë informale është evazioni fiskal. Sistemi tatimor konsiderohet mjaft i rëndësishëm për faktin se ai është instrumenti kryesor i cili financon buxhetin e shtetit. Sistemi tatimor eficient dhe efikas bën që organizatat e biznesit me vullnet të lirë të shlyejnë të gjitha detyrimet sipas ligjeve dhe normave në fuqi. Kur një sistem tatimor konsiderohet eficient dhe efikas? Cila do të ishte paketa fiskale e cila e bën të tillë një sistem tatimor? Të dyja pyetjet e ngritura mund të marrin përgjigje të ndryshme. Përgjigjet e tyre varen nga vendi të cilit i adresohen dhe individëve të shoqërisë së tyre. Kjo pasi janë pikërisht ata, individët, të cilët bëjnë evazion fiskal. Shtete të ndryshme kanë eksperimentuar ndryshimin e normave tatimore me qëllim arritjen e objektivave të tyre, por rritja e konkurrencës për tatimet mund të sjellë mundësi të reja për biznesin ose më shumë rreziqe për qeveritë. Norma të ulëta tatimore në situata të caktuara mund të ndikojnë në

favorizimin e biznesit dhe në të njëjtën kohë të sjellin edhe rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit. Ana tjetër e medaljes së kësaj politike fiskale do të ishte norma më të ulëta tatimore sjellin më pak të ardhura tatimore, të cilat nga ana e tyre do të nënkuptonin ulje të cilësisë së të mirave dhe shërbimeve publike në sektorë të ndryshëm. Sistemet tatimore moderne përbëhen nga një sërë tatimesh dhe taksash të cilat ndryshojnë për nga lloji, pesha dhe rëndësia. Ditët e sotme rëndësi të veçantë ka marrë edhe strukturimi i sistemit tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi si edhe harmonizimi i sistemit tatimor me *acquis communautaire*. Nga viti 2008 deri në vitin 2014, më saktësisht deri në 1 Janar të vitit 2014, Shqipëria aplikonte taksën e sheshtë prej 10 për qind. Kjo normë tatimore konsiderohej e ulët, megjithatë nën justifikimin se shtresat e varfra paguanin një detyrim më të madh se shtresat e mesme dhe të pasura të popullsisë, pra barra fiskale nuk konsiderohej e shpërndarë në mënyrë të drejtë, qeveria e koalicionit të majtë në vitin 2014 kaloi në tatimin progresiv. Efektet e sistemit tatimor progresiv në ekonominë e Shqipërisë ende mbeten për tu studiuar. Për të zgjeruar sado pak diskutimin rreth taksës së sheshtë mund të themi se në fund të viteve 70' u predikua për herë të parë një kurs i ri i njohur si ekonomiksi i anës së ofertës, i cili thekson se nivelet e ulëta të taksave ndikojnë në nxitjen e sipërmarrjeve të reja, rritjen e punësimit dhe si pasojë në rritjen e prodhimit. Sipas kësaj shkolle një tkurrje e tatimeve do të sillte rritje të të ardhurave të shtetit duke mos ndikuar në rritjen e deficitit buxhetor. Grafiku i mirënjohur i Lafferit tregon se të ardhurat nga taksat janë në lidhje të drejtë me normën tatimore, kjo deri në një nivel të caktuar të kësaj norme dhe më pas korrelacioni bëhet negativ. Përkrahësit e saj argumentojnë se një përqindje e lartë takse do të ulë nivelin e punës në një ekonomi formale, duke ulur kështu të ardhurat nga puna, kursimet dhe investimet dhe duke ndikuar drejtpërsëdrejti në arkën e shtetit (Oudheusden, 2010). Efekti tjetër i një takse të ulët lidhet me rritjen e të ardhurave publike, si pasojë e rritjes së bazës së tatueshme, individët

dhe bizneset nuk do të fshihnin fitimet e tyre. Një nga detyrat më të vështira të ideatorëve të politikave fiskale është pikërisht gjetja e normës optimale të tatimit, gjetja e numrit më të përshtatshëm të tatimeve dhe taksave në rang kombëtar dhe lokal si edhe administrimi optimal i tyre (Davidsson, 2012). E gjitha kjo ndryshon në varësi të nivelit të zhvillimit ekonomik dhe politikave sociale të një vendi, ku në të njëjtën kohë sistemi tatimor do të ndikohet nga kostot administrative dhe të përshtatjes. Gjetja e një sistemi pa kosto nuk përbën apo kërkon aftësi të veçanta, ajo që kërkon vëmendje e studime është pikërisht gjetja e një sistemi tatimor kostot e të cilit janë më të ulëta se përfitimet prej tij.

Aktorët më të ekspozuar ndaj ekonomisë informale

Ndaj ekonomisë informale qëndrojnë të ekspozuar një sërë grupesh ndër të cilët edhe grupet e varfra të tregut të punës. Sfidë kryesore e ekonomisë informale ende mbetet gjetja e metodave dhe teknikave për integrimin e saj në atë formale, si një çështje barazie dhe solidariteti shoqëror. Politikat e një vendi duhet të nxisin largimin nga kjo ekonomi, dhe mbështetja e grupeve pjesë të këtij sektori duhet të financohet nga e gjithë shoqëria. Problemet më të cilat ndeshen punonjësve me paga sipas orëve të punës janë të panumërta. Shkaqet vijnë nga kode pune të papërshtatshme, mos mbrojtja e pozicionit të punës, problemet me skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si edhe nga akseset e kufizuara në organizatat e mbrojtjes të së drejtave të punonjësve. Femrat si pjesë e ekonomisë informale vazhdojnë të zënë një pjesë të konsiderueshme të saj. Statistikat ndërkombëtare tregojnë se femrat zënë mesatarisht 60-80 për qind të këtij tregu. Për më tepër numri i forcave të punës që i përkasin këtij grupi është gjithnjë në rritje, duke përfaqësuar kështu numrin më të madh të punonjësve të papaguar. Puna e vajzave dhe djemve, pra të rinjve, mbetet një tjetër problem madhor. Ata përballen me probleme dhe pengesa nga më të ndryshmet, trajtimi dhe zgjidhja e të cilave kërkon, jo vetëm vëmendje, por edhe politika dhe

strategji të veçanta. Për shkak të nivelit të lartë të papunësisë së kësaj grup moshe ata ndjehen të detyruar ti drejtohen sektorit informal.

Vështirësitë dhe problemet me të cilat përballet ekonomia informale

Pasi kemi përmendur aktorët kryesorë të sektorit informal, le të shohim shkurtimisht se cilët janë problemet dhe vështirësitë me të cilat përballet ai. Ekonomia e tregut i detyron të gjitha bizneset të operojnë në përputhje me rregullat të cilat garantojnë qëndrueshmëri dhe konkurrencë. Ky treg mund të jetë shumë i ashpër, duke i vendosur kështu bizneset formale dhe ato informale përballë pengesave të ndryshme të cilat mund të dëmtojnë vazhdueshmërinë e biznesit. Shteti i favorizon këto pengesa, jo për të ndëshkuar biznesin formal, por si masa për kufizimin e atij informal. Probleme të tilla mund të jenë me natyrë infrastrukturore, institucionale apo edhe ekonomike. Këto pengesa janë të lidhura me njëra-tjetrën duke krijuar kështu rrethin vicioz të varfërisë dhe riskut të lartë. Për ta ilustruar me një shembull mund të themi se ndër arsyet kryesore të mungesës së kapitalit dhe mundësive për investime për sektorin informal është pamundësia për tu financuar nga institucionet financiare. Pavarësisht pengesave të përmendura duhet të theksojmë se ka edhe faktorë të tjerë si për shembull cikli i jetës së produktit, lloji i sipërmarrjes dhe niveli i zhvillimit të shoqërisë. Por sa i mundur është formalizmi i ekonomisë informale? Shkalla e lartë e informalitetit vështirëson detyrat e qeverisë për të mbledhur të ardhura publike. Ajo vetë nuk duhet ta lejojë informalitetin. Përpjekjet e agjentëve ekonomikë duhet të koordinohen në mënyrë të drejtë nga vetë qeveria duke çuar kështu në zvogëlim të vazhdueshëm të ekonomisë informale. Proçesi i negociatave me BE-në për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit pasqyroi progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit. Duke marrë parasysh statusin e Shqipërisë si një vend kandidat për në Bashkimin Evropian duhet të themi se janë rritur standardet dhe pritshmëritë dhe jo vetëm kaq, por përpara vendit tonë tashmë qëndrojnë

objektiva edhe më ambicioze. Duke pasur parasysh problemet aktuale me mbledhjen e të ardhurave publike ngremë pyetjen se si do të arrihen këto objektiva ambicioze. Eksperienca e vendeve në zhvillim ka treguar se që të përmirësosh qeverisjen me qëllim arritjen e objektivave sociale, do të thotë të kalosh nga një ekonomi pa infrastrukturë në një ekonomi që paguan tatime e taksa. Pjesa dërrmuese e këtyre reformave kërkon reduktim të korrupsionit, ineffiçencës burokratike dhe të shkaqeve të tjera të ekonomisë informale. Gjithnjë e më shumë po tentohet drejt reduktimit të transaksioneve me para në dorë. Veprimet bankare dhe transaksionet vetëm nëpërmjet bankave dhe institucioneve financiare pa diskutim që do të sjellin ulje të informalitetit. Por jo vetëm kaq, edhe vetë qeveria nëpërmjet strukturave administrative të saj mund të luaj një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe rregullimin e lëvizjes së parave dhe pagesave në dorë. Forcimi i kontrolleve nga institucione të ndryshme shtetërore, për evidentimin dhe denoncimin e sektorit informal, do të ishin të tjera mënyra për të formalizuar sektorin informal. Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin e tij të vitit 2014 thekson se përmirësimi i mbledhjes së tatimeve në Shqipëri do të arrihet duke përmirësuar administrimin tatimor dhe jo duke ndryshuar politikën tatimore. Me qëllim matjen e ekonomisë informale në Shqipëri janë bërë studime të ndryshme, kështu për shembull OECD ka vlerësuar se ekonomia informale në vendin tonë është afro 40 për qind. Instituti i Statistikave, INSTAT, vlerëson se pesha që zë ekonomia informale në vendin tonë është 32 për qind. Ashtu siç e kemi theksuar edhe më lart eliminimi i ekonomisë informale është pothuajse i pamundur, kështu që qëllimi i çdo vendi është mbajtja e saj në nivele të cilat nuk cenojnë zhvillimin ekonomik. Fenomeni i ekonomisë informale mund të analizohet duke u fokusuar në faktorët që e shkaktojnë atë. Ky fenomen kompleks vjen si pasojë e disa faktorëve të cilët nga ana e tyre ndër veprojnë me njëri-tjetrin duke sjellë kështu edhe zhvillim të mëtutjeshëm të ekonomisë informale dhe ndonjëherë edhe kalim nga ekonomia formale në atë

informale. Ndër faktorët të cilët ndikojnë në rritjes e saj në përgjithësi, përfshirë edhe vendin tonë, do të përmendnim;

- Numri i lartë i normave dhe rregullave ligjore dhe administrative.
- Papunësia.
- Detyrime të larta tatimore.
- Mungesa e besimit në institucionet publike dhe korrupsioni.
- E drejta e pronës.
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë ndaj detyrimeve tatimore.
- Miratimi i punës së zezë nga shteti.
- Mos deklarimi i të ardhurave.

Ekonomia informale në Shqipëri ka lindur pas viteve 1990, përpara kësaj periudhe për shkak të ekonomisë së centralizuar nuk mund të flasim për fenomene të tilla. Liberalizimi i tregut padyshim që solli lindjen dhe rritjen e saj. Kjo edhe për faktin se shteti nuk krijoi mekanizmat e nevojshëm për ta shmangur apo edhe për ta kontrolluar atë, këtij argumenti do ti rikthehemi sërish kur të shqyrtojmë reformat në sistemin tatimor. Pas shembjes së institucioneve të ekonomisë së centralizuar u krijuan hapësira apo vakume institucionale dhe ligjore. Edhe krizat financiare, ekonomike dhe politike të cilat kanë prekur vendin tonë, në periudha të ndryshme, kanë nxitur zhvillimin e informalitetit. Realiteti shqiptar tregon se autoritete shtetërore të niveleve të ndryshme shpesh, edhe për përfitime personale, ndihmojnë dhe përkrahin zhvillimin e informalitetin. Mos deklarimi i të ardhurave është një tjetër element i cili sjell rritje të ekonomisë informale. Ky faktor mund të shihet, si nga këndvështrimi i punëdhënësve, ashtu edhe nga ai i punëmarrësve. Punëmarrësit priren të deklarojnë më pak në mënyrë që të kenë më pak detyrime tatimore si tatim mbi fitimin, TVSH, sigurime shoqërore e shëndetësore. Ndërsa

punëmarrësit, si pasojë e mos deklarimit të të ardhurave, përfitojnë diferencën midis pagës reale dhe detyrimeve më të ulëta tatimore. Këto elementë ndikojnë në mbarëvajtjen e tregut të punës dhe si pasojë sjellin rritje të ekonomisë informale.

Evazoni fiskal

Disa herë përgjatë kësaj pjese të studimit kemi theksuar se burimi kryesor i mbledhjes së të hyrave publike janë pikërisht tatimet. Një pjesë e fitimit bruto të organizatave të biznesit shkon për shtetin në formën e tatimit. E gjitha kjo përkthehet në ulje të fuqisë blerëse të tatimpaguesve, prandaj procesi i tatimit është i ndërlikuar dhe shpesh shkakton efekte me natyrë ekonomike, fiskale dhe sociale. Ndër efektet e shkaktuara nga tatimet mund të përmendim bartjen e tatimit, rezistencën ndaj pagimit të tatimit, transformimin e tatimit, evazionin fiskal, efektet makroekonomike të tij etj. Por çfarë është evazoni fiskal? Evazoni fiskal duhet kuptuar si shmangie e qëllimshme e detyrimeve tatimore të cilat rrjedhin nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik. Rreth tij mund të flasësh vetëm atëherë kur subjekti tatimor i cili i është shmangur detyrimeve tatimore, në mënyrë të qëllimshme, është identifikuar dhe i është nënshtruar procedurave të caktuara në ligj. Dukuria e shmangies nga pagimi i detyrimeve tatimore është një dukuri me shtrirje të gjerë, pra përfshin dhe prek shumë sisteme tatimore, por arsyet që e shkaktojnë atë janë të ndryshme dhe po aq të ndryshme janë edhe pasojat e tij. Në realitetin shqiptar duket sikur anomalitë dhe paradokset prej vitesh janë pjesë e përditshmërisë, thënë këtë kuptojmë dhe ndoshta edhe pranojmë se gjetja e arsyeve për të mos paguar tatime dhe taksa është diçka lehtësisht e realizueshme. Shembja e komunizmit dhe kalimi i vendit në ekonomi tregu duket sikur njëherazi sollën edhe lindjen e ekonomisë informale dhe evazionit fiskal. Përgjatë viteve të para të zhvillimit të ekonomisë së tregut të gjithë jemi dëshmitarë të faktit se zhvillimi i institucioneve ligjore, fiskale apo edhe kuadri rregullator ishte disa hapa mbrapa në krahasim me

zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve private. Shembja e skemave piramidale, në 1997, solli trazira politike dhe ekonomike të cilat padyshim, jo vetëm që penguan zhvillimin e një kornize koherente institucionale, por edhe krijuan hendekun midis institucioneve tatimore dhe tatimpaguesve. Pas kësaj krize financiare, që kaploi të gjithë vendin, qeveritë shqiptare përtej ngjyrymeve partiake, në vazhdimësi kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar një sistem tatimor modern dhe të strukturuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Kuptimi i evazionit fiskal. Vështrim i përgjithshëm mbi legjislacionin fiskal në Shqipëri

Në Shqipëri evazoni fiskal reflektohet në spekulimet e bëra me vlerat e mjeteve në bilanc, në punësimin informal, në paga punonjësish joreale, në detyrimet e papaguara sociale etj. Përpara vitit 1990, për shkak të mendësisë së krijuar përgjatë viteve të regjimit komunist, shqiptarët mendonin se ishin i vetmi shtet në botë pa tatime e taksa. Të gjithë paguanin tatime dhe taksa, por ato ishin të fshehura në çmimet e kontrolluara të produkteve dhe shërbimeve të cilat ofroheshin nga ndërmarrjet shtetërore. Nën këto kushte për shoqërinë tonë nuk ka qenë e lehtë prezantimi dhe pranimi i një sistemi tatimor dhe i një administrate tatimore. Në këtë proces vlen të përmendet hartimi dhe miratimi i Ligjit 7928 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” si edhe përgatitja e infrastrukturës për zbatimin e tij. Sistemi tatimor vazhdoi të zhvillohet më tej me ligje të tilla si “Për Tatimin mbi të Ardhurat” në vitin 1998, “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” në vitin 1999, “Për Taksën Vendore për Biznesin e vogël” në vitin 2002, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” në 2002, paketa e taksës së sheshtë në vitin 2008 dhe ajo e taksës progresive në vitin 2014. Pavarësisht përpjekjeve të qeverive shqiptare, numri i deklaruesve të cilët i shmangen detyrimeve fiskale është ende i lartë. Shteti është agjent ekonomik dhe si i tillë ai synon mbledhjen e të ardhurave dhe ri shpërndarjen e tyre dhe kjo me qëllim arkëtimin e të ardhurave të parashikuara në buxhet. Si pasojë e saj bizneseve, të cilët në

lidhje me deklarimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore konsiderohen si më të rregullt, shpesh u ngarkohet një barrë fiskale më e lartë. Pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme të bëra në sistemin tatimor ka ende vend për rishikim dhe përmirësim, me qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm për të bërë biznes. Këto elemente konsiderohen si nxitës për zhvillimin e bizneseve. Që bizneset të zhvillohen kërkohet jo vetëm kaq, por edhe harmonizim i politikës fiskale me politikat e zhvillimit të biznesit. Aktualisht mund të themi se legjislacioni tatimor mbulon dhe rregullon pothuajse të gjitha aktivitetet, llojet e tatimeve dhe taksave. Progres është bërë, si në lidhje me hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, ashtu edhe në lidhje me administrimin e sistemit tatimor dhe megjithatë jemi ende në nivele shumë të larta të evazionit fiskal. Ashtu siç e kemi përmendur edhe më lart shmangia nga pagesa e detyrimeve tatimore është një fenomen i përhapur pothuajse në të gjithë botën. Përtej përhapjes së gjerë të tij, ai mund të jetë i ligjshëm ose e paligjshëm. Çfarë kuptojmë me evazion fiskal të ligjshëm e të paligjshëm? Në rastin e evazionit fiskal të ligjshëm veprimet e obliguesit tatimor nuk bien në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ky lloj i evazionit fiskal ndodh kur kuadri ligjor nuk flet qartë dhe lë hapësira për të bërë anashkalime apo shmangie të detyrimeve tatimore. Pra ai krijohet dhe ekziston për shkak të dispozitave ligjore jo të plota, apo edhe jo të sakta. Duke shfrytëzuar këto mangësi dhe hapësira obliguesi tatimor tenton të deklarojë shpenzime më të mëdha, apo edhe të ardhura më të vogla me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore. Në vija të përgjithshme u përpoqëm të sqarojmë konceptin e evazionit fiskal të ligjshëm, le të shohim tashmë se çfarë kuptojmë me evazion fiskal të paligjshëm. Ashtu sikurse mund të kuptohet edhe nga vetë emri evazion fiskal i paligjshëm ndodh në rastin kur obliguesi tatimor i shmanget pagimit të detyrimeve tatimore të parashikuara në ligj, apo edhe kur veprimet e tij bien në kundërshtim me ligjin.

Nëse hulumtojmë për të gjetur se cilat janë arsyet kryesore të ekzistencës së evazionit fiskal, atëherë mund të gjejmë disa faktorë, një pjesë të së cilëve po i përmendim në vijim.

- Niveli i arsimit të popullsisë

Vendet me popullsi të arsimuar konsiderohen si vende nënshtetasit e të cilëve zotërojnë njohuritë bazë mbi sistemin tatimor, domosdoshmërinë e tatimeve dhe pagimit të detyrimit tatimor. Tashmë shprehja e famshme “Vdekja dhe tatimet janë të pashmangshme” konsiderohet si kod universal, por duhet thënë se ajo nuk gjen zbatim po kaq të gjerë në praktikën shqiptare. Shoqëria shqiptare ende ka nevojë të kuptojë dhe pranojë se pagesa e detyrimeve tatimore është në të mirë të saj, se nëpërmjet tyre financohen shpenzimet publike, sigurohet rendi dhe qetësia, realizohen investimet, ofrohen shërbime më të mira etj.

- Korrupsioni

Lufta ndaj evazionit fiskal, e cila konsiderohet si detyrë parësore e administratës tatimore, duhet parë si e ndërlidhur me korrupsionin e mundshëm në radhët e kësaj administrate. Korrupsioni padyshim që tjetëron figurën e personelit tatimor dhe administratës, pjesë e së cilës ata janë. Prezenca dhe përhapja e këtij fenomeni ul ndjeshëm nivelin e të ardhurave publike.

- Sanksionet kundër tatimpaguesve

Tatimpaguesit i paguajnë detyrimet e tyre tatimore dhe nuk i shmangen atyre nëse janë të vetëdijshëm se në rast të kundërt i presin sanksionet. Sa më të forta këto sanksione, aq më të gatshëm do jenë tatimpaguesit të plotësojnë me korrektësi detyrimet e tyre tatimore.

- Paketa fiskale dhe normat tatimore

Dëshira për të “mbushur” arkën e shtetit në një afat të shkurtër kohe bën që qeveria, pa diskutim edhe ajo e vendit tonë, të vendosë norma të larta tatimore apo edhe të ndryshojë sistemin tatimor duke krijuar pakënaqësi dhe kundërshti nga ana e biznesit. Këto të fundit sjellin tendencën e

biznesit për të fshehur prodhimin dhe për të ndryshuar vlerën e mjeteve, duke shkaktuar kështu evazion fiskal. Përcaktimi i niveleve të pranueshme të tatimeve, të cilat duhet të jenë të krahasueshme edhe me vendet e rajonit, do të ndikonte pozitivisht, jo vetëm në vjeljen e më shumë të ardhurave tatimore, por do të krijonte gjithashtu edhe një atmosfere kundër evazionit. Kjo luftë midis shtetit dhe bizneseve provokon dhe nxit biznesin që të punojë me dy buxhete, një për fitimet reale të tij dhe një për t'ia paraqitur shtetit për shlyerjen e detyrime fiskale dhe tatimore.

- Auditimi tatimor dhe rëndësia e tij

Programet e kontrollit të administratës tatimore hartohen dhe zbatohen me qëllim identifikimin e gabimeve në vlerësimin dhe vjeljen e të ardhurave tatimore. Tatimpaguesit e regjistruar në vendin tonë vlerësojnë dhe deklarojnë tatimet ose paraqesin pasqyrat financiare në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e cila bën vlerësimin e tatimit. Nëse procesi i vlerësimit nuk kontrollohet, atëherë ka gjasa që tatimi i deklaruar të ulët në mënyrë progresive, duke sjellë edhe mosrealizim të objektivave në lidhje me realizimin e planit të të ardhurave për këtë drejtori, për Ministrinë e Financave dhe për vetë shtetin. Në mënyrë që të minimizohet evazoni fiskal dhe shmangia nga tatimi, sektorët e kontrollit në zyrat e drejtorive rajonale tatimore programojnë vizita dhe kontrolle në ambientet e deklaruesve, por jo vetëm. Kontrollet jo vetëm që minimizojnë ndryshimin midis tatimit të deklaruar dhe atij që realisht duhej paguar, por edhe shërbejnë si parandalues të evazionit fiskal. Me qëllim që diferenca midis detyrimit real dhe atij të paguar të jetë sa më e vogël, ndër të tjera duhet që deklaruesit të kuptojnë dhe të binden se evazoni fiskal është biznes i keq.

- Transparenca

Evazioni fiskal mund të konsiderohet edhe si përgjigje e arsyeshme ndaj rezultateve të varfra të qeverisjes. Sistemi fiskal duhet të jetë transparent përpara çdo qytetari. Të qenit një sistem i arsyeshëm, transparent dhe eficient konsiderohen si parakushte për çdo përgjigje pozitive të shoqërisë ndaj sistemit. Kjo vlen, si për sistemin tatimor, ashtu edhe për shpenzimet dhe të ardhurat publike si pjesë përbërëse të tij. Tatimpaguesit kanë të drejtë të kenë dijeni rreth mënyrës së shpenzimit të parave të tyre, të vjela në formën e tatimeve. Slogani “S`ka tatime pa pasqyrim të drejtë” duhet të gjej zbatim edhe në vendin tonë.

3.2 Sistemi tatimor në Shqipëri para viteve 1990

Le të hedhim fillimisht një vështrim të shkurtër mbi historikun e sistemit tatimor në Shqipëri. Në të vërtetë sistemi tatimor modern në Shqipëri i ka fillimit e tij në vitet e para të shekullit të kaluar, por gjurmë të tij shihen shumë më herët, në epokën e hershme para ilire. Më e njohur dhe e dokumentuar për sistemin tatimor në Shqipëri janë periudha e vonë e pushtimit turk, periudha deri në shpalljen e pavarësisë, disa qeveri shqiptare të ardhura më pas, sidomos ajo e Mbretërisë Shqiptare, deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Por periudhat më të rëndësishme të sistemit tatimor, ne mund ti ndajmë në disa etapa. Etapa e parë nis që nga fillimet e shekullit XVII deri në krijimin e shtetit shqiptar, kohë kur kanë ekzistuar tatime të tilla si tatimi mbi përdorimin e tokës bujqësore, mbi të ardhurat personale, taksa për duhanin, pijet alkoolike, kafën etj. Projektligji i parë tatimor për tatimin mbi fitimin (Nr. 2575, datë 31.11.1927) është hartuar në vitin 1927 nga Ministria e Financave e asaj kohe. Etapa e dytë përfshin periudhën 1928 – 1938, periudhë kjo që përkon me krijim e Mbretërisë Shqiptare dhe mbretërimin e Ahmet Zogut. Sistemi fiskal gjatë këtyre viteve ndahej në tre grupe të mëdha dhe më konkretisht në tatime direkte, tatime të tërthorta dhe taksat shtetërore. Etapa e tretë është ajo kur nuk ekzistonte asnjë sistem tatimor. Përgjatë periudhës 1944-1990, gjatë së cilës shteti komunist shpalli se nuk

ekzistonte prona private dhe tregtia e lirë, nuk mund të flitej për ligj tatimor. Gjatë sistemit komunist, në fakt, nuk duhet thënë se përfundimisht u zhduk sistemi i tatimeve dhe taksave. Ai u ruajt, por në mënyrë të kamufluar. Etapa e katërt janë vitet të cilat përfshijnë fillimin e viteve '90-të e në vazhdim, kur ka rinisur të formulohet dhe të ekzistojë në formë të institucionalizuar sistemi tatimor shqiptar. Në të gjithë jemi dëshmitarë të ndryshimeve të herë pas hershme të sistemit tatimor në vendin tonë, të cilat në përgjithësi tentojnë ta bëjnë atë një sistem modern bashkëkohor. Kështu, fillimisht në Maj 1991 u vunë në zbatim tatimet doganore, si elementët fiskalë më të lehtë për tu zbatuar dhe administruar. Ndërkohë që në Qershor të vitit 1991 u vendosën tatimet e para për veprimtaritë ekonomike private. Në janar të vitit 1992, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë miratoi një paketë ligjesh për sistemin tatimor duke hedhur kështu bazat e sistemit fiskal në Shqipëri. Paketa e legjislacionit fiskal ka pësuar ndryshime të ndjeshme gjatë këtyre viteve duke u pasuruar me ligje të reja dhe duke përmirësuar ato ekzistuese. Ndër to mund të përmendim;

- Periudha 1991-1993, fillimet e sistemit tatimor, hartimi dhe miratimi i paketës fiskale dhe futja e instrumenteve të ekonomisë së tregut në ekonominë e vendit.
- Periudha 1994-1996, implementimi i legjislacionit tatimor dhe vendosja e tatimeve dhe taksave.
- Periudha 1997-1998, stabilizimi i të ardhurave tatimore. Objektivi kryesor ishte frenimi i rënies së tyre, kapërcimi i krizës ekonomike dhe financiare të krijuar nga firmat piramidale në vitin 1997.
- Periudha 1999-2001, konsolidimi i sistemit tatimor dhe të ardhurave tatimore, të cilat ranë ndjeshëm pas ngjarjeve të vitit 1997.

- Periudha 2002-2006, krijimi i klimës makroekonomike për zhvillim dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet përmirësimit të marrëdhënieve me biznesin dhe rritjen e shërbimit të administratës tatimore ndaj tatimpaguesve dhe publikut.
- Periudha 2007-2014, ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit tatimor duke synuar hartimin e një ligji të ri për procedurat tatimore, sigurimin e të ardhurave sipas deklaramit vullnetar, reduktimin e korrupsionit nëpërmjet futjes së deklaramit elektronik, ngritjen e strukturës kundër korrupsionit dhe të rritjes së informacionit dhe ndihmës teknike për tatimpaguesit duke përmirësuar klimën me biznesin në Shqipëri.

3.3 Reformat e pas viteve 1990 në sistemin tatimor në Shqipëri

Në Shqipëri, ashtu sikurse edhe në të gjitha shtetet e Ballkanit, pas rrëzimit të sistemit komunist filloi reformimi i sistemit tatimor. Ky reformim ishte i domosdoshëm edhe për shkak të pranisë së tranzicionit ekonomik-shoqëror. Tranzicioni si koncept është proces transformues i përmasave të thella të një sistemi shoqëror-ekonomik, nëpërmjet të cilit ai kalon në një strukturë të re, e cila siguron efikasitet dhe efektivitet më të lartë (Mirdala, 2013). Shqipëria për të arritur efikasitetin dhe efektivitetin e nevojshëm duhet të bënte ndryshime të qenësishme në sistemin shoqëror, politik, ekonomik, fiskal, arsimor dhe pothuajse në të gjitha nënsistemet e tyre. Masat e para ishin liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë, zhvillimi dhe stabiliteti i financave publike, politika monetare, ristrukturimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve, krijimi i rrjetit të sigurimeve sociale dhe zhvillimi i kornizës juridike dhe institucionale të një ekonomie të orientuar nga tregu. Reformimi i sistemeve tatimore përbënte vetëm njërin nga segmentet kryesore të procesit reformues në kuadër të tranzicionit ekonomik-shoqëror. Analiza e procesit të reformave tatimore konsiderohet e vështirë për disa arsye. Së pari që analiza të jetë e plotë dhe e qëndrueshme ajo duhet të bazohet në të dhëna të besueshme, nga burime të besueshme dhe e shtrirë në një afat të

gjatë kohor. Problemi me të dhëna të besueshme, i cili ka qenë veçanërisht i shprehur në vitet e para të tranzicionit dhe për çështje të rëndësishme, përfshirë këtu edhe ato makroekonomike, vazhdon edhe në ditët e sotme. Së dyti procesi i tranzicionit, kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut u shoqërua me rritje të madhe të sektorit të ekonomisë informale, e cila ashtu sikurse e kemi përmendur edhe më lart kur kemi folur për të, nuk ka mundur të mbulohet asnjëherë me statistika. Në rastin e Shqipërisë sektori i ekonomisë informale ka vështirësi të shumta dhe të ndryshme, si në lidhje me njohjen, ashtu edhe me matjet e tij. Deri më tani ende nuk kemi analiza statistikore të mirëfillta. Institucionet e vendit tonë japin shifra krejt të ndryshme nga institucionet ndërkombëtare. Së treti gjerësia e sektorit publik, i cili përfshin në vetvete një numër të madh të dhënash dhe informacionesh, bën që analizat krahasuese të pengohen për shkak të vështirësive të krahasimit dhe pamundësisë së harmonizimit. Shpeshherë këto të dhëna ndryshojnë nga njëri institucion në tjetrin dhe vështirësia rritet edhe më shumë nëse të nevojitet të dhëna të aktivitetit privat, apo edhe nëse duhen krahasuar disa shtete së bashku.

Reformat e para, për të vazhduar në rrugën drejt ekonomisë së tregut, duhet të mbështeteshin vazhdimisht me reforma të tjera, reforma këto mjaft të domosdoshme si pasojë e ndryshimeve dhe vështirësive të tregut dhe ekonomisë në tërësi. Reformat fillestare kishin karakter stabilizues dhe bazoheshin në paketa standarde, e cila konsistonte në liberalizimin e plot të çmimeve, uljen dhe kontrollin e deficitit buxhetor dhe në politikën monetare shtrënguese, nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare dhe liberalizimit të tregtisë së jashtme. Paralelisht me reformat stabilizuese u ndërmorën dhe reforma strukturore. Qëllimi i reformave strukturore ishte reformimi i sistemit të tatimeve dhe sistemit financiar dhe bankar, modifikimi i strukturave institucionale për të rregulluar dhe kontrolluar aktivitetet ekonomike, lejuar ushtrimin e

veprimtarive private, lehtësuar pavarësinë financiare të ndërmarrjeve nga buxheti i shtetit, siguruar mbështetje financiare për sektorin privat në zhvillim si dhe ndihmuar në realizimin e reformave stabilizuese.

Sigurisht që menaxhimi i mirë i periudhës së tranzicionit kërkonte edhe reforma fiskale. Ekzistenca e një sistemi fiskal të konsoliduar në një ekonomi në tranzicion është një faktor i rëndësishëm, për stabilizimin e variablave makro ekonomike dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Nevoja për sisteme tatimore ka lindur si një domosdoshmëri e shtetit për të financuar të mirat dhe shërbimet publike, që ai i ofron shtetasve të tij. Të ardhurat e siguruara nga sistemi tatimor përbëjnë edhe potencialin kryesor të të ardhurave buxhetore. Megjithatë vendosja e një sistemi eficient dhe të ndershëm tatimor është shumë larg të qenit i thjeshtë, veçanërisht në vende si i yni, që kërkon të integrohet në ekonominë evropiane.

Prania e sistemit tatimor në ekonomi është më komplekse sesa thjesht realizimi i të hyrave publike. Meqenëse tatimet mbledhen nga bizneset dhe nga individët, ato vetë ndikojnë vendimmarrjen e tyre. Sistemi tatimor mund të prekë sjelljen e konsumatorëve duke ndryshuar nxitjet e tyre për të punuar, për të kursyer, për të arsimuar, për të investuar, mund të ndryshojë ekspozimin e tyre ndaj riskut, etj. Sistemi tatimor ka edhe efekte të tjera financiare siç mund të jetë ndryshimi i strukturës financiare të firmave, ndryshimi i strukturës organizative etj.

Qëllimi i mbledhjes së tatimeve është të financojnë shpenzimet qeveritare për prodhimin dhe ofrimin e të mirave publike si edhe të shërbimeve sociale bazë. Në këtë kontekst ndryshimi i strukturës tatimore do të ndikonte edhe në shpenzimet qeveritare. Reformat strukturore në sistemin e taksave, që në fillim të tranzicionit, kanë pasur si qëllim përshtatjen e sistemit ndaj ndryshimeve ekonomike të tregut në përgjithësi dhe sektorit privat. Parimi më i rëndësishëm, ndaj të cilit kërkohet vëmendja e gjithë sferës politike, në ekonominë e tregut është se sistemi i

taksave duhet të jetë instrument me një qëllim të vetëm, të rrisë të ardhurat në mënyrë sa më efikënte dhe të drejtë.

Reformat fiskale të viteve të para përfshinin, jo vetëm politikën tatimore, por edhe administrimin e tatimeve. Në thelb të tyre qëndronte ndërtimi i një sistemi tatimor optimal, duke qenë se nga e kaluara nuk trashëguam asnjë element të tij. Sistemi tatimor u vendos në mbështetje të ekonomisë dhe sektorit privat në rritje, nëpërmjet prezantimit të tatimeve dhe taksave të reja, tatimit të shërbimeve dhe transaksioneve të cilat më parë nuk tatoheshin dhe krijimit të kapaciteteve për të mbledhur dhe administruar këto tatime. Le të hedhim një vështrim mbi reformat kryesore të kësaj periudhe.

Tatimi mbi vlerën e shtuar zëvendëson tatimin mbi qarkullimin

Reforma në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar ka qenë mjaft e rëndësishme, pasi ky tatim edhe sot është burimi kryesor i të ardhurave tatimore, kësaj analize do ti rikthehemi sërish pak më vonë kur të analizojmë të ardhurat tatimore dhe ecurinë e tyre ndër vite. Në 1993 me ligjin nr 7676 “Për tatimin mbi qarkullimin” hyri në fuqi ai që sot njihet si tatimi mbi vlerën e shtuar. Në vitin 1995 e më saktësisht në 27.04.1995 u zëvendësua tatimi mbi qarkullimin me tatimin mbi vlerën e shtuar me ligjin nr 7928. TVSH është një tatim i cili paguhet për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në tregun shqiptar si edhe për të gjitha mallrat e importit.

Lidhur me rimbursimin e taksës mbi vlerën e shtuar mund të themi se në shumë sisteme tatimore për shitjet, burimet tatohen fillimisht dhe pastaj produkti përfundimtar tatohet sërish pasi burimet janë përdorur për të prodhuar një produkt. Kjo rezulton në tatim të shumëfishtë me efekt frenues. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar synon të shmangë problemin e tatimit të shumëfishtë. TVSH aplikohet për konsumin përfundimtar të mallrave apo shërbimeve nga konsumatori i fundit.

Mblidhet në çdo fazë të blerjes dhe shitjes, por garantohen zbritje për taksat e paguara nga blerjet e mëparshme. Kompanitë e regjistruara në zyrat tatimore vendore për TVSH lejohen të pretendojnë rikthimin e një shumë për TVSH-në që u kanë paguar furnitorëve. Ajo që kompanitë duhet t'u paguajnë autoriteteve tatimore rregullisht është teprica midis shumës së çmimeve që u vënë klientëve (taksa për autputin) dhe shumës së TVSH-së që u kanë paguar furnitorëve (taksa e inputit). Kompanitë e huaja zakonisht mund të marrin rimbursime për TVSH-në e paguar për blerjet për të cilat bizneset e regjistruara për TVSH mund të pretendojnë zbritjen e taksës së inputit nga rimbursimi vendor i TVSH-së. Po të mos kishte masa të tilla lehtësuese për bizneset e huaja, sistemi i TVSH-së do të konsiderohej diskriminues dhe në shkelje të marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare. Gjithashtu, TVSH normalisht rimbursohet sipas produkteve të eksportuara nga shteti tatues. Shumë nga vonesat dhe mangësitë e lidhura me kthimin e tatimeve mund të zvogëlohen nëpërmjet skedimit elektronik me bazë internetin. Në vendin tonë tatimi mbi vlerën e shtuar e tatoni konsumin e mallrave dhe shërbimeve në masën 20 për qind. Diskutimet lidhur me normën e tatimit mbi vlerën e shtuar vazhdojnë ende, ato përqendrohen kryesisht mbi përjashtimin, ose reduktimin për kategori të caktuara nga ky tatim. Shpesh herë është kërkuar nga bizneset të përdoren norma të diferencuara, por kjo nuk është pranuar nga qeveria për shkak të problemeve në zbatimin e tyre, administrimin dhe edukatës së ulët tatimore të tatimpaguesve. Vitet e fundit si subjekt i TVSH u përfshinë edhe librat shkollorë kurse në 2011 hyri në fuqi pagesa e tatimit edhe mbi medikamentet mjekësore. Përgjatë vitit 2014 ka pasur ndryshime të tjera në lidhje me procedurat e përjashtimit dhe përfitimit të shtyrjes së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Reformat në fushën e akcizës

Ligji i akcizës është i thjeshtë dhe sipas standardeve evropiane. Ndryshimi më i fundit i ligjit të akcizave u bë në fillim të vitin 2012 me ligjin nr 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” me anë të së cilit, jo vetëm që ndryshoi mënyra e funksionimit të mbikëqyrjes së akcizës, por ajo gjithashtu kaloi nën administrimin e organeve doganore. Normat e saj kanë ndryshuar dhe sipas paketës fiskale të 2014 do të vazhdojnë të ndryshojnë edhe në vitet në vazhdim. Me gjithë ndryshimet e bëra statistikisht flasin ende për mos realizim të të ardhurave nga akciza.

Reformat e tarifave doganore në kuadër të liberalizimit të tregtisë

Në kuadrin e respektimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë (MTL) dhe angazhimeve me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) është bërë reduktimi gradual i tarifave doganore, duke i unifikuar ato edhe me vendet me të cilat janë lidhur marrëveshje të tregtisë së lirë. Shqipëria është anëtare e OBT që prej Shtatorit të vitit 2000. Me anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë nisi edhe procesi i harmonizimit të legjislacionit tregtar, në përputhje me rregullat ndërkombëtare të tregtisë dhe të OBT-së. Niveli i tarifave doganore përcaktohet në bazë të nomenklaturës së kombinuar të klasifikimit të mallrave në nivel 8 shifror. Ky klasifikim është në përputhje të plotë me nomenklaturën e klasifikimit të mallrave që zbaton BE-ja. Sistemi tarifor është mjaft i thjeshtë. Tarifat doganore që zbatohen janë: 0 për qind, 2 për qind, 5 për qind, 6 për qind, 10 për qind dhe 15 për qind. Në zbatim të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, Shqipëria zbaton tarifa preferenciale importi me vendet e marrëveshjeve si CEFTA, EFTA, BE dhe Turqinë. Tarifat doganore kanë ardhur duke u reduktuar nga 35 për qind që kanë qenë në vitin 1997 deri në mesatarisht 1.3 për qind për vitin 2014.

Qeveritë vendore dhe administrimi i tatimeve

Në kuadër të reformës së decentralizimit shumë taksa të reja dhe ekzistuese i kaluan për administrim pushtetit lokal, pasi për nga rëndësia në mbledhjen e të ardhurave ishin shumë pak domethënëse për pushtetin qendror, kurse për atë lokal konsideroheshin një burim i rëndësishëm të ardhurash. Për vitin 2010 të ardhurat nga pushteti vendor përbënin vetëm 5 për qind të të ardhurave tatimore. Në vitin 2009 edhe taksa mbi biznesin e vogël u kalua në administrim të pushtetit lokal. Në 1 Janar 2014 është botuar në fletore zyrtare udhëzimi i ministrisë së financave me nr 32 i cili në lidhje me administrimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin shprehet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e ngarkuar me administrimin e tatimit të thjeshtuar për fitimin mbi biznesin e vogël dhe me vlerësimin e procedurave tatimore. Drejtoritë rajonale të tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohen agjent shërbimi i këtyre të fundit. Ato janë gjithashtu të ngarkuara me transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Thjeshtimi i sistemit tatimor

Me qëllim uljen e barrës fiskale dhe rritjen e efikasitetit të sistemit tatimor janë ndërmarrë disa reforma, në qendër të së cilave kanë qenë normat tatimore. Kështu normat e tatimit mbi fitimin u reduktuan, nga 25 për qind që ishin në 1993, në 10 për qind në vitin 2008. Gjithashtu tatimi mbi të ardhurat personale i cili ishte progresiv me nivel maksimal 25 për qind në 1993 erdhi duke u reduktuar deri në tatim të sheshtë 10 për qind në 2007. Ndryshimet e bëra në normat tatimore kanë ndikuar në rishpërndarjen e të ardhurave midis grupeve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë. Efektet e ndryshimeve fiskale të vitit 2014 do të jenë objekt studimi në vitet në vijim.

Kalimi në taksën e sheshtë dhe më pas në tatimin progresiv

Një nga reformat më të diskutuara para afro 10 viteve ka qenë vendosja e taksës së sheshtë. Qëllimi i kësaj reforme ishte të krijonte të ardhura në buxhet nëpërmjet rritjes së bazës së tatueshme, uljes së normës së tatimit, uljes së evazionit dhe ofrimit të lehtësirave administrative nga pikëpamja e llogaritjes dhe mbledhjes së të ardhurave. Tatimi i sheshtë zëvendësoi normat progresive të tatimit mbi të ardhurat personale dhe reduktoi në 10 për qind tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin mbi fitimin. Ka disa arsye se pse u aplikua taksa e sheshtë në Shqipëri. Aplikimi i taksës së sheshtë nga qeveri të reja është përdorur si një sinjal drejt kalimit në një regjim tatimor më pranë politikave të tregut. Në mjaft raste ky sinjal është pritur mirë. Gjithashtu problemet e mëdha të administrimit, evazionit të lartë dhe korrupsionit kanë ndikuar në vendosjen e taksës së sheshtë, e cila përbën një thjeshtim duke eliminuar disa forma të arbitrazhit, ose trajtimit të veçantë të kategorive të caktuara. Megjithatë kjo nuk do të thotë që pas vendosjes së kësaj takse sistemi tatimor nuk është më kompleks. Së fundmi përkrahësit e taksës së sheshtë theksojnë se ekzistenca e një strukture tatimore të shkallëzuar dhe me norma të larta tatimore mund të ketë ndikim negativ në administrimin e tatimit.

Në vendin tonë bisedimet në lidhje me vendosjen e taksës së sheshtë kanë filluar që në vitin 2004, por implementimi i saj u bë në korrik 2007 për tatimin mbi të ardhurat personale dhe në 1 janar 2008 për tatimin mbi fitimin. Struktura e saj ishte e tillë që niveli i pagës minimale nuk tatohej dhe për pagat deri në 30 000 lekë tatohej me 10 për qind diferenca midis pagës së individit me pagën minimale, kurse mbi këtë nivel aplikohej plotësisht tatimi 10 për qind. Ashtu sikurse është përmendur më lart, sistemi tatimor në Shqipëri ka probleme në lidhje me administrimin tatimor dhe evazionin fiskal. Thjeshtimi dhe vendosja e një norme të vetme më të ulët se më parë do të ndikonte në rritjen e nivelit të të ardhurave nëpërmjet zgjerimit të bazës


tatimore dhe do të shmangte abuzimet në lidhje me bizneset, kryesisht ato të mëdha për t'u deklaruar si një biznes i vogël. Po të flasim me gjuhën e shifrave në vitin 2008 dhe 2009 të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale të shprehura në përqindje të PBB-së janë dyfishuar në krahasim me vitin 2006. Në këtë këndvështrim duket sikur tatimi i sheshtë e ka arritur qëllimin e tij, megjithatë analizën e ecurisë së të ardhurave do ta realizojmë pak më poshtë. Debati mbi avantazhet dhe disavantazhet e taksës së sheshtë është një debat mjaft i gjerë. Studiues dhe ekonomistë të ndryshëm duket sikur mbajnë dy qëndrime në lidhje me të. Njëra palë shprehet se taksa e sheshtë rrit efikasitetin e sistemit tatimor, si nga pikëpamja administrative ashtu edhe nga pikëpamja e normave tatimore. Mendimi i palës tjetër është më skeptik dhe lidhet me shpërndarjen e ngarkesës tatimore midis individëve. Mendohet se ndryshimi në shpërndarje shkakton rritjen në të ardhura. Në 1 janar të 2014 në Shqipëri filloi të aplikohet tatimi progresiv. Një nga problemet më të mëdha që ka ekonomia jonë dhe kryesisht sektori publik është mos koordinimi i strategjive, ose edhe më keq mungesa e strategjive afatgjata. Megjithatë nuk ka studime të mirëfillta empirike për efektet e taksës së sheshtë, disa hipoteza tregojnë se kjo taksë ndikon pozitivisht në nivelet e larta të të ardhurave duke rënduar kryesisht në pjesën e popullsisë me të ardhura mesatare. Në këtë studim do të mundohemi të analizojmë efektin e taksës së sheshtë dhe taksave të tjera mbi PBB-në. Gjithashtu rritja e numrit të vendeve që kanë aplikuar takën e sheshtë tregon se vendosja e saj ka efekte pozitive, sidomos në drejtim të administrimit të sistemit tatimor. Në lidhje me Shqipërinë sipas mendimit të ekonomistëve, vendosja e takës së sheshtë ishte pozitive, pavarësisht ngjyrymeve politike që ajo mori, por kjo taksë mund të jetë e përkohshme, shpreheshin ata, dhe ashtu ndodhi. Megjithatë duhet të themi se kalimi nga taksa e sheshtë në një normë tjetër më të lartë u përball me vështirësi të shumta. Klasa politike shqiptare

po flet për ndryshime të reja në paketën fiskale edhe pse nuk janë mbushur koma dy vjet nga momenti i kalimit në tatimin progresiv.

3.4 Analiza e strukturës tatimore në Shqipëri për periudhën 1993-2014

Historia më shumë se 20-vjeçare e politikës tatimore të vendeve që iu nënshtruan transformimit të sistemeve politike dhe ekonomike flet edhe për vende që reformuan njëkohësisht sistemin e taksave dhe strukturën institucionale. Këto reforma i siguruan atyre, jo vetëm nivele të larta dhe të qëndrueshme të të ardhurave, por edhe mirë administrimin e tyre. Sot në Shqipëri politika e taksave zhvillohet në një kontekst institucional të përmirësuar dhe struktura tatimore i përgjigjet mirë nevojave për mbledhjen e të ardhurave publike dhe krijimit të një klime nxitëse për zhvillimin e sektorit privat. Për nga struktura dhe të ardhurat e mbledhura TVSH-ja është taksa që paraqitet më mirë në sistemin tatimor shqiptar. Struktura e saj është me tre shkallë tatimore, 20, 10 dhe 0 për qind. Tarifa e reduktuar e T.V.SH - së ka aplikim shumë të kufizuar. Në terma shumë të përgjithshme totali i të ardhurave në buxhet ka kaluar nga 33.5 miliardë lekë në vitin 1993 në 366.7 miliardë lekë në vitin 2014, pra është rritur me afro 11 herë. Nëse do të ndanim të hyrat publike në tre grupe: ndihmat, të ardhurat tatimore dhe jo tatimore, ndihmat rezultojnë që në 2014 të jenë gati 2 herë më të larta krahasuar me 1993, por me ulje të ndjeshme përgjatë viteve 1998-2001; të ardhurat tatimore janë rritur me afro 14 herë dhe të ardhurat jo-tatimore janë rritur 4 herë ndaj atyre të vitit 1993. Ecuria në vite tregohet më qartë në grafikun 1 më poshtë.

Grafiku 1: Të ardhurat gjithsej për periudhën 1993-2014




Burimi: Ministria e Financave

Tatimi direkt përkundrejt tatimit indirekt

Në terma të strukturës së tatimit, përgjatë viteve ka pasur një zhvendosje të tatimit nga tatimet mbi tregtinë drejt TVSH-së dhe akcizave. Niveli i të ardhurave nga tarifat doganore ka ardhur gjithnjë në ulje, kjo edhe për shkak të marrëveshjeve për tregtinë e lirë që vendi ynë ka nënshkruar me vende dhe rajone të ndryshme. Nga ana tjetër tatimi indirekt, pra ai mbi konsumin, zë pjesën më të madhe të të ardhurave kundrejt tatimit të të ardhurave të individëve, kompanive dhe atij mbi pasurinë. Ecuria në vite e tatimeve të ndara në tatime direkte dhe indirekte pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 2: Ecuria e tatimit direkt dhe tatimit indirekt (në milion Lekë)




Burimi: Ministria e Financave

Siç vihet re nga paraqitja grafike, përgjatë gjithë periudhës mbizotërojnë të ardhurat e mbledhura nga tatimet që rëndojnë mbi konsumin ku bëjnë pjesë TVSH-ja, akciza dhe taksa doganore, kundrejt tatimeve që rëndojnë direkt të ardhurat e përftuara nga individë dhe biznese si edhe

pasuritë e tyre. Madje edhe po ti referohemi ritmit të rritjes i cili pasqyrohet në grafikun 3, të ardhurat nga tatimi indirekt kanë pësuar rritje më të lartë se tatimet direkte, veçanërisht në periudhën 1998 deri në 2008, vit pas të cili ndjehen pasojat e rënies së konsumit dhe si rrjedhojë të prodhimit të brendshëm dhe importit.

Grafiku 3: Ecuria e tatimit direkt dhe indirekt (në milion Lekë) si edhe ritmi i rritjes së tyre (në %)




Burimi: Ministria e Financave

Në këtë raport të të ardhurave nga tatimi indirekt (ku janë përfshirë TVSH, akciza dhe taksa doganore) përkundrejt tatimit direkt (ku janë përfshirë tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi pasurinë dhe taksa e biznesit të vogël) kanë ndikuar disa faktorë. Kështu për shembull mund të themi se tatimet indirekte janë më të thjeshta për t'u mbledhur, veçanërisht ajo pjesë që mbledhet në momentin e importit, ndërsa tatimet direkte sidomos ato mbi të ardhurat individuale për një kohë të gjatë kanë qenë objekt i niveleve të larta të shmangies dhe evazionit tatimor. Duhet gjithashtu të theksojmë se deri në vitin 2014 politika e ndjekur ka qenë ajo e uljes së vazhdueshme të normave të tatimit direkt, me fokus të veçantë tatim fitimin, ndërsa lidhur me tatimin indirekt mund të themi se norma e TVSH-së është mbajtur e pandryshuar që në vitin

1996 dhe akciza ka pësuar rritje të vazhdueshme të reflektuara këto edhe në paketën fiskale të vitit 2014.


Grafiku 4: Pesha e tatimit direkt dhe indirekt në totalin e të ardhurave (në milion Lekë)



Burimi: Ministria e Financave

Një tjetër faktor ndikues në këtë raport ka qenë edhe administrimi tatimor, në kuptimin e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave, masave kundër evazionit, edukimin e taksapaguesve dhe rritjen e bazës së tatueshme. Progres i rëndësishëm është bërë edhe në fushën e administrimit të tatimeve dhe doganave, veçanërisht duke filluar nga viti 1998 e në vazhdim. Si zhvillime të rëndësishme përmendim ristrukturimin e administratës tatimore sipas funksioneve bazë, kompjuterizimin e sistemit tatimor dhe atij doganor, ndarjen dhe specializimin e funksioneve të njësisë së tatim-paguesve të mëdhenj, shkrirjen e zyrave të vogla lokale në struktura rajonale më të mëdha dhe më të pakta në numër, rritjen e kapaciteteve të personelit dhe shpërndarjen e përshtatshme të stafit, rritjen e numrit të taksapaguesve të regjistruar përmes thjeshtimit të procesit të regjistrimit, përmirësimin e procedurave të kontrollit tatimor përmes zhvendosjes në kontrolle specifike kundrejt atyre të përgjithshme dhe rritjen e përdorimit të analizave të riskut etj.

Grafiku 5: Të ardhurat tatimore për periudhën 1993-1998 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %)




Burimi: Ministria e Financave

Referuar faktorëve dhe ngjarjeve në Shqipëri analizën e të ardhurave mund ta ndajmë në disa periudha. Kështu për periudhën 1993-1998 mund të themi se kanë qenë disa faktorë të cilët kanë ndikuar rezultatet e të ardhurave publike. Ecuria e tyre paraqitet në grafikun 5. Ndër faktorët e sipërpërmendur veçojmë historinë dhe vitin 1991 dhe krizën financiare të vitit 1997. Të dy këta faktorë kanë influencuar dukshëm në procesin e reformës së taksave. Pas rënies së komunizmit mund të themi se vendi ynë e pati pikën e fillimit pothuajse nga zero. Sipas raporteve ndër vite të Bankës Botërore vendet të cilat qysh në fillimet e tranzicionit kanë pasur rezultatet më të mirë në të ardhurat e kanë ruajtur këtë trend edhe në periudhat në vijim. Në të kundërt vendet e tjera, arritjet e të cilave kanë qenë më të ulëta se të tjerët, kanë vijuar të mbajnë diferenca me këto vende. Kjo për shumë faktorë, ku më kryesorët janë diferenca në nivelet e taksimit, kultura e dobët e administratës tatimore dhe taksapaguesve, si dhe prirjet më të theksuara për evazion nga taksat, të nxitura edhe nga ambienti institucional dhe ligjor. Sistemi i tatimeve është po aq i rëndësishëm sa edhe zbatimi i tyre. Eksperienca ka treguar se reformat efektive të tatimeve nuk mund të përmbushen të izoluara nga aftësitë e sistemit të administratës së tatimeve dhe kulturës së taksapaguesve. Në këtë periudhë më shumë vëmendje iu kushtua modernizimit të politikave fiskale, duke lënë kështu në plan të dytë çështje shumë të rëndësishme si ato të administratës dhe pajtimit vullnetar të taksapaguesve. Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera në tranzicion, u favorizuan qëndrime ndërhyrëse si përjashtime dhe lehtësira nga taksat, të cilat në kthim e bënë më të lehtë evazionin fiskal, deformimet dhe abuzimet, duke rritur kostot administrative dhe ndarjen jo të drejtë të barrës tatimore midis taksapaguesve. Për të qenë efektive dhe e suksesshme reforma e taksave është e nevojshme të shoqërohet me reforma institucionale dhe strukturore në të gjithë ekonominë. Në veçanti reformat institucionale në fusha të ngjashme me

reformën fiskale, të tilla si sistemet kontabël dhe detyrimet e ligjeve të falimentit, kanë rezultuar më se të domosdoshme.

Grafiku 6: Të ardhurat tatimore për periudhën 1999-2008 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %)




Burimi: Ministria e Financave

Periudha e dytë është ajo e viteve 1999-2008, e cila përkon me mbarimin e periudhës së destabilizimit të shkaktuar nga rënia e skemave piramidale. Ecuria e të ardhurave përgjatë kësaj periudhe pasqyrohet në grafikun 6. Të ardhurat tatimore në përqindje të PBB-së patën një trend rritës në vitet në vazhdim, me rritje më të theksuar deri në vitin 2008, kur të ardhurat tatimore ndaj PBB-së arritën në 24.3 për qind dhe më pas përqindja ndaj PBB-së u stabilizua. Rritja mesatare vjetore e të ardhurave deri në 2008 ka qenë në nivelin prej 18 për qind. Ky nivel tejkalon në masë të konsiderueshme rritjen e PBB-së, çka do të thotë se në të ardhurat e mbledhura rol të rëndësishëm ka luajtur faktori i administrimit fiskal, gjë e cila përbën ndryshim thelbësor krahasuar me periudhën 1993-1998 kur administrimi nuk ishte në fokus. Gjithashtu i rëndësishëm është edhe indikator i të ardhura ndaj PBB-së. Ky indikator tregon rritje të vazhdueshme gjatë periudhës në fjalë, veçanërisht për zërin të ardhura nga tatime dhe dogana. Rritja e raportit të ardhura mbi PBB-në reflekton zhvillimet në ekonomi, me kalimin gradual nga zona jo-monetare në zonën informale dhe nga zona informale në atë formale. Me rritjen relative të ekonomisë formale ndaj asaj jo formale rritet dhe kontributi në të ardhura për çdo njësi të PBB-së. Për periudhën 1999-2008 normat e rritjes së PBB-së i gjeni të pasqyruara në grafikun e


mëposhtëm me nr 7, ndërsa në grafikun 8 përshkruhet raporti i të ardhurave tatimore ndaj PBB-së.

Grafiku 7: Norma e rritjes së PBB-së ndër vite (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë


Grafiku 8: Raporti i të ardhurave tatimore me PBB-në për periudhën 1999-2008



Burimi: Banka e Shqipërisë

Përgjatë kësaj periudhe në lidhje me zëra të veçantë të tatimeve ka pasur disa zhvillime kryesore. Kështu në vitin 1996, ashtu siç e kemi përmendur edhe kur kemi trajtuar reformat në sistemin tatimor, u shfuqizua tatimi mbi qarkullimin dhe u bë zëvendësimi i tij me tatimin mbi vlerën e shtuar. Në këtë mënyrë TVSH-ja u bë burimi kryesor dhe më i qëndrueshëm i të ardhurave për sistemin tatimor shqiptar. Sistemi i TVSH-së si pjesë e legjislacionit fiskal shqiptar është i thjeshtë, me bazë të gjerë, përmban një shkallë tarifore standarde prej 20 për qind dhe ka një prag përjashtimi të arsyeshëm, tipik për vendet në zhvillim. Rritja mesatare vjetore e të ardhurave nga TVSH-ja për periudhën në analizë ka qenë afro 15.4 për qind. Në grafikun më poshtë pasqyrohet ecuria përgjatë kësaj periudhe e zërave të ndryshëm të të ardhurave tatimore si TVSH, tatim mbi fitim, akcizë, tatim mbi të ardhurat personale dhe taksa doganore.

Grafiku 9: Zërat kryesorë të të ardhurave për periudhën 1999-2008 (në milion Lekë)



Burimi: Ministria e Financave


Në këtë periudhë të ardhurat nga tatim fitimi dhe të ardhurat personale u rritën si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje të totalit të strukturës së të ardhurave, duke reflektuar zhvillimet pozitive ekonomike, përmirësimin e klimës së investimeve dhe politikat e zhvillimit të sektorit privat. Politika më e rëndësishme tatimore e kësaj periudhe për tatimin direkt ishte vendosja e taksës së sheshtë në vitin 2007, e cila u zbatua për tatimin individual dhe për fitimin e kompanive. Siç e thamë edhe më lart ndryshimi i strukturës dhe nivelit të tatimit u shoqërua me masa administrative që ndikuan në rritjen e ndjeshme të të ardhurave nga ky tatim. Në mënyrë të veçantë taksa e sheshtë për taksimin e individëve, ndikoi në thjeshtimin e administrimit të sistemit dhe rritjes së bazës së tatueshme.

Reforma ndryshoi në thelb strukturën e kësaj takse, duke zëvendësuar shkallët progresive të taksimit me një shkallë unike, për të gjitha llojet e të ardhurave personale, prej 10 për qind. Rritja mesatare vjetore e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën në fjalë ka qenë rreth 42 për qind. Për vitin 2008 të ardhurat nga tatim fitimi përbëjnë 2.2 për qind të PBB-së nga 1.1 për qind që ishin në vitin 1998. Shfuqizimi gradual i përjashtimeve dhe lehtësirave nga tatim-fitimi thjeshtoi sistemin, e bëri atë më transparent dhe reduktoi hapësirat për evazion. Politika e akordimit të lehtësirave dhe përjashtimeve është zëvendësuar me atë të uljes së

vazhdueshme të taksave për biznesin. Norma e tatim-fitimit është ulur në vite, nga 30 për qind në 1999 (pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8438, 28.12.1998), në 20 për qind në 2007 dhe 10 për qind në Janar të 2008. Për sa i takon nivelit të mbledhjes së të ardhurave rritja mesatare vjetore për periudhën 1999-2008 ka qenë rreth 16.5 për qind. Nga ana tjetër të ardhurat nga tarifat doganore kanë pësuar ulje të ndjeshme, kjo si pasojë e politikave të liberalizimit të tregtisë të aplikuara nga Shqipëria. Si rezultat i përmirësimeve në kuadrin ligjor dhe administrimit rritje të vazhdueshme kanë pasur dhe të ardhurat nga akciza, nga niveli i ulët i vitit 1997. Legjislacioni për akcizat në vendin tonë ka qenë objekt i ndryshimeve të shpeshta. Nivelet e akcizës në Shqipëri kanë pasur rritje të vazhdueshme, ashtu si dhe gama e produkteve dhe mallrave që i nënshtrohen kësaj takse. Për këtë periudhë Shqipëria ka pasur rritje të qëndrueshme të të ardhurave nga akciza në përqindje të PBB-së. Rritja mesatare për periudhën në fjalë është 21.5 për qind. Ashtu si tatimi mbi të ardhurat personale, hallkë tjetër e dobët e sistemit tatimor kanë qenë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Megjithatë, përgjatë viteve, sistemi i sigurimit shoqëror ka qenë në qendër të reformave, si për sa i përket barrës së tatimit, ashtu edhe pajtueshmërisë së kontribuesve dhe administrimit të tyre. Në Dhjetor 2002 qeveria shqiptare vendosi transferimin dhe unifikimin e mbledhjes së kontributeve tek administrata tatimore. Ky proces zgjati për disa vite. Administrimi dhe mbledhja e kontributeve lidhet ngushtë me rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në skemën e sigurimit të detyrueshëm. Duke i konsideruar kontributet në aspektin e kostos së punës, politika e ndjekur ka qenë ajo e uljes së vazhdueshme të normës kontribuese të punëdhënësit, duke u kujdesur që kjo të mos ndikojë negativisht në të ardhurat e mbledhura, por të baraspeshohet nga rritja e deklarimeve dhe e numrit të personave në skemë. Rritja mesatare vjetore e kontributeve të mbledhura për periudhën në fjalë ka qenë rreth 11.7 për qind.

Përgjatë këtyre viteve normat tatimore kanë ndryshuar në drejtim të lehtësimit dhe thjeshtësimit fiskal. Por nëse kjo politikë nuk do të shoqërohej nga përmirësime në administrim, efekti pozitiv do të ishte shumë i ulët. Disa nga reformat kryesore në drejtim të administrimit ishin përmirësimi i sistemit të informacionit për taksapaguesit, kompjuterizimi i sistemit doganor duke përfshirë ASYCUDA WORLD dhe duke e shtrirë këtë sistem në të gjitha pikat doganore. Të tjera reforma lidhen me trajnimin e vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve të administratës tatimore, ri hartimin e ligjeve mbi taksat dhe procedurat, prezantimin e numrit të identifikimit për taksapaguesit, krijimin e sistemit të apelimit të taksave, forcimin e auditimit dhe investigimit, krijimin e njësive të taksapaguesve të mëdhenj, plotësimin e formularëve online për të reduktuar kostot e dyanshme apo edhe pajisjen e bizneseve me kasa fiskale. Megjithatë janë bërë mjaft reforma përsëri niveli relativisht i ulët i mbledhjes së të ardhurave të bën të mendosh se ekzistojnë disa elementë që kanë ndikuar negativisht në ecurinë e tyre. Këto elementë rritin ineffiçencën e sistemit tatimor, ndikojnë negativisht mbi ecurinë e bizneseve, nxitjen e investimeve, shpërndarjen e burimeve, shpërndarjen e të ardhurave në grupe të caktuara, etj.

Grafiku 10: Ecuria e të ardhurave më të rëndësishme për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë)




Burimi: Ministria e Financave

Për sa i përket periudhës 2009-2014, pasqyruar edhe në grafikun nr 10, duhet të theksojmë se viti 2009 ishte viti i parë i ndikimit të krizës globale financiare në ekonominë shqiptare. Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike u reflektua në aftësinë kontribuese në taksa dhe tatime të individëve dhe bizneseve, si në tatimin direkt mbi të ardhurat ashtu dhe në atë të tatimit indirekt përmes uljes së konsumit të mallrave dhe shërbimeve.

Përgjatë periudhës 2009-2014 rritja mesatare vjetore e të ardhurave gjithsej nga tatimet dhe doganat ka qenë 3.7 për qind në baza vjetore. Zërat me të rëndësishëm të tatimeve janë rritur me ritme mjaft të ngadalta përgjatë gjithë periudhës 2009-2014, ndërsa në 2012 të ardhurat nga TVSH-ja, akciza dhe tatimi direkt krahasuar me një vit më parë kanë pësuar rënie.

Në grafikun 11 pasqyrohen të ardhurat nga tatimet dhe doganat dhe ritmi i rritjes së tyre.

Grafiku 11: Ecuria e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë) dhe ritmi i rritjes së tyre (në %)




Burimi: Ministria e Financave

Le të shohim edhe nëpërmjet paraqitjes grafike ecurinë dhe ritmin e ndryshimit të tatimit mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Grafiku 12 pasqyron pikërisht këto ndryshime. Ashtu sikurse shihet edhe në të, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë rritur me afro 42 për qind. Në raport me PBB-në të ardhurat totale arritën në vitin 2013 në 23.7 për qind, niveli më i ulët që nga viti 1998. Grafiku i mëposhtëm, grafiku 13, paraqet pikërisht raportin e të ardhurave tatimore me PBB-në për këtë periudhë të tretë.


Grafiku 12: Ecuria e tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi të ardhurat personale për periudhën 2009-2014 (në milion Lekë)

dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave


Grafiku 13: Të ardhurat tatimore në raport me PBB-në për periudhën 2009-2014



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 14, më poshtë, na mundëson të hedhim një vështrim mbi normat e rritjes së PBB dhe të të ardhurave tatimore. Ndërsa PBB vazhdon të ulet duket sikur të ardhurat tatimore janë në rrugë të mbarë, rritja e tyre ka ardhur kryesisht nga rritja e tatimit mbi fitimin si zëri i të ardhurave tatimore i cili ka pësuar rritjen më të lartë në vitin e fundit, rritje prej 42 për qind.

Grafiku 14: Normat e rritjes së PBB-së dhe të të ardhurave tatimore për periudhën 2009-2014




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave

Për sa i takon politikave, edhe gjatë periudhës së fundit, reforma në fushën tatimore ka vijuar dhe pritet që ndryshimet e bëra të reflektojnë ndikimin e tyre në vitet në vijim. Përmendim këtu tatimin progresiv, reformimin e vazhdueshëm të akcizës që përfshin përafrimin e legjislacionit të vendit tonë me atë të BE-së dhe kalimin e administrimit të saj tek administrata doganore, reformimin e TVSH me draftin e ligjit të ri në përputhje me Acquis.

3.5 Analiza e shpenzimeve publike përgjatë viteve 1993-2014

Konsolidimi fiskal, nëpërmjet vendosjes së balancës midis reduktimit të deficitit dhe borxhit publik dhe nevojës për të kryer investime kapitale ndikon pozitivisht, si në drejtim të stabilitetit, ashtu edhe në drejtim të rritjes ekonomike (Misale, 1999). Sipas koncepteve teorike një tjetër mënyrë për të parë rezultatet e sektorit publik është nëpërmjet ecurisë së shpenzimeve (Howard M. , 2001). Ashtu sikurse duket edhe në grafikun 15 në përgjithësi si shpenzimet korrente, ashtu edhe ato kapitale kanë pasur tendencë rënëse megjithatë jo në të gjitha periudhat.

Grafiku 15: Ecuria e shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale në përqindje të PBB-së




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave

Grafiku 16 përshkruan ecurinë e shpenzimeve korrente dhe ritmin e rritjes së tyre. Ndërsa shpenzimet kapitale, si ndarja e dytë e shpenzimeve gjithsej, ku si ndarje të parë po konsiderojmë shpenzimet korrente, dhe ritmi i rritjes së tyre përshkruhen në grafikun 17. Që pas krizës financiare të vitit 1997 ritmet e rritjes së shpenzimeve, nga një vit në tjetrin, kanë qenë më të


ngadalta ndërkohë që pesha e tyre ndaj PBB-së pothuajse ka pasur gjithnjë tendencë rënës. Në uljen e nivelit të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndaj PBB-së kanë ndikuar disa nga politikat e qeveris, ndër të cilat përmendim shkurtimet e administratës publike dhe liberalizimin e kurseve të këmbimit dhe të çmimeve. Këto politika sollën reduktimin e subvencioneve në ekonomi, uljen e shpenzimeve të mbrojtjes, uljen e normave të interesit të borxhit si edhe uljen a normave të bonove të thesarit për financimin e brendshëm. Rënia pothuajse e qëndrueshme e shpenzimeve korrente ka arritur vlerën më të ulët në vitin 2006, rreth 23.2 për qind të PBB-së, ndërsa niveli i shpenzimeve kapitale ndaj PBB-së e ka arritur vlerën e tij më të ulët në vitin 2003, rreth 4.5 për qind. Për vitet në vazhdim niveli i shpenzimeve korrente ka qëndruar në vlera konstante 23 – 25 për qind e PBB-së. Nga ana tjetër shpenzimet kapitale pas vitit 2003 janë rritur duke arritur në vitin 2009 vlerën më të lartë prej 8.7 për qind dhe fill pas këtij viti niveli i tyre ka pësuar rënie të vazhdueshme duke arritur në vitin 2014 vlerën prej 4.7 për qind. Në vitin 2008 shpenzimet kapitale janë rritur me afro 67 për qind krahasuar me nivelin e tyre një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve kapitale në infrastrukturë, dhe më konkretisht nga ndërtimi i rrugës së kombit, Durrës – Morinë. Ajo çfarë të bie në sy është lidhja midis rritjes së shpenzimeve qeveritare dhe periudhave elektorale, kështu sa herë që ndodhemi në vit elektorale duket se shpenzimet rriten. Kjo shpjegon edhe nivelet e larta të shpenzimeve për vitin 2009 edhe pse kishin filluar të ndjeheshin efektet e krizës financiare.

Grafiku 16: Ecuria e shpenzimeve korrente dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave


Grafiku 17: Ecuria e shpenzimeve kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave

Qëllimi i politikës së shpenzimeve, i cili vihet re edhe më shumë gjatë 5 viteve të fundit, ka qenë reduktimi i shpenzimeve korrente nëpërmjet reduktimit të numrit të punonjësve të administratës, riorganizimit të ministrive, uljes së shpenzimeve operative, subvencioneve, etj, për të krijuar më shumë mundësi rritjeje për shpenzimet kapitale. Ajo çfarë ka ndodhur është pikërisht përmirësimi i strukturës së shpenzimeve dhe cilësisë së drejtimit të tyre.

Grafiku 18: Shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale ndaj totalit të shpenzimeve publike



Burimi: Ministria e Financave

Analiza e mësipërme lidhet kryesisht me ecurinë e shpenzimeve korrente dhe kapitale ndër vite. Megjithatë për të thënë se shpenzimet kanë qenë apo jo efëcente kërkohet të analizohet menaxhimi i tyre. Menaxhimi i shpenzimeve publike mund të analizohet duke u bazuar në reformat e ndërmarra në sistemin buxhetor. Sistemet e buxhetit duhet të arrijnë tre objektiva bazë

të ruajnë një disiplinë agregate fiskale, të shpërndajnë burimet në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe të nxisin efikasitetin në shpërndarjen e burimeve (Bruce, N. & Turnovsky, S., 1999).

Në Shqipëri veçanërisht vitet e fundit janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të menaxhimit të shpenzimeve, këtu nënkuptojmë kuadrin institucional, mënyrën e hartimit të buxhetit, duke u bazuar në standardet evropiane, kuadrin fiskal afatmesëm, etj. Gjithsesi vlen të përmendet se jo gjithnjë dhe jo të gjitha reformat e ndërmarra janë respektuar me rigorozitet. Kështu për shembull, procesi i buxhetit duhet të jetë transparent dhe në të duhet të përfshihet edhe shoqëria civile. Në mënyrë të përmblodhur do të përmendim disa prej arritjeve në menaxhimin e shpenzimeve publike. *Së pari* janë bërë përmirësime në lidhje me kuadrin ligjor, ku mund të përmendim ligjin organik të buxhetit. *Së dyti* përmirësime janë bërë në kuadrin fiskal afatmesëm, si një element i cili i shoqëron buxhetin. Buxheti nuk mund të hartohet pa pasur një parashikim fiskal afatmesëm, i cili do të sigurojë vazhdimësinë e objektivave fiskale. Marrja parasysh e këtij kuadri ka ndikuar pozitivisht në procesin e hartimit të buxhetit. *Së treti* mund të përmendim përmirësimet e bëra në procesin e hartimit të buxhetit. Drafti i buxhetit tashmë kalon në parlament në periudhën e fund vitit, ndryshe nga sa ndodhte përpara fillimit të reformës, kur buxheti miratohej pasi kishte filluar viti kalendarik. Miratimi i buxhetit përpara fillimit të vitit kalendarik i krijon qeverisë, ministrive dhe institucioneve buxhetore, hapësira kohore për fillimin e procedurave ligjore, për ekzekutimin e buxhetit, si dhe krijimin e premisave për një përdorim efektiv të fondeve publike. *Së katërti* do të përmendim përmirësimet në zbatimin dhe monitorimin e buxhetit. Ministria e Financave bazuar në një sistem të unifikuar të llogarive financiare monitoron shpërndarjen e shpenzimeve përgjatë vitit. Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave duhet të mbajnë përgjegjësi për shqyrtimin e raporteve periodike mbi rezultatet financiare, si në lidhje me buxhetin, ashtu edhe në lidhje me rishikimin e objektivave dhe

politikave në përputhje me ndryshimin e kushteve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër shpërndarja e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit në mënyrë të njëtrajtshme nga pikëpamja kohore, do ti mundësonte Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë një menaxhim me të mirë të burimeve financiare të siguruara kryesisht nga tatimet dhe taksat dhe të deficitit. *Së pesti* mund të themi se për tu siguruar për mënyrën sesi janë duke u përdorur fondet përdoren kontabiliteti, raportimi dhe kontrolli financiar. Në ditët e sotme ende vazhdojnë përpjekjet për të krijuar një sistem optimal, si nga këndvështrimi ligjor, ashtu edhe nga ai i kontrollit në përputhje me standardet ndërkombëtare.


Megjithëse pak më lart përmendëm disa nga përmirësimet e bëra në menaxhimin e shpenzimeve duhet theksuar se ende ka shumë rrugë për të bërë. Kështu menaxhimi i shpenzimeve publike ka disa probleme të rëndësishme njëra prej më kryesoreve konsiderohet zbatimi i kuadrit rregullator. Në këtë aspekt duhet të ekzistojë vullneti politik, i cili shpesh herë mungon. Ndryshimi i shpeshtë i politikave ndikon negativisht mbi vendim marrjen fiskale afatmesme. Thënë këtë kuptojmë se strategjitë e zhvillimit duhet të mbështeten nga politikat buxhetore, për të siguruar në këtë mënyrë një rezultat pozitiv. Efikasiteti i shpenzimeve publike do të rritej nëse do të respektoheshin në mënyrë rigoroze politikat e shpallura më parë dhe jo të ketë ndryshime të menjëhershme. Rishikimi i buxhetit në gjysmën e dytë të vitit duke rregulluar nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara, është përsëri një problem që vihet re edhe vitet e fundit. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mungesës së politikave të qarta dhe të studiuara, mungesës së kapaciteteve në përthithjen e investitorëve, mungesës së kontrollit për shpërndarjen e shpenzimeve gjatë vitit, etj. Ashtu sikurse edhe FMN ka përmendur në raportin e tij, të cituar pak më lart, planifikimi i fondeve për investime, në vendin tonë, vuan nga dy probleme

kryesore; fragmentimi i fondeve në shumë objekte si edhe investimi për shumë vite në një objekt pa pasur të qartë sesa është kostoja e këtij investimi.

3.6 Deficiti buxhetor dhe ecuria e borxhit publik ndër vite


Si një pjesë thelbësore e programit të saj të përshtatjeve fiskale, Shqipëria deri në vitin 2014 ka ndërmarrë një reduktim të rëndësishëm në masën e deficitit buxhetor. Ecuria e tij për të gjithë periudhën paraqitet në grafikun 19. Gjatë gjithë periudhës, siç përshkruhet edhe në grafikun 20 deficiti është zvogëluar nga 6.82 për qind që ishte në 1993 në 3.66 për qind të PBB-së në 2014. Kjo politikë konsiderohet si një reflektim i angazhimit të autoriteteve ndaj konsolidimit fiskal. Fazat e veçanta të përshtatjeve fiskale do të përdorim edhe në analizimin e ecurisë së deficitit dhe borxhit publik. Në Shqipëri periudha pas krizës piramidale konsiderohet si periudha më e gjatë dhe më e qëndrueshme e përshtatjeve fiskale. Nga fundi i vitit 1997, masat e marra në anën e të ardhurave bënë të mundur vendosjen e TVSH-së, masë e cila solli edhe reduktimin e deficitit në vitet në vazhdim dhe frenimin e akumulimit të shpejtë të borxhit publik. Kështu në 1999 deficiti ishte 9.02 për qind e PBB-së. Ndërkohë që pas vitit 1999 përshtatjet fiskale janë bërë kryesisht përmes shkurtimeve në shpenzimet publike. Reduktimi i deficitit pas 1999 është më i madh, megjithëse gradual, duke arritur kështu vlerën e tij më të ulët në vitin 2010, vit në të cilin deficiti ishte 3.07 për qind e PBB-së.

Grafiku 19: Deficiti buxhetor dhe norma e rritjes së tij përgjatë viteve 1993-2014



Burimi: Ministria e Financave


Grafiku 20: Deficiti buxhetor i shprehur në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave

Në një studim të FMN-së theksohet se financimi i brendshëm tenton të pengojë rritjen ekonomike. Një pikë përqindje rritje në financimin e brendshëm reduktoi ritmin e rritjes për frymë me 1-3 pikë përqindje. Efekti i vlerësuar i financimit të një deficiti fiskal me fonde të jashtme është më i vogël dhe mund të kompensohet duke i drejtuar shpenzimet drejt projekteve kapitale të financuara nga jashtë (Alves, 2014). Lidhur me borxhin publik mund të themi se vlerësimet për nivelet e “sigurta” të borxhit publik ndryshojnë në shkallë të madhe dhe varen nga faktorë specifikë të vetë shtetit. Nivelet e sigurta të borxhit publik për tregjet e reja mund të mos jenë më shumë se 50 për qind e PBB-së dhe më të ulëta se sa 25 për qind e PBB-së. Borxhi publik, në 55 për qind të PBB-së, është një nivel relativisht i lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Kufijtë e kujdesshëm të borxhit ndryshojnë rrënjësisht mbështetur mbi cilësinë e qeverisë (Atkinson A. & Stiglitz J., 1980).


Grafiku 21: Ecuria e borxhit publik (në milion lekë) dhe norma e rritjes së tij (në %)



Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 22 përshkruan borxhin publik në përqindje të PBB-së si edhe rritjen e tij në krahasim me vitin paraardhës. Ashtu sikurse edhe mund të shihet në grafik aktualisht borxhi publik zë afro 69 për qind të PBB-së, nivel ky mjaft i lartë krahasuar me nivelin e konsideruar si të sigurt. Borxhi publik në vendit tonë, pas vitit 1997, ka arritur nivelin e tij më të ulët në raport me PBB-në në vitin 2007, vit në të cilin ai ishte rreth 53.4 për qind e PBB-së. Pas kësaj periudhe deri në fund të 2014 ai është rritur afërsisht me 29 për qind.

Grafiku 22: Borxhi publik në përqindje të PBB-së dhe norma e rritjes së këtij raporti për periudhën 1993-2014



Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë

Përpijekjet e konsolidimit reduktojnë raportet e borxhit ndaj PBB-së dhe krijojnë një rreth vicioz në drejtim të qëndrueshmërisë së financave publike (Dornbusch R.& Dragi M., 1990). Përpijekjet e qeverisë në të ardhmen duhet të kenë si qëllim reduktimin në mënyrë të qëndrueshme të borxhit të përgjithshëm publik aty ku është e mundur, të kërkohej ndërhyrje e arsyeshme në financimin e jashtëm afatgjatë dhe të formulohet dhe zbatohet një strategji e menaxhimit të borxhit në qendër të së cilës duhet të jenë rritja e afatit mesatar të borxhit publik dhe rishpërndarja e burimeve në çështjet ekonomike të cilat kanë qenë të nën financuara.

3.7 Të përbashkëtat dhe ndryshimet e sistemeve tatimore në vendet e Ballkanit

Perëndimor. Analizë krahasuese

Shtetet e ish Jugosllavisë dhe Shqipëria cilësohen si vende me mjaft probleme të përbashkëta, por edhe me ndryshime, të cilat në këtë kontekst cilësohen si të pa konsiderueshme. Në

rrugëtimin e tyre drejt zhvillimit, këto vende janë karakterizuar nga problematika të përbashkëta, më të ndjeshmet prej të cilave kanë qenë dhe mbeten papunësia, korrupsioni, administrata publike gjithnjë e më e ngjeshur, optimizmi i pajustificuar kur planifikohet buxheti, keq menaxhimi i financave publike dhe nga disiplina e varfër fiskale, e cila më së shumti varet nga të qenit ose jo në vit elektoral. Në këto vende vihet re mungesa e harmonisë midis politikave ekonomike dhe fiskale dhe nevojave reale të ekonomisë. Kjo shihet si një tjetër e përbashkët e madhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo ngjashmëri problematikash ngushton hapësirën për të konkurruar lidhur me aftësinë thithëse të investimeve të huaja. Por cila është panorama makroekonomike në shtetet e Ballkanit Perëndimor? Cilat janë sistemet e tyre tatimore? Sa janë investimet e huaja direkte? A shërben sistemi tatimor si nxitës i këtyre investimeve? Në këtë pjesë të studimit paraqitet një analizë krahasuese e sistemeve fiskale të vendeve të këtij rajoni. Duke qenë se ekzistojnë dy tipologji përvojash lidhur me sistemin tatimor, ku njëra prej të cilave i trajton tatimet thjesht si instrumente për mbledhjen e të ardhurave dhe tjetra si faktorë nxitës për zhvillimin ekonomik, objekt i këtij punimi është mbrojtja e argumentuar se politikat ekonomike dhe fiskale ndërtohen në funksion të zhvillimit ekonomik të një vendi. Çdo shtet e sheh me interes analizën e politikës fiskale, e kjo për vetë faktin se kostoja e kapitalit nuk përfshin vetëm koston e parasë, të shprehur në formën e normës së interesit për kredinë, por edhe koston fiskale, të shprehur në formën e barrës fiskale, që duhet të paguajë investitori. Një ngarkesë fiskale e lartë, gjë që rrit koston direkte të investimit, mund të rezultojë në dekurajim të investitorit dhe në kërkimin e borxheve për financimin e një projekti. Shpesh në debatin publik, për të përligjur vendimet për rritjet e niveleve të taksave dhe tatimeve, autoritetet financiare propagandojnë se nivelet e tyre në fakt janë ndër më të ulëtat në rajon. Në këtë pjesë do të ndalemi në analizën krahasuese të barrës tatimore. Kemi bërë një vështrim krahasues të niveleve

të taksave dhe tatimeve për disa vende të rajonit²⁹. Në termat e vendosjes së një projekti investimi, këto mund të jenë dhe vendet kandidate konkurruese me vendin tonë, Shqipërinë. Një investitor, që do të synonte t'i shërbente tregut ballkanik, do të konsideronte vendosjen e projektit potencial në një nga vendet që janë marrë në analizë. Në analizën e investitorëve pesha e faktorëve të kostos, kryesisht e sistemeve të tatimit, do të ishte një ndër influencuesit kryesorë në marrjen e vendimit për investim (De Mooij, R.A. dhe S. Ederveen, 2005). Për rrjedhojë diferencat në sistemet e trajtimit fiskal të investimeve bëhen instrumente konkurruese. Vendet e Ballkanit Perëndimor patën rritje të fortë ekonomike në periudhën para krizës së vitit 2008, por rritja ishte e bazuar në një konsum të brendshëm të lartë, të lidhur me rritjen e shpejtë të kredisë dhe u shoqërua me një zgjerim të deficitit të llogarisë korrente dhe rritje të borxhit të sektorit privat. Kjo rritje ekonomike u ndal kur kriza financiare globale preku rajonin kryesisht përmes tregtisë dhe kanaleve financiare, duke rezultuar në uljen e kërkesës së jashtme për eksportet e rajonit, krizën e kredive, rënien e të ardhurave nga emigrantët dhe rënien e investimeve të huaja direkte. Kriza shkaktoi një rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik, zgjerimin e deficiteve buxhetore dhe rritjen e borxhit publik dhe atij të huaj. Në vitin 2009 PBB-ja ra në Bosnje Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, ndërsa në Shqipëri rritja ishte e ngadaltë krahasuar me periudhën para krizës. Konsolidimi i rimëkëmbjes ekonomike që filloi në vitin 2010 në të gjitha vendet e rajonit rezultoi në rritje të moderuar. Ndërsa u vunë re disa përmirësime në gjysmën e parë të vitit 2011, aktiviteti ekonomik ra në gjysmën e dytë të këtij viti dhe në gjysmën e parë të vitit 2012. Perspektivat ekonomike afatshkurtra për rajonin e Ballkanit Perëndimor mbeten të dobëta dhe vulnerabiliteti është rritur si rezultat i krizës së eurozonës. Departamenti i uljes së varfërisë dhe menaxhimit ekonomik të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore në Bankën Botërore në raportin e tij të vitit 2012 shprehet se dobësitë në sektorin

²⁹ Vendet e marra në analizë janë Shqipëria, Mali i zi, Serbia, Kroacia, Maqedonia dhe Bosnjë Hercegovina.

financiar përbëjnë një shqetësim të veçantë, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e sistemit bankar është në pronësi të huaj dhe se shumica e vendeve mbështeten tek financimi nga jashtë, megjithatë kjo nuk është pjesë e këtij punimi dhe ne nuk do të ndalemi më gjerë në të (BankaBotërore, 2012). Një mjedis i favorshëm për biznesin është një nga parakushtet kryesore për rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Shumë elementë të një mjedisi të shëndoshë biznesi si institucionet qeveritare efikase dhe të parashikueshme, politika fiskale e qëndrueshme, një forcë punëtore e arsimuar, infrastruktura fizike e mirë dhe aksesimi në financim kanë lidhje të drejtpërdrejta me rritjen ekonomike. Kriza ekonomike e fundit ka nënvizuar se një mjedis që mbështet konkurrencën ekonomike ka rëndësi të madhe për mbështetjen më të mirë të ekonomive kombëtare për të absorbuar tronditjet dhe për të siguruar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Statistikat e institucioneve ndërkombëtare tregojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mbetur prapa vendeve të grupit të 10 vendeve të BE-së në një varg treguesish të mjedisit të biznesit, investimit dhe konkurrencës si dhe të reformës institucionale.

Rritja ekonomike për Ballkanin Perëndimor

Kjo pjesë e studimit të Ballkanit Perëndimor mbulon Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Rajoni ka një popullsi prej më pak se 20 milion banorë dhe një nivel relativisht të ulët zhvillimi. Pas stabilizimit politik dhe rinovimit të procesit të tranzicionit në fund të viteve 1990 dhe fillim të viteve 2000 rajoni ka arritur progres të konsiderueshëm ekonomik. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor patën norma relativisht të larta të rritjes ekonomike vjetore në periudhën para krizës (2001-2008), mesatarisht 5,7 për qind rritje të PBB-së. Megjithatë rritja ekonomike e rajonit në periudhën para krizës u bazua në një konsum të brendshëm të lartë, të lidhur me rritjen e shpejtë të kredisë dhe një rritje të lartë të pagave reale. Modeli i tij i rritjes ishte i bazuar kryesisht në kapital të lirë ndërkombëtar dhe kredi të

indeksuara ndaj monedhave ndërkombëtare dhe liberalizim të tregtisë së jashtme dhe tregjeve financiare (BankaBotërore, 2012). Kriza financiare globale që filloi në gjysmën e dytë të vitit 2007, fillimisht si një krizë e tregut të banesave në SHBA, u përhap përtej sektorit financiar dhe preku rëndë ekonominë globale. Tregjet e kapitalit të vendeve të këtij rajoni u tronditën kur në vjeshtë të vitit 2008 institucionet e huaja filluan tërheqjen e fondeve si dhe kur në fund të po atij viti pati tërheqje të kursimeve në valutë të huaj (BankaBotërore, 2014). Në tabelën e mëposhtme qartazi shquajmë se përgjatë vitit 2013 situata e përgjithshme e rajonit ka qenë pozitive. Rritja e prodhimit të brendshëm bruto për vitin 2014 është parashikuar të jetë pozitive, përjashtim bëjnë ekonomitë e Serbisë dhe Kroacisë.

Tabela 2: Norma e rritjes së PBB-së (në %)

	2012	2013	2014
Maqedoni	-0,4	2,9	3,4
Mal i zi	-2,5	3,5	2,3
Shqipëri	1,1	0,4	2,1
Bosnjë Hercegovinë	-1,2	2,1	0,7
Serbi	-1,5	2,5	-0,5
Kroaci	-2,2	-0,9	-0,8

Burimi. IMF, Prill 2015

Sistemet tatimore aktuale në vendet e Ballkanit Perëndimor

Analiza në vijim nuk pretendon të ndriçojë ndikimet e politikave fiskale në investime dhe në rritjen ekonomike të vendeve të rajonit, por nëse konsiderata e vendosjes së një projekti investimi në një nga vendet e rajonit, të përfshira në analizë, do të ndikohej në një masë të caktuar nga politikat fiskale, siç edhe thekson teoria dhe literatura në lëmin e financave, analiza

krahasuese është mjaft e rëndësishme dhe mund të shërbejë si një përgjigje për politika neutralizuese dhe/ose konkurruese (De Mooij, R.A. dhe S. Ederveen, 2005). Kur marrim në konsideratë vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me ekonomi të vogla dhe tregje jo të mëdha. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë firmosur dhe janë bërë palë e shumë marrëveshjeve tatimore midis tyre dhe institucioneve dhe rregullave ndërkombëtare, por zbatimi i tyre pothuajse nga të gjitha shtetet e marra në analizë lë për të dëshiruar. Edhe pse qeveritë e këtyre vendeve kanë rënë dakord për zbatimin e disa parimeve, procedurave apo normave tatimore implementimi i plotë i tyre duket ende larg. Po cilat janë tatimet dhe normat tatimore me të cilat përballen individët dhe bizneset në këto shtete? Le ti shohim një e nga një duke filluar me grupin e tatimeve direkte dhe më pas me ato indirekte.

- Tatimi mbi fitimin

Në kategorinë e tatimeve direkte tatimi mbi fitimin e kompanive është më i rëndësishmi. Analiza krahasuese e tatimit mbi fitimin e kompanive merr rëndësi të veçantë pasi ajo mundëson identifikimin e politikave nxitëse që shtete të ndryshme ofrojnë me qëllim nxitjen e ri-investimit të një sasive më të madhe kapitali apo zhvillimin më të shpejtë të aktivitetit ekonomik të kompanive dhe të ekonomisë në përgjithësi. Për secilin prej shteteve kemi bërë analizën e mëposhtme.

Bosnja dhe Hercegovina

Kompanitë rezidente³⁰ janë subjekt i tatimeve për të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktiviteti brenda territorit të Bosnjë Hercegovinës dhe jashtë tij, ndërsa kompanitë jo rezidente tatohen vetëm mbi të ardhurat e krijuara brenda juridiksionit të këtij shteti. Baza tatimore përcaktohet duke rritur fitimin bruto ose humbjen për shpenzimet e pazbritshme ose duke ulur këtë fitim apo

³⁰ Një kompani konsiderohet rezidente nëse është e regjistruar në këtë shtet si entitet ligjor.

humbje me shpenzimet e zbritshme. Në Bosnjë Hercegovinë dividendët tatohen vetëm kur u shpërndahen aksion mbajtësve. Fitimi kapital tatohet si fitimi i zakonshëm me normë tatimorë 10 për qind. Dividendët e paguar nga ky vend për jo rezidentët tatohet me 5 për qind. Për sa u përket nxitësve fiskalë mund të themi se ky shtet kompanitë, eksporti i të cilave i kalon 30 për qind të të ardhurave totale, i përjashton tërësisht nga tatimi mbi fitimin. I njëjti përjashtim u ofrohet edhe kompanive, investimet e të cilave arrijnë jo më pak se 20 milion BAM (e konvertuar në dollarë është afërsisht 11.35 milion \$) në pesë vite të njëpasnjëshme në prodhim (në vitin e parë duhen investuar minimumi 4 milion BAM dhe vazhdohet me katër vitet e tjera të investohet deri sa të plotësohet shuma totale e investimit). Një kompani mund të përjashtohet nga tatimi mbi fitimin për një vit nëse përgjatë atij viti minimumi 50 për qind e fuqisë së tij punëtore përbëhet nga persona me aftësi të kufizuar apo persona me nevoja të veçanta të punësuar për një periudhë më të gjatë se një vit. Të gjitha kostot për kërkime dhe zhvillime njihen si shpenzime.

Maqedonia

Kompanive rezidente, ashtu sikurse edhe në Bosnjë Hercegovinë, u tatohen të gjitha të ardhurat e krijuara brenda dhe jashtë vendit. Entitetet legale të cilat krijojnë të ardhura nga aktivitetet e biznesit janë subjekt i tatimit mbi fitimin, i cili është në nivelin prej 10 për qind. Fitimi i pashpërndarë tatohet vetëm në momentin që shpërndahet. Dividendët e shpërndarë tek jo rezidentët tatohen me 10 për qind, pavarësisht se kjo normë tatimore sipas marrëveshjeve tatimore me institucionet ndërkombëtare duhej të ishte më e ulët. Në lidhje me nxitësit tatimor mund të themi se kompanitë të cilat operojnë në zonat e tregtisë së lirë për një periudhë 10-vjeçare nuk paguajnë tatime.

Shqipëria

Në Shqipëri një kompani konsiderohet rezidente nëse vendndodhja e saj ligjore është në vendin tonë. Tatimpaguesit rezident taten mbi të gjitha të ardhurat e krijuara brenda dhe jashtë vendit, ndërsa jo rezidentët vetëm për të ardhurat e krijuara nga burimet shqiptare të të ardhurave. Të ardhurat nga dividendët konsiderohen si të ardhura të tatueshme edhe pse duhet të trajtoheshin ndryshe për shkak të marrëveshjeve tatimore dhe përjashtimeve si pjesë e saj. Fitimi kapital taten si të ardhurat e zakonshme. Duke nisur nga 01 Janar i vitit 2014 për kompanitë me nivel qarkullimi mbi 8 milion Lekë norma tatimore është 15 për qind. Nëse qarkullimi total i një kompanie është midis 2 dhe 8 milion Lekë tatimi mbi të ardhurat e kompanisë është 7.5 për qind. Kompanitë me nivel xhiroje nën 2 milion Lekë janë subjekt i tatimit të thjeshtë, pra taten si biznes i vogël me një shumë fikse vjetore prej 25 000 Lekë. Dividendët që u shpërndahen jo rezidentëve paguajnë 10 për qind tatim (edhe pse kjo normë është ulur me marrëveshje fiskale midis shteteve). Lehtësira tatimore në lidhje me tatimin mbi të ardhurat mund të fitohen nëse bëhen investime në sektorin publik, në infrastrukturë, turizëm dhe industrinë e vajrave të rëndë.

Serbia

Në Serbi tatimet mbi korporatat janë njësoj si në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Maqedoni. Të ardhurat e tatueshme përfshijnë si të ardhurat e zakonshme ashtu edhe ato kapitale. Norma tatimore është 15 për qind. Fitimi kapital për rezidentët taten me 15 për qind ndërsa për jo rezidentët me 20 për qind. Dividendët e paguar nga një kompani rezidente tek një tjetër kompani Serbe janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat e kompanive. Marrëveshjet tatimore janë përmendur disa herë në këtë analizë krahasuese, edhe Serbia ashtu sikurse edhe shtetet e tjera nuk i respekton të gjitha ato. Kështu, edhe pse ekzistojnë këto marrëveshjeve, dividendët që u paguhen jo rezidentëve taten me 20 për qind. Pagesat e bëra ndaj një rezidenti, nën një juridiksion preferencial tatimor, taten me 25 për qind. Për sa u përket nxitësve tatimore mund

të themi se investitorët të cilët investojnë mbi 1 miliardë RSD (e konvertuar në dollarë kjo shumë është afërsisht 9.23 milion\$) në mjete fikse dhe punësojnë 100 punëtorë më shumë gjatë periudhës së investimit, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin për një periudhë 10-vjeçare.

Kroacia

Në Kroaci rezidentët tatohen për të gjitha të ardhurat e tyre brenda dhe jashtë vendit, ndërsa jo rezidentët, ashtu si në Shqipëri dhe Mal të Zi, tatohen vetëm mbi të ardhurat e krijuara brenda vendit. Norma e tatimit për korporatat është 20 për qind. Fitimi kapital përfshihet në të ardhurat e tatueshme dhe tatohet me të njëjtën normë, pra me 20 për qind. Dividendët janë gjithashtu të tatueshëm, përjashtim bëjnë vetëm dividendët të cilët u paguhen një entiteti rezident. Dividendët për jo rezidentët tatohen me 12 për qind edhe pse norma është më e lartë nga marrëveshjet apo përjashtimet sipas direktivave të BE-së. Zbritjet për shpenzimet e lidhura me kërkim-zhvillimin janë të vlefshme. Nxitësit për investime mund të ulin normën e tatimit të korporatave, kjo në varësi të sasisë së kapitalit të investuar dhe numrit të të punësuarve të lidhur me investimin.


Mal i Zi

Rezidentët tatohen njësoj si në Shqipëri dhe Kroaci. Edhe në këtë shtet fitimi kapital tatohet njësoj si fitimi nga të ardhurat e zakonshme, norma e tatimit për të dyja llojet e fitimit është 9 për qind. Dividendët e shpërndarë ndaj rezidentëve apo jo rezidentëve tatohen me normën prej 9 për qind. Për sa u përket nxitësve tatimorë mund të themi se tatimet pushojnë së paguari për një periudhë 8-vjeçare për kompanitë të cilat investojnë në prodhim në zonat e pazhvilluara.

Bazuar në të dhënat e mësipërme arrijmë në përfundimin se Shqipëria më së shumti nxit bizneset e vogla. Bosnja dhe Hercegovina me tatimin e saj mbi të ardhurat e kompanive qartazi duket se nxit importet dhe eksportet. Nga ana tjetër Kroacia nëpërmjet sistemit të saj tatimor nxit investimet dhe punësimin e ndërsa Maqedonia stimulon më shumë investimet në zona e tregtisë

së lirë. Mali i zi dhe Serbia me anë të përjashtimeve dhe instrumenteve tatimore nxitës që aplikojnë nxisin investime në sektorë më pak të zhvilluar.

Grafiku 23: Tatimi mbi kompanitë rezidente në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Doing Buissnes 2014

- Tatimi mbi të ardhurat personale

Shtete si Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia aplikojnë taksën e sheshtë (Business, 2013). Këto të dhëna pasqyrohen në tabelën 7 në aneks. Literatura dhe të dhënat empirike theksojnë se ky tatim konsiderohet si një tatim i cili nxit kursimet dhe investimet. Duke nisur që nga 1 Janari i vitit 2014 Shqipëria aplikon tatimin progresiv mbi të ardhurat. Po të njëjtin sistem tatimor, pra taksën progresive, aplikojnë edhe shtete të tjera si Kroacia dhe Mali i Zi. Norma progresive në Kroaci fillon nga 12 për qind e vazhdon deri në 40 për qind.

Pjesa më e madhe e vendeve, pas krizës financiare të vitit 2008, aplikuan tatimin progresiv si një mënyrë për të mbledhur më shumë të ardhura, pa marrë në konsideratë eksperiencat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe studimet empirike të cilat theksojnë se rritja e normave tatimore ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike.


- Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi indirekt në përgjithësi luan një rol të rëndësishëm në të ardhurat për buxhet për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (Crawford I, M. Keen and S. Smith, 2009). Në raportin e Bankës Botërore theksohet se tatimi indirekt përbën 14 për qind të PBB-së dhe TVSH-ja zë peshën më të

madhe të tij, afro 10.8 për qind të PBB (BankaBotërore, 2012). Por cilat janë karakteristikat kryesore të TVSH-së në shtetet e Ballkanit Perëndimor? A aplikojnë këto shtete lehtësira tatimore?

Maqedonia aplikon TVSH-në mbi furnizimet me të mira dhe shërbime, në dhënien e shërbimeve dhe në importe. Në Kroaci TVSH-ja aplikohet mbi shitjet e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve dhe është pikërisht ky shtet i cili ka dhe normën më të lartë të TVSH-së, 25 për qind. Norma e TVSH-së në Shqipëri është gjithashtu një ndër më të lartat në Ballkanin Perëndimor. Çfarë lloj përjashtimesh përdorin këto shtete në lidhje me TVSH? Maqedonia aplikon TVSH-në prej 5 për qind mbi produktet ushqimore, farmaceutike, pajisjet e prodhimit, kompjuter dhe transportin publik. Përjashtime bëhen edhe për furnizimet e bankave dhe institucioneve financiare, kompanitë e sigurimit, në shëndetësi dhe edukim dhe TVSH-ja mbi eksportet është 0 për qind. Në Bosnjë Hercegovinë disa shërbime publike si shëndetësia dhe shërbimet financiare janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Edhe në këtë shtet nuk aplikohet TVSH mbi mallrat që eksportohen. Përjashtimi i mallrave që eksportohen nga TVSH-ja është i zbatueshëm edhe në vendin tonë. Në Shqipëri së fundmi shtyrja e TVSH për investime është hequr. Furnizimet me medikamente konsiderohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja. Serbia aplikon norma preferenciale TVSH-je, 10 për qind, dhe disa të mira janë të përjashtuara apo kanë normë prej 0 për qind. Në Kroacia TVSH-ja është 25 për qind dhe zbritjet e saj janë deri në 13 apo edhe 5 për qind. Mali i Zi aplikon një normë të zbritur 7 për qind për disa të mira dhe shërbime. Mbi eksportet nuk aplikohet TVSH, pra ajo është 0 për qind dhe ky shtet përjashton nga TVSH-ja shërbimet financiare, shitjen e tokës etj.

Grafiku 24: Normat e T.V.SH-së në vendet e Ballkanit Perëndimor




Burimi: Ligji tatimor i secilit vend 2014.

Përqendrimi i investimeve të huaja direkte në shtetet e Ballkanit

Mungesa e harmonisë midis sistemit dhe tërësisë së procedurave dhe nevojave reale të ekonomisë është një e ‘keqe’ e përbashkët e Ballkanit Perëndimor. Të gjitha shtetet e rajonit vuajnë nga përmasa relativisht të mëdha të ekonomisë informale. Informaliteti është veçanërisht i zgjeruar në Bosnjë Hercegovinë (Evropian, 2013). Më lart, për secilin prej vendeve të marra në analizë, pasqyruam një pjesë të sistemit tatimor, atë që drejtpërdrejt lidhet me thithjen e investimeve të huaja dhe rritjen ekonomike. Le të shohim se sa kanë qenë vitet e fundit investimet e huaja direkte për secilin prej shteteve të marra në analizë. Ashtu sikurse vihet re nga të dhënat e pasqyruara në grafikun 25 në vitin 2013 është Serbia shteti i cili ka nivelin më të lartë të investimeve të huaja, e ndjekur më pas nga Shqipëria dhe Bosnjë Hercegovina. Nëse i referohemi përsëri normës së tatimit mbi fitimin kujtojmë se Serbia së bashku me Maqedoninë dhe Bosnjë Hercegovinën aplikojnë tatimin e sheshtë prej 10 për qind, për më tepër edhe vendi ynë aplikonte të njëjtën normë tatimore në vitin në fjalë.

Grafiku 25: Investimet e huaja direkte në vendet e Ballkanit Perëndimor




Burimi: Banka Botërore

Banka Botërore në raportin e saj të vitit 2013 shprehet se të ardhurat tatimore si përqindje e PBB-së janë reduktuar nga 24 në 22 për qind në ish Republikat Sovjetike dhe nga 35 në 33 për qind në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Për periudhën 1990 – 2000, të ardhurat tatimore të mbledhura nga vendet në tranzicion të Evropës qëndrojnë shumë poshtë nga mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian që është 37 për qind e PBB-së.

Të ardhurat nga tatimet si përqindje ndaj PBB-së, gjatë periudhës 10 vjeçare 2001-2011, janë reduktuar mesatarisht me 3 për qind për vende si Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia. Gjatë së njëjtës periudhë raporti i të ardhurave tatimore ndaj PBB-së është përmirësuar me afro 4.2 për qind për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor si; Bosnja Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia. Megjithatë vlerat e raportit të ardhura tatimore PBB për vendet e Ballkanit Perëndimor qëndrojnë larg mesatares së vendeve të industrializuara që është 65 për qind e PBB. Nëse do ti referohemi shpenzime publike themi se shpenzimet publike të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë mesatarisht 40.4 për qind e PBB-së. Banka Botërore në raportin e saj për vitin 2013 lidhur me shpenzimet funksionale në Shqipëri krahasuar me vende të tjera nxjerr në pah për vendin tonë tri tipare të rëndësishme: shpenzime relativisht të ulëta në arsim, shpenzime me të larta sesa mesatarja në shërbime të përgjithshme publike dhe shërbime të tjera dhe nivel mesatar i

shpenzimeve në shërbimet ekonomike, duke përfshirë infrastrukturën, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale.


Grafiku 26: Shpenzimet buxhetore në përqindje të PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: FMN

Grafiku 26 përshkruan peshën që shpenzimet buxhetore të vendeve të Ballkanit Perëndimor zënë në PBB-të e tyre përkatëse për një periudhë 10-vjeçare. Shpenzimet buxhetore në Shqipëri krahasuar me PBB-në e saj janë në nivele më të ulëta krahasuar me shtete të tjera. Ashtu sikurse duket edhe në grafikun 27 Shqipëria ndodhet në të njëjtën situatë edhe kur krahasojmë të ardhurat e saj buxhetore ndaj PBB-së me ato të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Grafiku 27: Të ardhurat buxhetore në përqindje të PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: FMN

Nëse i referohemi krahasimit të peshës që zënë të ardhurat tatimore dhe shpenzimeve buxhetore në PBB-të përkatëse të secilit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor mund të shohim se Bosnja Hercegovina është vendi i cili ka vlerat më të larta për të dy këto elementë të politikës fiskale. Norma e tatimit mbi fitimin e kompanive dhe TVSH-ja në Bosnjë Hercegovinë është një ndër normat më të ulëta në rajon. Nga ana tjetër është po ky shet i cili për vitin 2013 ka vlerën më të lartë të PBB-së. Pothuajse në të njëjta pozita ndodhet edhe Mali i zi. Për Shqipërinë nivelet mesatare të ardhurave tatimore dhe shpenzimet publike në raport me PBB-në janë ndër më të ulëtat në rajon edhe pse për nga niveli i normës së rritjes së PBB-së renditemi në vend të dytë.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

4.1 Projektimi i kërkimit

Barro në 1990 dhe Baxter së bashku me King në 1993, analizuan një funksion të prodhimit Cobb-Douglas dhe përfshinë në të kanalet nëpërmjet të cilave politika fiskale mund të përcaktojë nivelin e prodhimit dhe normën ekuilibër të rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Në funksionin e prodhim tashmë përfshihen, jo vetëm kapitali fizik dhe ai njerëzor, por edhe sektori publik. Në këtë mënyrë tregohet se rritja varet gjithashtu edhe nga veprimtaria e qeverisë.

Forma e funksionit të parë të regresionit të shumëfishtë të ngritur në këtë studim është si më poshtë vijon:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (TD_t/Y_t) + \beta_2 (TI_t/Y_t) + \beta_3 (TTjera_t/Y_t) + \beta_4 \text{Lojitaksës} + \mu_i \quad (1)$$

Y_t - simboli i cili përfaqëson variabëlën e varur është vlera e produktit të përgjithshëm bruto në periudhën t , TD_t është variabëli i pavarur i të ardhurave nga tatimet direkte, TI_t përfaqëson të ardhurat nga tatimet indirekte, $TTjera_t$ janë të ardhura të tjera jo tatimore dhe **Lloji i taksës** është variabëli “dummy” me anë të së cilit do të përpiqemi të studiojmë efektin që ka taksa i sheshtë në krahasim me taksa të tjera mbi PBB-në. Vlerat e të gjithë variablave janë vjetore, pra për secilin vit të periudhës së marrë në studim 1993-2014. Vlerat vjetore të variablave të pavarur të tatimit direkt, tatimit indirekt dhe të ardhurat e tjera publike janë marrë në raport me vlerat e PBB-së në vitin përkatës.

β_0 - konstantja ose vlera e pritshme e variabëlit të varur Y , kur të gjithë variablat e pavarur janë zero (0) dhe $\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4$ janë parametrat e pjesshëm për secilin prej variablave të pavarur.

μ_i - termi i gabimit

Studime të ndryshme empirike kanë treguar se disa forma të politikave tatimore mund të nxisin ose të zvogëlojnë rritjen ekonomike. Bazuar edhe tek Barro dhe Sala-i-Martin (2004), të ardhurat tatimore u kategorizuan fillimisht në të ardhura direkte dhe të ardhura indirekte, funksioni (1) dhe më pas secila kategori është ndarë sipas zërave specifike, funksioni (2) për zërat e tatimit direkt dhe funksioni (3) për zërat e tatimit indirekt.

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (TP_t / TotTr_t) + \beta_2 (TFK_t / TotTr_t) + \beta_3 (TBV_t / TotTr_t) + \beta_4 (Sig_t / TotTr_t) + \beta_5 (TAP_t / TotTr_t) + \mu_i \quad (2)$$

Në funksionin e mësipërm (2), Y_t - është vlera e produktit të përgjithshëm bruto, TP_t janë të ardhurat nga tatimet mbi pasurinë, TFK_t përfaqësojnë të ardhurat nga tatimet mbi fitimet e kompanive, TBV_t janë të ardhurat nga tatimet mbi biznesin e vogël, Sig_t përfaqësojnë të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe TAP_t janë tatimet mbi të ardhurat personale. Vlerat e këtyre variablave në studim janë marrë në përqindje të të ardhurave totale të shënuara me $TotTr_t$. Vlerat e të gjithë varibaleve janë përsëri vlera në baza vjetore.

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (TVSH_t / TotTr_t) + \beta_2 (TDoganë_t / TotTr_t) + \beta_3 (Akcizë_t / TotTr_t) + \mu_i \quad (3)$$

Në funksionin (3) sërisht me Y_t është shënuar vlera e produktit të përgjithshëm bruto në periudhën t, $TVSH_t$ janë të ardhurat nga tatimet mbi vlerën e shtuar, $TDoganë_t$ përfaqësojnë të ardhurat doganore dhe $Akcizë_t$ janë të ardhurat nga akciza. Vlerat vjetore të këtyre variablave janë marrë në përqindje të të ardhurave totale të po atij viti të shënuara me $TotTr_t$.

Në mbështetje të ndikimit të të ardhurave tatimore, si një prej elementëve të politikës fiskale, mbi PBB-në kemi ndërtuar edhe një tjetër ekuacion regresi:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (TI_t) + \beta_2 (IP_t) + \beta_3 (BP_t) + \mu_i \quad (4)$$

Në ekuacionin (4) Y_t është produkti i përgjithshëm bruto vjetor, TI_t janë të ardhurat vjetore nga tatimi direkt, IP_t janë shpenzimet vjetore publike dhe BP_t përfaqëson nivelin vjetor të borxhit publik.

Kur modelohet marrëdhënia endogjene midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në lidhje me variablat fiskalë u morën parasysh disa përjashtime të rëndësishme. Modeli duhet të përmbajë të dyja anët e buxhetit meqenëse politika fiskale ndikon mbi prodhimin nëpërmjet politikave tatimore dhe atyre të shpenzimeve. Megjithatë për të shmangur kolinearitetin perfekt një element i politikës fiskale duhet lënë jashtë modelit. Kështu meqenëse deficitin buxhetor përftohet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve tatimore, këtë variabël fiskal nuk e kemi përfshirë në model. Ky përjashtim mundëson mënyrën e duhur për të interpretuar çdo ndryshim në variablat fiskalë të përfshirë në model. Favero dhe Gaviuzzi (2007) theksojnë se modelet empirike të politikës fiskale mund të shfaqin probleme të vlerësimit të njëanshëm, nëse nuk përfshijnë edhe tregues të borxhit publik. Megjithatë duhet të përmendim edhe faktin se metodat e përdorura për të financuar borxhin mund të ndikojnë si anën e ofertës, ashtu edhe atë të kërkesës agregate. Teoria nënvizon edhe ndryshimin e ndikimit të borxhit publik mbi rritjen ekonomike. Kështu rritja e tij mund të bëjë që ky variabël të ndryshojë shenjë, pra nga stimulues mund të kalojë në pengues i rritjes ekonomike.

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (PF_t) + \beta_2 X_{2t} + \beta_3 (FKFB_t) + \beta_4 (EX_t) + \mu_i \quad (5)$$

Në ekuacionin (5) Y_t është produkti i përgjithshëm bruto për frymë për periudhën t , PF_t është variabëli i politikës fiskale, $FKFB$ është formimi i kapitalit fiks bruto dhe EX_t është treguesi i hapjes ndaj tregtisë apo eksporti neto i shprehur si diferencë midis vlerës totale vjetore të eksporteve me importet totale të po atij viti.

Formimi bruto i kapitalit fiks përfshin përmirësimet e truallit, të mbjellave, makinerive, blerjen e pajisjeve dhe makinerive, ndërtimin e rrugëve, hekurudhave dhe ndërtimin e shkollave, zyrave, spitaleve, rezidencave private dhe ndërtimet industriale dhe tregtare.

Variabëli i politikës fiskale është ndërtuar si mesatare e tre elementëve, më konkretisht i të ardhurave nga tatimet direkte, shpenzimeve qeveritare dhe nivelit të borxhit publik. Të dhënat janë vjetore.

Bazuar në teorinë ekonomike variablat e kapitalit fizik dhe atij human janë ndër faktorët kryesorë të prodhimit. Për të analizuar efektet e sektorit të jashtëm ndaj rritjes ekonomike është përdorur variabëli tjetër jo fiskal, ai i hapjes ndaj tregtisë. Ashtu siç e kemi përmendur edhe në trajtimin e pjesës teorike, politika fiskale ndikon prodhimin nëpërmjet politikave tatimore dhe atyre të shpenzimeve. Në ekuacionin (5) variabëli politikë fiskalë synon të kapi efektet e plota të politikës fiskale, pasi ky variabël do të ndërtohet si mesatare e tre treguesve, më konkretisht e treguesit të të ardhurave tatimore, shpenzimeve publike dhe borxhit publik. Në këtë mënyrë do të analizojmë efektet e politikës fiskale si pjesë e faktorëve agregat që ndikojnë mbi rritjen ekonomike.

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e këtyre lidhje do të jetë ajo e katrorëve më të vegjël (MKV ose në anglisht OLS). Një nga arsyt kryesore të përdorimit OLS është seria e të dhënave relativisht e shkurtër, e cila nuk lejon përdorimin e metodave të tjera si VECM, apo VAR të cilat

bëjnë një shpjegim, jo vetëm të lidhjes midis variablave, por edhe të dinamikave afatshkurtra dhe afatgjata. Për përdorimin e kësaj metode duhet të plotësohen disa supozime (Gujarati, 2001, p. 506).

Së pari zgjedhja duhet të jetë e rastësishme dhe vërtetimet duhet të jetë të pavarura nga njëra tjetra dhe të kenë të gjitha një shpërndarje normale.

Së dyti nuk duhet të ketë kolinearitete perfekte të variablave të pavarur. Ky supozim lejon që variablat shpjegues të kenë lidhje midis tyre, por jo një lidhje perfekte.

Së treti mesatarja e kushtëzuar të jetë zero, (për $t = 1, 2, \dots, n$). Pra për çdo t , vlera e pritur e mbetjeve, duke pasur të dhëna të gjithë variablat shpjegues për të gjitha periudhat, është zero. Ky supozim thekson se mbetjet janë të pa korreluara me secilin variabël shpjegues, në çdo periudhë kohe. Në modelet e serive kohore, ky supozim nuk pranon që të ketë korrelacion të përkohshëm midis mbetjeve dhe variablave. Plotësimi i këtij supozimi është i domosdoshëm për të pasur qëndrueshmëri në vlerësimin me anë të metodës së katrorëve më të vegjël.

Së katërti varianca e gabimit μ_t , e kushtëzuar nga variabli shpjegues X , të jetë e njëjtë për çdo t .
$$\text{Var}[\mu_t | X] = \text{Var}(\mu_t) = \sigma^2 \text{ për } t = 1, 2, \dots, T.$$

Ky supozim nënkupton se varianca e gabimit është konstante, ai njihet ndryshe si parimi i homoskedasticitetit. Nëse ky supozim nuk plotësohet atëherë themi se mbetjet janë heteroskedastike.

Së pesti mungesa e korrelacionit serial, pra mbetjet në dy periudha kohe të ndryshme, të kushtëzuar nga variabli shpjegues X , të mos jenë të korreluara me njëra tjetrën.

$$\text{Corr}[\mu_t, \mu_s | X] = 0 \text{ për çdo } t \neq s.$$

Nëse ky supozim nuk plotësohet, atëherë mund të themi se midis mbetjeve ka korrelacion serial, ose auto korrelacion, pasi ato janë të lidhura midis tyre në kohë. Duhet theksuar se ky supozim nuk ka të bëjë me korrelacionin midis variablave shpjegues (Demaris, 2004, p. 175).

Përpara se të kalojmë tek forma përfundimtare e ekuacioneve do të testojmë nëse plotësohen të gjitha supozimet e mësipërme në mënyrë që vlerësimi me anë të metodës së katrorëve më të vegjël të jetë domethënës. Në përmbledhje të testeve që do të kryhen për secilin nga ekuacionet e regresit nënvizojmë se testimi i supozimeve bazë do të bëhet nëpërmjet: Scatter Plot Matrix, Histogram dhe testit DURBIN-WATSON. Testimi i stacionaritetit të secilit variabël do të realizohet me anë të testit LJUNG-BOX.

4.2 Të dhënat

Modeli i rritjes ekonomike bazohet në variablat e kapitalit, hapjes ndaj tregtisë dhe variablave fiskalë. Të dhënat mbi produktin e përgjithshëm bruto dhe PBB-në për frymë u siguruan nga Banka Botërore. Të ardhurat tatimore, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik u morën nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Të dhënat për formimin e kapitalit fiks bruto janë marrë nga Banka e Shqipërisë. Treguesi i hapjes ndaj tregtisë përfaqëson diferencën midis shumës së eksporteve totale dhe importeve totale. Të dhënat për eksportet dhe importet e mallrave dhe të shërbimeve janë marrë nga Banka e Shqipërisë.

Në këtë studim rezultatet fillimisht nxirren nga klasifikimi i të ardhurave tatimore në të ardhura nga tatimet direkte dhe të ardhura nga tatimet indirekte. Grupi i të ardhurave tatimore përbën edhe një nga çështjet kryesore të tij. Të ardhurat direkte janë të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e kompanive, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi biznesin e vogël dhe të ardhurat nga

fondet speciale apo kontributet e sigurimeve shoqërore. Të ardhurat nga tatimet indirekte janë shuma e të ardhurave nga TVSH-ja, taksat doganore dhe akcizat.

Shpenzimet qeveritare përfaqësojnë nivelin e përgjithshëm të tyre dhe të ardhurat e qeverisë të përfshira në ekuacionin (5) janë të ardhurat nga tatimet direkte meqenëse janë pikërisht këto të ardhura të cilat në ekuacionin e parë rezultuan nga ana statistikore të rëndësishme. Shpenzimet totale të qeverisë janë shuma e shpenzimeve publike kapitale dhe korrente. Shpenzimet korrente të qeverisë janë shuma e shpenzimeve për personelin, subvencione, shuma e shpenzimeve sociale, shpenzime operative mirëmbajtje, shpenzime të tjera, kompensim i energjisë elektrike, kompensim për shpronësim, kosto e interesave të ristrukturimit të bankës, huadhënie për KESH-in, pagesa për pjesëmarrjen në kapitalin e BSH-së dhe subvencione për energjinë. Periudha e marrë në studim është 1993-2014.

4.3 Kufizimet e metodologjisë

Ky punim analizon ecurinë e sektorit publik për periudhën 1993 – 2014 duke vlerësuar arritjet dhe problemet e tij, këto të fundit për politikë bërësit përkthehen në sfida për të ardhmen. Një nga kontributet kryesore të këtij punimi është informacioni i sintetizuar në lidhje me mënyrën se si rezultatet fiskale dhe institucionale e sektorit publik kanë ndikuar rritjen ekonomike.

Një modeli ekonometrie i vlerësimit të ndikimit të të ardhurave tatimore ndaj rritjes ekonomike është një tjetër kontribut i këtij punimi i cili në mënyrë modeste nxjerr lidhjen midis variablave fiskale të marra në studim dhe rritjes ekonomike.

Rezultatet e modelit varen plotësisht nga metoda e ekonometrisë e përzgjedhur, numri i observimeve, cilësia e të dhënave, zgjedhja e variablave, etj. Kështu që disa nga kufizimet e këtij modeli mund të përmbledhen si më poshtë:

Seri kohore e vogël. Përdorimi i një zgjedhjeje të përbërë nga vetëm 21 observime e kushtëzon analizën dhe nuk lë shumë hapësira për zgjedhjen e një metode ekonometrie dhe për bërjen e një analize më të plotë të fenomenit në studim.

Të dhënat dhe mangësitë e tyre. Të dhënat në dispozicion dhe mangësitë në metodologjitë e llogaritjes së tyre krijojnë kufizime në vlerësimin e variablave të ndryshëm, duke u bërë kështu shkak për besueshmëri të ulët të rezultateve të modelit.

Të dhënat e variablave të pavarur, apo të serive kohore, të përdorura në këtë punim janë pothuajse konstante nga njëri vit në tjetrin. Vlerat konstante të tyre mund të vihen re edhe tek grafikët e stacionaritetit të secilit prej tyre. Këto vlera nuk kanë variabilitet dhe kështu prekin një prej supozimeve të modelit klasik të regresionit linear (MKRL), atë të variabilitetit të serive kohore.

KAPITULLI V: ANALIZA EMPIRIKE DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE

5.1 Efektet e tatimit direkt dhe atij indirekt ndaj PBB-së

Fillimisht do të realizojmë të gjitha testet e nevojshme lidhur me ekuacionin (1) i cili shpreh efektet e të ardhurave tatimore mbi produktin e përgjithshëm bruto. Le të shohim dhe të interpretojmë një e nga një secilin prej tyre.

Testi 1. Testet e stacionaritetit apo të rrënjës njësi

Stacionariteti i një serie kohore ndikon në sjelljen dhe në vetitë e saj (Kedem, B. & Fokianos, K., 2002, p. 217). Në qoftë se variablat në një model regresi nuk janë stacionare do të thotë se supozimet standarde për një analizë asimptotike nuk janë të vlefshme. Me fjalë të tjera normat- t të testimit të parametrave të regresit nuk do të jenë sipas shpërndarjes- t , prandaj nuk do të jetë e mundur që të bëhen testime të hipotezave për to. Në qoftë se një seri nuk është stacionare, do të thotë se ka rrënjë njësi, atëherë ajo duhet të diferencohet derisa të bëhet stacionare. Seritë stacionare shënohen me $I(0)$. Nëse një seri jo stacionare diferencohet njëherë dhe kthehet në stacionare, ajo quhet seri e integruar e rendit të parë dhe shënohet $I(1)$. Kjo seri ka një rrënjë njësi. Nëse seria diferencohet njëherë dhe nuk bëhet stacionare ajo diferencohet përsëri dhe nëse bëhet stacionare shënohet $I(2)$. Në përgjithësi variablat ekonomikë dhe financiarë janë $I(0)$ dhe $I(1)$. Për të vlerësuar nëse një seri është stacionare apo jo testohet hipoteza H_0 (ka një rrënjë njësi, pra është jostacionare) dhe hipoteza H_1 (është stacionare). Nëse hipoteza H_0 hidhet poshtë seria është stacionare dhe nëse kjo hipotezë qëndron seria diferencohet dhe testohet përsëri derisa hipoteza H_0 të hidhet poshtë. Për të testuar stacionaritetin është përdorur statistika Ljung-Box.

Nga rezultatet e këtij testi themi se PBB-ja për Shqipërinë rezulton stacionare, por me një pikë thyerje apo vlerë ekstreme në vitin 1997. Tatimi direkt, tatimi indirekt dhe të ardhurat e tjera jo tatimore rezultojnë të integruara të rendit të parë, pra stacionare me një diferencë. Këto rezultate pasqyrohen edhe në grafikët përkatës të vendosur në anekse.

Testi 2. Testimi i multikolinearitëit midis variablave

Nëse variablat kanë lidhje të fortë me njëri tjetrin, pavarësisht nëse kjo lidhje është negative apo pozitive, atëherë ajo na pengon që të vlerësojmë koeficientët e regresionit në mënyrë të besueshme, e thënë ndryshe rezultatet e përfutuara nuk janë shumë të besueshme. Ngjashmëritë midis variablave të pavarur do të rezultojnë në një korrelacion të fortë. Testi i multikolinearitëit bëhet pikërisht për të mënjeluar sjellje në procesin e marrjes së vendimeve, sjellje të cilat lidhen me ndikimet pjesore të variablave të pavarur në variabëlën e varur. Një model regresioni konsiderohet i mirë atëherë kur midis variablave të pavarur nuk ka korrelacion apo multikolinearitëit (Gujarati, 2001, p. 335).

Për testimin e lidhjes shumëfishe midis variablave me njëri tjetrin janë përdorur koeficientët e korrelacionit të Spearmanit. Nga analiza e kryer rezulton se variablat nga ana statistikore nuk kanë lidhje të rëndësishme me njëri tjetrin me përjashtim të TD - TI, por megjithatë lidhja e tyre është e dobët dhe e rëndësishme në nivelin 10% të rëndësisë, pasi koeficienti i tyre i korrelacionit na rezulton 0.4. Sipas edhe përfundimeve të këtij testi koeficientët e modelit tonë të regresionit mund ti vlerësojmë në mënyrë të besueshme.

Testi 3. Testimi i formës funksionale dhe rëndësisë së çdo variabëli mbi variabëlin e varur

Për të testuar formën funksionale të modelit është përdorur testi Ramsey. Nga rezultatet e testit Ramsey themi se të ardhurat nga tatimi direkt na rezultojnë nga ana statistikore të rëndësishme. Vlera e probabilitetit e këtij variabëli është pikërisht 0.054, vlerë kjo pothuajse sa $\alpha = 0.05$ dhe më e vogël se 0.1 (α). Forma e lidhjes së tatimit direkt me PBB-në është lineare në nivelin e rëndësisë prej 5 për qind dhe jo lineare në nivelin e besimit prej 10 për qind, referuar vlerave të Fkr në tabelën e formës së funksionit. Pasi kemi testuar formën funksionale të çdo variabëli mbi variabëlin e varur, do të kalojmë në testimin e rëndësisë së çdo variabëli mbi PBB-në. Tabelat të cilat tregojnë ndikimin dhe rëndësinë e çdo variabëli të pavarur janë vendosur në anekse. Në rastin e një variabëli të parëndësishëm nga ana statistikore ne mund të vazhdojmë me interpretimin e vlerës së koeficientit të tij, por variabëli nuk qëndron në model pasi nuk ndikon në R^2 e variabëlit të varur. Bazuar në rezultatet e deritanishme arrijmë në përfundimin se për çdo ndryshim me 1 për qind të të ardhurave nga tatimet indirekte PBB-ja rritet me 0.306 milion lekë, ndërkohë që variablat e tjerë mbahen të pandryshueshëm. Lidhur me ndikimin e të ardhurave të tjera mbi PBB-në themi se për çdo ndryshim me 1 për qind të tyre PBB-ja ndryshon me 0.577 milion lekë. Në tabelën e ndikimit të variablave të pavarur mbi PBB-në, tabelë e cila përfshin të dhënat vetëm për variablat e pavarur të cilët kanë formë lidhjeje lineare me PBB-në, kemi të përfshirë edhe variabëlin DUMMY, pra llojin e taksës së aplikuar. Meqenëse në 2008 në Shqipëri u aplikua tatimi i sheshtë atëherë ky variabël është përfshirë në model, në përpjekje për të analizuar ndikimin e tij mbi PBB-në. Kështu në lidhje me këtë variabël për të cilin me zero (0) kemi shënuar taksën e sheshtë dhe me një (1) kemi shënuar një lloj tjetër takse, funksionin e shkruajmë në këtë formë:

$$y = 5.405 - 0.495 D_1.$$

Nëse i japim vlerën 1 variabëlit DUMMY atëherë vërejmë se PBB-ja zvogëlohet me 0.495 milion lekë më shumë se sa në rastin e taksës së sheshtë. Në rast se vlera e variabëlit DUMMY është 0 (pra taksë e sheshtë) atëherë ekuacioni do të jetë $y = 5.405$. Pra mund të themi se në krahasim me taksa të tjera taksa e sheshtë e zvogëlon më pak PBB-në. Efekti i të dyja llojeve të taksave është negativ, por taksa e sheshtë ka ndikim më të ulët se sa një tjetër lloj takse.

Meqenëse forma e lidhjes së tatimit direkt me PBB-në nuk është lineare atëherë të dhënat për ndikimin e saj mbi PBB-në i gjejmë në tabelën vijuese në anekse.

Forma funksionale ku $Y = \text{PBB}$ dhe $X = \text{TD}$ është:

$$Y = 3.644 + 12.504 X - 2.450 X^2 - 9.231 X^3$$

Ndryshimi në Y për çdo ndryshim me 1 për qind të X , i cili në këtë rast është tatimi direkt TD, gjendet duke derivuar funksionin e mësipërm. Nga derivimi i tij rezulton pjerrësia e barabartë me -59.886 milion lekë. Pra për çdo ndryshim me 1 për qind të të ardhurave nga tatimet direkte produkti i përgjithshëm bruto zvogëlohet me 59.886 milion lekë.

Rezultatet e analizës ekonometrike

Tabela e testimit të modelit na tregon se koeficienti i thjeshtë i korrelacionit është 0.696, nivel ky i cili tregon një shkallë relativisht të lartë korrelacioni. Pra meqenëse koeficienti i korrelacionit është relativisht i lartë atëherë themi se ka korrelacion relativisht të lartë midis produktit të përgjithshëm bruto dhe katër variablave të përfshira në model. R^2 tregon se 48.5 për qind e variacionit total në variabëlën e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto, shpjegohet nga të gjitha variablat e pavarur të modelit, pjesa tjetër mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit. Megjithatë akoma nuk e dimë rëndësinë e kontributit të secilit prej variablave të pavarur. Kësaj çështjeje të rëndësishme do ti kthehemi pak më poshtë kur të flasim për tabelën e koeficientëve dhe rëndësinë statistike të tyre.

Në tabelën e ANOVA-s jemi të interesuar për vlerën e sig e cila duhet të jetë më e vogël se alfa, për të thënë përfundimisht se modeli i regresionit është i rëndësishëm. Ashtu edhe sikurse mund të shihet në tabelën 14 në aneks Sig është lehtësisht më e madhe se $\alpha = 0.05$ apo 5 për qind, por nuk mund të kalojmë në alfa 10 për qind. Kjo tabelë na tregon se modeli i regresionit nga ana statistikore e parashikon produktin e përgjithshëm bruto. Pra mund të themi se në 95 nga 100 raste lidhja midis variablave ndodh sipas rezultateve të tabelës së koeficientëve.

Korrelacioni dhe analiza e regresionit të shumëfishtë janë përdorur për të ekzaminuar lidhjen midis produktit të brendshëm bruto dhe tatimeve direkte. Në tabelën e koeficientëve shohim se tatimet direkte janë të lidhura negativisht me PBB dhe nga ana statistikore janë të rëndësishëm.

Në bazë të tabelës së koeficientëve modeli ekonometrik është:

$$Y = 3.764 + 12.550 X - 2.778 X^2 - 9.410 X^3 - 0.077 X_1 + 0.583 X_2$$

Në këtë model X , X^2 dhe X^3 janë TD apo tatimi direkt (kjo për shkak të lidhjes kubike midis TD dhe PBB-së), X_1 janë të ardhurat nga tatimi indirekt X_2 janë të ardhurat e tjera. Lloji i taksës nuk na lejonte të vlerësonim koeficientët e regresionit, pra paraqisnin probleme të multikolinearitetit, kjo është edhe arsyeja se pse u la jashtë modelit.

Sipas modelit të mësipërm për çdo ndryshim me 1 për qind të tatimeve direkte produkti i përgjithshëm bruto zvogëlohet me 55.386 milion lekë. Ndikimi i tatimit indirekt është gjithashtu negativ. Kështu themi se për çdo ndryshim me 1 për qind të të ardhurave nga tatimet indirekte PBB-ja ulet me 0.077 milion lekë. Të ardhurat e tjera, jo tatimore ndikojnë pozitivisht PBB-në, pra për çdo rritje me 1për qind të të ardhurave të tjera PBB rritet me 0.583 milion lekë.

Testi 4. Testi i auto korrelacionit dhe normalitetit të termit të gabimit

Për të testuar auto korrelacionin e termit të gabimit të modelit të përfutur është përdorur statistika DW (Gujarati, 2001, p. 441). Në rastin tonë $DW = 2.876$, vlerë e cila tregon që kemi auto

korrelacion pozitiv, i cili në këtë rast vjen si rezultat i formës kubike të PBB-së me TD dhe lidhjes që TD ka me shumëfishat e tij (TD^2 dhe TD^3).

Për të testuar dhe provuar një nga katër supozimet e përdorura në këtë punim për modelin e regresionit, atë të shpërndarjes normale të të dhënave, janë përdorur dy teste. Testi i parë është Kolmogorov – Smirnov dhe testi i dytë Shapiro – Wilk.

Për të thënë se kemi shpërndarje normale të termit të gabimit, apo për të thënë se modeli është i qëndrueshëm në afatin e gjatë, Sig duhet të jetë me i madh se alfa. Referuar tabelës së testit të normalitetit përfundimisht themi se nuk kemi probleme me normalitetin e termit të gabimit.

Testi 5. Testimi i heteroskedasticitetit

Për testimin e heteroskedasticitetit janë përdorur testet White dhe Breusch – Pagan. Vlerat e probabilitetit të përfuara janë 0.294 dhe 0.062, por jo të gjitha parametrat e vlerësuar rezultojnë të parëndësishëm, kjo do të thotë që modeli nuk është i qëndrueshëm në afat të gjatë dhe parametrat e vlerësuar nuk janë BLU, pra nuk kanë cilësitë si; lineariteti, efikasitet dhe qëndrueshmëria (Orme, G.J. & Orme, C.T., 2009). Problematikat vijnë si rezultat i vlerës ekstreme që shfaq variabëli jonë i varur dhe variabilitetit jo të madh që kanë observimet e variablave të pavarur. Në këto kushte do rivlerësojmë modelin ekonometrik duke hequr vlerën ekstreme nga variabëli i varur.

Vlerësimi i modelit pas heqjes të vlerës ekstreme nga variabëli i varur, PBB

Pas heqjes së vlerës ekstreme nga variabëli i varur tashmë ky variabël nuk rezulton më i qëndrueshëm, ai bëhet i tillë pas transformimit me një diferencë. Gjithashtu variablat nuk shfaqin

problematika të multikolinearitetit dhe forma funksionale e çdo variabëli me variabëlin e varur rezulton lineare. Për testimin e heteroskedasticitetit u përdor testi White, sipas rezultateve të këtij testi tashmë nuk kemi probleme me heteroskedasticitetin. Vlera e probabilitetit është 0.318, vlerë e cila është më e madhe se alfa 0.05, duke plotësuar edhe kushtin e këtij testi ($0.318 > 0.05$).

Tabela 3: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (1)

Variabli	Koeficientët	P-value
Konstantja	-0.142	0.808
Të ardhurat nga tatimet direkte	-1.944	0.096*
Të ardhurat nga tatimet indirekte	0.695	0.301
Të ardhura të tjera	0.610	0.155

*të rëndësishëm në nivelin 10% të rëndësisë *të parëndësishëm

Variabëli del i rëndësishëm në alfa 10 për qind, por duhet theksuar se variabëli mbetet i rëndësishëm nga ana statistikore ose më saktë përforcohet rezultati që ai është i rëndësishëm. Vëmë re se auto korrelacioni përmirësohet, $DW = 2.384$. Gjithashtu supozimi i normalitetit vazhdon të ruhet dhe përforcohet. Tabela e vlerësimit të variacionit na tregon edhe një herë se modeli i regresionit e parashikon nga ana statistikore produktin e përgjithshëm bruto.

Forma funksionale: $PBB = -0.142 - 1.944 TD + 0.695 TI + 0.610 Ttjera$

Ashtu sikurse edhe teoria nënvizon tatimi direkt ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike, ndërsa tatimi direkt ka ndikim pozitiv, kjo vërtetohet edhe nga shenjat e koeficientëve të këtyre dy variablave në modelin e ndërtuar në këtë studim. Referuar modelit përfundimtar të ndikimit të të ardhurave direkte mbi produktin e përgjithshëm bruto themi se për çdo ndryshim me 1 për

qind në të ardhurat nga tatimet direkte produkti i përgjithshëm bruto zvogëlohet me 1.944 milion lekë. Lidhur me ndikimin e të ardhurave nga tatimet direkte themi se çdo ndryshim me 1 për qind e tatimeve indirekte e rrit PBB-në me 0.659 milion lekë. Të ardhurat e tjera ashtu sikurse edhe tatimet indirekte ndikojnë pozitivisht mbi PBB. Kështu çdo ndryshim me 1 për qind e të ardhurave të tjera e rrit PBB me 0.610 milion lekë.

Megjithatë meqenëse të ardhurat nga tatimet direkte janë variabël i vetëm i cili na rezulton i rëndësishëm nga ana statistikore duhet theksuar se R^2 i produktit të përgjithshëm bruto shpjegohet vetëm nga ky variabël. Variablat e tjerë të pavarur nuk ndikojnë në R^2 e PBB-së, apo nuk e shpjegojnë atë. Pra meqenëse koeficienti i korrelacionit është në nivele mesatare (0.482) atëherë themi se ka korrelacion në nivele mesatare midis produktit të përgjithshëm bruto dhe variablave të përfshira në model apo më saktë midis produktit të përgjithshëm bruto dhe të ardhurave nga tatimet direkte. R^2 tregon se 23.2 për qind e variacionit total në variabëlin e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto, shpjegohet nga të ardhurat e tatimit direkt, pjesa tjetër mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit. Nëse variablat e pavarur të cilët rezultuan të parëndësishëm nga ana statistikore i heqim nga modeli atëherë forma përfundimtare e funksionit është:

$$PBB = - 0.142 - 1.944 TD$$

Heteroskedasticiteti sistemohet, vlerat e probabilitetit rezultuan 0.318. Si përfundim mund të themi se modeli është i qëndrueshëm dhe i pranueshëm.

5.2 Ndikimi i zërave të veçantë të tatimit direkt dhe indirekt mbi PBB

Pasi kemi studiuar ndikimin e dy kategorive të të ardhurave tatimore, tatimit direkt dhe tatimit indirekt, do të analizojmë fillimisht ndikimin e zërave të veçantë të tatimeve direkte.

Në këtë kategori të tatimeve janë përfshirë të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e kompanive, të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi pasurinë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Vlerat e këtyre variablave janë marrë në përqindje të të ardhurave totale. Këto variabla rezultojnë të integruar të rendit të parë, ndërsa tatimi nga të ardhurat i integruar i rendit të dytë.

Forma e funksionit (2) e ndërtuar në fillim të punimit është:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1(TP_t/TotTr_t) + \beta_2(TFK_t/TotTr_t) + \beta_3(TBV_t/TotTr_t) + \beta_4(Sig_t/TotTr_t) + \beta_5(TAP_t/TotTr_t) + \mu_i$$

Nga përfundimet e testeve të realizuara shohim se koeficienti i thjeshtë i korrelacionit është 0.614, nivel ky i cili tregon një shkallë relativisht të lartë korrelacioni. Pra meqenëse koeficienti i korrelacionit është relativisht i lartë atëherë themi se ka korrelacion relativisht të lartë midis produktit të përgjithshëm bruto dhe pesë variablave të përfshira në model. Varianca, apo R^2 , tregon se 37.7 për qind e variacionit total në variabëlën e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto, shpjegohet nga të gjitha variablat e pavarur të rëndësishëm nga ana statistikore të modelit, pjesa tjetër mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit.

Tabela 4: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (2)

Variabëli	Koeficientët	P-value
Konstantja	-0.653	0.285
Tatimi mbi pasurinë	-7.453	0.412

Tatimi mbi fitimin e kompanive	-4.279	0.075
Tatimi mbi biznesin e vogël	-0.872	0.922
Sigurimet shoqërore	3.474	0.184
Tatimi mbi të ardhurat personale	2.363	0.367

*të rëndësishëm në nivelin 10% të rëndësisë

***të parëndësishëm**

Modeli ekonometrik i ndërtuar në bazë të tabelës së vlerësimit të koeficientëve është:

$$Y = -0.653 - 7.453 TP - 4.279 TFK - 0.872 TBV + 3.474 Sig + 2.363 TAP$$

Nga vlerësimi i koeficientëve β na rezulton se efektin më të madh negativ e ka tatimi mbi pasurinë, por nga ana statistikore i rëndësishëm është vetëm tatimi mbi fitimin, në rastin kur alfa është 10 për qind. Përfundimisht themi se për çdo ndryshim me 1 për qind të të ardhurave nga tatimi mbi pasurinë PBB-ja ndryshon me, apo më saktë ulet me 7.453 milion lekë. Nëse të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e kompanive ndryshojnë me 1 për qind atëherë pritet që PBB-ja të ulet me 4.279 milion lekë. Tatimi mbi biznesin e vogël gjithashtu e ul PBB-në. Ndikimi i tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore mbi PBB-në na rezulton pozitiv. Kështu për çdo ndryshim me 1 për qind të tyre PBB-ja rritet respektivisht me 3.474 milion lekë (nga sigurimet shoqërore) dhe 2.363 milion lekë (nga tatimi mbi të ardhurat personale). Interpretimi i ndikimit të variablave të pavarur mund të realizohet, por duhet theksuar se në këtë model vetëm të ardhurat nga tatimet mbi fitimin e kompanive nga ana statistikore janë të rëndësishme. Thënë ndryshe vetëm ky variabël e shpjegon variacionin e produktit të përgjithshëm bruto. Nisur nga kjo që sapa thamë modeli ekonometrik është:

$$Y = -0.653 - 4.279 TFK$$

Në fillim, për të studiuar efektet e tatimeve individuale të grupit të tatimeve indirekte, kemi ndërtuar edhe një funksion tjetër, funksioni (3), por meqenëse vetë variabëli i të ardhurave indirekte na rezultoi i parëndësishëm nga ana statistikore atëherë edhe të gjithë zërat e tij rezultojnë të parëndësishëm nga ana statistikore dhe modeli nuk qëndron.

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1(TVSH_t / TotTr_t) + \beta_2(TDoganë_t / TotTr_t) + \beta_3(Akcizë_t / TotTr_t) + \mu_i \quad (3)$$

Efektet e tatimeve indirekte, dhe e zërave të veçantë të këtij grupi, mund të studiohen si faktorë që ndikojnë në elementë të tjerë agregat të rritjes ekonomike, duke krijuar kështu edhe hapësira për studime të mëtejshme.

5.3 Politika fiskale dhe ndikimi i elementëve të saj mbi PBB-në

Nëpërmjet dy funksioneve të mëparshme analizuam ndikimin që të ardhurat nga tatimet direkte kanë mbi produktin e përgjithshëm bruto, tashmë do të analizojmë ndikimin që të ardhurat nga tatimet direkte, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik kanë mbi PBB-në. Funksioni i ndërtuar për këtë analizë është:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1(TI_t) + \beta_2(IP_t) + \beta_3(BP_t) + \mu_i \quad (4)$$

Stacionariteti i tatimit direkt është testuar më parë. Për të testuar stacionaritetin e dy variablave të tjerë është përdorur sërish statistika Ljung-Box. Nga rezultatet e këtij testi rezulton se shpenzimet qeveritare (IP) dhe borxhi publik janë të integruara të rendit të parë, pra stacionare me një diferencë. Këto rezultate pasqyrohen edhe në grafikët përkatës të vendosur në anekse. Për testimin e lidhjes shumëfishe midis variablave me njëri tjetrin janë përdorur koeficientët e

korrelacionit të Spearmanit. Nga analiza e kryer rezulton se variablat nga ana statistikore nuk kanë lidhje të rëndësishme me njëri tjetrin, prandaj koeficientët e modelit tonë të regresionit mund ti vlerësojmë në mënyrë të besueshme. Forma funksionale e modelit, e cila rezulton lineare, u testua nëpërmjet testit Ramsey

Nga testimi i modelit na rezulton se koeficienti i thjeshtë i korrelacionit është 0.677, nivel ky i cili tregon një shkallë relativisht të lartë korrelacioni. Meqenëse koeficienti i korrelacionit është relativisht i lartë atëherë themi se ka korrelacion relativisht të lartë midis produktit të përgjithshëm bruto dhe tre variablave të përfshira në model. Varianca, R^2 , tregon se 45.9 për qind e variacionit total në variabëlën e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto, shpjegohet nga tatimet direkte, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik, pjesa tjetër mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit.

Referuar vlerave të Sig në tabelën e ANOVA si përfundim themi se modeli i regresionit është i rëndësishëm. Vlera e Sig është 0.054, pra lehtësisht më e madhe se $\alpha = 0.05$ apo 5 për qind, por nuk mund të kalojmë në alfa 10 për qind. Kjo tabelë na tregon se modeli i regresionit e parashikon nga ana statistikore produktin e përgjithshëm bruto. Pra mund të themi se në 95 nga 100 raste lidhja midis variablave ndodh sipas rezultateve të tabelës së koeficientëve.

Korrelacioni dhe analiza e regresionit të shumëfishtë janë përdorur për të ekzaminuar lidhjen midis produktit të brendshëm bruto dhe elementëve të politikës fiskale. Në tabelën e koeficientëve shohim se sërish tatimi direkt është i lidhur negativisht me PBB, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik janë të lidhura pozitivisht. Të tre variablat nga ana statistikore janë të rëndësishëm në nivelin e rëndësisë prej 10 për qind.

Tabela 5: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (4)

Variabëli	Koeficientët	P-value
Konstantja	61,287,709,308.365	0.000
Tatimet direkte	-4,172,686,153.312	0.068*
Shpenzimet qeveritare	0.411	0.078*
Borxhi publik	2,809,773,767.650	0.086*

*të rëndësishëm në nivelin 10% të rëndësisë

Në bazë të tabelës së koeficientëve modeli i ekonometrisë është:

$$Y = 61,287 - 4,172 \text{ TD} + 0.411 \text{ IP} + 2,809 \text{ BP}$$

Rritja me 1 milion lekë e të ardhurave nga tatimet direkte do të ulte me 4,172.6 milion lekë produktin e përgjithshëm bruto. Nga ana tjetër rritja e shpenzimeve qeveritare e rrit produktin e përgjithshëm bruto. Megjithatë efektet e kategorive të ndryshme të shpenzimeve qeveritare mund të jenë objekt i studimeve të tjera. Nga interpretimi i rezultateve të përftuara mund të themi se rritja me 1% e shpenzimeve qeveritare e rrit produktin e përgjithshëm bruto me 0.411 milion lekë. Ndërsa rritja e borxhit publik me 1 milion lekë e rrit PBB-në me 2,809.7 milion lekë. Megjithatë ndikimi i borxhit publik, sipas teorisë, nuk është shumë i qartë pasi herë shfaqet me shenjë negative dhe herë të tjera me shenjë pozitive. Studimi i efekteve të tij sigurisht që krijon hapësira për studime të mëtejshme. Në rastin tonë $DW = 1.994$, gjithashtu nuk kemi probleme me normalitetin e termit të gabimit, dhe heteroskedasticitetin.

5.4 Politika fiskale dhe faktorë të tjerë agregat

Qëllimi kryesor i këtij punimi është studimi i efekteve të tatimeve mbi rritjen ekonomike. Deri tani kemi arritur në përfundimin se rritja e të ardhurave nga tatimet direkte ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike. Për ta mbështetur këtë përfundim studiuam edhe efektet që komponentë të tjerë të politikës fiskale kanë mbi rritjen ekonomike, duke arritur në përfundimin se modeli i

ndërtuar qëndron. Në mënyrë që të themi se politika fiskale dhe elementët e saj janë faktorë agregat dhe kanë ndikimin e tyre mbi rritjen ekonomike do të testojmë edhe funksionin e mëposhtëm.

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 (PF_t) + \beta_2 X_{2t} + \beta_3 (FKFB_t) + \beta_4 (EX_t) + \mu_i \quad (5)$$

Në ekuacionin (5) Y_t është produkti i përgjithshëm bruto për frymë; PF_t është politika fiskale, $FKFB$ është formimi i kapitalit fiks bruto dhe EX_t është treguesi i hapjes ndaj tregtisë, eksporti neto.

Përpara se të kalojmë në testet e nevojshme për modelin ekonometrik të mësipërm, do të ndalemi fillimisht tek analiza e faktorëve për variabëlin e pavarur të ndërtuar dhe emërtuar politika fiskale. Ky variabël i pavarur është krijuar si mesatare e tre elementëve të politikës fiskale, më konkretisht të të ardhurave nga tatimet direkte, të shpenzimeve të përgjithshme publike dhe të borxhit publik. Nga analiza e faktorëve rezulton se tre elementët e zgjedhur shpjegojnë afro 55.6 për qind të variacionit të variabëlilit të krijuar, nivel ky i cili konsiderohet i kënaqshëm. Thënë ndryshe të ardhurat tatimore nga tatimet direkte, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik shpjegojnë 55.6 për qind të variacionit të politikës fiskale. Për shkak të numrit të vogël të faktorëve të përfshirë në këtë variabël, kemi vetëm tre faktorë, vlera e kushtit e vendosur për këtë analizë është 0.45. Nga analiza e komponentëve kryesorë vlera e kushtit për secilin komponent është më e madhe se vlera e vendosur prej nesh. Besueshmëria e faktorit është testuar nëpërmjet testit Cronbach's Alpha. Në mënyrë që faktori i krijuar të cilësohet si i besueshëm duhet që vlera e këtij testi të jetë më e madhe se 0.6. Vlera e Cronbach's Alpha është 0.676 prandaj përfundimisht themi se mund ta krijojmë këtë faktor.

Pas analizës së faktorëve për variabëlën e varur të politikës fiskale mund të kalojmë në testimet e nevojshme për modelin ekonometrik. Testimi i lidhjes shumëfishe midis variablave me njëri tjetrin është realizuar sërish nëpërmjet koeficientëve të korrelacionit të Spearmanit. Nga analiza e kryer rezulton se ata nga ana statistikore variablat nuk kanë lidhje të rëndësishme me njëri tjetrin. Ashtu siç duket edhe në tabelën e korrelacioni e vetmja lidhje është ajo midis FKFB dhe treguesit të hapjes së tregtisë, por kjo lidhje është e rëndësishme në nivelin 0.01 ose 1 për qind. Në përfundim të këtij testi themi se koeficientët e modelit tonë të regresionit mund ti vlerësojmë në mënyrë të besueshme.

Nga testimi i modelit na rezulton se koeficienti i thjeshtë i korrelacionit është 0.993, nivel ky i cili tregon një shkallë të lartë korrelacioni. Pra meqenëse koeficienti i korrelacionit është i lartë atëherë themi se ka korrelacion të lartë midis produktit të përgjithshëm bruto për frymë dhe tre variablave të përfshira në model. Varianca apo R^2 tregon se 98.5 për qind e variacionit total në variabëlën e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto për frymë, shpjegohet nga të gjitha variablat e pavarur të modelit, pjesa tjetër mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit.

Referuar vlerave të Sig në tabelën e ANOVA arrijmë në përfundimin se modeli i regresionit është i rëndësishëm. Vlera e Sig është 0.000, pra më e vogël se $\alpha = 0.05$ apo 5 për qind. Kjo tabelë na tregon se modeli i regresionit e parashikon nga ana statistikore produktin e përgjithshëm bruto për frymë, ose themi se në 95 nga 100 raste lidhja midis variablave ndodh sipas rezultateve të tabelës së koeficientëve.

Tabela 6: Përmbledhje e vlerave të koeficientëve dhe p-value për funksionin (5)

Variabëli	Koeficientët	P-value
-----------	--------------	---------

Konstantja	52096.107	0.000
Politika fiskale	-0.0000004993	0.039*
Formimi bruto i kapitalit fiks	0.0000013950	0.000*
Eksporti neto	0.00000001654	0.899

*të rëndësishëm në nivelin 5% të rëndësisë

***të parëndësishëm**

Korrelacioni dhe analiza e regresionit të shumëfishtë janë përdorur për të ekzaminuar lidhjen midis produktit të brendshëm bruto për frymë dhe elementëve të tjerë agregat. Në tabelën e koeficientëve shohim se politika fiskale është e lidhur negativisht me PBB, investimet private apo formimi bruto i kapitalit fiks dhe borxhi publik janë të lidhura pozitivisht. Politika fiskale dhe FBKF nga ana statistikore janë të rëndësishëm në nivelin e rëndësisë prej 5 për qind. Treguesi i hapjes ndaj tregtisë, vlera e eksportit neto, na rezulton i parëndësishëm kjo ndoshta edhe për shkak të vlerave negative të tij, meqenëse vlerat e eksportit për vendin tonë janë më të ulëta se vlerat e importit.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE

6.1 Konkluzione dhe rekomandime

Vëmendja ndaj teorive të rritjes ekonomike në dekadat e fundit ka rritur interesin e ekonomistëve për të identifikuar dhe kuptuar lidhjet midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Qeveritë duhet të miratojnë strategji ekonomike afatmesme dhe afatgjatë, politika fiskale të disiplinuar dhe të jenë të hapur ndaj tregtisë me jashtë. Politikat e qëndrueshme makroekonomike janë pjesë vendimtare e kuadrit të politikave nxitëse, ato ulin rrezikun e të bërit biznes, garantojnë një klimë përgjithësisht të parashikueshme për biznesin dhe ndikojnë në vendimet për investime. Stabiliteti makroekonomik konsiderohet si parakusht për rritjen ekonomike. Ndër qëllimet e çdo qeverie duhet të jetë edhe stabiliteti i ligjit tatimor. Përpara tyre shtrohet domosdoshmëria e gjetjes së një balance midis shërbimeve publike që ato do të ofrojnë dhe taksave që do të imponojnë. Stabiliteti legjislativ ndër të tjera mbështet klimën e duhur për të bërë biznes dhe për të tërhequr investime. Ndryshimet e vazhdueshme të bazës ligjore ndikojnë negativisht në aftësinë e investitorëve për të parashikuar fitimet e projekteve të tyre. Nëse një investitori do ti duhej që kohë pas kohe të ndryshonte praktikën apo operacionet e përditshme të aktivitetit të tij, atëherë të gjitha këto ndryshime do të përktheheshin në më shumë kosto dhe humbje kohe. Si përfundim themi se një nga karakteristikat kryesore të strukturës së taksave është stabiliteti.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik kërkon vëmendje të veçantë ndaj faktorëve të ndryshëm makro ekonomikë si inflacioni, papunësia dhe rritja ekonomike. Këta faktorë kanë ndikime të ndërsjella midis tyre, kjo e vështirëson së tepërmi mbajtjen e tyre në nivele të dëshirueshme. Politika fiskale është një prej tyre, ajo ka ndikimin e saj mbi stabilitetin makroekonomik. Nëse niveli i deficitit dhe i borxhit publik është i ulët atëherë mund të themi se ka më shumë gjasa për

një politika fiskale të qëndrueshme, kështu që politika e tatimeve dhe shpenzimeve do të jenë të parashikueshme. Nga ana tjetër deficitit fiskal dhe rritja e borxhit publik, rastet kur të ardhurat janë shumë më të ulëta se shpenzimet publike, mund të ulin rritjen ekonomike, pasi në përgjigje të taksave më të larta, të cilat mund të vendosen në të ardhmen, ulët nxitja e sektorit privat për të investuar. Nivelet e ulëta të deficitit ndikojnë pozitivisht në ekonomi në dy mënyra. Nga njëra anë ato ndalojnë absorbimin e shumave të mëdha të kursimeve nga sektori publik dhe nga ana tjetër nëpërmjet normave të ulëta të interesit inkurajojnë investimet në sektorin privat duke rritur kështu stokun e kapitalit.

Debati në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi përqendrohet më së shumti në efektin që ai ka në rritjen ekonomike. Ndryshimet e rritjes ekonomike në kohë, brenda së njëjtit shtet dhe midis shteteve të ndryshme, shpjegohen nga diferenca në produktivitetin e shteteve, apo atë të një shteti në periudha të ndryshme kohore. Këto ndryshime vijnë si pasojë e diferencave në sasitë e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara nga çdo njësi e burimit punë. Produkti i brendshëm bruto është treguesi i cili përdoret gjerësisht për të monitoruar ndryshimet ekonomike të një vendi, kjo për vetë faktin se ai konsiderohet një matës gjithë përfshirës i aktivitetit ekonomik. Kur produkti i brendshëm bruto bie dhe ekonomia e vendit është në rënie, atëherë të ardhurat personale, fitimet e biznesit, shpenzimet për konsum, shpenzimet për investime dhe shumë faktorë të tjerë të tregut shënojnë rënie. Kur PBB-ja rritet, atëherë të gjithë faktorët e sipërpërmendur rriten. Në shkencën e makroekonomisë gjenden dy tradita kryesore të mendimit ekonomik intelektual. Njëra prej tyre beson se tregjet funksionojnë më mirë në qoftë se qeveria nuk ndërhyr në to, ndërsa tjetra beson se ndërhyrja shtetërore mund të përmirësojë dukshëm veprimtarinë e ekonomisë. Në teorinë e rritjes, pas vitit 1945, gjenden tre rryma kryesore interesi. Qëllimi i teorisë së rritjes është të shpjegojë përcaktuesit e normave të rritjes në një vend dhe

arsyet për ndryshime në normat e rritjes dhe në të ardhurat për frymë midis vendeve. E përbashkëta e modeleve endogjene të rritjes ekonomike është fakti se zgjedhjet e bëra nga agjentët ekonomikë e përcaktojnë së bashku normën e rritjes. Këto zgjedhje mund të ndikohen nga politika ekonomike.

Në këtë punim duket qartë se instrumentet tatimorë bashkëveprojnë me zgjedhjet që sjellin rritjen ekonomike. Në përgjithësi rishikimi i modeleve teorike tregon efektet që politikat mund të kenë, por nuk japin ndonjë vlerësim të peshës apo rëndësisë që ato kanë. Që të merret ky vlerësim nevojitet të merren në konsideratë edhe gjetjet e kërkimeve sasiore. Përfshirja në një analizë politike bindëse pa kërkimet sasiore është pothuajse e pamundur.

Sistemi i tatimeve duhet të jetë i thjeshtë, i gjithë pranuar dhe sigurisht i përshtatshëm me kushtet ekonomike të vendit. Vendosja e lidhjeve të mundshme midis kontributeve dhe përfitimeve nga sistemi tatimor, shihet si një mundësi e mirë që bizneset dhe individët të orientohen drejt ekonomisë formale. Shqipëria deri në fillim të vitit 2014 aplikonte sistemin e tatimit të sheshtë, tatime këto që shpesh shihen si tatime të cilat nxisin zgjerimin e bazës tatimore dhe regjistrimin e bizneseve dhe individëve në sistemin tatimor. Efektet e tatimit progresiv, si pjesë e paketës fiskale të vitit 2014, mbi ekonominë në përgjithësi dhe mbi atë informale në veçanti do të mund të studiohen në periudha të ardhshme. Megjithatë aktualisht themi se lufta e Shqipërisë ndaj evazionit fiskal nuk duhet të përqendrohet vetëm në normat tatimore. Zbatimi i ligjeve dhe rregullave në fuqi sikurse edhe trajtimi jo preferencial i bizneseve, renditen si të tjera kushte dhe rrugë për uljen e informalitetit dhe evazionit fiskal. Ndërgjegjësimi i shoqërisë mbetet detyrë e autoriteteve dhe institucioneve qeveritare. Ai, ndërgjegjësimi, mund të mbulojë tema të tilla si tatimet që nuk mblidhen, mënyrat dhe rrugët me të cilat shmangen procedurat tatimore dhe doganore dhe politikat për shmangien e hapësirave të krijuara. Ekonomia informale është një

fenomen me shtrirje të gjerë, prandaj çdo pjesë apo element i saj duhet punuar veçmas. Në luftën kundër saj mund të përfshihen të gjitha palët e interesit, ndër të cilat edhe vetë biznesi i regjistruar. Duhet gjithashtu të theksojmë se lufta kundër korrupsionit është një pjesë shumë e rëndësishme e luftës kundër evazionit fiskal dhe ekonomisë informale. Kjo luftë duhet kuptuar si forcim dhe konsolidim i strukturave dhe institucioneve shtetërore dhe i administratës publike.

Diskutimi mbi tatimet gjithnjë nxjerr në pah një numër të konsiderueshëm tiparësh, të cilat nuk mund të argumentohen vetëm mbi baza efëcence apo barazie. Ka disa arsye se pse është i vështirë përmirësimi i sistemit tatimor. Në shumë raste edhe ekspertët e fushës nuk bien dakord në lidhje me drejtimin që një reformë duhet të marrë. Proçesi politik i nevojshëm për çdo reformë, mund të çojë në modele të ardhurash apo shpenzimesh të cilat nga ana e shoqërisë konsiderohen si jo efëcentë dhe jo optimale. Megjithatë këto kundërshtime nuk janë të vetmet pengesa. Shpesh individët e një shoqërie e ndryshojnë sjelljen e tyre sa herë që paraqitet një ndryshim fiskal. Drejtësia horizontale tatimore thekson se është e padrejtë që të ndryshohen dispozitat të cilat kanë bërë që njerëzit të marrin vendime, përmbysja e të cilave për ta përkthehet në kosto shtesë.

Sistemi tatimor varet nga shumë faktorë dhe ai vetë ndryshon nga një vend në një tjetër. Ajo çfarë gjerësisht rekomandohet është një sistem tatimor i cili siguron rritje ekonomike dhe minimizon efektet deformuese të tatimeve. Sistemet tatimore në Evropë, pas krizës financiare të 2008, reflektojnë dy ndryshime kryesore. Në afatin e shkurtër kohor, shtete të ndryshme evropiane u përpoqën që nëpërmjet uljes së normave tatimore të stimulonin rritjen e kërkesës, duke synuar kështu të ndikonin mbi ekonominë reale. Ky ishte ndryshimi i parë, ndërsa ndryshimi i dytë lidhet me konsolidimin e bilancit të tyre. Sistemi tatimor i orientuar nga rritja ekonomike, nga njëra anë ofron mundësi për të siguruar më shumë të ardhura publike dhe nga

ana tjetër minimizon efektet deformuese të tatimeve mbi faktorët e rritjes. Reformat tatimore duhet të ndërtohen pikërisht mbi këto baza. Në shumë vende të Evropës u rrit tatimi mbi konsumin dhe barra tatimore mbi kapitalin, ndërsa tatimi mbi fitimin e kompanive vazhdon ende të ulët. Institucionet ndërkombëtare shprehen gjithashtu se tatimi mbi kapitalin dhe qarkullimin duket sikur janë në drejtim e duhur, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për tatimin mbi punën. Strategjia e BE për vitin 2020 rekomandon që reformat për konsolidimin e buxhetit të ecin paralelisht me reformat fiskale për të siguruar në këtë mënyrë sisteme tatimore të cilat sjellin rritje ekonomike. Rritja ekonomike për pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor parashikohet të jetë pozitive, por sërish në nivele të ulëta. Pjesa më e madhe e të ardhurave tatimore në këto vende mblidhen nga taksat indirekte dhe më saktësisht nga tatimi mbi vlerën e shtuar, i cili zë edhe peshën kryesore në pjesën e të ardhurave tatimore në raport me produktin e brendshëm bruto. Bosnjë Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi janë tre shtetet të cilat aplikojnë normën më të ulët të TVSH-së, këto shtete aplikojnë gjithashtu tatimin e sheshtë, i cili konsiderohet si më transparent dhe më lehtësisht i zbatueshëm. Me përjashtimet dhe referencat në fushën e tatimeve Shqipëria më së shumti nxit bizneset e vogla, Bosnja dhe Hercegovina me tatimin e saj mbi të ardhurat e kompanive, qartazi duket se nxit importet dhe eksportet. Nga ana tjetër Kroacia nxit investimet dhe punësimin ndërsa Maqedonia stimulon më shumë investimet në zonat e tregtisë së lirë. Mali i zi dhe Serbia me anë të përjashtimeve dhe lehtësirave tatimore që aplikojnë, nxisin investimet në sektorët më pak të zhvilluar. Serbia, Kroacia, Shqipëria dhe Mali i Zi janë shtetet të cilat përgjatë tre viteve të fundit kanë thithur pjesën më të madhe të investimeve të huaja. Të gjitha shtetet e këtij rajoni pa diskutim që kanë nevojë për rritje ekonomike më të lartë, por më e rëndësishme për to konsiderohet rritja e qëndrueshme. Komisioni Evropian në raportin e vitit 2013 thekson se pothuajse të gjitha shtetet e këtij rajoni

kanë nënshkruar dhe rënë dakord të zbatojnë procedura dhe dekrete ndërkombëtare në sferën e politikave ekonomike dhe fiskale, por implementimi i tyre është pjesor. Konsolidimi dhe zbatimi i politikave fiskale në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, mbetet detyrë e qeverive të këtij rajoni. Kalimi i këtyre vendeve nga një sistem tatimor në një tjetër, nuk lidhet me objektiva afatgjata të ekonomisë dhe mirëqenies sociale, por me objektiva afatshkurtër për të pasur më shumë të ardhura në buxhet. Ndryshimet e politikave fiskale nuk mund të mbeten pre as e premtimeve elektorale, por ato duhet të mbështeten në studime të mirëfillta empirike dhe në eksperiencat e vendeve me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Në vendet me ekonomi të hapur, sistemi kombëtar i tatimeve duhet të marrë në konsideratë sistemet tatimore të shteteve të tjera, meqenëse shtete të ndryshme gjithnjë e më shumë po e përdorin sistemin e tyre tatimor për të përmirësuar aftësitë e tyre për të konkurruar në tregun global. Globalizimi mund gjithashtu të rrisë mundësitë për shmangie dhe evazion fiskal, veçanërisht prej ndryshueshmërisë së bazës tatimore të të ardhurave kapitale. Kjo është edhe një prej arsyeve se pse ndryshueshmëria e bazës tatimore duhet të jetë pjesë e reformave tatimore kombëtare të ndërmarra në kuadër të ndërtimit të sistemeve tatimore. Bashkëpunimet ndërkombëtare janë më se të domosdoshme, pasi nëpërmjet tyre do të zvogëlohen hapësirat dhe mundësit për abuzime me rregullat tatimore.

Përgjatë dy dekadave të fundit në vendin tonë janë ndërmarrë një sërë reformash fiskale. Megjithatë pavarësisht reformave fiskale dhe përmirësimeve të bëra gjendja e financave publike në Shqipëri është ende shqetësuese. Borxhi publik është në nivele të larta, të ardhurat nuk arrijnë nivelet e planifikuara, politika e shpenzimeve ka gjithashtu problemet e saj. Rënia e të ardhurave tatimore si pasojë e efektit të ngadalësimit të rritjes ekonomike tregon se ka një lidhje të ngushtë midis rritjes ekonomike dhe mbledhjes së të ardhurave dhe nxjerr në pah faktin se faktorët e tjerë si

administrimi, korrupsioni, evazoni, nuk kanë ndryshuar dukshëm. Këto dhe probleme të tjera të kësaj natyre, të para nga këndvështrimi i politikave fiskale, përbëjnë çështje thelbësore për mbarëvajtjen në tërësi të jetës ekonomike të vendit si dhe në zgjidhjen e mjaft problemeve të aspektit social kudo në botë.

Struktura e sistemeve tatimore mund të përshkruhet në mënyra të ndryshme, një prej të cilave është edhe kategorizimi i tatimeve. Ai na ndihmon ti shohim tatimet në kontekstin e tyre teorik. Tatimet indirekte të njohura edhe si tatimet mbi konsumin përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, taksa dhe tarifa mbi mallrat e importit dhe akcizën. Mbështetur në literaturën e financave publike themi se efektet më të padëshirueshme të kësaj kategorie tatimesh janë efektet negative të T.V.SH-së mbi vendimet për konsum të të gjithë pjesëmarrësve në treg. Literatura sugjeron disa metoda sipas të cilave mund të ulen këto efekte negative si për shembull normë më e lartë për një grup produktesh. Akciza, nga ana tjetër, vendoset me qëllim ndikimin mbi sjelljen e agjentëve ekonomikë. Rregulli i elasticitetit të kundërt varet nga elasticiteti i çmimit të produkteve dhe shërbimeve dhe sipas tij sugjerohen tatime të larta për produktet me çmime më pak elastike. Vendosja e çmimeve të larta, kur elasticiteti i çmimit është i ulët, nuk do ta ulte ndjeshëm kërkesën. Pra këto produkte konsumohen pavarësisht çmimit të tyre. Kështu që vendosja e tatimit mbi këto produkte nuk do ta ndryshonte ndjeshëm sjelljen e konsumatorëve. E kundërta ndodh me tatimin mbi produktet me çmime vërtetë elastike, tatim ky i cili duhet të jetë i ulët në mënyrë që të kemi një sistem tatimor eficient meqenëse ato, tatimet, mund ta ndryshojnë sjelljen e konsumatorëve. Teori dhe studime të tjera mbështesin diferencimin tatimor, pra janë pro vendosjes së tatimeve mbi mallrat e luksit për ti bërë ato jo atraktive. Nga rezultatet e këtij punimi arritëm në përfundimin se kjo ndarje e të ardhurave tatimore nuk ndikon drejtpërdrejt mbi rritjen ekonomike. Nga ana statistikore ky faktor na rezultoi i parëndësishëm. Mbështetur edhe

në literaturën e hulumtuar themi se tatimet indirekte ndikojnë mbi faktorë të ndryshëm agregat. Studimi i tyre në ekonominë e vendit tonë krijon hapësira për studime të tjera.

Tatimi i mjedisit, në këto kohë kur në debatet publike flitet kaq shumë për ngrohjen globale, po bëhet gjithnjë e më shumë i rëndësishëm. Teoria thekson se përveç efekteve të tjera tatimi i mjedisit ka edhe një anë tjetër, atë të uljes së të ardhurave. Tatimi mjedisor është një tatim sasior, për çdo njësi dëm mbi faktorët e prodhimit paguhet një sasi fikse parash. Meqenëse këto sasi parash nuk janë të indeksuara me inflacionin, atëherë pritet që me kalimin e kohës të ardhurat nga tatimi mjedisor të ulen. Të ardhurat nga ky lloj tatimi priten të ulen si pasojë e implementimit të metodave të reja të prodhimit dhe tendencës për të qenë më miqësor me mjedisin. Teoria gjithashtu sugjeron se, meqenëse tatimi mjedisor nxit zhvillimi e teknologjisë, në fund ai konsiderohet pozitiv.

Ky punim, bazuar në një model regresioni të shumëfishtë, analizoi efektet e politikës fiskale, nëpërmjet efekteve të të ardhurave tatimore në Shqipëri në rritjen ekonomike. Qëllimi ynë nuk është zgjidhja përfundimtare e debatit të nxehtë lidhur me ndikimin e politikës fiskale mbi rritjen ekonomike, por analizimi i rastit të një vendi të vogël me ekonomi të hapur dhe në zhvillim, siç është Shqipëria. Nga analiza e realizuar arritëm të gjenim se taksa e sheshtë në krahasim me taksa të tjera e zvogëlon më pak PBB-në. Efekti i të dyja llojeve të taksave është negativ, por taksa e sheshtë ka ndikim më të ulët se sa një tjetër lloj takse. Më konkretisht PBB-ja zvogëlohet me 5.4 milion lekë nëse aplikojmë taksën e sheshtë dhe ajo zvogëlohet me afro 6 milion lekë nëse aplikojmë lloje të tjera taksash. Tatimi i thjeshtuar ndihmon në sheshimin e fushës së lojës midis kompanive, inkurajon pagimin e vullnetshëm të taksave, ndihmon kompanitë të parashikojnë më mirë kostot dhe të bëjnë projeksione më të sakta financiare, si dhe e bën më të lehtë mbledhjen e taksave. Në përgjithësi një sistem i drejtë, i thjeshtë, me norma ulëta tatimore

dhe që nuk diskriminon kompanitë është baza më e mirë për zhvillimin e sipërmarrjeve dhe për tërheqjen e investimeve. Thjeshtimi i tatimit realizohet duke eliminuar tatimin progresiv dhe adoptuar një taksë të sheshtë, domethënë një nivel të vetëm për taksat mbi fitimin dhe të ardhurat.

Lidhur me elementët e tjerë fiskalë, rezultatet e arritura tregojnë se produkti i përgjithshëm bruto ndikohet negativisht nga rritja e të ardhurave tatimore direkte, kjo është edhe ajo çfarë nënvizon teoria. Referuar modelit përfundimtar të ndikimit të të ardhurave direkte mbi produktin e përgjithshëm bruto arritëm në përfundimin se për çdo ndryshim me 1 për qind në të ardhurat nga tatimet direkte produkti i përgjithshëm bruto zvogëlohet me 1.944 milion lekë.

Me anë të një modeli tjetër regresi arritëm të gjenim se brenda klasës së tatimeve direkte efektin më të madh negativ e ka tatimi mbi pasurinë, por nga ana statistikore më i rëndësishëm është tatimi mbi fitimin. Nëse të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e kompanive rriten me 1 për qind atëherë pritet që PBB-ja ulet me 4.279 milion lekë. Përfundimisht themi se tatimet direkte apo më saktë rritja e tyre ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike. Në mbështetje të këtij përfundimi ndërtuam edhe një tjetër model ekonometrik. Nëpërmjet tij analizuan ndikimin e tre faktorëve fiskal mbi produktin e përgjithshëm bruto. Modeli rezulton i qëndrueshëm dhe i rëndësishëm. Elementët fiskal të përfshira në të, të ardhurat nga tatimet direkte, shpenzimet qeveritare dhe borxhi publik, shpjegojnë afro 45.9 për qind të ndryshimeve në produktin e përgjithshëm bruto. Ky punim përmbyllet me studimin e një tjetër modeli i cili e vendos politikën fiskale përkrah faktorëve të tjerë agregat si investimet private dhe eksporti neto. Nga testimi i modelit na rezultoi se koeficienti i thjeshtë i korrelacionit është 0.993, nivel ky i cili tregon një shkallë të lartë korrelacioni. Faktorët agregat të përfshirë në model, formimi bruto i kapitalit fiks dhe politika fiskale, faktorë të cilët rezultuan të rëndësishëm nga ana statistikore,

shpjegojnë afro 98.5 për qind e variacionit total në variabëlin e varur, pra në produktin e përgjithshëm bruto për frymë. Sipas përfundimeve të tij një pjesë shumë e vogël e ndryshimeve në PBB-në për frymë mbetet e pashpjeguar ose shpjegohet nga burime të tjera të variacionit. Treguesi i hapjes ndaj tregtisë, vlera e eksportit neto, na rezultoi i parëndësishëm kjo ndoshta edhe për shkak të vlerave negative të tij, meqenëse vlerat e eksportit për vendin tonë janë më të ulëta se vlerat e importit.

Nëpërmjet këtij punimi jemi munduar të tregojmë se politika fiskale luan një rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Askush nuk mund të presë që politika e duhur fiskale të na ofrohet e gatshme, por sugjerimet dhe eksperiencat e vendeve të tjera duhet të përshtaten me kushtet specifike të cilat tregojnë gjendjen reale ekonomike dhe sociale të vendit. Ajo duhet të ndërtohet duke u mbështetur në konsultime me institucione ndërkombëtare dhe studime empirike, studime këto të cilat kërkojnë krijimin dhe mbështetje nga një klasë ekonomistësh profesionistë. Shqipërisë i nevojitet ta orientojë politikën e saj fiskale drejt rritjes ekonomike. Qeveria duhet të ndjekë qasje afatgjata për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për hir të përfitimeve afatshkurtra nuk duhet t'i kthejë shpinën së ardhmes.

Ndryshimi i politikës fiskale kërkon paraprakisht vlerësimin e një numri të madh faktorësh, përfshirë këtu edhe ecurinë e faktorëve dhe indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar. Politika fiskale në funksion të sistemit tatimor të një vendi duhet që mbi të gjitha, të garantojë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, të konsolidojë të ardhurat fiskale në funksion të realizimit të shpenzimeve në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit, të kontribuojë në reduktimin e mëtejshëm të evazionit fiskal dhe kontrabandës dhe të krijojë një klimë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm të biznesit vendas dhe të huaj. Arritja e objektivave të politikës fiskale ndër të tjera kërkon bashkërenditje të instrumenteve fiskale për të ndikuar në

përbërjen dhe nivelin e kërkesës agregate, analiza makroekonomike për ecurinë dhe prirjet e indikatorëve kryesorë ekonomikë dhe koordinim të politikave makro ekonomike.

6.2 Hapësira për kërkime të tjera

Gjykoj se do ishte me interes nëse analizës së të ardhurave tatimore në Shqipëri do ti shtoheshin edhe të dhëna nga vende të tjera, si për shembull vendet e Ballkanit Perëndimor, duke formuar kështu një bazë më të gjerë me të dhëna dhe studime të mëtejshme. Duke menduar rreth karakteristikave të përbashkëta të këtyre vendeve do të mund të përforcohej vlerësimi për ndikimin e të ardhurave tatimore apo edhe elementëve të tjerë të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike.

Në termat e rritjes ekonomike debati mbi ndikimin e strukturës së tatimeve ka marrë rëndësi të veçantë. Baza e përshtatshme tatimore e tatimin mbi fitimin dhe diskutimet mbi të, konsiderohen si çështje primare për një shtet dhe sigurisht po kaq primare për studime të ardhshme.

Në analizën e bërë rezultoi se taksa e sheshtë e dëmton më pak rritjen ekonomike. Taksa e sheshtë është në thelb një taksë e vetme e përbashkët për të ardhurat e kompanive dhe personale, me idenë që thjeshtësia e sistemit ia bën qeverisë më të lehtë që të mbyllë shtigjet dhe të ndjekë penalisht ata që i shmangen tatimeve, duke rritur motivimin e tyre që të prodhojnë ose të fitojnë më tepër. Ndikimet dhe efektet e taksës së sheshtë mbi ekonominë informate, apo edhe mbi ekonominë në tërësi mund të konsiderohen një tjetër mundësi për kërkime shkencore.

Ky punim arriti të tregojë se studimet e ndikimit të shpenzimet publike mbi rritjen ekonomike paraqesin interes për studime të tjera. Si do të ndikonte rritja e qëndrueshme e shpenzimeve publike mbi rritjen afatgjatë ekonomike? Niveli i shpenzimeve dhe kategoritë e tyre vlerësohen të jenë një fushë që ofron sfida për të ardhmen dhe sigurisht edhe mundësi për studime të tjera.

Ashtu siç është shpjeguar edhe pak më lart tatimi mjedisor, si për shembull detyrime të vendosura mbi aktivitete të cilat dëmtojnë mjedisin si energjia, transporti dhe burimet ndotëse të mjedisit, ka për qëllim të influencojë konsumatorët dhe prodhuesit nëpërmjet nxitësve në formë çmimi dhe ti drejtojë ata drejt sjelljes së dëshiruar, që në këtë rast është dëmtimi i ulët i mjedisit. Si ndikon ky tatim në sjelljen e aktivitetit privat?

Evazioni fiskal nuk rezulton të jetë më një fenomen i përkohshëm, por për ato vende të cilat nuk arrijnë të shpërndajnë në mënyrë efikente kapitalet dhe të ardhurat e tyre ai konsiderohet një fenomen i pashmangshëm. Nëse politikat dhe strategjitë e një shteti, të ndërmarra në kuadër të rritjes ekonomike, nuk sjellin ulje të nivelit të papunësisë, shpërndarje efikente të të ardhurave atëherë nuk do të kemi ulje të nivelit të informalitetit. Ekonomia informale është një temë e nxehtë për realitetin shqiptar dhe një mundësi për studime të tjera. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë në ekonominë informale dhe secili prej tyre ka një peshë specifike, por ai që prek më shumë dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ekonominë informale është evazioni fiskal. Në Shqipëri mungojnë studime empirike për efektet e tij, qoftë këto edhe mbi nivelin e të ardhurave tatimore.

Studime të tjera mjaft interesante do të mund të zhvilloheshin në nivel mikroekonomik. Kështu mund të studiohet lidhja e zërave të ndryshëm tatimorë, për shembull akcizës me çmimet e produkteve, sjelljen e konsumatorëve apo edhe me vendimet e tyre. A do të konsumohen po njësoj këto produkte pavarësisht çmimit të tyre?

Sjellja e aktorëve të tregut dhe ndikimi i vendimeve të tyre nga tatimi mbi pasurinë përbëjnë një tjetër mundësi për kërkime të tjera. Tatimi mbi pasurinë, brenda grupit të tatimeve direkte, në analizën tonë rezultoi me ndikimin më të lartë krahasuar me ndarjet e tjera të tatimeve brenda të

njëtit grup, studimi i modeleve dhe ndikimeve të tij, për vendin tonë, mund të përbëjë një fushë interesante studimi.

BIBLIOGRAFIA

Acemoglu, D. (2008). *Introduction to Modern Economic Growth*; Massachusett. USA: Massachusetts University Press.

Alves, J. (2014). *The role of government debt on economic growth*. Lisboa: Lisboa School of Economics and management.

Arrow, K. J. (1962). The Economic Implication of Learning by Doing. *The Review of Economic Studies* 29:3, 155-173.

Assaf Razin and Sadka Efraim. (1991). Efficient investment in the presence of capital flight. *Journal of International economies Vol 31 Issues 1-2*, 171-181.

Atkinson A. & Stiglitz J. (1980). *Lectures on Public Economics*. New York, USA: McGraw-Hill.

Baranova, V. & Janickova, L. (2012). “Taxation of corporations and their impact on economic growth: The case of Eu countries”, *Journal of competitiveness, Vol. 4*, f. 96-108.

Barro, R. (1990). “Government spending in a simple model of endogenous growth”. *Journal of political economy, Vol.98*, f.103-125.

Baumol J.W & Blinder S.A. (2009). *Macroeconomics, principles, and policy*; New York, USA: South-Western Cengage Learning.

Boadway R., E. Chamberlain and C. Emmerson. (2009). Taxation of Wealth and Wealth Transfers in The Mirrlees Review: Dimensions of Tax Design, S. Adam, T. Besley and R. Blundell. *Oxford University Press*.

Brian Snowden and Howard R Vane. (2005). *Modern Macroeconomics. Its origins, development and current status*. Lincolnshire UK: Edward Elgar Inc.

Bruce, N. & Turnovsky, S. (1999). "Budget balance, welfare and the growth rate". *Journal of money, credit, and banking*, Vol. 31, f.162-186.

Buchholz, T. G. (2007). *Ide të gjalla nga ekonomistë të vdekur*. Tiranë: ISP & DITA 2000.

Buettner, T. (2007). "Tax incentives and the location of FDI: Evidence from a panel of german multinationals". *International tax and public finance*, Vol. 4, f. 151-164.

Cass, D. (1965). Optimum Growth in an Aggregative Model of Capital Accumulation. *The Review of Economic Studies* 32:3, 233-240.

Chen, B. (2007). "Factor taxation and labor supply in a dynamic one-sector growth model". *Journal of economic dynamic and control*, Vol. 31, f.3941-3964.

Cheryl Gray, Tracey Lane and Aristomene Varoudakis. (2007). *FISCAL POLICY AND ECONOMIC GROWTH. Lessons for Eastern Europe and Central Asia*. Washington, DC: The World Bank.

Civici, A. (2013). *Shteti apo Tregu. Cilin model zhvilimi të ndjekim?* Tiranë: UETPRESS.

Corlett W.J. and D. C. Hague. (1953). Complementarity and the Excess Burden of Taxation. *Review of Economic Studies* 21, 21-30.

Crawford I, M. Keen, and S. Smith. (2009). Value added tax and excises in The Mirrlees Review: Dimensions of Tax Design. . *The Mirrlees Review: Dimensions of Tax Design*, 275.

Cremer H. and P. Pestieau. (2003). Wealth Transfer Taxation: A Survey. *CESifo Group Munich*, 1061.

D.Myles, G. (2009). Economic Growth and the Role of Taxation-Theory. *OECD*, 48.

Davidsson, M. (2011). "Growth, taxation and public finance". *Interdisciplinary review of economics and management, Vol.1 (2)*, f.52-58.

Davidsson, M. (2012). "Optimal Growth Taxation". *Research in the world economy, Vol. 3*, f.35-44.

De Mooij, R.A. & S. Ederveen. (2005). Explaining the Variation in Empirical Estimates of Tax Elasticities of Foreign Direct Investment. *Tinbergen Institute Discussion Paper 108*, 150-182.

Demaris, A. (2004). *Regression with social data. Modeling continuous and limited response variables*. Ohio, USA: John Wiley & Sons, Inc.

Devereux, M.P.& Griffith, R. (2003). "The impact of corporate taxation on the location of capital". *Economic analysis and policy, Vol. 33*, f.375-292.

Devruux, M. B & Love, D. R. (1995). The Dynamic Effects of Government Spending Policies. *Journal of Money, Credit and Banking*, 232-256.

Dornbusch R.& Dragi M. (1990). *Public Debt management; theory and history*; Cambridge, Englan: Cambridge University Press.

Engen M. E. & Skinner, J. (1992). "Fiscal policy and economic growth". *NBER working paper series, working paper no.4223*, f.1-44.

Gärtner, M. (2006). *Macroeconomics*. Edinburgh, England: Prentice Hall.

- Gordon, R. H. (1985). Taxation of investment and saving in a world economy. *American Economic Review* 76, 1086-1102.
- Gujarati, D. N. (2001). *Basic Econometrics*. Boston: Mc Grow-Hill.
- Harrod, R. (1939). 'An essay in dynamic theory'. *Economic Journal*, 14–33.
- Harvey S Rosen, Gayer T. (2008). *Public Finance*. New York, USA: Mc Graw Hill.
- Howard, M. (2001). *Public Sector Economics for Developing Country*. Canada: GreenWood.
- Hurd, M. (1990). "Research on the Elderly: Economic Status, Retirement, and Consumption and Savings.". *Journal of Economic Literature* 28, 565-637.
- Itaya, J. (2008). "Can environmental taxation stimulate growth". *Journal of economic dynamics and control*, Vol. 32, f.1156-1180.
- James A. Richardson and W. Bartley Hildreth. (1999). *Handbook on Taxation*. Basel: Marcel Dekker Inc.
- Kedem, B. & Fokianos, K. (2002). *Regression models for time series analysis*. New Jersey, USA: John Wiley & Sons, Inc.
- Keynes, J. M. (1936). *The General Theory of Employment, Interest and Money*. London.
- Keynes, J. M. (1936). Ideas in Politics: Questions and Issues. J. M. Keynes, *Fiscal Politics* (f. 14). Vancouver: UBC Press.
- Keynes, J. M. (1936). *The General Theory of Employment, Interest and Money*. London.

- King, R.E. & Rebelo, S. (1990). "Public policy and economic growth: developing neoclassical implications". *Jornal of political economy*. Vol.95, f.126-151.
- Kleven H.J., W.F. Richter and P.B. Sørensen. (2000). Optimal taxation with household production. *Oxford Economic Papers* 52, 584–594.
- Kleven, H. (2004). Optimum Taxation and the Allocation of Time. *Journal of Public Economics*, 545-557.
- Koester B.Reinhard & Roger C.Kormendi. (1988). Taxation Aggregate Activity and Economic Growth; Cross Country Evidence on Some-Side Hypotheses". *Economic Inquiry*.
- Laurence, S. (2008). *Public Finance*. New York, USA: McGraw Hil.
- Lee, Y. & Gordo, R.H. (2005). "Tax structures and economic growth". *Journal of public economics*, Vol.89, f.1027-1043.
- Lucas. (1988). On the Mechanisms of Economic Development. *Journal of Monetary Economics*, 22, 3-42.
- Mançellari, A. (2010). *Efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri*. Tiranë: Banka e Shqipërisë.
- Mankin, N.G., & Biederman, D.K. (2003). *Principles of microeconomics*. NewYork: Thomson Learning EMEA, Limited.
- Manteli. (2013). *Sistemi Tatimor në Shqipëri*. Tiranë: Banka e Shqipërisë.
- Mauro, P. (1995). "Corruption and Growth". *The Quarterly Journal of Economics*, Vol. 110, f.25-34.

- Mirdala, R. (2013). "Fiscal imbalances and current account adjustments in the European transition economies". *William Davidson Institute, Working paper no 1065*, f.1-33.
- Misale, A. (1999). *Public debt management*. Oxford: Oxford university press.
- Mishkin. (2010). *The economics of money, banking and financial markets*. Boston, USA: Pearson.
- Mishkin, F. S. (2012). *MACROECONOMICS: policy and practice*. Boston: PEARSON.
- Mooij, R. A. & Ederveen, S. (2003). "Taxation and direct foreign investment: A synthesis of empirical research". *International tax and public finance, Vol.10*, f.337-358.
- Nicodème, G. (2007). Does Large Companies Have lowered Effective Corporate Tax Rates? A European Survey. *Centre Emile Bernheim*, 07-001.
- Orme, G.J. & Orme, C.T. (2009). *Multiple regression with discrete dependent variables*. New York, USA: Oxford University press.
- Oudheusden, P. (2010). "Fiscal policy reforms and dynamic Laffer effects". *Center and department of economics, Tilburg University*, f.1-26.
- Parry, I. W.H. and W. E. Oates. (1998). Policy Analysis in a Second-Best World. *Resources for the Future, Washington, DC*, 48.
- Prammer, D. (2011). *QUALITY OF TAXATION AND THE CRISIS: TAX SHIFTS FROM A GROWTH PERSPECTIVE*. Luxembourg: European Union.
- Ramsey. (1927). A Contribution to the Theory of Taxation. *The economic Journal*, 47-61.

Ramsey, f. (1928). A mathematical Theory of saving. *Economic journal* 38(152), 543-559.

Rebelo, S. (1991). Long-run Analysis and Long-run Growth. *The Journal of Political Economy*, 99:3, 500-521.

Robert J.Barro and Xavier Sala-iMartin. (1999). *Economic growth*. New York: The MIT Press.

Romer, P. (1986). Long-run Policy and Long-run Growth. *The journal of Political Economy* 99:3, 1002-1037.

Rosen, H. S. (2002). *Public Finance*. New York: Mc Graw Hill.

Rudiger Dornbusch; Stanley Fischer. (2000). *Makro Ekonomia. Botim ndërkombëtar*. Tiranë: Dituria.

Samuelson, P. A. (1954, November). The Pure Theory of Public Expenditure. *The Review of Economics and Statistics*, Vol. 36, No. 4. , f. 387-389.

Sheshinski, E. (1967). *Optimal Accumulation with Learning by Doing*. In: *Essays on the Theory Optimal Economic Growth*. Cambridge: MIT Press.

Snowdon B. & Howard R.V. (2005). *Modern Macroeconomics. Its origins, development and current status*. Lincolnshire UK: Edward Elgar Inc.

Smith, A. (1977). *The Wealth of Nations*. London: J M Dent and Sons.

Solow, M. (1956). A Contribution to the theory of Economic Growth. . *Quarterly Journal of Economics*, Vol 70, 65-94.

Stiglitz, J. E. (1999). "Toward a General Theory of Wage and Price Rigidities and Economic Fluctuations. *American Economic Review*, 89(2), 75–80.

Stiglitz, J. E. (2002). New Perspectives on Public Finance: recent achievements and future challenges. *Journal of public Economics*, NY, 125-137.

Swan, W. (1956). Economic growth and Capital Accumulation. *Economic Record*, Vol 32, 334-361.

Szostak, R. (2009). *The Causes of Economic Growth. Interdisciplinary Perspectives*. Berlin: Springer.

Tiebout, C. M. (1956, October). A Pure Theory of Local Expenditures. *The Journal of Political Economy*, Vol. 64, No. 5, f. 416-424.

Union, E. (2013). *2013 Economic and Fiscal Programmes of Albania and Bosnia and Hercegovina*. Belgium: European Union.

Wildasin, D. (1995). "Factor mobility, risk, and redistribution in the welfare state". *Scandinavian Journal of economics*, Vol. 7, f. 5247-546.

Komisioni European (2013), *Study on the vulnerability and resilience factors of tax revenues in developing countries*, Brussels, Nëntor 2013, FED (2013) 306594/2.

Marrë nga: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/nov/final_reports_en.pdf (parë më 13 shkurt 2014).

Banka Botërore (2012), *The challenges to long run fiscal sustainability in Romania*, Brussels, Janar 2012, WPS (2012) 5927.

Marrë nga: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/nov/final_reports_en.pdf
(parë më 27 Gusht 2014).

Group of Thirty (2012), *Policies for Stabilization and growth in small very open economies*, Washington, D. C. 2012, OP (2012) 85.

Marrë nga: <http://ssrn.com/abstract=2182324> (parë më 21 shkurt 2014).

CESinfo (2013), *Successful fiscal adjustments. Does choice of fiscal instrument matter?*, Norvegji, Tetor 2013, WP (2013) 4456.

Marrë nga: <http://ssrn.com/abstract=2353306> (parë më 21 shkurt 2014).

Banka Botërore (2012) Evropa juglindore: Raporti i zhvillimeve ekonomike

Nr.3 *Nga Recesioni i Dyfishtë në Reforma të Përsheptuara*, 18 dhjetor 2012, (PDA 74593)

Marrë nga <http://worldbank.org/eca/seerer/pda74593> (parë më 20 mars 2014)

SHTOJCA

Tabela 7: Normat e tatimeve mbi të ardhurat personale për vendet e Ballkanit Perëndimor


	Maqedoni	B&H	Shqipëri	Serbi	Kroaci	Mal i Zi
<i>Norma e tatimit</i> ³¹	10%	10%	Të ardhurat deri në 30000 Lekë përjashtohen, 30000-130000 Lekë tatohen me 13% për të ardhurat mbi 30000, të ardhurat prej 130001 dhe mbi këtë shumë tatohen me 13000 Lekë plus 23% të shumës mbi 130000 Lekë.	10%	12% deri në 40 % në varësi të të ardhurave bruto.	Tatim progresiv 9% dhe 15%. Paga bruto prej 720 EUR tatohet me normën 9%, mbi këtë shumë tatimi është 5%.
<i>Tatimi mbi fitimin kapital</i> ³²	10% deri në 70% në varësi të vlerës së fitimit kapital	Nuk ka tatime mbi fitimi kapital	10%	10 % për bizneset, 15% dhe 20% për trashëgiminë.	Nga 25% deri në 40% në varësi të natyrës së transaksionit.	9%

Burimi: Doing Business 2014


³¹ Në këtë rast të ardhurat e tatueshme përfshijnë të ardhurat nga paga, puna dhe forma të tjera të kompensimit të punës.

³² Fitimi kapital rezulton nga shitja e mjeteve të qëndrueshme, pjesa e kapitalit në një kompani, të ardhurat nga e drejta e autorit dhe trashëgimia si dhe interesa nga depozitat dhe llogaritë bankare.


Grafiku 1: Testi i stacionaritetit për produktin e përgjithshëm bruto për Shqipërinë




Grafiku 2: Testi i stacionaritetit për tatimet direkte



Grafiku 3: Testi i stacionaritetit për të ardhura të tjera



Grafiku 28: Testi i stacionaritetit për tatimet indirekte



Grafiku 29: Testi i stacionaritetit për llojin e taksës




Tabela 8: Korrelacioni i shumëfishtë i variablave (multikolineariteti).

Variablat	Korrelacioni	Lidhja (+ ose -)
PBB - TD	+ 0.42	Pozitive
PBB - TI	+ 0.101	Pozitive
PBB - Të tjera	+ 0.077	Pozitive
PBB - Lloji i taksës	- 0.022	Negative
TD - TI	+ 0.377	Pozitive
TD – Të tjera	+ 0.225	Pozitive
TD - Lloji i taksës	+ 0.091	Pozitive
TI – Të tjera	+ 0.197	Pozitive
TI – Lloji i taksës	- 0.027	Negative
Të tjera – Lloji i taksës	+ 0.075	Pozitive

Tabela 9: Multikolineariteti për variablat e funksionit (1)

		Correlations				
		DIFF(PBB,1)	DIFF(TD%,1)	DIFF(TI%,1)	DIFF(Etj%,1)	DIFF(llojtax,1)
DIFF(PBB,1)	Pearson Correlation	1	-.079	-.119	-.023	-.268
	Sig. (2-tailed)		.735	.608	.920	.253
	N	21	21	21	21	20
DIFF(TD%,1)	Pearson Correlation	-.079	1	.414	.111	.091
	Sig. (2-tailed)	.735		.062	.630	.702
	N	21	21	21	21	20
DIFF(TI%,1)	Pearson Correlation	-.119	.414	1	.066	-.027
	Sig. (2-tailed)	.608	.062		.776	.909
	N	21	21	21	21	20
DIFF(Etj%,1)	Pearson Correlation	-.023	.111	.066	1	.075
	Sig. (2-tailed)	.920	.630	.776		.752
	N	21	21	21	21	20
DIFF(llojtax,1)	Pearson Correlation	-.268	.091	-.027	.075	1
	Sig. (2-tailed)	.253	.702	.909	.752	
	N	20	20	20	20	20

Tabela 10: Testimi i formës funksionale për modelin (1)

Variabli i pavarur	Flllog	Fkr	P-value	Forma e lidhjes
TD	4.120	4.38 ³³ dhe 8.18 ³⁴ (1,19) ³⁵	0.054*	Lineare ³⁶ dhe jo lineare ³⁷
TI	0.113	4.38	0.741*	Lineare
Të tjera	0.526	4.38	0.477*	Lineare
Lloji i taksës	0.009	4.41 (1. 18)	0.926*	Lineare

*i rëndësishëm në 5 %

*të parëndësishëm statistikisht

Tabela 11: Impakti dhe rëndësia e çdo variabëli të funksionit (1) mbi PBB-në

Variabëli	bo	b1	p-value	DW	R	R ²
TI	5.161	0.306	0.741	2.131	0.077	0.006
Të tjera	5.24	0.577	0.477	2.164	0.164	0.027
Lloji i taksës	5.405	-0.495	0.926	2.151	0.022	0.000

Tabela 12: Impakti i tatimeve direkte mbi PBB-në

Ekuacioni	R ²	P-value	bo	b1	b2	b3
Linear	0.178	0.057	4.416	3.605		
Kuadratik	0.178	0.171	4.397	3.612	0.048	
Kubik	0.458	0.013	3.644	12.504	- 2. 450	- 9. 231

³³ Në nivelin 5% të rëndësisë

³⁴ Në nivelin 10 % të rëndësisë

³⁵ Vlerat në kllapa përfaqësojnë shkallët e lirisë.

³⁶ Në nivelin 5%

³⁷ Në nivelin 10%

Tabela 13: Testi për modelin ekonometrik

Model Summary^b

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.696 ^a	.485	.313	4.05408	2.876

a. Predictors: (Constant), DIFF(Etj%,1), DIFF(TI%,1), TD2, DIFF(TD%,1), TD3

b. Dependent Variable: PBB për Shqipërinë

Tabela 14: Analiza e variancës së modelit ekonometrik

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	231.897	5	46.379	2.822	.053 ^b
	Residual	246.533	15	16.436		
	Total	478.430	20			

a. Dependent Variable: PBB për Shqipërinë

b. Predictors: (Constant), DIFF(Etj%,1), DIFF(TI%,1), TD2, DIFF(TD%,1), TD3

Tabela 15: Vlerësimi i koeficientëve

Coefficients^a

Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
1 (Constant)	3.764	1.304		2.886	.011
DIFF(TD%,1)	12.550	3.511	1.469	3.575	.003
TD2	-2.778	2.296	-.252	-1.210	.245
TD3	-9.410	3.294	-1.247	-2.857	.012
DIFF(TI%,1)	-.077	.826	-.019	-.093	.927
DIFF(Etj%,1)	.583	.666	.166	.875	.395

a. Dependent Variable: PBB për Shqipërinë

Tabela 16: Rezultatet e testeve të normalitetit

Tests of Normality

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Standardized Residual	.145	21	.200*	.931	21	.141

*. This is a lower bound of the true significance.

a. Lilliefors Significance Correction

Tests of Normality

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Unstandardized Residual	.147	19	.200*	.947	19	.354

*. This is a lower bound of the true significance.

a. Lilliefors Significance Correction

Tabela 17: Rivlerësimi i modelit ekonometrik

Model Summary^b

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.482 ^a	.232	.079	2.26476	2.384

a. Predictors: (Constant), DIFF(Etj%,1), DIFF(TD%,1), DIFF(TI%,1)

b. Dependent Variable: DIFF(PBBpaoutlier,1)

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	23.272	3	7.757	1.512	.252 ^b
	Residual	76.937	15	5.129		
	Total	100.209	18			

a. Dependent Variable: DIFF(PBBpaoutlier,1)

b. Predictors: (Constant), DIFF(Etj%,1), DIFF(TD%,1), DIFF(TI%,1)

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	-.142	.574		-.248	.808
	DIFF(TD%,1)	-1.944	1.094	-.465	-1.777	.096
	DIFF(TI%,1)	.695	.648	.287	1.072	.301
	DIFF(Etj%,1)	.610	.407	.355	1.499	.155

a. Dependent Variable: DIFF(riritjapaoutlier,1)

Tabela 18: Rezultatet e testit të heteroskedasticitetit

Model Summary^b

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.506 ^a	.256	.058	1.16312	1.857

a. Predictors: (Constant), DIFF(Ilojtax,1), DIFF(TI%,1), DIFF(Etj%,1), DIFF(TD%,1)

b. Dependent Variable: u2

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	6.981	4	1.745	1.290	.318 ^b
	Residual	20.293	15	1.353		
	Total	27.273	19			

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	.932	.286		3.259	.005
	DIFF(TD%,1)	-1.097	.522	-.515	-2.099	.053
	DIFF(TI%,1)	.285	.234	.297	1.219	.242
	DIFF(Etj%,1)	.096	.189	.114	.508	.619
	DIFF(Ilojtax,1)	1.039	1.204	.194	.863	.402

Tabela 19: Vlerësimi i modelit të ndikimit të zërave të veçantë të tatimit direkt

Model Summary^b

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.614 ^a	.377	.117	2.27566	2.292

a. Predictors: (Constant), DIFF(trperq,2), DIFF(mbifitiminperq,1), DIFF(biznperq,1), DIFF(sigshoqperq,1), DIFF(pasuriperq,1)

b. Dependent Variable: DIFF(PBBpaoutlier,1)

ANOVA^a

Model	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1 Regression	37.541	5	7.508	1.450	.276 ^b
Residual	62.143	12	5.179		
Total	99.684	17			

a. Dependent Variable: DIFF(rritjapaoutlier,1)

b. Predictors: (Constant), DIFF(trperq,2), DIFF(mbifitiminperq,1), DIFF(biznperq,1), DIFF(sigshoqperq,1), DIFF(pasuriperq,1)

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	-.653	.584		-1.119	.285
	DIFF(pasuriperq,1)	-7.453	8.774	-.274	-.850	.412
	DIFF(mbifitiminperq,1)	-4.279	2.196	-.518	-1.948	.075
	DIFF(biznperq,1)	-.872	8.664	-.025	-.101	.922
	DIFF(sigshoqperq,1)	3.474	2.466	.452	1.409	.184
	DIFF(trpersonaleperq,2)	2.363	2.523	.256	.937	.367

a. Dependent Variable: DIFF(rritjapaoutlier,1)

Grafiku 30: Testet e stacionaritetit për variablat e pavarur për modelet e tjera ekonometrike




Tabela 20: Testet e modelit të katërt ekonometrik

Model Summary^b

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.677 ^a	.459	.324	19605566900.2 20	1.994

a. Predictors: (Constant), DIFF(Borxhi,1), DIFF(td,1), DIFF(Invest_Publike,1)

b. Dependent Variable: DIFF(PBB,1)

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	3912857936214 069600000.000	3	1304285978738 023200000.000	3.393	.054 ^b
	Residual	4612539041747 926000000.000	12	3843782534789 93850000.000		
	Total	8525396977961 996000000.000	15			

a. Dependent Variable: DIFF(PBB,1)

b. Predictors: (Constant), DIFF(Borxhi,1), DIFF(td,1), DIFF(Invest_Publike,1)

Coefficients^a

Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	61287709318.365		10.252	.000
	DIFF(td,1)	-4172686153.312	-.106	-.416	.068
	DIFF(Shpenzimet gjithsej,1)	.411	.496	1.925	.078
	DIFF(Borxhi,1)	-2809773767.650	-.415	-1.871	.086

a. Dependent Variable: DIFF(PBB,1)

Tabela 21: Testet e analizës faktoriale

Total Variance Explained

Component	Initial Eigenvalues			Extraction Sums of Squared Loadings		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
1	1.669	55.618	55.618	1.669	55.618	55.618
2	.741	24.694	80.312			
3	.591	19.688	100.000			

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Communalities

	Initial	Extraction
Shpenzimet gjithsej	1.000	.630
Borxhi i përgjithshëm	1.000	.546
qeveritar (si % ndaj PBB-së)	1.000	.492
td		

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Component Matrix^a

	Component
	1
Investimet publike	-.794
Borxhi i përgjithshëm	.739
qeveritar (si % ndaj PBB-së)	
Tatimi direkt	.702

Extraction Method: Principal Component Analysis.

a. 1 components extracted.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha ^a	N of Items
0.676	3

Tabela 22: Testi i korrelacionit për variablat e modelit të pestë ekonometrik

Correlations

		polfiskale	DIFF(FKBF,1)	DIFF(NX,1)
polfiskale	Pearson Correlation	1	.049	-.221
	Sig. (2-tailed)		.830	.324
	N	22	22	22
DIFF(FKBF,1)	Pearson Correlation	.049	1	-.935**
	Sig. (2-tailed)	.830		.000
	N	22	23	23
DIFF(NX,1)	Pearson Correlation	-.221	-.935**	1
	Sig. (2-tailed)	.324	.000	
	N	22	23	23

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela 23: Testet e modelit të pestë ekonometrik

Model Summary

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.993 ^a	.985	.983	19558.707

a. Predictors: (Constant), DIFF(NX,1), DIFF(Shpenzimetgjithsej,1), polfiskale

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	456077820403.110	3	152025940134.370	397.409	.000 ^b
	Residual	6885774262.344	18	382543014.575		
	Total	462963594665.455	21			

a. Dependent Variable: PBB për frymë

b. Predictors: (Constant), DIFF(NX,1), DIFF(Shpenzimetgjithsej,1), polfiskale

Coefficients^a

Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
1 (Constant)	52096.107	7907.733		6.588	.000
polfiskale	-4.993E-007	.000	-.084	-2.223	.039
DIFF(Shpenzimetgj ithsej,1)	1.395E-006	.000	.992	34.213	.000
DIFF(NX,1)	1.654E-008	.000	.005	.128	.899

a. Dependent Variable: DIFF(PBB për frymë,1)

Autocorrelations

Series: PBB për Shqipërinë

Lag	Autocorrelation	Std. Error ^a	Box-Ljung Statistic		
			Value	df	Sig. ^b
1	-.041	.199	.043	1	.837
2	-.158	.195	.699	2	.705
3	.072	.190	.842	3	.839
4	-.067	.185	.976	4	.913
5	.209	.179	2.327	5	.802
6	.026	.174	2.348	6	.885
7	-.017	.169	2.358	7	.937
8	.010	.163	2.362	8	.968
9	.024	.157	2.385	9	.984
10	-.003	.151	2.385	10	.992
11	-.115	.144	3.017	11	.991
12	.023	.138	3.044	12	.995
13	-.034	.131	3.112	13	.998
14	-.044	.123	3.240	14	.999
15	-.015	.115	3.257	15	.999
16	-.026	.107	3.318	16	1.000

a. The underlying process assumed is independence (white noise).

b. Based on the asymptotic chi-square approximation.

Autocorrelations

Series: Të ardhurat nga tatimi direkt

Lag	Autocorrelation	Std. Error ^a	Box-Ljung Statistic		
			Value	df	Sig. ^b
1	.822	.199	17.006	1	.000
2	.713	.195	30.413	2	.000
3	.588	.190	40.031	3	.000
4	.462	.185	46.301	4	.000
5	.314	.179	49.369	5	.000
6	.138	.174	50.002	6	.000
7	.014	.169	50.009	7	.000
8	-.086	.163	50.285	8	.000
9	-.175	.157	51.523	9	.000
10	-.238	.151	54.008	10	.000
11	-.329	.144	59.204	11	.000
12	-.359	.138	65.998	12	.000
13	-.365	.131	73.818	13	.000
14	-.382	.123	83.438	14	.000
15	-.390	.115	94.888	15	.000
16	-.361	.107	106.331	16	.000

a. The underlying process assumed is independence (White noise).

b. Based on the asymptotic chi-square approximation.

Autocorrelations

Series: Të ardhurat nga tatimi indirekt

Lag	Autocorrelation	Std. Error ^a	Box-Ljung Statistic		
			Value	df	Sig. ^b
1	.754	.199	14.301	1	.000
2	.631	.195	24.820	2	.000
3	.501	.190	31.782	3	.000
4	.294	.185	34.325	4	.000
5	.113	.179	34.718	5	.000
6	.093	.174	35.003	6	.000
7	-.001	.169	35.003	7	.000
8	-.017	.163	35.014	8	.000
9	-.077	.157	35.258	9	.000
10	-.147	.151	36.215	10	.000
11	-.232	.144	38.792	11	.000
12	-.316	.138	44.063	12	.000
13	-.392	.131	53.059	13	.000
14	-.386	.123	62.895	14	.000
15	-.389	.115	74.336	15	.000
16	-.332	.107	84.014	16	.000

a. The underlying process assumed is independence (white noise).

b. Based on the asymptotic chi-square approximation.

Autocorrelations

Series: Të tjera

Lag	Autocorrelation	Std. Error ^a	Box-Ljung Statistic		
			Value	df	Sig. ^b
1	.451	.199	5.112	1	.024
2	.124	.195	5.520	2	.063
3	-.004	.190	5.520	3	.137
4	.016	.185	5.528	4	.237
5	-.296	.179	8.251	5	.143
6	-.256	.174	10.416	6	.108
7	-.123	.169	10.947	7	.141
8	-.141	.163	11.697	8	.165
9	-.155	.157	12.671	9	.178
10	-.096	.151	13.077	10	.219
11	-.054	.144	13.219	11	.279
12	-.134	.138	14.162	12	.290
13	-.077	.131	14.509	13	.339
14	-.010	.123	14.515	14	.412
15	.061	.115	14.792	15	.466
16	.048	.107	14.996	16	.525

a. The underlying process assumed is independence (white noise).

b. Based on the asymptotic chi-square approximation.

Autocorrelations

Series: Standardized Residual

Lag	Autocorrelation	Std. Error ^a	Box-Ljung Statistic		
			Value	df	Sig. ^b
1	-.461	.203	5.124	1	.024
2	.015	.198	5.130	2	.077
3	-.002	.193	5.130	3	.163
4	-.007	.188	5.132	4	.274
5	.134	.182	5.673	5	.339
6	-.208	.176	7.065	6	.315
7	-.036	.170	7.109	7	.418
8	.106	.164	7.525	8	.481
9	-.123	.158	8.130	9	.521
10	.121	.151	8.772	10	.554
11	-.075	.144	9.047	11	.618
12	.041	.137	9.136	12	.691
13	.089	.129	9.615	13	.725
14	-.147	.120	11.108	14	.678
15	.305	.111	18.593	15	.233
16	-.276	.102	25.946	16	.055

a. The underlying process assumed is independence (white noise).

b. Based on the asymptotic chi-square approximation.